

EFEKTET E KRIZËS FINANCIARE GLOBALE NË EKONOMINË E KOSOVËS NË TRANZICION

Artan NIMANI

Dorëzuar:
Universitetit European të Tiranës

Shkollës Doktorale

Në përmbushje të detyrimeve të programit të Doktoratës në Shkenca Ekonomike
me profil Financa, për marrjen e gradës shkencore “Doktor”

Udhëheqës shkencor: Prof. Asoc. Dr. Elvin MEKA

Numri i fjalëve: 63 834

Tiranë, Prill 2016

DEKLARATA E AUTORËSISË

Përmes kësaj deklarate pohoj se e kam shkruar vetë këtë punim disertacioni dhe se nuk kam pranuar ndihmën e dikujt tjetër. Të gjitha fjalitë apo thëniet e personave të tjerë, janë cituar dhe janë paraqitur në fusnota si dhe në fund të disertacionit, në pjesën e literaturës dhe bibliografisë.

Ky punim nuk i është dorëzuar më parë ndonjë komisioni vlerësues në formën e njëjtë si dhe nuk është publikuar asnjëherë.

Artan NIMANI

Nënshkrimi:.....

Data:.....

ABSTRAKTI

Kriza Financiare globale nënkupton paraqitjen e problemeve financiare në ekonomi, duke e shfuqizuar potencialin ekonomik dhe financiar të vendeve të ndryshme. Krizat janë paraqitur zakonisht në vendet me sistem jo të qëndrueshëm politiko - ekonomik (të varfra) apo në ata vende ku kanë ndikuar faktor të jashtëm, ndërsa tani kemi paraqitjen e krizës në vende të pasura dhe industriale. Gjenerata jonë është dëshmitare e një prej krizave ekonomike më të madhe në histori, ku kemi parë se si falimentojnë njëri pas tjetrit institucione të mëdha financiare apo se si vepron “Efekti Domino” për të cilin deri tani kishim dëgjuar e lexuar veç nëpër tekste.

Lufta për çlirim e Kosovës (1998-1999) dhe procesi i tranzicionit politiko - ekonomik ishin sfida më vete për ekonominë e Kosovës, edhe ashtu të brishtë përballë krizës. Kosova ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme, si financiare ashtu edhe nëpër kufizime të shumta ekonomike, që i ka sjellë për shumë vite me rradhë statusi i pazgjidhur i saj. Prandaj lindja e krizës financiare e gjeti ekonominë e vendit të paqëndrueshme dhe të pafuqishme në prag Pavarësie. Kriza financiare ngadalësoi transformimin e ekonomisë së Kosovës në një ekonomi të tregut të lirë nga ajo e centralizuar, mbikqyrur dhe “ngrirë” në periudhën e administrimit të OKB-së.

Procesi i privatizimit në Kosovë është ndikuar direkt pasi kanë munguar ofertuesit seriozë nga Korporatat e fuqishme ndërkombëtare, si pasojë e krizës dhe jostabilitetit financiar global.

Kanalet kryesore përmes të cilave kriza ndikoi në ekonominë e Kosovës janë: të hyrat nga jashtë, kryesisht dërgesat e emigrantëve dhe investimet e huaja direkte të cilat u zvogëluan gjatë kësaj periudhe. Po ashtu u ndërruan format dhe llojet e dërgesave. Pra, remitencat pësuan rënie dhe një lloj informaliteti, pasi dërgesat bankare përveç që u reduktuan, ato u zëvendësuan me mallra dhe blerje të paluajtshmërive. Analiza statistikore e përdorur në këtë punim, bazohet në nga Tabela e paparashikueshmerisë(kontigjences), testit Hi - katror, metodës grafike, metodës së mesatares rrëshqitëse, metodën e trendit dhe indekseve ku argumentohen hipotezat mbi ndikimin e krizës në ekonominë e Kosovës. Analiza e serive kohore është kryer në tri dimensione: a) studimi i trendit, b) studimi i luhatjeve përmes indekseve dhe c) mesatarja rrëshqitëse.

Kriza globale financiare dhe bashkimi familjar janë faktorët kryesore të uljes në sasi të remitencave në vend. Faktorët e tjerë si: pagat e ulëta, pasiguria në punë, gjendja socio - ekonomike dhe konsumi, kanë ndikim por janë kryesisht të lidhura me krizën dhe janë derivat

i saj. Analiza që krahason se si pozicionohen remitencat kundrejt faktorëve të tjerë të krizës së IHD-ve, kursimeve, pagave, papunësisë etj., nxjerr në pah rolin e secilit indikator dhe të gjithëve së bashku në ekonominë e brendshme. Mirëpo, kjo nuk do të vlejë për investimet e huaja sepse në këto gjashtë vitet e fundit, shqetësim më i madh është rënia shumë e theksuar e sasisë së IHD-ve në Kosovë, e që është reduktuar për deri në 29 %. Kjo tregon një opsion jo fort interesant të tërheqjes së investimeve të huaja në vend dhe shfaq shenja të një ekonomie ku niveli i jetesës dhe konsumi janë të lidhura ngushtë me kontributin e diasporës, si një kategori e rëndësishme në jetën ekonomike të vendit.

Arsyet kryesore për rënien e IHD-ve kryesisht mund t'i faturohet imazhit të keq të Kosovës, të krijuar nga niveli i lartë i korrupsionit (Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit rendit Kosovën në vendin e 111-të nga 177 pozicione me një rezultat 33/100), zhvatjes, krimit të organizuar, burokracisë dhe probleme të tjera të ngjashme.

Duke marrë për bazë vitin 2008 kur edhe reflektohet kriza financiare globale në vendin tonë, kemi rënie të vazhdueshme ku mesatarja e rënieve të IHD-ve është 16.24 %, me përjashtim të vitit 2011 ku kemi një rritje të lehtë. Bazuar në keto perfundime, Institucionet e Kosovës duhet bërë përpjekje më të mëdha në përmirësimin e kushteve dhe të imazhit për rritjen e investimeve të huaja në vend dhe të sigurojnë një stabilitet politiko-ekonomik dhe ambient të favorshëm për të investuar duke krijuar një strategji kombëtare e veçantë për qytetaret në diasporë si dhe t'i informojë ata për mundësitë e investimeve në Kosovë.

Themelimi i fonde për investime nga diaspora, të cilat janë të interesuar të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit duke e koordinuar komunikimin më të mirë mes biznesmenëve që veprojnë në vende të ndryshme të botës me asociacionet e biznesit në Kosovë.

Rënia e eksporteve, të cilat edhe ashtu kishin nivel të ulët, dhe shkalla e ulët e prodhimit, ndikuan negativisht në aktivitetin ekonomik në vend dhe bënë që Kosova të ketë defiçit të lartë të bilancit tregtar.

Të ndërtohet një sistem i ri ekonomik që të japë zgjidhjet institucionale për sistemin e pavarur ekonomik të Kosovës, të bazuar në ekonominë e hapur të tregut. Ai duhet të krijojë mekanizmat nëpërmjet të cilëve bëhet rregullimi makroekonomik në kushtet e veprimit të tregut integral. Prona, privatizimi i pronës shoqërore, siguria dhe mbrojtja e saj, është po ashtu një segment i rëndësishëm që sigurohet në sistemin e ri që bazohet edhe në proceset euro-integruese deh Kosova tejkalon pasojat e krizës financiare.

Fjalët kyçe: Kriza financiare, remitenca, Kosova, BE, IHD, FMN, AKP, TRUST, BQK, BB.

ABSTRACT

The global financial crisis means the presentation of financial problems in the economy, to abolish economic and financial potential of different countries. Crises are usually present in countries with unstable political system - economic (poor) or in those countries where external factors have affected, and now we have a crisis at the rich and industrial countries. Our generation is witnessing one of the greatest economic crises in history, where we see how bankrupt one after the other large financial institutions or on how the "Domino Effect" for which so far had already heard and read the texts.

Kosovo liberation war (1998-1999) and the process of political transition - were challenge Kosovo's economy which was already fragile before it face of the crisis. Kosovo has gone through various difficulties, both financial and through many economic limitations, which has led to many years of its unresolved status. Hence the birth of the financial crisis the country's economy was unstable and weak on the eve of independence.

The financial crisis slowed economic transformation of Kosovo from a centralized into a free market economy, monitored and "frozen" in the period of UN administration.

The privatization process in Kosovo is directly affected as serious bidders were missing from powerful international corporations, as a result of the global financial crisis and instability.

The main channels through which the crisis affected the economy of Kosovo, revenues from abroad, mainly remittances and foreign direct investments which decreased during this period. They were also changed format and types of deliveries. So, remittances declined and a kind of informality, as deliveries were reduced bank besides, they were replaced by goods and purchase of real estates. The statistical analysis used in this paper, based on the contingency table, test Hi - square, graphic method, sliding average method, the method of trend and indices which argued hypotheses about the impact of the crisis on the economy. Time series analysis is performed in three dimensions: a) the study of the trend, b) study of fluctuations through indexes and c) moving average.

The global financial crisis and family reunification are the main factors reducing the amount of remittances in the country. Other factors such as low wages, job insecurity, socio-economic and consumption have an impact but are mainly related to the crisis and are derivative thereof. The analysis compares how remittances position versus other factors FDI crisis, savings, wages, unemployment, etc., Highlights the role of each indicator and all together in the

domestic economy. However, this does not apply to foreign investment For the past six years, the biggest concern is more pronounced decline in the amount of FDI in Kosovo, which is reduced to 29%. This shows a not very interesting option of attracting foreign investment in the country and the economy shows signs where the standard of living and consumption are closely related to the contribution of the Diaspora as an important category in the economic life of the country.

The main reasons for the decline in FDI can be largely billed bad image of Kosovo, created by high levels of corruption (Corruption Perception Index ranked Kosovo in the 111th place out of 177 positions with a result 33 / 100), extortion, organized crime, bureaucracy and other similar problems.

Taking into account also reflected in 2008 when the global financial crisis in our country, continued to decline where the average FDI downturns is 16:24%, with the exception of 2011, which have increased slightly. Based on these conclusions, Kosovo institutions should make greater efforts to improve conditions and image to increase foreign investment in the country and ensure a stable political and economic environment conducive to investment by establishing a national strategy special for citizens in the Diaspora as well as inform them about investment opportunities in Kosovo.

The establishment of investment funds from abroad, which are interested in contributing to the economic development of the country to coordinate better communication between businessmen operating in different countries of the world with business associations in Kosovo.

The decline in exports, which already had low levels, and low levels of production, negatively affected economic activity in the country and Kosovo have led to high deficit of trade balance. To build a new economic system to provide institutional solutions for independent economic system of Kosovo, based on an open market economy. It should establish mechanisms through which is adjusted macroeconomic market conditions integral action. Property, property privatization of social security and its protection is also an important segment to ensure that the new system is based on the Euro-integration processes Kosovo drunk exceeds the consequences of the financial crisis.

Key words: Financial crisis, remittances, Kosovo, EU, FDI, IMF, AKP, TRUST, FDI, WB.

FALENDERIME

Me shumë kënaqësi, dua të shpreh falënderimet e mia të sinqerta, për të gjithë ata që më ndihmuan me konsulta dhe për ata që mbështetën moralisht gjatë realizimit të kësaj teme disertacioni.

Fillimisht falënderoj Udhëheqësin Shkencor të këtij disertacioni Prof. Asoc. Dr. Elvin Meken, i cili me kontributin e tij shkencor dhe metodik, më ka qëndruar pranë, më ka mbështetur dhe përcjellë gjatë gjithë punës sime; veçanërisht vlen të theksohet komunikimi i tij në ditët e punimit të doktoratës, ku për çdo pjesë të punimit është treguar i gatshëm të japë kontributin e tij konkret, gjë që për mua ishte tejet e rëndësishme. Por, edhe në momentin kur përfundova punimin, kuptova se pa ndihmën e tij të domosdoshme, ky punim do të ishte thuajse i pamundur.

Falënderime shkojnë për të gjithë kolegët e mi, të cilët direkt ose indirekt janë bërë pjesë e punës sime disavjeçare për realizimin e këtij punimi.

UET si dritare e dijes dhe e shkencës, meriton një urim të veçantë për punën, korrektësinë dhe komunikimin profesional me mua.

Falënderime të veçanta po ashtu i takojnë familjes sime, prindërve, bashkëshortes dhe vajzave Edra dhe Evë, që me durim e përkushtim më kanë kuptuar, nxitur, ndihmuar e më kanë ndenjor pranë në ditët e gjata të punës për hulumtimin dhe përfundimin e kësaj teme.

Respekt për Ju miq dhe lexues!

Artan NIMANI

PËRMBAJTJA E PUNIMIT

LISTA E TABELAVE.....	12
LISTA E FIGURAVE.....	14
LISTA E GRAFIKËVE	15
LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT	17

KAPITULLI I PARË

1. HYRJE	20
1.1. Qëllimi i studimit	22
1.2. Objektivat	22
1.3. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë.....	23
1.4. Metodologjia	24
1.5. Shpjegime të shkurtëra mbi strukturën e punimit	25
1.6. Kufizimet e punimit	27

KAPITULLI I DYTË

2. RISHIKIM I LITERATURËS RRETH KRIZËS EKONOMIKE DHE FINANCIARE

GAJBALE.....	28
2.1. Historiku i krizave.....	28
2.2. Përkufizimet mbi krizën financiare.....	29
2.3. Tipet e krizave financiare.....	32
2.4. Kriza e kredive hipotekare nënstandarde	33
2.5. Paraqitja e krizës financiare globale	36
2.6. Përhapja e krizës ekonomike në Evropë	41
2.6.1. Europa e bashkuar dhe kriza ekonomike	47
2.6.2. Nga kriza financiare te kriza ekonomike	48
2.6.3. Nga kriza ekonomike te kriza sociale dhe politike	49
2.6.4. Euro dhe Bashkimi European	50
2.6.5. Qytetarët e BE-së duan të drejta vendimmarrëse.....	51
2.6.6. Modeli gjerman i suksesit antikrizë	52
2.7. Iniciativat për përballimin e krizës	53

2.7.1. Koordinimi ndërkombëtar dhe implikimi i organizatave ndërkombëtare financiare në krizën globale	56
2.7.2. Fondi Monetar Ndërkombëtar - FMN.....	58
2.7.3. Grupi i të 20-ve, G 20	60

KAPITULLI I TRETË

3. TRANZICIONI DHE EFEKTET E	62
KRIZËS FINANCIARE GLOBALE NË EKONOMINË E KOSOVËS	62
3.1. Ekonomia e Kosovës - tranzicioni dhe kriza	62
3.2. Ekonomia e Kosovës nën administrimin ish Jugosllavisë	68
3.3. Zhvillimi ekonomik i Kosovës në periudhën e pasluftës (1999)	69
3.4. Kosova dhe rezistenca e saj ndaj krizës	71
3.5. Prirjet e zhvillimit ekonomik në Kosovës.....	77
3.6. Specifikat e tranzicionit dhe privatizimit në Kosovë	84
3.7. Orientimi për rregullimin makroekonomik në fazën e tranzicionit në Kosovë	87
3.8. Ndikimi i krizës globale në burimet e financimit në Kosovë	89
3.9. Identifikimi i barrierave kryesore dhe ndikimi i tyre në burimet e financimit	91
3.10. Pasojat e normave të larta të interesit	91
3.11. Mundësitë e financimit të bizneseve në Kosovë.....	93
3.12. Kushtet ekonomike të kredive në fillimet e krizës.....	93
3.13. Bizneset përballë krizës	94
3.14. Efektet e krizës globale në bizneset private në Kosovë	95
3.15. Kriza globale financiare dhe ndikimi i saj në bizneset në Kosovë	96
3.15.1. Hulumtimi mbi ndikimin e krizës në biznese.....	98
3.16. Kriza globale dhe sektori bankar i Kosovës	109
3.17. Qëndrueshmëria e sistemit bankar në Kosovë dhe BE.....	113

KAPITULLI I KATËRT

4. NGECJET EKONOMIKE NË KOSOVË, SI PASOJË E KRIZËS FINANCIARE	119
4.1. Rritja e ngadalshme dhe kriza	119
4.1.1. Pasqyra ekonomike e Kosovës.....	121
4.2. Ndikimi i krizës në financat e Kosovës.....	129

4.3.	Rritja më e ngadalësuar e eksporteve	132
4.4.	Remitenat dhe investimet e huaja direkte.....	134
4.4.1.	Remitenat dhe ecuria e tyre gjatë krizës	134
4.4.2.	Hulumtimi mbi remitenat	138
4.4.3.	Investimet e huaja direkte dhe Kosova	144
4.4.4.	Përfitimet nga IHD-ja në vendin mikpritës.....	151
4.4.5.	Anët negative të IHD-ve në vendin mikpritës	155
4.4.6.	Përfitimet dhe humbjet e vendit të origjinës nga IHD-ja.....	156
4.4.7.	Investimet e huaja direkte në Kosovë dhe në Europën Juglindore	157
4.5.	Investimet në Kosovë	160
4.5.1.	Sektorë kyç të ekonomisë së Kosovës	162
4.5.3.	Investimet e huaja direkte në Kosovë gjatë viteve të fundit	164
4.6.	Raporti i investime të huaja direkte dhe remitenave në Kosovë	165
4.7.	Raporti i investimeve të huaja direkte sipas sektorëve ekonomikë.....	169
4.7.1.	Investimet e Huaja Direkte në Kosovë sipas sektorëve ekonomikë në vitet e krizës	170
4.7.	Masat shtrënguese në ekonomi	172
4.8.	Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës.....	175
4.8.1.	Sistemet pensionale në Kosovë.....	177
4.8.2.	Kriza financiare globale dhe TRUSTI	178
4.8.3.	Performanca e instrumenteve të TRUSTI-t	180
4.9.	Performanca e menaxhuesve të mjeteve dhe investimet e Trustit gjatë krizës	180
4.9.1.	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës gjatë krizës	182

KAPITULLI I PESTË

5. TEJKALIMI I KRIZËS FINANCIARE DHE MUNDËSITË PËR ZHVILLIM

EKONOMIK NË KOSOVË	186
5.1. Dalja nga kriza financiare	187
5.2. Krijimi i kushteve për tërheqjen e investimeve të huaja	190
5.3. Eliminimi i barrierave ekonomike	192
5.4. Procesi i stabilizim - asociimit, Kosova dhe mekanizmi përcjellës i stabilizim asociimit (MPSA)	193

5.5. Kriza globale financiare dhe dalja nga ajo	196
KAPITULLI I GJASHTË	
ANALIZA, DISKUTIME, KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	199
6. Analiza statistikore e efekteve të krizës në Kosovë.....	199
6.1. Diskutim mbi gjetjet kryesore	218
6.2. Kontributet e studimit - Konkluzionet	220
6.3. Rekomandime.....	222
6.4. Fusha për kërkime të mëtejshme	224
BIBLIOGRAFIA	225
Literatura.....	225
Publikime shkencore dhe raporte.....	226
Webfaqe dhe burime tjera.....	228
ANEKSI 1	
NDIKIMI I KRIZËS FINANCIARE GLOBALE, E PARAQITUR PËRMES GRAFEVE.....	232
A.1.1. Ndikimi i krizës financiare globale në vendet në zhvillim	232
A.1.2. Ndikimi i krizës financiare në Kosovë.....	233
A 1.3. Diagrami i funksionimit të remitencave.....	234
ANEKSI 2	235
EFEKTI I KRIZAVE FINANCIARE GLOBALE NË BIZNESET EKONOMIKE NË KOSOVË	235
2.1. PYETËSORI	235
ANEKSI 3	239
A3.1 Baza e të dhënave mbi pyetsorin e Remitancave	239
A 3.2. Baza e të dhënave të sondazhit mbi krizës.....	240
VËREJTJET APO SUGJERIMET TUAJA	241

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Bruto Produkti Vendor 2004 - 2014	70
Tabela 2. Rezultatet e pyetësorit mbi remitencat	78
Tabela 3. Indikatorët kryesorë Makroekonomikë 2008 - 2013.....	79
Tabela 4. Treguesit kyç të tregut të punës, përqindjet (2004 - 2008)	81
Tabela 5. Problemet kryesore me të cilët përballet Kosova.....	82
Tabela 6. Treguesit e përzgjedhur makroekonomikë.....	83
Tabela 7. Ndikimi i krizës në numrin e punëtorëve në vitet 2008 - 2012.....	97
Tabela 8. Cila është pozita në kompaninë ku punoni?.....	99
Tabela 9. Niveli i kualifikimit tuaj.....	99
Tabela 10. Faktorët e qeverisjes së kompanisë.....	100
Tabela 11. A i shton vlerë organizatës sistemi i qeverisjes së kompanisë?	101
Tabela 12. Parandalimi dhe përballja me krizat.....	102
Tabela 13. Kriza të zakonshme të qeverisjes së korporatave.....	103
Tabela 14. Pengesa e vendimmarrjes së shëndoshë.....	104
Tabela 15. Shenjat paralajmëruese të krizës	105
Tabela 16. Nga kush përbëhet skuadra për krizën?	107
Tabela 17. Struktura e aseteve të sistemit bankar në Kosovë	110
Tabela 18. Institucionet financiare në Kosovë.....	110
Tabela 19. Përmbledhje e rezultateve të stress testit: Rreziku i likuiditetit.....	117
Tabela 20. Norma e rritjes së PBB - së reale në vendet e Ballkanit Perëndimor.....	121
Tabela 21. Krahësimi i treguesve të zhvillimit ekonomik - socialë në Kosovë.....	128
Tabela 22. Partnerët tregtarë të Kosovës në eksport.....	134
Tabela 23. Partnerët tregtarë të Kosovës në import.....	134
Tabela 24. Eksporti i Kosovës në rajon (2008 - 2012)	134
Tabela 25. Vendet nga vijnë remitencat në Kosovë	136
Tabela 26. Tabela e pyetjeve bazë mbi remitencat	139
Tabela 27. Faktorët që ndikuan në uljen e remitencave.....	143
Tabela 28. Partnerët kryesorë të Kosovës në eksport dhe import gjatë vitit 2013.....	158
Tabela 29. Investimet (IHD) në Kosovë nga vendet e origjinës.....	159
Tabela 30. Shpërndarja e kompanive të huaja investuese sipas sek të ekon në Kosovë.....	162

Tabela 31. Investimet e Huaja Direkte në Kosovë në vitet 2008 - 2013	165
Tabela 32. Llogaritja e Trendit Lineare IHD në Kosovë në vitet 2008 -2013.....	166
Tabela 33. Remitanca në Kosovë në vitet 2008 - 2013	168
Tabela 34. Llogaritja e trendit linear, remitenca në Kosovë në vitet 2008 -2013.	168
Tabela 35. Investimet e Huaja Direkte në Kosovë sipas sek. ekon. viteve 2007 - 2013	170
Tabela 36. Të dhënat numerike mbi arsyet e rënies së remitencave.....	201
Tabela 37. Të dhënat në përqindje mbi arsyet e rënies së remitencave	201
Tabela 38. Frekuencat e lidhjes së sasisë së remitencave me krizën	202
Tabela 39. Pavarësia statistikore e paparashikueshmerisë.....	203
Tabela 40. Tabela e paparashikueshmerisë që vërteton trajtën 2 x 3.....	203
Tabela 41. Tabela e paparashikueshmerisë që vërteton trajtën 2 x 4.....	204
Tabela 42. Frekuenca e lidhjes së sasisë së remitencave me shkaqet	205
Tabela 43. Tabela e paparashikueshmerisë 2 x 2, “shkaqet” në dy modalitetet	205
Tabela 44. Paparashikueshmeria dhe rezultatet e shkakut kyç.	206
Tabela 45. Tabela e llogaritjes përmes mesatares rrëshqitëse	207
Tabela 46. Remitencat në Kosovë në vitet 2008 - 2013. Vlera në milionë euro	209
Tabela 47. Llogaritja e trendit linear. Remitenca në Kosovë në vitet 2008 -2013	209
Tabela 48. Tabela e llogaritjes përmes mesatares rrëshqitëse për IHD	212
Tabela 49. Treguesit absolutë të variacionit për IHD-të në Kosovë në miliona euro.....	214
Tabela 50. Indeksi i vlerës së investimeve (viti 2008 është vit bazë).....	216

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Diagram i ndikimit të krizës globale financiare në Kosovë	21
Figura 2. Anatomia e krizës financiare, përhapja e pasigurisë Knightian	38
Figura 3. Ndikimi i krizës financiare në vendet në zhvillim.....	40
Figura 4. Diagrami i funksionimit të remitencave	143

LISTA E GRAFIKËVE

Grafiku 1. Inflacioni në rajon (mesatarja për vitet 2008 - 2012)	75
Grafiku 2. Kreditë sipas sektorëve ekonomikë	92
Grafiku 3. Ndikimi i krizës në numrin e punëtorëve në vitet 2008 - 2012	97
Grafiku 4. Cila është pozita në kompaninë ku punoni.....	99
Grafiku 5. Niveli i kualifikimit	100
Grafiku 6. Faktorët e qeverisjes së kompanisë	100
Grafiku 7. A i shton vlerë organizatës sistemi i qeverisjes së kompanisë	101
Grafiku 8. Parandalimi dhe përballja me krizat	102
Grafiku 9. Kriza të zakonshme të qeverisjes së korporatave	103
Grafiku 10. Pengesat e vendimmarrjes së shëndoshë	104
Grafiku 11. Shenjat paralajmëruese të krizës	105
Grafiku 12. Nëse perceptoni apo realisht jeni në krizë, cilat hapa do t'i ndërmerrni	106
Grafiku 13. Nga kush përbëhet skuadra përgjegjëse për krizën	107
Grafiku 14. Rritja reale e PBB - së	120
Grafiku 15. Rritja reale e PBB-së	124
Grafiku 16. BPV për frymë (Euro)	125
Grafiku 17. Norma vjetore e çmimeve të konsumit, importit dhe prodhimit	126
Grafiku 18. Rritja reale ekonomike	131
Grafiku 19. Pranimi i dërgesave të emigrantëve në milionë euro.....	137
Grafiku 20. Pranimi i remitencave nga bashkëkombasit që punojnë jashtë vendit	140
Grafiku 21. Prej kujt vijnë remitencat.....	140
Grafiku 22. Shuma e remitencave të pranuar në muaj	141
Grafiku 23. Si ju vijnë remitencat.....	141
Grafiku 24. Për çfarë përdoren remitencat e marra.....	142
Grafiku 25. A ka ndikuar kriza financiare në shumën e remitencave të marra	142
Grafiku 26. Cilët faktorë mendon që kanë ndikuar në uljen e remitencave	143
Grafiku 27. Struktura e IHD-ve sipas shteteve kryesore, në përqindje	147
Grafiku 28. Investimet e huaja direkte në Kosovë gjatë viteve 2008 - 2013.....	165
Grafiku 29. Investimet e huaja direkte në Kosovë në vitet 2008 - 2013	167
Grafiku 30. Paraqitja grafike e Remitencave në Kosovë 2008 - 2013.....	168

Grafiku 31. Diagrami i pranimi të remitancave gjatë viteve 2008 - 2013	169
Grafiku 32. Investimet e huaja direkte në Kosovë sipas sektorëve ekonomikë 2013.....	171
Grafiku 33. Performanca komulative e Trustit nga themelimi	184
Grafiku 34. Investimet e mjeteve në tremujorin e parë të vitit 2011	184
Grafiku 35. Të dhënat numerike mbi arsyet e rënies së remitancave	201
Grafiku 36. Të dhënat në përqindje mbi arsyet e rënies së remitancave	202
Grafiku 37. Frekuencat e lidhjes së sasisë së remitancave me krizën	202
Grafiku 38. Diagrami i pranimi të remitancave 2008-2013.....	210
Grafiku 39. IHD në Kosovë gjatë kohës së krizës globale financiare	213

LISTA E SHKURTIMEVE DHE E FJALORIT

AER	Agjencia Evropiane për Rindërtim
AQBK	Autoriteti Qendror Bankar i Kosovës
AJN	Mjetet e Jashtme Neto
ANE	Agjencia Ndërkombëtare e Energjisë
AKP	Agjencia Kosovare e Privatizimit
BE	Bashkimi Evropian
BB	Banka Botërore
BEC	Kategoritë Kryesore Ekonomike (<i>angl. Broad Economic Categories</i>)
BPK	Banka e Përlllogaritjes Kombëtare
BRSA	Agjencia e Mbikëqyrjes dhe Rregullimit të Bankave në Turqi
BaFin	Agjencia Federale e Mbikëqyrjes Financiare në Gjermani
BIS	Banka për Përlllogaritjen Ndërkombëtare
BE	Bashkimi Evropian
BQE	Banka Qendrore Evropiane
BQK	Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
BSH	Banka e Shqipërisë
CARDS	Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim
CEFTA	Marrëveshja e Tregtisë së Lirë me Shtetet e Evropës Juglindore
CDS	Credit Default Swap
ESK	Enti i Statistikave të Kosovës

EJL	Evropa Juglindore
FED	Rezerva Federale
FMA	Mbikëqyrje Financiare në Austri
FMN	Fondi Monetar Ndërkombëtar
FP	Fondet Pensionale
GDP	Bruto Produkti Shoqëror
IHD	Investimet e Huaja Direkte
CIP	Indeksi i Çmimeve të Konsumit (<i>shqip: IÇK</i>)
IPA	Instrumenti Para Anëtarësimit
IPI	Indeksi i Çmimeve të Importit (<i>angl.: Import Price Index</i>)
KE	Këshilli Evropian
MEF	Ministria e Ekonomisë dhe e Financave
MFSM	Manuali i Statistikave Monetare dhe Financiare
MPMS	Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale
MTI	Ministria e Tregtis dhe Industrisë
NASDAQ	Sistemi i Kuotimeve automatike të letrave me vlerë të Shoqatës Kombëtare të Ndërmjetësve
OKB	Organizata e Kombeve të Bashkuara
OB	Organizata Buxhetore
PBB	Produkti i Brendshëm Bruto
RNK	Raporti i Normave të Interesit
RNK	Raporti i Normave të Interesit

RSB	Raporti Statistikor Bankar
SNA	Sistemi i Llogarive Kombëtare i Kombeve të Bashkuara
ShPP	Shërbimi Publik për Punësim
TKPK	Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës
TVSH	Tatimi mbi Vlerën e Shtuar
UNDP	Programi për Zhvillim i Kombeve të Bashkuara
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

KAPITULLI I PARË

1. HYRJE

Sistemi financiar ekonomik botëror gjatë vitit 2008 u përfshi në një turbullirë e cila kushtëzuar nga shkalla e globalizmit dhe integritet financiar aktual, dha efektin e saj në mënyra të ndryshme, në shumicën e vendeve të botës. Efekti i parë i kësaj krize përfshiu tregjet financiare në vendet më të zhvilluara të rruzullit. Ndërsa efekti i dytë dha ndikimin e saj në treguesit e ekonomisë reale, si në vendet e zhvilluara, ashtu edhe në vendet në zhvillim e sipër apo në vendet e varfëra.

Ekonomitë e industrializuara u përballën me goditje me ndikim negativ si nga kahu i kërkesës, ashtu edhe nga ai i ofertës. Rënia e vazhdueshme e vlerës së mjeteve financiare dhe e çmimit të banesave, ndikoi në fuqinë blerëse dhe investuese të familjeve. Humbja e besimit u reflektua te konsumatorët, të cilët duke qenë përpara një situatë të tensionuar financiare, filluan të jepnin shenja frenimi në konsum dhe në ulje të kërkesës për kredi të reja.

Avancimi i krizës ndikoi në rritjen e kostos së financimit dhe shtrëngimin e shkëmbimeve në tregjet financiare. Problemet me likuiditetin në tregun bankar u thelluan duke goditur institucionet që financoheshin kryesisht në tregun monetar. Gjatë kësaj krize, sistemi financiar u dobësua nga humbjet e mëdha që rregjistruan bankat në bilancet e tyre. Përqindja e kredive me probleme në portofolet e bankave, shënoi rritje.

Tema që trajtohet gjerë e gjatë në këtë punim, për objekt studimi ka efektet e krizës globale në ekonominë e Kosovës. Gjatë shtjellimit të saj janë paraqitur disa çështje themelore lidhur me krizën globale, si dhe ndikimi i krizës në ekonominë e Kosovës. Interes i veçantë i kushtohet mënyrës së reflektimit të krizës në treguesit realë të këtyre ekonomive si dhe lëvizjet fiskale, monetare apo operationale të institucioneve përkatëse, sipas profilit ekonomik të secilit vend; më tej vazhdohet me njohjen dhe analizimin e faktorëve dhe shkaqeve që ka sjellë një krizë ekonomike globale, analizimin e krizës ekonomike dhe financiare që është paraqitur në ekonominë e Kosovës.


Cilat janë pasojat dhe çfarë duhet të bëjmë ne për të tejkaluar këtë krizë, cilat janë mundësitë dhe metodat për krijimin e një ekonomie funksionale dhe të qëndrueshme?

Së pari duhet nisur nga ndryshimi i politikave ekonomike, siç janë politikat fiskale, të cilat kanë rëndësi të veçantë për zhvillimin ekonomik të një vendi. Politikat ekonomike duhet të jenë në favor të bërjes biznes, në favor të prodhuesve vendorë, në favor të investitorëve të jashtëm. Vetëm në këtë mënyrë mund të tërheqim investues të huaj në Kosovë sepse vendi ynë ka tepër nevojë për këto investime, të cilat do të ofrojnë më shumë mundësi për punësim.

Aktualiteti dhe arsyeshmëria e këtij punimi ka të bëjë padyshim me vërtetimin se kriza e ka prekur edhe ekonominë e Kosovës. Në fakt këtu flitet për thellimin e krizës, sepse vendi ynë veç ka qenë në krizë prej shumë vitesh më rradhë. Kosova nuk ka zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, ka papunësi të lartë në vend, ka rënie të remitencave, po ashtu ka mungesë të investimeve të huaja direkte.

Modeli është ndërtuar duke u bazuar kryesisht në rezultatet e arritura nga ky disertacion, e që janë refleksionet e krizës financiare në ekonominë e Kosovës, vend i cili ndodhet ende në procesin e tranzicionit.

Figura 1. Diagram i ndikimit të krizës globale financiare në Kosovë¹



¹ Modeli i ndërtuar nga autori, duke u bazuar në rrezultatet e nxerrura nga ky disertacion.

1.1. Qëllimi i studimit

Qëllimi i këtij disertacioni është analiza e efekteve të krizës financiare globale në ekonominë kosovare në tranzicion, identifikimi i nevojave që duhet të plotësojë ekonomia jonë si një ekonomi jo e zhvilluar, si një ekonomi e dalë nga lufta. Kriza financiare ka prekur disa segmentë të ndërlidhur me ekonominë e huaja, që direkt apo indirekt kanë ndikim në ekonominë e Kosovës. Synim në këtë punim është që të nxjerr disa rekomandime të qarta për rrugët dhe drejtimet që duhet të ndjekin sektorët e prekur nga kriza dhe po ashtu rekomandime për tërë ekonominë e brishtë e në tranzicion të Kosovës.

1.2. Objektivat

Ky disertacion synon të paraqesë krizën e viteve 2008 - 2009 si krizë globale ekonomiko - financiare, të analizojë shkaqet dhe pasojat e saj globalisht, etapat nëpër të cilat kaloi zhvillimi i saj, si dhe ta krahasojë atë me krizat e mëparshme, duke u orientuar kryesisht në ndikimin që ka pasur në ekonominë e Kosovës.

Gjenerata jonë është dëshmitare e një prej krizave ekonomike më të mëdha në histori. Të gjithë jemi dëshmitarë dhe kemi parë sesi bien njëri pas tjetrit institucione të mëdha financiare, apo se si materializohet “Efekti domino” për të cilin deri tani kishim dëgjuar e lexuar veç në tekste. Këto dy vitet e fundit, kemi parë sesi paniku mund të pushtojë sistemin financiar global dhe të kërcënojë atë stabilitet global që janë dashur vite e dekada për ta krijuar. Tranzicioni në Kosovë dhe procesi i privatizimit, i ndikuar direkt në ngecjen ekonomike, pasi që vetë ofertat gjatë procesit ishin më të reduktuara, si pasojë e krizës në korporatat botërore.

Në mënyrë të përmbledhur, objektivat e tezës janë: Analiza e origjinës dhe e shkaqeve të krizës, kronologjia e tipareve të saj; dallimi ndërmjet fazave të ndryshme nëpër të cilat kaloi kriza financiare dhe pasojat e saj për pjesëmarrësit kryesorë të sistemit financiar global; masat e marra nga qeveritë dhe bankat qendrore globalisht, efektiviteti i tyre në luftën kundër krizës; ndikimi i saj në ekonominë e Kosovës në tranzicion e veçmas në procesin e privatizimit; analiza e ndikimit të krizës në remitenca dhe në investimet e huaja direkte në Kosovë.

1.3. Pyetjet kërkimore dhe hipotezat bazë

Ky disertacion përmban në vetvete pesë pyetje kërkimore dhe dy hipoteza, ku është vërtetuar ndikimi real i krizës dhe efektet e saj në ekonominë e Kosovës në tranzicion.

Pyetjet:

P1. A është prekur ekonomia e Kosovës nga kriza globale financiare?

P2. Sa dhe si janë prekur bizneset në Kosovë nga kriza globale financiare?

P3. A ka ndikuar kriza në remitencat dhe në investimet e huaja direkte?

P4. Sa ka ndikuar Kriza në procesin e privatizimit dhe në fondin e Trustit?

P5. A ka arritur Kosova të tejkalojë krizën financiare dhe pasojat e saj?

Hipotezat:

H1. Kriza financiare globale ka prekur Kosovën, ka ngadalësuar remitencat dhe ka ndikuar direkt në uljen e investimeve të huaja direkte në Kosovë.

H2. Kriza financiare globale ka ndikuar drejtpërdrejtë në procesin e privatizimit dhe në tranzicionin e ngadaltë të ekonomisë së Kosovës.

“Kriza financiare globale” është një përkeqësim i mprehtë i një sërë treguesish financiarë dhe ekonomikë, si p.sh.: rritja ekonomike, disbalanca mes ofertës dhe kërkesës për para, rënia e çmimeve të aktiveve e cila mund të shoqërohet edhe me falimente të institucioneve financiare si: bankat, fondet e përbashkëta dhe fondet e investimeve, por edhe falimentim të institucioneve jofinanciare. Me “*remitenca*” kuptojmë që ato janë pagesa të rregullta të emigrantëve (punëtorët të cilët dërgojnë pará në familjet e tyre në vendin e origjinës). Me “*Investimet e Huaja Direkte*” kuptojmë një fenomen relativisht të ri, i cili lindi për të financuar zhvillimin ekonomik në vende të ndryshme, si dhe në formën e pronësisë mbi aktivet financiare. IHD-ve konsiderohen si një faktor i rëndësishëm për vendet në zhvillim në kushtet e globalitetit si dhe impakt direkt apo indirekt që kanë në ekonominë e Kosovës. Ndërsa me “*procesin e privatizimit*” nënkuptojmë ndërrimin e pronarëve të ndërmarrjeve shoqërore, të cilat AKP-ja ia shet investitorëve privatë aksionet e Ndërmarrjes së Re që ajo i mban në

mirëbesim. Këta investitorë mund të jenë vendas dhe të huaj. Të ardhurat do të mbahen në mirëbesim nga ana e AKP-së, pa paragjykuar pronësinë ose pretendimet e kreditorit ndaj ndërmarrjes së vjetër.

1.4. Metodologjia

Ky punim bazohet në literaturë të gjerë teorike dhe vrojtime praktike të viteve të fundit. Ndikimi i madh i krizës në nivel global ka bërë që të ketë literaturë të konsiderueshme, duke më mundësuar që të mbështetem në burime të shumta dhe të shumëllojshme. Shfrytëzimi i publikimeve të rëndësishme nga institucione prestigjioze, si: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar apo BERZH, të njohura globalisht për seriozitetin dhe shumëllojshmërinë e materialeve kërkimore, ka mundësuar të kem edhe krahasime relevante. Ndërsa për të bërë gjetjet dhe krahasimet rreth ndikimit të saj në Kosovë, kam vizituar, shfletuar dhe bazuar në materialet e ofruara nga Raportet e Bankës Qendrore të Kosovës, Ministra e Financave, ASK, ATK, Trusti, institucionet e ndryshme akademike në Kosovë dhe atyre që kanë shkruar për krizën dhe Kosovën.

Përpunimi i informatave të dala nga anketimi dhe intervistat me biznese, qytetarë dhe anketimi i institucioneve ekonomiko - financiare të Kosovës, ishin një burim i fuqishëm ku kam bazuar metodologjinë kërkimore dhe rezultatet për të vërtetuar hipotezën se edhe Kosova është prekur nga kriza globale financiare, dhe bile kjo ka ndodhur në disa fusha.

Realizimi i pyetësorëve është bërë në metodën e intervistave direkt sy me sy (face to face) me pronarët, menaxherët e ndërmarrjeve, ku secila përgjigje është shënuar në pyetësor. Bizneset që janë analizuar në këtë punim përbëjnë rreth 50 % të xhiros në vend.

Baza e të dhënave është dizajnuar mbi bazën e Microsoft Office Excelme metodën Likert.

Raportet e The World Bank dhe “Stres Testi” i sistemit bankar në Europë dhe ai në Kosovë, kanë nxjerrë disa rekomandime të fuqishme që mund t’i llogarisim si rezultat domethënës në këtë disertacion.

Efektet në aktivitetin ekonomik të Kosovës nga tronditjet në vendet pritëse të diasporës, vlerësohen duke përdorur një model të korigjimit të gabimit të vektorit (VECM), ku sqarohen remitencat dhe rrjedha e tyre ndër vite.

Përmes metodës së trendit linear ($y_c = a + bx$) kam nxjerrë rezultatet e kërkuara të cilat vërtetojnë H1 dhe H2. Çdo lloj analize e bërë këtu, përmban idetë dhe mendimet e autorëve, strukturuar dhe harmonizuar më objektivat e këtij punimi. Ajo bazohet në të gjetjet pas hulumtimeve dhe përpunimit të tyre me programe statistikore, gjë e cila ka mundësuar që të kem të dhëna më të sakta. Pa diskutim që punimi ka edhe kufizimet e veta, diktuar nga fakti se janë prekur ato çështje që janë konsideruar më të rëndësishmet. Jam i ndërgjegjshëm se ka vend për zgjerime dhe përmirësime të mëtejshme, por e konsideroj këtë punim si një hap solid në analizimin e njërës prej shqetësimeve kryesore të këtij fillimshekulli.

1.5. Shpjegime të shkurtëra mbi strukturën e punimit

Punimi është strukturuar sipas standardeve të përcaktuara. Ai ndahet në shtjellimin bazë të literaturës dhe analizave të nxjerra nga hulumtimet e bëra për këtë temë. Punimi është ndërtuar mbi pesë kapituj, duke mos llogaritur pjesën hyrëse dhe përfundimtare të tij, ku janë paraqitur përfundimet dhe rekomandimet e dala nga studimi. Në temë po ashtu, me qëllim të ilustrimit sa më adekuat, janë ndërtuar: 35 tabela, 33 grafe dhe 4 figura sqaruese.

Në Kapitullin e parë trajtohen elementet përbërëse të temës, ku vend meritohet zënë hipotezat, pyetjet, fjalorthi dhe pjesa hyrëse e punimit, duke pretenduar që sqarohet elementi bazë i punimit në tërësi.

Në Kapitullin e dytë trajtohet kronologjia e krizave ekonomike dhe financiare gjatë historisë, tipet, format dhe indikatorët e krizës. Në këtë kapitull paraqitet ekspozita e ndikimit të krizës në Eurozonë dhe përhapja e saj në vendet e tjera. Po ashtu, këtu trajtohen dhe analizohen më kujdes nismat për tejkalimin e krizës, masat konkrete të marra nga vendet e Eurozonës dhe ato me ndikim më të lartë të krizës. Përballimin e krizës nga vendet e fuqishme ekonomike dhe pasojat e saj, ne i nxjerrim si mësim për një kohë tjetër në të ardhmen. Modeli gjerman i suksesit në tejkalimin e krizës, zë një vend të rëndësishëm në këtë punim. Po ashtu, në të paraqes qëndrimet dhe vendimet e FMN-së dhe të G-20 në përpjekjet e tyre për tejkalimin e krizës.

Në Kapitullin e tretë trajtohet ekonomia e Kosovës si element bazë i temës, duke paraqitur një kronologji të ngjarjeve dhe indikatorëve ekonomikë që nga paslufta e dytë botërore, për të

ardhur deri tek ditët e sotme, por gjithsesi një vështrim hidhet edhe në kohën e okupimit dhe administrimit të Kosovës nga UN. Tranzicioni ekonomik, apo thënë ndryshek alimi nga ekonomia e centralizuar në ekonominë e lirë të tregut në Kosovë, ishte pak më i vështirë se vendet e tjera sepse kishim edhe luftën për liri. Kjo etapë në këtë punim shpjegohet qartë dhe me plot argumente. Këtu paraqiten hapat, politikat, specifikat dhe projektet konkrete në procesin e transformimit të ekonomisë dhe procesin e privatizimit në Kosovë. Nuk mungon të trajtohet më tej ndikimi i krizës në ekonomi, por në mënyrë të posaçme ai trajtohet me korrektësi tek bizneset private, duke intervistuar biznese të ndryshme që përbëjnë mbi 50 % të fuqisë reale ekonomike në Kosovë.

Kapitulli i katërt përshkruan dhe argumenton ngadalësimin e ekonomisë së Kosovës përballë krizës. Ndër elementet që kanë ndikuar direkt në të paraqiten: Remitencat dhe Investimet e Huaja Direkte, të cilat gjatë krizës u luhatën dhe ranë si pasojë e vendeve të origjinës.

Duke shfrytëzuar pyetësorët kam nxjerrë konstatime që argumentojnë hipotezën bazë. Element shtesë i analizuar me kujdes është Fondi i Kursimeve Pensionale, i njohur në Kosovë si Trusti, i cili ka pësuar goditjen direktë nga kriza si pasojë e investimeve të mjeteve jashtë vendit në bursat ndërkombëtare. Edhe politika fiskale trajtohet shkurtazi sepse del si një element që duhet të rekomandohet për të siguruar një ekonomi formale, e cila i përballon krizës.

Në kapitullin e pestë, përshkruhet në mënyrë të hollësishme tejkalimi i krizës, krijimi i kushteve për kthimin e besimit tek investitorët e jashtëm, terheqja e bizneseve përmes krijimit të kushteve të favorshme fiskale, mundësia e shfrytëzimit të organizmave ndërkombëtare, e posaçërisht MSA-së dhe Fondeve për zhvillim të akorduara nga to.

Në fund kam përpiluar një përmbledhje të përfundimeve dhe të konkluzioneve të arritura gjatë studimit, ku paraqiten rekomandimet bazë të cilat konsideroj se janë të rëndësishme për ata që do të merren me këtë fushë studimi në të ardhmen, si dhe për institucionet që preken dhe merren me tejkalimin e krizës.

1.6. Kufizimet e punimit

Realizimi i këtij punimi pati disa kufizime, e që duhet patjetër që të evidentohen, me qëllim të krijimit të një pasqyre të qartë dhe dhe hapsirë për studiudsit tjerë. Kufizimet janë si në vijim: Së pari, vërtetësia e të dhënave dhe mungesa tyre. Pothuaj çdo studim që bazohet mbi të dhëna të marra nga institucione të ndryshme në Kosovë por edhe në rajon, ka dilema në saktësinë e tyre. Jo vetëm që informacioni mungon, po dhe saktësia e tyre lë për të dëshiruar, ndërkohë që kemi të bëjmë me të dhëna të ndryshme, përfshirë ato të sistemit bankar, bizneset, fondet dhe raportet ndërshtetërore ku dhe saktësia duhet të jetë më e lartë.

Vihet re, ashtu sikundër e kam cituar në brendësi të punimit, që për të njëjtin tregues kemi të dhëna të ndryshme në vite të ndryshme, si në raportet e mbikëqyrjes, FMN, BB, raporte nga Banka Qendrore, Ministrisë së Financave, të cilat të jepnin idenë e njëjloj rregullimi me qëllim që edhe ecuria e treguesve të dukej ajo që donin këto institucione.

Së dyti, koherenca e të dhënave. Vlerësimet vjetore të bankave qendrore apo dhe të institucioneve të tjera mbi gjendjen ekonomike, si pasojë e krizës ishin të diskutueshme.

Së treti, sondazhet dhe intervistat ishin në një kohë të caktuar dhe përgjigjet mund të jenë subjektive kur flasin për biznesin e tyre dhe ndikimet e krizës financiare, pasi që shumë pak kompani kanë aftësi të masin këtë fenomen, apo edhe janë viktimë e konkurrencës dhe praktikave abuzive.

Së katërti, natyra e të dhënave (për pranimin e remitencave ndër vite) për vlerësimin e modeleve të njohura, binin ndesh më dërgesat në rrugë legale, edhe pse përgjithësisht rezultatet nuk ndryshonin shumë nga prania e tyre.

Së pesti, ekonomia e Kosovës nuk është shumë formale dhe indikatorët mund të ndërrojnë pasi raportet në mes të Agjensive në Kosovë bien ndesh njëri me tjetrin.

KAPITULLI I DYTË

2. RISHIKIM I LITERATURËS RRETH KRIZËS EKONOMIKE DHE FINANCIARE GLOBALE

2.1. Historiku i krizave

Kriza ekonomike, shenjat e para apo parashenjat e së cilës u shfaqën në vitin 2007, dhe realisht u vërejt në vitin 2008, ka qenë sa e parashikueshme aq dhe e pashmangshme. Kjo krizë shënon një kthesë të thellë e të përhershme pas disa dekadash zhvillim, pas një periudhe kur ekonomistët përhapën idenë e gabuar mbi mundësinë e rritjes ekonomike të vazhdueshme, e cila sipas tyre është e nevojshme dhe e mundur për t'u arritur. Tashmë janë krijuar pengesa të pakapërcyeshme ndaj rritjes së mëtejshme ekonomike dhe bota po përplaset me këto pengesa (Heinberg 2011:127).

Kriza ekonomike për herë të parë paraqitet në gusht të vitit 2007, por viti 2008 ishte viti i krizës së vërtetë financiare. Gjatë këtij viti, ekonomia e Shteteve të Bashkuara, e Evropës dhe e Japonisë, është futur në recesion për herë të parë pas Luftës së Dytë Botërore.

Kriza filloi të hedhë rrënjë në një terren të favorshëm. SHBA-të përjetuan një rritje të çmimeve të pasurive të paluajtshme dhe banesave gjatë viteve 2000 - 2005, të cilat arritën deri në 50 përqind (Meka, 2010:45).

“Një rreth vicioz humbjesh, reduktim kapitali, shtrëngim krediti, likuidime të detyruara kompanish dhe shitje aktive me çmime shumë të ulëta, do të çojnë në një cikël humbjesh dhe shtrëngimi të mëtejshëm krediti” (Nouriel, 2008). Ishte ky njëri nga 12 etapat e skenarit të krizës financiare që parashikoi profesori i ekonomisë në Universitetin e New Yorkut, Nouriel Roubini, që në Shkurt 2008, përpara se të ndodhnin falimentimet e bujshme të institucioneve gjigante financiare. Roubini ishte në minorancë atëherë kur parashtronte tezat e tij në lidhje me krizën financiare dhe ekonomike globale, por tani askush nuk qesh më me të! “Pakujdesia e theksuar dhe neglizhenca në zbatim të marrëveshjeve dërgon deri te kjo situatë”. Megjithëse amerikanët nuk i kishin zbatuar asnjëherë në mënyrë strikte rregullat e “Bazel II”, kriza bankare dhe financiare, e shpërthyer në SHBA dhe pastaj e përhapur në shumë vende e rajone të botës, dëshmoi për dobësitë e sistemit të mbikëqyrjes dhe kërkoi me urgjencë një rishikim dhe plotësim të tij, në përgjigje të mësimave të krizës” (Civici, 2012).

Kjo nuk do të thotë se SHBA - ja ose bota nuk do të kenë më një tremujor apo një vit tjetër me rritje ndaj periudhës së mëparshme. Por nëse shikojmë trendin e përgjithshëm të ekonomisë (të matur në prodhim dhe konsum të mirash materiale), ky trend do të jetë i sheshuar ose në rënie, jo në rritje që këtej e tutje. Nuk do të jetë e pamundur për një rajon, shtet ose biznes që të vazhdojnë të rriten edhe për ca kohë. Disa do të vazhdojnë ecurinë e mbarë edhe për një farë kohe. Por nëse shikojmë më thellë, kjo rritje do të arrihet në kurriz të rajoneve, shteteve dhe bizneseve të tjera. Me tone më optimiste paraqitet fituesi i çmimit “Nobel” për ekonomi Joseph Stiglitz, ndonse e vlerëson se: "kjo që ndodhi ishte pasojë e parashikueshme e një administrimi të keq të ekonomisë dhe financave botërore" sipas të cilit kriza financiare duhet të “jetë më e butë se sa ajo e vitit 1929” ngase “sot ne disponojmë mjetet për të evituar një tjetër depresion të madh”, por ai vazhdon duke shprehur dyshimin se shpesh “njohuritë nuk arrihen gjithherë të praktikohen në jetë” (Stiglitz, 2009:79). A na priste i njëjti skenar i errët si ai i të “enjtës së zezë” të 24 tetorit 1929, i cili gjithashtu ishte pasojë e një “fluksi financiar” gjigant e spekulativ?

A kishte ardhur fundi i vetë kapitalizmit si sistem apo edhe këtë rradhë faji duhej kërkuar te kapitalistët e këqinj dhe te mjeshtërit e financave botërore “të Wall Street - it”?

2.2. Përkufizimet mbi krizën financiare

Ka një literaturë të gjerë përse i përket krizave financiare, hartuar nga ekonomistë, teoricienë financiarë dhe analistë politikash. Çdo krizë financiare është unike në natyrën e saj, formën, shkaqet dhe pasojat. Gjithsesi një teori e përgjithshme mund të përdoret për të shpjeguar krizat financiare. Përkufizimet dhe këndvështrimet në lidhje me krizat financiare janë të larmishme. Por kur “vinte fjala për politikën ekonomike e financiare, ekonomistët ishin të ndarë” (Civici, 2010:124) dhe nuk arrinin një konsensus të përbashkët.

Nëse i referohemi "Historinë e krizave financiare" të Kindleberger, mbetesh veçanërisht i befasuar kur shikon sesa struktura e kësaj krize të sapofilluar nuk është gjë tjetër veçse një klishe e përsëritur shumë herë gjatë këtij shekulli të fundit. Për të shmangur dyshime, duhet nënvizuar se librin e tij Kindleberger e shkroi në vitin 1978, domethënë në një largësi mbi 30-vjeçare nga kriza aktuale.

Shifra prej miliarda dollarë, paund, yen apo euro të humbura brenda ditës nga bankat më të mëdha amerikane, evropiane, kineze e japoneze shkaktuan një panik dhe frikë të përgjithshme për atë që mund të ndodhte: recesion dhe krizë ekonomiko-financiare botërore. Asnjëherë institucionet financiare nuk ishin ndeshur më një situatë të tillë kaq problematike e me kaq shumë pikëpyetje për të ardhmen e tyre. Drejtori i FMN-së, D.Straus-Kahn, e cilëson këtë "si një situatë shumë serioze për të ardhmen e ekonomisë botërore", ndersa njohesi dhe fituesi i çmimi "Nobel" në ekonomi, amerikan John Kenneth Galbraith, një nga ekspertët më të mirë në botë për krizat e bursave deklaroi se "ajo që ne jemi të sigurt për momentin është se kriza të tilla nuk përfundojnë kurrë me qetësi. Duhet të përgatitemi për më të keqen edhe pse pjesa më e madhe e njerëzve mendojnë se ajo ka pak gjasa që të ndodhë". Mediat botërore dhe institucionet e ndryshme mbushin faqet me editoriale dhe parashikime, e që janë përmbledhur në këtë formë "kriza nuk është vetëm ajo e kredive të këqija në SHBA, por ajo është globale, krizë e kreditit, e financimeve, e ekonomisë botërore në tërësi, sistemi financiar botëror, brenda disa muajve kaloi nga situata e besimit absolut në situatën e dyshimit absolut ndaj tij". Multimiliarderi dhe filantropi, George Soros, në një intervistë në gazetën "Standard" të Vjenës e cilëson situatën "si kriza më e madhe dhe globale që ka përfshirë ndonjëherë botën ekonomike dhe financiare mbas Luftës së Dytë Botërore".

Po ju përcjell në vijim disa prej tyre: Bazuar në fjalorin e biznesit, një krizë financiare është një "situatë në të cilën oferta për parë tejkalohet nga kërkesa për parë. Kjo nënkupton që likuiditeti "avullon" shpejt, pasi paraja e gatshme tërhiqet nga bankat, duke i detyruar bankat që ose të shesin investime të tjera për të kompensuar këtë rënie likuiditeti, ose të falimentojnë". Një nga përkufizimet më të mira për krizën financiare është dhënë nga R. Goldsmith në 1982, i cili i përcakton krizat financiare si: "Një përkeqësim i mprehtë, i shpejtë, ultraciklik i të gjithë apo pjesës më të madhe të një grupi treguesish financiarë - normat afatshkurtra të interesit, çmimet e aktiveve, mungesë solidariteti dhe dështim i institucioneve financiare".

Kriza ndodhi por ne nuk mund të jemi vetëm spektatorë sepse ne e shkaktuam nga egoja e shfrenuar për fitim të shpejtë. "Duket se objektiv i institucioneve financiare nuk ishte kryerja e një biznesi të kujdesshëm e me fitim të arsyeshëm, por krijimi i fitimeve maksimale brenda një periudhe të shkurtër kohore" (Meka, 2010:7).

Një përcaktim më i afërt në kohë është dhënë nga Frederic Mishkin, i cili i përcaktoi krizat financiare nën këndvështrimin e problemeve me asimetrinë e informacionit: "Një krizë

financiare është një çrregullim në tregjet financiare në të cilët problemet me “adverse selection” dhe “moral hazard” bëhen aq të mprehta sa që tregjet financiare bëhen të paafta që të kanalizojnë me eficiencë fondet tek ata që kanë oportunitete investimi më produktive (Mishkin, 1992:115).

Pra, një krizë financiare është një përkeqësim i mprehtë i një sërë treguesish financiarë dhe ekonomikë, si p.sh.: rritja ekonomike, disbalancë mes ofertës dhe kërkesës për parë, rënie e çmimeve të aktiveve, që mund të shoqërohet edhe me falimentime të institucioneve financiare si: bankat, fondet e përbashkëta dhe të investimeve, por edhe falimentim të institucioneve jofinanciare.

Duke qenë se rritet numri i kompanive që falimentojnë, rritet edhe papunësia dhe shkohet drejt një ngadalësimi të rritjes ekonomike.

Problemet që lidhen me informacionin asimetric mes huadhënësit dhe huamarrësit, rriten dhe kështu tregjet dështojnë. Studiues të tjerë të ekonomisë i lidhin krizat financiare me ciklet e biznesit. Kështu p.sh. Irving Fisher në “Teorinë Borxh - Deflacion i Depresioneve të Mëdha” (Fisher, 2011:145) të vitit 1937, flet për ciklet e biznesit. Sipas tij: “Në boom - et e mëdha dhe në depresione, aktorët kryesorë “të këqinj” janë dy: niveli i tepërt i borxhit si fillim dhe deflacioni që vjen pas tij”. Gjithashtu Kindleberger argumenton se “krizat financiare janë të lidhura me kulmet e cikleve të biznesit”.

Kapitalizmi është në një gjendje të përhershme çekuilibri, pasi asnjë nuk e di me siguri se ku po shkon ai, dhe kjo mungesë njohurie çon në një cikël boom - esh dhe dështimesh. Ndërkohë që ekonomia lëviz drejt kulmit të ciklit, struktura financiare bëhet më delikate pasi ngjitja drejt majës financohet së tepërmi me borxh (Minsky, 112).

Ajo që është e qartë dhe mësim që po nxjerrin nga kjo krizë e paprecedentë është se tashmë fenomeni i globalizimit "na ka vendosur të gjithëve në të njëjtën anije", se çdo "furtunë apo turbulencë" në financat apo ekonominë e disa vendeve apo zonave ekonomike prek menjëherë si efekt domino të gjitha vendet dhe zonat e tjera

Ajo që ndodhi me ekonominë amerikane dhe evropiane gjykohet se ka ndikim të drejtpërdrejtë në ekonominë kineze, japoneze, indiane, ruse, braziliane etj. Kështu rënia e fuqisë blerëse në SHBA ndikon direkt në një krizë eksportesh kineze apo indiane, në uljen e të ardhurave të Rusisë nga eksporti i naftës, në uljen e eksporteve braziliane të bioenergjisë etj.

Përveç kësaj, evidentohet se mësimi i tjetër mjaft i rëndësishëm është ai se "produktet dhe veprimet e tregjeve financiare dhe bankave duhet të jenë sa më transparente e të

verifikueshme" në çdo hap në raport me pasqyrimin e saktë të tyre në bilancet dhe kontabilitetin e bankave

2.3. Tipet e krizave financiare

Një krizë financiare zakonisht kategorizohet si një nga katër tipet e mëposhtme (Claessens& Kose, 2013):

Krizë bankare. Kjo shkaktohet nga një tërheqje e papritur e depozitave bankare nga shumë klientë, një situatë kjo e njohur si "bank run". Bankat mund të mos kenë fonde të mjaftueshme për të paguar një numër të madh depozituesish, duke qenë se fondet i japin hua në formë kredishë. Situata ku "bank runs" marrin përhapje të gjerë, njihet edhe si panik bankar. Një situatë pa përhapje të gjerë të "bank runs", por në të cilën bankat hezitojnë të japin kredi pasi ata janë të shqetësuar për nivelin e pamjaftueshëm të fondeve të disponueshme, quhet shpesh krizë krediti².

Shembuj të krizave bankare përfshijnë rrjedhjen e depozitave të Bank of the United States në vitin 1931 dhe të Northern Rock në 2007.

Kriza amerikane e kursimeve dhe ajo e kredisë e viteve 1980, çoi në një krizë krediti që është konsideruar si një nga faktorët kryesorë të recesionit të ekonomisë amerikane në vitet 1990 - 1991.

Fluskat spekulative. Fluskat shfaqen kur çmimi i një aktivi financiar (si p.sh. i një aksioni) tejkalon vlerën aktuale të flukseve të ardhshme të parasë (si p.sh. të ardhura nga interesat apo dividendët) që do të përfitoheshin nga mbajtja e asetit deri në maturim. Në qoftë se shumica e pjesëmarrësve të tregut i blejnë aktivet kryesisht me synimin që t'i shesin më vonë me një çmim më të lartë, në vend që t'i blejnë për të ardhurat që do të gjenerojnë, kjo është një tregues se ekziston një fluskë. Në qoftë se ekziston fluskë, ekziston gjithashtu edhe risku i një kolapsi në çmimet e aktiveve: pjesëmarrësit e tregut do të blejnë për aq kohë sa ata presin që edhe të

² "Crunch Credit" apo "Krizë Credit" përkufizohet si mungesa e disponueshmërisë së kredive për të dy palët, konsumatorët dhe bizneset nga institucionet tradicionale financiare. Kjo do të thotë se bankat dhe kompanitë e kreditit kartave nuk janë duke bërë më shumë (ose ndonjë) kredi, dhe se kreditë që ata janë duke bërë, me norma shumë të larta interesi, janë vetëm për njerëzit dhe bizneset që kanë histori kredie të shkëlqyer dhe shumë asete për kolateral.

tjerët do të blejnë, dhe kur shumë prej tyre të vendosin të shesin aktivet e blera, çmimet e tyre do të bien. Fluska të njohura gjatë historisë janë: ajo e Ëall Street më 1929, fluska e pasurive në Japoni në vitet 1980, shfryrja e fluskës “dot.com” në vitet 2000 - 2001, si dhe ajo e sotshmja e kredive për shtëpi në SHBA (D.Furceri & A. Mourougane)

Krizat financiare ndërkombëtare. Kur një vend që mban regjimin e fiksuar të kurseve të këmbimit, papritur detyrohet që të zhvlerësojë monedhën e tij për shkak të një sulmi spekulativ, kjo quhet krizë valutash ose krizë e bilancit të pagesave. Kur një vend dështon në shlyerjen e borxhit qeveritar, atëhere kjo quhet dështim qeveritar.

Disa prej monedhave që bënin pjesë në Mekanizmin Evropian të Kurseve të Këmbimit, vuajtën nga kriza të tilla në vitet 1992 - 1993 dhe u detyruan të zhvlerësojnë monedhat e tyre ose të tërhiqen nga mekanizmi. Një tjetër shembull i krizave të valutave ndodhi në Azi në vitet 1997 - 1998. Shumë vende amerikano - latine dështuan në shlyerjen e borxheve të tyre në fillimin e viteve 1980. Kriza financiare ruse e vitit 1998 rezultoi me një zhvlerësim të rublës dhe dështim të qeverisë në shlyerjen e borxhit obligacionar.

Kriza më të gjera ekonomike. Siç dimë, rritja ekonomike negative që zgjat dy ose më shumë tremujorë, quhet recesion. Një recesion i zgjatur mund të quhet depresion, ndërsa një periudhë e gjatë e rritjes ekonomike të ngadaltë, por jo domosdoshmërisht negative, shpesh quhet stagnacion ekonomik. Duke qenë se këto fenomene prekin më tepër se sa vetëm sistemin financiar, ato zakonisht nuk quhen kriza financiare në vetvete. Një shembull i rëndësishëm është Depresioni i Madh, që u parapri në shumë vende nga krizat bankare dhe ato të bursave të aksioneve (D.Furceri & A. Mourougane).

Kriza e kredive hipotekare dytësore dhe shpërthimi i fluskave të tjera të pasurive të patundshme, ka çuar në recesion në SHBA dhe në vende të tjera të botës, nga fundi i vitit 2008 dhe fillimi i vitit 2009. Gjithsesi, disa ekonomistë argumentojnë se krizat financiare shkaktohen nga recesionet dhe jo anasjelltas.

2.4. Kriza e kredive hipotekare nënstandarde

Kriza e kredive hipotekare nënstandarde - *subprime mortgage crisis*, është një krizë e vazhdueshme pasurish të patundshme dhe financiare, si pasojë e rritjes dramatike të dështimit në shlyerjen e kredive hipotekare nënstandarde në SHBA, me ndikim të madh negativ për

bankat dhe tregjet financiare në mbarë botën. Kriza, që i ka rrënjët në fundin e shekullit XX, u bë e evidente në vitin 2007 dhe ka vënë në dukje dobësi të shumta në rregullimin e industrisë financiare edhe në sistemin financiar global.

Origjina dhe kronologjia e krizës. Një studim i financuar nga IMF (Claessens & Kose, 2013) e studion krizën financiare globale duke e ndarë në dy faza të dallueshme: një periudhë trazirash financiare me përhapje të kufizuar nga Korriku i vitit 2007 deri në 15 Shtator 2008, e pasuar nga faza e kolapsit total të besimit, që shënoi përhapjen e krizës në mbarë botën. Përgjigjia e politikës gjatë këtyre dy fazave ishte e ndryshme.

Nëse shohim një kronologji dhe kthehemi pas në fillimin e viteve 2000, pas shfryrjes së fluskës “Dot.Com” në vitin 2001 dhe në ngjarjet e 11 Shtatorit 2001, ekonomia amerikane u përball me recesionin. Me synim nxitjen e rritjes ekonomike, Federal Reserve, e drejtuar nga Alan Greenspan, uli normën bazë të interesit në një (1) përqind.

Bonot e thesarit që deri atëherë kishin qenë një investim i mirë për investitorët amerikanë, tashmë nuk ishin më të tillë. Ata filluan të kërkonin forma të tjera investimi, me norma kthimi më të larta. Nga ana tjetër, ulja e normës bazë të interesit do të thoshte huazim fondesh nga bankat te FED - i me kosto mjaft të ulët. Në po të njëjtën periudhë, kishte një tepriçë kapitali në mbarë botën. Bankat mund të merrnin hua të lira nga Kina, Japonia dhe Lindja e Mesme. Menaxherët e investimeve ishin të shqetësuar se ku do t’i investonin këto kapitale, që të siguronin kthim sa më të lartë. Përgjithësisht kërkesa ishte e lartë për investime me risk të ulët dhe kthim të kënaqshëm. Në këtë kohë filloi rritja e fuqishme e tregut të shtëpive. Ulja e normave të interesit i inkurajoi familjet të merrnin kredi për shtëpi.

Ndërsa çmimet e shtëpive filluan të rriten nga kërkesa në rritje, huadhënësit e shtëpive i zbutën kriteret për dhënien e kredive.

Kriza financiare globale është krizë e sistemit financiar botëror. Konsiderohet të jetë një ndër krizat më të vështira që kanë ndodhur deri tani sepse humbjet dhe pasojat janë shumë të mëdha nga fillimi i kësaj krize financiare. Themelet e sistemit financiar aktual janë krijuar në Bretton Woods në gjysmën e shekullit të kaluar. Si bazë e këtij sistemi ka shërbyer dollari amerikan, në të cilin janë fiksuar të gjitha valutat e tjera, kurse vetë dollari ka qenë i bazuar në ari. Një konstruksion i tillë ka funksionuar gjer te shkëputja e konvertibilitetit të dollarit në fillim të viteve të shtatëdhjeta. Shkëputja e konvertibilitetit e ka ndërprerë në një mënyrë simbolike ekonominë reale nga ajo financiare. Nga kjo kohë, në sektorin financiar ka filluar të fryhet baloni financiar. Këtu ka ndodhur transformimi i sistemit tradicional konservativ bankar, që

ka pasuar me lindjen e institucioneve të reja, me krijimin e produkteve të reja financiare, të ashtuquajtura inovacione, opsione, derivime. Duke u bazuar në tërë këtë, sektori financiar është zhvilluar i pavarur dhe në mënyrë të pakrahasueshme, më shpejt se sa ekonomia reale (Selmani, 2009).

Rritja e sektorit financiar dhe globalizimi i tij ka mundësuar rirregullimin dinamik. Këtë e ka mundësuar zhvillimi i teknologjive të larta: informatikës dhe telekomunikacionit, si dhe zhvillimi i teknologjive adaptive të një numri të madh të inovacioneve financiare. Tregu financiar është bërë global, janë zhvilluar subjekte financiare gjigante, banka dhe fonde të tjera financiare të cilat janë bërë aq të mëdha sa që mundësia e falimentimit eventual ishte minimale. Në mungesë të mbikëqyrjes dhe rregullimit, shumë produkte inovative financiare, posaçërisht në sektorin investiv bankar, kanë funksionuar jashtë mbikëqyrjes së sistemit rregullativ. Kjo njëkohësisht, ishte dobësia kryesore që shkaktoi stihi në sistemin financiar, i cili veproi në mënyrë të pakontrolluar nga ana e rregullatorit mbikëqyrës.

Të gjitha krizat e paraqitura deri sot, ofrojnë mundësi dhe shans për të mësuar se si duhet menaxhuar ekonominë në përgjithësi në kushte të tilla. Për 200 vitet e fundit, me përjashtim të Depresionit të Madh, krizat e mëdha financiare janë krijuara në vendet e varfra dhe të paqëndrueshme, të cilat pastaj kanë nevojë për ndryshime të mëdha politike. Kriza e sotme ka filluar në vendet e pasura industriale, jo vetëm me hipotekat më kryesore në Shtetet e Bashkuara, por edhe me keqmenaxhimin e bankave dhe të borxhit publik në Evropë. Kjo do të thotë që kriza ekonomike financiare, gjithmonë është paraqitur dhe përhapur në vende më të varfëra për arsye të ndryshme, siç mund të jenë pasojat nga keqmenaxhimi i parasë publike nga ana e qeverive të ndryshme apo keqmenaxhimi i borxhit publik, si dhe si pasojë e korrupsionit të lartë në vendet të cilat janë më të varfëra, për arsye se aty nuk ka një mbikëqyrje të drejtë të parasë publike. Ndërsa në kohën e sotme, kemi të bëjmë me një krizë të thellë e cila ka filluar në shtetet e pasura, konkretisht që nga viti 2008 në Shtete të Bashkuara të Amerikës, dhe gjithashtu është përhapur edhe në Evropë në dimensione të mëdha.

Kriza globale ka sjellë probleme financiare në shumë ekonomi të mëdha dhe ende kemi shume vende të cilat po vuajnë nga këto pasoja. Për arsye të paraqitjes së krizës ekonomike, që nga viti 2008 e deri në vitin 2013, është vërejtur se ka pasur rritje të papunësisë dhe përkeqësim të standartit jetësor të qytetarëve. Kriza financiare amerikane shumë shpejt është përhapur edhe në sektorin financiar evropian, në atë bankar dhe në bursa.

Siç u cek më lart, ekonomia globale është duke përjetuar krizën më të rëndë financiare në 80 vitet e fundit. Kriza së pari përfshiu një pjesë të madhe të sistemit financiar amerikan, kreditë hipotekare, kurse gradualisht është përhapur në sistemin bankar të sigurimeve, të фондеве dhe në bursa. Rritja ekonomike globale e BPSH (GDP) seriozisht është ngadalësuar, janë në rënie çmimet e patundshmërive (të të gjitha llojeve), disa prej sektorëve të industrive kanë filluar të pësojnë humbje të mëdha (Selmani, 2009). Treguesit e shumtë po tregojnë për rrezikun që për momentin po përjeton ekonomia globale e cila gjithnjë e më shumë po i ofrohet recesionit, e ndoshta edhe depresionit të paparë gjer tani. Në përpjekje që të evitohet përhapja e krizës, qeveritë dhe bankat qendrore të vendeve më të zhvilluara me masa energjike, po e vejnë në veprim kapitalin e freskët në sektorin bankar. Përveç kësaj, disa banka gjer tani me emër të madh në SHBA dhe në Britaninë e Madhe, më nuk ekzistojnë, pra kanë falimentuar. Disa prej këtyre bankave, Qeveria amerikane i ka marrë në mbikëqyrje, dhe në Europë gjithashtu po ndodh i njëjti skenar.

Kriza financiare që filloi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shumë shpejt u përhap në të gjithë botën. Fillimi i kësaj krize u vërejt në tregjet financiare amerikane, kështu që për një kohë të shkurtër u vërejtën ndikimet e kësaj krize në të gjitha tregjet e botës, duke treguar kështu, se sa të lidhura janë tregjet botërore me njëri - tjetrin. Në këtë mënyrë, kriza financiare u përhap kudo në botë, duke u bërë kështu kriza ekonomike më e madhe që ka ndodhur ndonjëherë.

2.5. Paraqitja e krizës financiare globale

Kriza globale financiare e fundit është një ndër krizat më të mëdha që kanë ndodhur ndonjëherë, duke u bazuar në terma të kapitalit të përfshirë nga kriza financiare. Kriza që filloi në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, shumë shpejt u përhap edhe në Europë, duke përfshirë kështu sektorin financiar europian, bankar dhe në bursa. Duke u bazuar në analiza të shumta që i janë bërë paraqitjes dhe impaktit të krizës globale, mund të konkludojmë se kriza ka pasur pasoja të thella në strukturën e sistemit financiar global, dhe normalisht ende po vazhdon të këtë pasoja të mëdha, bile nuk dihet saktë se si do të përfundojë. Në gusht të vitit 2007 vërehen shenjat e para të krizës, sidomos kur bankrotoi Fondacioni i njohur Amerikan “Home Mortgage” si viktimë e parë e tregut amerikan të paluajtshmërive (hipotekave dytësore); më 9


gusht, “BNP Paris Bank” i suspendoi tri fondet e veta investive me vlerë prej 2 miliard euro, për shkak të asaj që tregu i tyre u “zhduk”; Banka Qendrore Europiane ia dha 95 miliardë euro sistemit bankar, po ashtu ngjashëm veproi edhe FED - i amerikan dhe Banka Qendrore Japoneze (Selmani, 2009). Rrjedha negative ka vazhduar me pasoja të tjera: kemi vazhdimin e falimentimeve të reja siç ishte ajo e bankave: “BEAR STEARNS”, “LEHMAN BROTHERS” dhe e disa të tjerave. Kështu që, tsunami i krizës financiare u përhap shumë shpejt edhe në sistemin financiar të Europës e në tërë pjesën tjetër të ekonomisë globale. Sipas shumë analizave dhe shkrimeve të ndryshme rreth kësaj teme, deri në një masë krizën financiare e kanë shkaktuar kreditë hipotekare në SHBA, mirëpo nuk mund të thuhet se vetëm kreditë hipotekare janë shkaktari kryesor pasi ka edhe shkaktarë të tjerë, të cilët kanë ndikuar në paraqitjen e saj.

Është e ditur tashmë se kreditë hipotekare të pakthyera dhe rënia e çmimit të tyre në tregun e patundshmërive, ka shkaktuar humbje të pariparueshme për një mori fondesh dhe bankash (Selmani, 2009). Bankat Qendrore dhe Qeveritë e tyre hodhën shumë para në treg, gjatë krizës financiare dhe ekonomike. Kështu nuk mund të vazhdohet gjithnjë, sepse kjo sjell me vete rreziqe. Historia nis me 11 shtatorin e vitit 2001. Alan Greenspan (shefi i atëhershëm i Bankës Qendrore Amerikane (FED) ul përqindjen bazë të interesit deri në 1 për qind nga frika e një recesioni. Kush vazhdon të kursejë ende, tani është budalla! Miliona kryetarë familjesh, vendosin brenda nate të blejnë shtëpi. Llogaria e momentit është kjo: Blen shtëpinë, pret pak, çmimi rritet. Biznes tepër i mirë! “Ishte shumë e qartë që ishte një fluskë e madhe në tregun e imobilitareve, që herët apo vonë do të pëlciste dhe do të kishte pasoja serioze.” Gjatë vitit 2006, kur gjithçka lulëzonte dhe bota ishte mbushur plot me para të fituara lehtë, shumë njerëz blinin shtëpi të re me para borxh, sepse iu kishin thënë se çmimi i shtëpive njihet vetëm ngritje. Nuk ekzistonte frika as për marrjen e kredive duke lënë hipotekë, sepse analistët parashikuan që ngritja e çmimit të shtëpive, rrit vlerën e kolateralit edhe nëse borxhlinjtë nuk kishin të paguanin. Idea e largët se çmimi i shtëpive edhe mund të ulej, nuk i shkoi askujt në mendje. Kriza e kredive të shtëpive filloi të shfaqej, deri sa “plasi” (Angjeli, 2012:22).

Gjatë viteve 2002 - 2006, me miliona amerikanë shfrytëzuan rritjen e çmimeve të pasurive të paluajtshme për të rritur të ardhurat e tyre. Pronarët ndjeheshin të sigurtë të merrnin kredi për rikonstruksionin e shtëpive. Në anën tjetër, bankat ndjeheshin të sigurt në dhënien e kredive të reja, për aq kohë sa çmimet vazhdonin të rriteshin. Ndërkohë, magjistarët e Woll Stritit, po

gjenin mënyra për shndërrimin e kredive hipotekare të dyshimta, në borxhe të mira të kolateralizuara, të cilat mund t'u shiteshin me fitim investitorëve me pak ose aspak rrezik (Heinberg, 2011:10).

Figura 2. Anatomia e krizës financiare, përhapja e pasigurisë Knightian



Burimi: Matthew Pritsker, Knightian Uncertainty and Interbank Lending, 2011

Gjatë vitit 2008 kemi paraqitjen e një krize financiare me përmasa të mëdha, krizë e cila shkaktoi lëkundjet e para në Wall Street, duke dëmtuar rëndë sistemin bankar dhe duke tronditur bursat. Këtu duhet cekur, se gjatë vitit 2008, si pasojë apo shkak i humbjeve të mëdha

nga kreditë, erdhi edhe fundi i Wall Street - it, që njihet si një nga institucionet më të mëdha financiare. Si rezultat i krizës, bankat nuk kishin më besim tek njëra - tjetra. Ato kufizonin dhënien e parave sepse nuk e dinë se kush ka para të zhvlerësuar dhe sa. Gjatë vitit 2008 shumë banka ishin në prag të falimentimit.

Me 15 shtator filloi kolapsi “Lehman Brothers”, një nga bankat më të mëdha investuese në botë. Dështimi i Lehman Brothers ua vështirësoi bizneseve madje edhe pagat e punëtorëve (Moore, 2008). Ndërsa “Merrill Lynch” u mor nga një bankë tjetër. Thesari shpalli një plan emergjent miliarda dollarësh, për të shpëtuar gjigantin e sigurimeve AIG (Moore, 2008).

Rënia e bankave të tjera bëri që në kulmin e krizës të lindë plani 700 miliardë dollarësh i qeverisë, për të blerë borxhet e këqija. Kjo ndodhi për shkak se kriza shkaktoi reaksione vargore në sistemin financiar.

Shumë shpejt kemi parë falimentime edhe në Gjermani, në Britaninë e Madhe, në Danimarkë e kështu me radhë. Angela Merkel, kancelarja gjermane, kishte dhënë një garanci shtetërore të paparë kurrë deri atëhere. “Ne iu themi depozituesve dhe depozituesëve, që kursimet e tyre janë të sigurta. Dhe për këtë përgjigjet qeveria gjermane”, deklaroi kancelarja Merkel. Islanda provon të bëjë po kështu. Ajo shtetëzon tri nga bankat e saj, që përbëjnë pothuajse të gjithë sistemin financiar të Islandës dhe vjen kështu në prag të falimentimit. Bankat emetuese merren vesh me njëra - tjetrën dhe iu vënë në dispozicion instituteve të tyre financiare disa bilionë euro. Interesin e tyre bazë, ata e ulin shumë: Banka Qendrore Europiane nga 4.25 përqind në fund e ul deri në 1 përqind. Banka Emetuese Amerikane FED, kalon në politikën e përqindjeve zero. Sistemi financiar shpëton, por kriza tani kap ekonominë reale. Të parët që japin alarmin janë prodhuesit e automjeteve dhe pasojnë degët e tjera. Për zonën e euros, ekspertët presin afro 4 përqind më pak se një vit më parë. Europa Lindore preket më shumë se asnjë rajon tjetër në botë. Lituanië, kriza i kushton sipas FMN-së, një të katrën e produktit të brendshëm bruto. Kina, India dhe Brazili nga ana tjetër pësojnë ngritje. Vendet në ekspansion ekonomik janë bërë papritur motorri në krizën globale. Zhvillohen disa samite financiare të G 20-ës, duke bërë një rregullim mbarëbotëror të sistemit financiar (DW, 2009)

Duke u munduar që të identifikojmë shkaqet të cilët kanë sjellë një krizë të tillë, sipas analizave që i janë bërë krizës vijmë në përfundim se shkaktarë kryesor janë kreditë e pasurive të patundshme në SHBA. Fillimi i krizës në vitin 2006, me rënien e kredive hipotekare me


risk në SHBA, filloi të godasë shumë zona dhe banka të botës, duke kaluar kështu në një krizë financiare botërore. Këto lloj kredish, që në fund të vitit 2006 kapnin shifrën e 650 miliardë dollarëve ose 23 % të totalit të kredive imobiliare në SHBA, fillimisht vunë shumë pikëpyetje mbi institucionet financiare ndërmjetëse, mbi fondet e investimeve dhe sistemin bankar amerikan, për t'u shndërruar më vonë në një krizë të përgjithshme besimi për sistemin financiar në përgjithësi, në një rënie të tregjeve financiare dhe krizë likuiditeti bankar (Strauss - Kahn, 2009).

Banka “Goldman Sachs” në SHBA humbi 1.5 miliardë USD vetëm gjatë dy tremujorëve të fundit të vitit 2007, “Merrill Lynch” humbi 8.4 miliardë USD, “CitiGroup” humbi 6 miliardë USD, “UBS” Zvicër humbi 11 miliardë franga zviceriane, “Deutsche Bank” humbi 2.2 miliardë euro etj., ndërkohë sipas vlerësimit të “Royal Bank of Scotland”, humbjet e bankave në këtë periudhë janë rreth 500 miliardë dollarë.

Shkaqet e përhapjes së krizës në Europë janë të shumta. Nga hulumtimet dhe analizat që janë bërë për krizën e eurozonës, ka pasur shumë mendime dhe supozime në lidhje me paraqitjen e krizës ekonomike dhe financiare në Europë. Janë cekur disa supozime dhe mendime, siç është supozimi për krizën e krijuar nga gabimet e projektit të euros që në fillim të tij. Të tjerë argumentuan se kjo është e lidhur me dobësitë e integritit politik të Europës (mungesa e një Kushtetute Europiane, ekzistonte Traktati i Lisbonës³). Shumë analistë të ekonomi - financave dhe politikës monetare, fajësuan mungesën e rregullave të mbikëqyrjes, mungesën e unifikimit fiskal dhe bankar, kreditë hipotekare, mungesën e politikave të përbashkëta buxhetore etj. Po ashtu kishte nga ata që krizën e lidhën me funksionimin jo të plotë të BQE-së etj. Mendime të ndryshme, faktorë dhe probleme të shumta, që të gjitha konvergjuan në një pikë. Kriza e borxheve sovraane preku Eurozonën, tregjet financiare u tronditën thellë, recesioni ekonomik “mbërtheu” vendet e eurozonës dhe me thellë, papunësia u rrit me shpejtësi, Europa u trondit (Angjeli, 2012:65).

Figura 3. Ndikimi i krizës financiare në vendet në zhvillim

³Traktati i Lisbonës shënon një hap të rëndësishëm të rrugës së Bashkimit Europian drejt konsolidimit të mëtejshëm të vlerave të përbashkëta mbi të cilat është krijuar ai. Pas hyrjes në fuqi të Traktatit të Lisbonës më 1 dhjetor 2009, reformimi dhe modernizimi i institucioneve europiane, bën të mundur promovimin e plotë të objektivave të BE-së në shërbim të qytetarëve dhe shteteve anëtare, si dhe konsolidon urën lidhëse mes qytetarëve dhe projektit europian, të nisur në fillim të viteve ‘50 drejt “pajtimit” dhe “unifikimit” të kontinentit europian. Nëpërmjet ripërtëritjes së vendimmarrjes në institucionet europiane, ky Traktat përforcon kapacitetin e Bashkimit për një funksionim sa më eficient dhe demokratik në një bashkësi prej 27 vendësh anëtare



Burimi: Prasad, Naren and Megan Gerecke (2010), “Social policy in times of crisis”, Global Social Policy, 10(2):218-247

2.6. Përhapja e krizës ekonomike në Evropë

Fillimisht, mendimet e para krijuan përshtypjen se kriza që shpërtheu në SHBA, me të njëjtën forcë dhe shpejtësi, nuk do të kalonte oqeanin dhe nuk do të përfshinte kontinentin e vjetër evropian. Kjo, jo më tepër për faktin se kriza nuk parashikohej të ishte e përmasave të mëdha, sesa referuar “reagimit” disi të fshehtë që bëri Europa, sidomos në fillimet e saj. Por, ajo që ndodhi dhe vazhdon të jetë e pranishme, ishte krejt ndryshe. Kur valët e krizës u përplasën në brigjet e Europës, muret e saj u goditën aq fort, sa tregjet financiare evropiane u lëkundën, recesioni ekonomik përfshiu kështu shumicën e vendeve të Eurozonës (Angjeli, 2012:60).

Impakti i krizës financiare ishte mjaft i madh, duke ditur se shumë vendeve iu është vështirësuar gjendja ekonomike, dhe normalisht, kjo krizë është për arsye të keqmenaxhimit të shpenzimeve, pra është shumë e thjeshtë për t'u kuptuar, ata kanë shpenzuar me shumë se sa kanë pasur të hyra. Është shumë e rëndësishme që të kuptojmë fillimin e krizës, se si ka nisur të paraqitet kriza financiare në Europë dhe se cilat vende të BE-së i ka prekur më shumë. Kriza ekonomike që filloi në Amerikë u përhap me shpejtësi në tërë Europën. Lidhjet e forta të institucioneve financiare dhe monetare të vendeve europiane me Amerikën, u bënë shkak që shumë vende evropiane dhe sidomos vendet më të dobëta, të bien në vorbullën e krizës financiare dhe ekonomike (Vestervelle, 2011). Europa është në një krizë të thellë e cila është njohur nga një numër në rritje e analistëve, ekspertëve dhe vëzhguesve. Kriza e Eurozonës ka qenë në faqen e parë të gazetave kryesore për një kohë të gjatë. Shumë gjëra janë thënë dhe shkruar gjatë katër viteve të kaluar për efektin e krizës globale ekonomike dhe financiare në BE. Kjo gjendje e rëndë ende po vazhdon dhe nuk dihet se si do të përfundojë kriza e thellë ekonomike (Miszlivetz, 2012).

Kriza e euros vazhdon ende të jetë e pazgjidhur, ndonëse monedha e përbashkët, euroja, konsiderohej projekti më i madh i afrimit mes shteteve të kontinentit të vjetër (Angjeli, 2013). Kancelarja Angela Merkel u shpreh me tone pesimiste, duke konsideruar një gabim elementar faktin që mes anëtarëve të BE-së vazhdon të mungojë afrimi ekonomik. “Duhet bërë reforma të thella, duke u fokusuar në katër shtyllat kryesore të vazhdimin të reformave në eurozonë, që duhen marrë parasysh për stabilizimin e gjendjes”. Ajo ngriti këto çështje:

1. **Rregullimi i tregut financiar.** Në këtë çështje duket se BE-ja po përparon me hapa të vegjël, sepse britanikët në mënyrë të veçantë i druhen konkurrencës ndërkombëtare në treg.
2. **Mbikqyrja e bankave** është një propozim shumë i ri, i debatuar në dy samitete fundit dhe i miratuar në dhjetor, që duhet të fillojë të aplikohet në mars të vitit 2014.
3. **Disiplina financiare - buxhetore** në BE, të cilën pothuajse asnjë vend nuk e ka respektuar. Dallimet themelore mes vendeve në Veri dhe në Jug të Evropës, do të vazhdonin të dominonin edhe debatin për buxhetin e ardhshëm të BE-së.
4. **Koordinimi ekonomik** se si mund të zvogëlohen dallimet e mëdha ekzistuese mes vendeve anëtare të bllokut mbi politikën ekonomike. (Kancelarja gjermane Angela Merkel)

E pra, përballja me krizën në Eurozonë duket se do të jetë përsëri sfida kryesore e BE-së edhe gjatë vitit 2013.

Kriza financiare, u shndërrua shumë shpejt në një krizë të përgjithshme ndërkombëtare ekonomike. Brenda një kohe të shkurtër u zhgënjyen të gjithë, që në fillim besonin se Europa nuk do të prekej prej krizës (Hasselbach, 2009). Ndonëse sistemet evropiane sociale, mjaft të zhvilluara deri tani i bënë ballë shumë efekteve të krizës. Duhet thënë se kriza ka goditur çdo buxhet, dhe kjo vërehet tek humbjet e vendeve të punës, tek rritja e borxheve dhe po ashtu ka ndikuar në standardin jetësor të qytetarëve. Shumë vende janë prekur nga kriza, duke rritur kështu përqindjen e të papunëve e kjo ndodh veçanërisht në vende të cilat kanë qenë vende të suksesshme. Brenda një kohe të shkurtër, niveli i papunësisë në BE arriti mbi 17 % dhe kjo thuhet se është një përqindje e lartë në vendet e BE-së, të cilat kanë pasur një ekonomi stabile.

Kriza që përfshiu Europën, ka pasur ndikimet e saj në shtete të ndryshme, siç janë: Greqia, Portugalia, Italia, Irlanda, Spanja dhe në shumë vende të tjera. Kriza që përfshiu ekonominë e Greqisë, ka ndikuar shumë negativisht në zhvillimin ekonomik të këtij vendi. Pasojat e shumta nga kjo krizë janë: humbja e vendeve të punës, rritja e borxheve, përkeqësimi i standardit jetësor etj.

Natyrisht, probleme të veçanta Greqia ka përjetuar edhe më parë, por ngjarjet e pas 2009-ës e vunë atë në kufinjtë e defoltit (falimentimit të shtetit). Sot, flitet shumë për krizën greke dhe shkaqet e saj. Pavarësisht nga tezat dhe hipotezat, supozimet dhe mendimet e ndryshme, shumica e ekspertëve bashkohen në faktin se shkaqet e krizës greke mund të përmbledhen në tri grupe (Angjeli, 2012:61):

- Kondicionet - shkaqe ekonomike (të brendshme dhe të jashtme)
- Kondicionet - shkaqe morale - etike të qeverisë
- Kondicionet - shkaqe sociale

Për herë të parë, problemet ekonomike në Greqi u shfaqën në vitin 2009, kur defiçiti i buxhetit kaloi shifrën e 13 % të PPB-së. Ndërkohë që, borxhi total i qeverisë kaloi kufirin kritik duke arritur shifrën e 300 miliard euro. Të tilla arsye, bënë që vendi të ndodhej përballë një situatë defolti (ose ndryshe falimentim i shtetit).

Instituti Kombëtar i Statistikave në Greqi publikoi të dhëna shokuese që tregonin se thellimi i krizës në vend dhe reformat e ashpra financiare, kanë gjunjëzuar akoma më shumë ekonominë dhe vetë grekët. Sipas shifrave, në muajin nëntor të vitit 2012, papunësia në Greqi arriti në 27 për qind, që është edhe kuota më e lartë në Bashkimin European. Gjithashtu, papunësia tek të rinjtë nga moshë 15 deri 24 vjeç, ka arritur statistikën tjetër rekord prej 61.7 për qind (Merkel, 2012). Sipas shumë raporteve mbi krizën ekonomike në Greqi, bëhet e ditur se ekonomia greke është tkurrur me 6 për qind në tremujorin e katërt të vitit 2011, ndërsa recesioni për të gjithë vitin 2012 ka qenë në shifrën prej 6.5 për qind, pra tejet më i lartë se parashikimet. Greqia veproi me politika ekonomike të gabuara. Shteti grek aplikoi programe të mëdha sociale, programe të cilat pas përkeqësimit të ekonomisë, kanë dalë jashtë kontrollit. Kështu, menaxhimi i situatës doli jashtë kontrollit dhe shteti grek nuk kishte mundësi t'i mbulonte shpenzimet e tepërta të krijuara, ndaj ka huazuar duke emituar borxhe më normë rritëse. Greqia, gjatë tërë kësaj kohe, ka marrë hua duke pasur kështu rritje të kostos së huas, duke iu vështirësuar gjithnjë e më shumë gjendja ekonomike.

Meqenëse Greqia është pjesë e Bashkimit European, dhe ekonominë e tyre e ndajnë me 26 shtetet tjera anëtare, rreziku i kolapsit ekonomik në Greqi do të të kumbonte përgjatë gjithë Eurozonës. Se rreziku i një shteti për të prekur të gjithë Eurosistemin ka qenë një shqetësim i BE-së që nga ditët e para të tij. Si rezultat, Unioni ka miratuar Paktin e Stabilitetit dhe të Rritjes⁴ (Stability and Growth Pact), në bazë të të cilit Pakt, niveli i defiçitit buxhetor nuk duhet të jetë më i lartë se 3 % e prodhimit kombëtar bruto të vendeve, ndërsa niveli i borxhit të qeverive nuk duhet të shkojë më shumë se 60 % e prodhimit kombëtar bruto. Por, rrezikimi i shumë bankave dhe institucioneve financiare nga falimenti, u bë shkak që shumica e vendeve të Eurozonës, të shkelin pikat e Paktit të stabilitetit të Europës dhe të vënë në prioritet shpëtimin e institucioneve financiare nga falimentimi. Kufizimet që u vendosën në Paktin e Stabilitetit, kanë qenë të vështira për t'u zbatuar, ndërsa vendet kanë ardhur në një situatë të

⁴ Pakti i Stabilitetit u krijua më 10 qershor të vitit 1999 me iniciativë të BE -së, në Këln (PS) për Vendet e Europës Juglindore. Kjo ishte përpjekja e parë serioze e bashkësisë ndërkombëtare për të zëvendësuar politikën e mëparshme reaktive të ndërhyrjes në kriza në rajon me një strategji të gjerë, afatgjatë, të parandalimit të konfliktit. Të gjitha vendeve të rajonit iu premtua integrimi euroatlantik. Në një mbledhje të nivelit të lartë në Sarajevë në 30 korrik 1999, PS-ja u vulos edhe një herë në mënyrë solemne. Në samitin e tij në Zagreb, nëntor 2000, Jugosllavia u pranua si anëtare e plotë. BE ka lançuar procesin e stabilizimit dhe asociimit për pesë vende: Shqipërinë, Bosnje - Hercegovinën, Kroacinë, Maqedoninë dhe Republikën Federale të Jugosllavisë.

tillë që kanë shkelur të paktën njërin nga kufizimet e vendosura, ndërsa Greqia i ka shkelur që të dyja rregullat e vendosura nga Pakti i Stabilitetit.

Një vit pas ndjekjes së kësaj politike, jo vetëm që nuk u vu re rimëkëmbja ekonomike në strukturat financiare të kërcënuara nga falimentimi, por ekonomitë evropiane u zhytën në një krizë të thellë me rritjen e deficitit buxhetor dhe me shtimin e borxheve publike. Pasojat e kësaj krize, u ndjenë menjëherë me uljen e vlerës së monedhës së përbashkët evropiane euro (Vestervelle, 2012).

Shkaqet dhe indikatorët e krizës greke janë: Deficiti buxhetor: 12.7 %, borxhi publik 300 miliardë euro, papunësia 27 % e forcës aktive të punës, importet 2 herë më të mëdha se eksportet. Inflacioni arriti në 5.1 % (sipas BQE 2 %). Punonjësit janë paguar 14 paga. Janë dhënë shuma të mëdha për pensione të parakohshme (shif e.g. Llojdia, 2013). Ajo që ka ndodhur është rezultat i një serie të gjatë të vendimeve të këqija. Që nga koha kur ekziston euro, raporti i borxhit të Greqisë ndaj BPB-së ka qëndruar mbi 100 % dhe vendi u zhyt në defiçite të vazhdueshme (Merovci, 2008:131).

Greqisë i duhet që të bëjë një program më të rreptë, duke përfshirë shkurtime të mëdha në paga e pensione publike dhe një mori të tatimeve të reja, sepse ndihmat të cilat i janë dhënë Greqisë nuk mund t'i sigurojnë asaj një stabilitet ekonomik, e as që bëhet fjalë për këtë, duke ditur se të gjitha borxhet të cilat i janë dhënë Greqisë nga institucionet financiare, që të gjitha kanë një normë të kthimit. Kjo nënkupton se të gjitha borxhet duhen kthyer me një rritje të interesit, dhe sado e lehtë që të jetë ajo, prapë është e vështirë për Greqinë, po të bazohemi në atë se në çfarë gjendje të rëndë ekonomike është shteti grek. Po ashtu, duhet theksuar se një ndër problemet e shtetit grek është edhe evazioni fiskal apo shmangia e pagesës së tatimit. Kjo bëhet kryesisht duke fshehur të ardhurat që fitojnë, pra duke deklaruar vetëm një pjesë të vogël të të ardhurave, për të evituar kështu pagimin e taksave të shtetit. Të gjithë faktorët apo shkaqet që u cekën më lart, tregojnë për fillimin e krizës greke.

Po ashtu, kriza ekonomike dhe financiare ka pasur ndikim edhe në aspektin politik të vendeve të ndryshme. Kjo ka bërë që të ndërrohen shumë qeveri. Pra, ndikim të madh politik kishte mbi qeveritë në pushtet në 8 nga 17 vendet e Eurozonës, duke çuar në ndërrime të pushtetit në Greqi, Irlandë, Itali, Portugali, Spanjë, Slloveni, Sllovaki dhe Hollandë.

Pas përhapjes së krizës në Greqi, shumë shpejt kemi përhapjen e po të njëjtës krizë edhe në shtetet e tjera, siç janë: Portugalia, Italia, Irlanda dhe Spanja. Këto vende po përballen me pasoja të rënda ekonomike, kriza ka ndikuar po ashtu edhe në shqetësimin e shumë investitorëve.

Fillimisht kriza financiare u shndërrua në një krizë klasike të borxhit publik, pasi qeveritë u pozicionuan për të garantuar detyrimet bankare. Nga ana tjetër, kjo krijoi një seri të re shqetësimesh për bankat që janë mbingarkuar (Merovci, 2008:124).

Europës i duhet një rritje e shpejtë dhe e qëndrueshme në mënyrë që të kalojë problemet me të cilat po përballlet. Kriza ka filluar si pasojë e marrjes së borxheve të mëdha dhe nga mosmenaxhimi efikas i këtyre mjeteve, domethënë nuk është investuar në investime profitabile por i kanë alokuar në projekte apo investime të cilat më pastaj nuk kanë dhënë rezultatet e pritura. Impaktet e krizës janë shumë të mëdha kur dihet se çfarë kapitali ka prekur dhe se pasojat nga kjo krizë do të jenë shumë të mëdha për këtë kohë, por edhe më të mëdha do të jenë për gjeneratat e ardhshme, sepse i gjithë ky borxh duhet paguar. Kjo i ngarkon më shumë gjeneratat e ardhshme, gjë e cila vjen si pasojë e keqmenaxhimit dhe marrjes së vendimeve të gabuara nga udhëheqësia e tanishme. Kjo barrë përfshin borxhin publik (borxh i marrë nga qeveria) dhe borxhin e jashtëm (borxh i vendit, si tërësi, ndaj të huajve).

Pas krizës financiare në Greqi, kemi përhapjen e krizës edhe në Itali. Impaktet e kësaj krize janë të mëdha, por qeveria italiane ka deklaruar se do t'i tejkalojë këto probleme ekonomike, pa pasur nevojë për ndihmë financiare nga vendet evropiane. Vendimi i qeverisë italiane ka qenë i rëndësishëm dhe i drejtë, në mënyrë që krizën financiare ta tejkalojë me mundësitë e veta, pa u ngarkuar me borxhe të reja, sepse duke hyrë në borxhe të reja shtohen edhe me tej obligimet në të ardhmen, gjë që sjell një të ardhme të pasigurt, aq më tepër kur dihet se edhe kreditë më të buta nga institucionet financiare, prapë se prapë duhet të paguhen (Merovci, 2008:124). Duke u nisur nga vëllimi ekonomik, Italia bën pjesë në 7 shtetet më të industrializuara të botës, duke u renditur e katërta në Europë. Kriza që ka prekur Italinë ka ndikuar shumë në jetën e qytetarëve të cilët jetojnë në Itali. Si pasojë e paraqitjes së krizës financiare është rritur numri i të papunëve dhe jeta e qytetarëve është vështirësuar si pasojë e përkeqësimit ekonomik.

Spanja u bë vendi i katërt i Eurozonës që kishte nevojë për ndihmë financiare, pas Greqisë, Irlandës dhe Portugalisë. Ndërkohë që Spanja përjetonte vitin e pestë të rënies ekonomike, rinia e këtij vendi mbante në kurriz një pjesë të pabarabartë të barrës. Me papunësinë e përgjithshme prej 25 përqindësh, shkalla e papunësisë mes spanjollëve nën 30 vjeç është 50 %. (Merovci, 2008:175). Po ashtu, edhe Portugalia është prekur nga kriza financiare globale, por gjendja ekonomike është më e mirë së ajo e Greqisë. Problemi është i njëjti në të gjitha shtetet, “borxhi” e nivelet e tij janë problematike, dhe nëse vazhdon kjo gjendje e rëndë ekonomike, shumë vende do të kërkojnë ndihmë financiare. Një ristrukturim i rëndësishëm i borxhit privat dhe / ose publik, ka të ngjarë të jetë i nevojshëm në të gjitha vendet e Eurozonës. Në fund të fundit, dhënia e ndihmës nga BE-ja dhe FMN-ja janë vetëm një masë e përkohshme.

I gjithë problemi financiar dhe ekonomik në vendet e ndryshme, mund të ndryshohet nëse punohet më shumë në këtë drejtim, duke marrë masa stabilizuese dhe njëkohësisht duke vendosur masa shtrënguese në ekonomi, në mënyrë që të vihet gjer tek një stabilitet ekonomik, i cili është shumë i vështirë për t’u arritur në këtë kohë.

2.6.1. Europa e bashkuar dhe kriza ekonomike

Që kur lindi ëndrra dhe idea europiane, ka filluar edhe lufta mes optimistëve, skeptikëve e nihilistëve, që promovojnë ose mohojnë sendërtimin e të ardhmes së saj. Kriza e zgjatur ekonomike e Eurozonës iu dha zemër euroskeptikëve e nihilistëve të rinj, madje frymëzoi së shumti partitë ekstremiste, duke shfaqur dukurinë e rënies së ndjeshme të besimit e mbështetjes për partitë tradicionale, duke i akuzuar ato si të korruptuara e të dështuara. Është e nevojshme të mos lejohet që ëndrra dhe idea europiane të futet në krizë, që euroskeptikët të rrisin avantazhin që kanë fituar, që partitë antieuropiane të përfitojnë nga situata në kushtet kur disa parti tradicionale po largohen duke humbur zgjedhjet elektorale. Popujt e vendeve europiane janë realisht garantuesit e fuqishëm të projektit europian, sepse e kanë dashur dhe e duan këtë projekt, por nevojiten edhe parti politike me besim, vizion europian e aftësi të zhvilluara për ta çuar më përpara projektin europian.

Qytetarët europianë, prej paraqitjes së krizës ekonomike e deri më sot, po kalojnë ditë të vështira ekonomike, duke u përballur me presionin e masave të ashpra ekonomike dhe reduktim të shpenzimeve publike. Le të shpresojmë që shumë shpejt, të kemi një ekonomi më

të fortë dhe të qëndrueshme, që do të sigurojë një standard jetësor më të mirë për qytetarët. Europa është përfshirë jo vetëm nga kriza ekonomike, por edhe nga kriza e besimit të politika. Qytetarët e BE-së besojnë pak tek aftësitë e politikanëve drejtues për dalje nga kriza (DW, 2012).

Ndryshimi është princip themelor i projektit europian të bashkimit dhe i ecursisë së suksesshme të tij deri sot. Europa ka ardhur deri këtu duke ndryshuar me vendosmëri përmes hapave e vendimeve të rëndësishëm, duke u shndërruar në një aktor të rëndësishëm në sistemin e marrëdhënieve ndërkombëtare. Europa ka ndryshuar, jo vetëm kur është dashur të përballohen probleme të vështira, por edhe kur është dashur të thellohet e të zgjerohet procesi i projekti europian. Ajo ka ndryshuar edhe kur kishte qëndrueshmëri e rritje të kënaqshme ekonomike, edhe kur besimi për BE-në ishte në nivele të larta, por edhe kur besimi u ul së tepërmi. Në një pjesë të madhe të shteteve të Bashkimit Europian, po rritet mosbesimi ndaj projektit Europë. Sipas një studimi të Qendrës Studimore Amerikane (Mars, 2012), vetëm 45 % e qytetarëve të BE-së shprehen pozitivisht për BE-në. Para një viti ishin 60 %. (Dodi, 2012). Bruce Strokes, njëri nga autorët e studimit të Qendrës Studimore tha: “problemi më i madh është kriza ekonomike. Ajo ndikon gjithçka. Dhe bindja se projekti Europë, politika e përbashkët ekonomike është e mirë për njerëzit, po zhduket. Shumë thjesht, nuk e besojnë këtë” (Strokes, 2012).

2.6.2. Nga kriza financiare te kriza ekonomike

Përballimi i krizës së zgjatur të Eurozonës çoi në definimin e disa masave që synonin daljen nga kriza dhe rifillimin e rritjes ekonomike, masa të cilat u formësuan nga një analizë e shfaqjes së krizës në këto vende. Masat, si të thuash u unifikuan edhe si koncept profesional, por edhe që të mos krijohej ndonjë përshtypje negative në vendet e veçanta nën krizë. Këto masa janë përgatitur nga ekspertë të BE-së, por në diskutim e miratim me drejtuesit e vendeve nën krizë. Tashmë ajo njihet si paketa e masave shtrënguese që përfshijnë edhe ndihma e dhënie borxhesh, por edhe masa për reforma të rëndësishme strukturore, ekonomike e financiare, edhe masa për përmirësimin e qeverisjes dhe administrimit ekonomik, por edhe për forcimin e shtetit juridik dhe luftën kundër korrupsionit qeveritar e evazionit fiskal.

Kriza aktuale në Europë nisi si krizë financiare, si krizë e “kredive bankare”. Si në shumë vende të botës, edhe në Europë, një numër i madh bankash u ndodhën papritur përpara një numri të madh kreditorësh, që nuk ua kthenin dot më kreditë e marra. Në këtë situatë doli në pah edhe se shumë banka nuk kishin ruajtur kapital të mjaftueshëm vetjak. Aktivitetet financiare ato i kryenin në një masë më të madhe se kufiri i nevojshëm me para “të huaja”, p.sh. të shtetasve të tjerë që ua jepnin bankave këto para hua në formë investimesh, aksionesh e kursimesh të depozituara nëpër banka. Pikërisht këto para, bankat i kishin futur në qarkullim për të nxjerrë fitime, duke i dhënë hua edhe në formë kredish, tanimë të pakthyeshme.

Por kredi te bankat nuk kishin marrë vetëm qytetarët, por edhe vetë shtetet. Dhe këtu ndërhyjnë një faktor i dytë, specifik për krizën europiane: kriza e euros.

Me futjen e euros si monedhë vendase, marrja e kredive shteteve borxhmarrëse iu kushtonte më lirë, pasi në sajë të Eurozonës interesat bankare ishin më të ulëta. Shtete si Greqia, Italia, Portugalia e Spanja, pa shtuar prodhimin, pra të ardhurat, shtuan shpenzimet, të cilat i financonin me borxhe. Administrata shtetërore joefikase, shpesh gjigante, dhe tregje pune jo të zhdërvjelltë në këto vende, vazhduan t’i marrin frymën ekonomisë. Që prej futjes në Eurozonë, sidomos shtetet e jugut të Europës, nuk përdorën dot më as mjetin e emergjencës: zhvlerësimin e monedhës kombëtare për të shtensionuar ekonominë. Tani monedha është e përbashkët.

2.6.3. Nga kriza ekonomike te kriza sociale dhe politike

Mbërritja e shteteve në borxhe në buzë të falimentimit, përkeqësoi gjendjen e përgjithshme ekonomike në vendet e BE-së: shtetet kanë pakësuar investimet dhe të detyruara kanë nisur reforma të ashpra strukturore, për të pakësuar shpenzimet vetjake (PEW, 2013). Kudo janë shkurtuar subvencionet shtetërore: në arsim, në sistemet e mbështetjes sociale; papunësia, sidomos tek të rinjtë, është thelluar edhe më tej. Pagat dhe pensionet në shumicën e vendeve të BE-së janë ulur, duke shkaktuar pasiguri për të ardhmen dhe protesta kudo në Europë. Kriza financiare është kthyer në krizë të përgjithshme ekonomike dhe sociale. Por edhe politike.

E gjithë kjo, nxjerr në pah një fakt të përbashkët për këto vende: mosbesimin e qytetarëve te politikanët që i drejtojnë. Njerëzit nuk besojnë se politikanët që i drejtojnë, janë të aftë të gjejnë një rrugëdalje. Qytetarët kanë ndjesinë se e kanë humbur kontrollin mbi proceset në Europë. Detyrohen të pranojnë gjëra, që u paraqiten pa alternativa, si zgjidhjet e vetme të mundshme.

Gjermanët p.sh., detyrohen të aprovojnë paketa të reja kredish për vendet në borxhe, europianët e jugut në borxhe detyrohen të aprovojnë paketa të reja kursimesh. Më tej, shumë ekspertë mendojnë se ekzistojnë probleme edhe me mënyrën e marrjes së vendimeve në BE. Shpesh vendimet merren në mbledhje jopublike nga eurogrupi apo trojka, dhe parlamentet detyrohen thjesht t'i miratojnë ato. Kjo mënyrë jodemokratike e marrjes së vendimeve, nuk sjell mbështetje për vendimet e marra. Një pjesëmarrje reale e parlamenteve dhe qytetarëve në vendimmarrje, do të ishte rruga më e përshtatshme.

Më e keqja është se akoma nuk po tregohet reflektim për këtë dëmtim të madh të projektit europian. Nuk duhet lejuar të luhet me fatkeqësinë dhe sentimentet e popujve nga askush. Edhe njeriu më i thjeshtë e di se borxhi që merret, duhet kthyer. Kjo vlen edhe për qeveritë që marrin borxhe. Po kështu, të gjithë e dinë se huadhënësit, nuk janë misionarë të filozofisë së Nënë Terezës. Ata edhe ndihmojnë, por edhe llogarisin të fitojnë. Në fakt, ky është thelbi i kapitalit. Kapitali është shumë i vlefshëm, por i egër, i ftohtë e jo human. Po kështu, edhe pse mendohet qetësisht se Greqia mund të vendosë të dalë nga BE-ja, pavarësisht se kjo sjell një problematikë komplekse, nuk po duket ndonjë reflektim i thelluar nga strukturat e BE-së, që dëshmon se sa të papërgatitur kanë qenë për këtë zhvillim problematik.

2.6.4. Euro dhe Bashkimi European

Monedha e përbashkët e vendeve të BE-së, EURO, nuk është thjesht projekt ekonomik. Ai është në rradhë të parë një projekt politik. Ky projekt nisi më 1992 me Marrëveshjen e Mاستrihtit. Kjo marrëveshje e rreth 20 viteve më parë vuri themelet e europolitikës. Synimi atëherë ishte të bashkohej Europa, pas kolapsit të Bashkimit Sovjetik, në një zonë model të mirëqenies.

Federalizmi i Europës, një buxhet i përbashkët europian, me një ministër financash të plotëfuqishëm për të ndërhyrë në politikat nacionale financiare të shteteve europiane, politika të unifikuara taksash e pensionesh, të mbrojtura nga parti europiane, ky ishte dhe është vizioni i synuar i mbështetësve të Europës. Nga ana institucionale, bashkimi fiskal dhe bankar i vendeve të BE-së do t'i vinte kapakun ngrehinës ende të paplotë. Në thelb do të kishim një dorëzim të mëtejshëm të sovraniteteve kombëtare tek Brukseli. Por, siç është thënë me të drejtë: reformat duhet të bëhen në kohë të mira, jo në kohë krize. Për momentin, vizioni i synuar është më se i largët. Kriza ua ka kthyer kombeve europiane vështrimin tek vetja.

Mosvazhdimi i ristrukturimit të BE-së me bazë euron, ka nxjerrë në pah probleme të ndërtimit të Eurozonës: euro ka bashkuar vende me ekonomi të strukturuara krejt ndryshe, në veri dhe në jug të Europës, vende më të pasura dhe të varfra, vende, me ekonomi të bazuar tek eksporti me vende të tjera, me ekonomi të bazuar tek shërbimet. I ka bashkuar mbi bazën e vetëm pak rregullave. Këtu qëndron thelbi i krizës aktuale: jo tek euroja, te krijimi i Eurozonës, por te projekti i papërfunduar politik i Evropës, me eurozonën.

Nëse nuk reflektohet e kryhet një shkundje e shëndoshë, mund të lindë alternativa ose do të shtrohet mprehtë një kërkesë: do të shkojë përpara projekti europian, duke u përmbyllur sipas standarteve e principeve të doktrinës së shtetit e të së drejtës, apo do të lindë nevoja e një kthimi prapa në formën e një Europe politike me disa mundësi bashkëpunimi dhe rikthim i formës së bashkëpunimit ekonomik të ngjashëm me ish TPE. Natyrisht, që kjo do të kishte dhimbje të mëdha dhe kosto të rëndë komplekse gjithashtu. Kjo do të thoshte që edhe BE të pësonte fatin e shpërbërjes së BS apo të ish Jugosllavisë, që do të thotë fitore e shteteve të pavarura, kombe mbi format të tipit të federatës apo konfederatës. Me sa duket, forma europiane e raportit mes ekonomisë së tregut, shtetit social dhe mbrojtjes sociale, forma e bashkimit të vlerave të përbashkëta, do të mundësohej jo si strukturë bashkimi, por si shtete - kombe. Ndoshta tregu dhe shteti kanë një limit marrëdhënieje reciproke mes tyre, që shfaqet ndryshe në nivelin e shtetit - komb dhe ndryshe si bashkësi shtetesh - kombe. (Kureta, 2015)

2.6.5. Qytetarët e BE-së duan të drejta vendimmarrëse

Gjithmonë ka ide pro dhe kundër ndaj pothuajse të gjitha iniciativave kombëtare e posaçërisht atyre ndërkombëtare. Rëndimi i gjendjes ekonomike kudo në Europë ka shtuar mbështetjen për euroskeptikët. Jo vetëm në vendet e krizës në jug të Europës, si në Greqi e Itali, por edhe në Gjermani, janë shtuar zërat që kërkojnë fundin e Eurozonës, dhe bashkë me të, fundin e projektit aktual europian. “Alternativa për Gjermaninë”, partia e themeluar vetëm pak muaj më parë në Gjermani, merr aktualisht sipas sondazheve tre përqind të votave të zgjedhësve. Mbështetja për këto parti flet për një krizë legjitimiteti të BE-së. I shqetësuar për këtë gjendje, presidenti i Komisionit Europian, Jose Manuel Barroso, kujtoi pak ditë më parë se “nuk mjafton që një politikë e caktuar të jetë konceptuar si duhet. Që të ketë sukses, ajo duhet të marrë një minimum mbështetjeje nga qytetarët.” (Barroso, 2014)

Vende që mbështesin politika më të ashpra reformash dhe kursimesh, si Gjermania, Danimarka, Hollanda, Finlanda etj., duket se po tolerojnë heshtur një zbutje të disa kërkesave. Njëra prej tyre është kërkesa për një ulje të shpejtë të deficitit buxhetor.

Kështu, nga njëra anë po pranohet një ngadalësim i ritmeve të uljes së deficitit buxhetor. Spanjës për shembull, iu dhanë edhe dy vjet kohë, para se të fillojnë procedurat e BE-së, që i ndëshkojnë vendet që shkelin kufinj të deficitit buxhetor të përcaktuar nga BE. Francës, të zhytur në recesion, pritet t'i jepet edhe një vit kohë në dispozicion për të ulur deficitin buxhetor, në këmbim të premtimit për përsheptimin e reformave strukturore.

2.6.6. Modeli gjerman i suksesit antikrizë

Gjermanët kanë vendosur t'i ndihmojnë të tjerët edhe duke eksportuar një nga "sekretet" që i ka ndihmuar ata në dekada të luftojnë papunësinë. Federata gjermane vendosi të nënshkruajë me Spanjën një marrëveshje, me të cilën Gjermania zotohet ta mbështesë Spanjën për të ngritur edhe ajo një "sistem të dyfishtë të trajnimit profesional"⁵, shumë i suksesshëm në luftimin e papunësisë në Gjermani. Sipas këtij sistemi, të rinjtë punojnë tre ose katër ditë në javë në një qendër pune, ndërsa pjesën tjetër të kohës, 8 deri 12 orë në javë e kalojnë në shkollë. Në fund të trajnimit, studentët duhet të kalojnë një test dhe fitojnë kështu një dëshmi aftësish.

Po ashtu, Gjermania u deklarua se do ta ndihmojë Portugalinë të ngrejë një bankë, e cila do të mbështesë financiarisht punësimin e të rinjve nën 25 vjeç. Nga ana tjetër, Gjermania dhe vende të tjera, kërkojnë që vendet me borxhe, të përshejtojnë reformat strukturore, pra të zhdërvjelltësojnë tregun e punës e të produkteve, si dhe ta bëjnë administratën publike më efikase, në mënyrë që këto vende të bëjnë ato reforma të cilat Gjermania i nisi 10 vjet më parë me "Agenda 2010", të iniciuar nga kancelari Gerhard Schröder. Suksesin e këtyre hapave Gjermania po e përjeton sot.

Në këtë kuadër, Gjermania dhe Franca pritët të shpallin në qershor një iniciativë, për të nxitur ekonominë dhe punësimin në Europë. Megjithë mosmarrëveshjet me njëra - tjetrën për politikën ekonomike me të cilat Europa mund të dalë nga kriza, Gjermania dhe Franca, motorri ekonomik dhe politik i Europës, e ndiejnë nevojën emergjente për veprime, nevojën për një përpjekje të re, që Europa të mos i humbasë qytetarët e saj.

⁵Ministrja gjermane e Punës, Ursula von der Leyen, nënshkroi marrëveshje për mbështetjen e Mbretërisë Spanjolle për tejkalimin e krizës.

2.7. Iniciativat për përballimin e krizës

Kriza financiare globale konsiderohet si një ndër krizat më të mëdha, pas asaj të viteve 1929 - 1930, ndërsa nëse e analizojmë nga aspekti i përfshirjes së kapitalit nga kjo krizë, atëherë mund të thuhet se kriza e sotme është me dimensione më të mëdha se sa kriza e viteve 1929 - 1930. Për çdo problem duhet të ekzistojë zgjidhja, edhe pse është shumë e vështirë të gjendet një formulë për të gjitha shtetet, të cilat duhet bërë disa hapa drejt daljes nga kriza. Dihet se kemi të bëjmë me një krizë sistimore financiare e cila do të kalojë, por do të mbesin pasoja të thella në strukturën e sistemit financiar global. Një sërë nismash dhe veprimesh janë marrë nga qeveritë dhe institucionet ndërkombëtare për të minimizuar rreziqet dhe pasojat e krizës. Të tilla kanë qenë (Angjeli, 2012:196):

- takimet, vendimet, nismat e Federal Rezervës në SHBA për ndryshime në politikën monetare;
- takimet dhe nismat e FMN-së për rritjen e vëmendjes ndaj krizës globale, të kredive, asaj të naftës dhe të çmimeve të produkteve ushqimore;
- takimet dhe vendimet e OPEEC-ut⁶ për kuotat e prodhimit dhe çmimit të naftës;
- takimet dhe vendimet OKB-së për krizën ushqimore;
- takimet dhe vendimet e nismat e G 7-s, G 8-s për krizën e tregjeve financiare ndërkombëtare, të tregjeve ndërkombëtare të naftës dhe të çmimeve të produkteve ushqimore;
- vendimet e qeverisë amerikane për “injektimin e ekonomisë amerikane” përmes një mbështetjeje prej 150 miliardë USD;
- nismën e dhjetë bankave private amerikane për krijimin e një fondi prej 7 miliardë USD amerikanë për mbështetje në minimizimin e risqeve të kësaj krize;

⁶OPEC është akronim për "Organization of the Petroleum Exporting Countries" (Organizata e Shteteve Naftë - Eksportuese). Ajo u themelua më 14 shtator 1960 në Bagdad (Irak). Që prej vitit 1965 e ka qendrën në Vjenë. Anëtarët e parë ishin: Irani, Iraku, Kuvajti, Arabia Saudite dhe Venezuela. Më vonë, iu bashkangjitën edhe Katari, Indonezia, Libia, Emiratet e Bashkuara Arabe, Algjeria dhe Nigeria. Ekuadori ishte anëtare prej vitit 1973 deri më 1992, kurse Gaboni ishte anëtare prej vitit 1975 deri më 1994

Banka Qendrore Europiane (BQE) hodhi 70 miliardë euro likuiditete në bursat europiane, me qëllim shmangien e tensioneve, duke shënuar kështu operacionin e dytë financiar për minimizimin e krizës financiare (në operacionin e parë hodhi 30 miliardë euro);

Gjithsesi, ringjallja e ekonomisë globale me masat shtetërore, do të varet nga ringjallja e partnerëve kryesorë tregtarë të SHBA-ve (UE, Japonia, Kina etj), në rast se përmirësimi i ekonomive të tyre do të jetë më i ngadalshëm. Atëherë recesioni në ekonominë globale do të zgjatet (Selmani, 2009).

Shumëçka në sistemin financiar dhe në organizimin e institucioneve financiare, në rolin dhe funksionimin e tyre, në produktet financiare, në metodat e rregullimit dhe të mbikqyrjes, patjetër do të ndryshojë. Të paktë janë ata të cilët mund të dinë se si do të duket sistemi financiar i së nesërme. Kalimi i krizës financiare globale në sektorin real të ekonomisë, e cila konkretisht po përcillet me rënie të prodhimit, rritjen e papunësisë dhe rënie të GDP (bruto prodhim vendor), ka shënuar fillimin e krizës ekonomike globale. Përmasat e këtij recesioni global, po bëhen gjithnjë e më shumë të pakontrolluara, kurse kohëzgjatjen tashmë askush nuk mund ta dijë.

Edhe pse është menduar që ekonomia globale do të përmirësohet pas masave antirecesive të Presidentit Obama për ringjalljen e ekonomisë amerikane (shkurt, 2013), nga ngjarjet e fundit po vërehet se implementimi i masave nga ana e administratës amerikane nuk është duke dhënë rezultatet e dëshirueshme në bursat amerikane, të cilat nga momenti i parë i lajmërimit të programit, kanë pësuar rënie në minimumin e ri. Kështu që, Dow Jones ka shënuar rënie 10 %, kurse bursat europiane po vazhdojnë me rënie rapide pas lajmërimit të rezultateve bankare për vitin e kaluar afarist (Young, 2016).

Siç u theksua më lart, ringjallja e ekonomisë globale varet nga ringjallja e partnerëve kryesorë tregtarë të SHBA-ve (UE, Japonia, Kina etj). Ndërsa, nëse analizojmë thirrjen e Kryetarit amerikan drejtuar korporatave dhe qytetarëve amerikanë, që ata të blejnë vetëm prodhimet “Made in USA”, nuk mund të llogaritet për një ringjallje të shpejtë të partnerëve të saj tregtarë. Kjo do t’i kushtojë Amerikës me vazhdimin e recesionit dhe me përkeqësimin e ekonomisë në tërësi. Arsyeja është e thjeshtë, kur dihet se deficitin buxhetor i SHBA-ve, varet nga shitja e obligacioneve shtetërore pikërisht këtyre partnerëve tregtarë. Pra, ky defiqit buxhetor, i cili

është 2 miliardë në ditë, mund të mbulohet vetëm nga sufiçiti i Japonisë, Kinës, Gjermanisë, Holandës, Norvegjisë (Selmani, 2009).

Nxitja e politikave fiskale dhe e masave për stabilizimin e institucioneve financiare, si dhe të tregut financiar, do të ndihmojnë për daljen nga recesioni. Pra, shteti përsëri duhet të inkuadrohet që t'i përmirësojë "gabimet" e tregut, të cilat kryesisht lajmërohen gjatë periudhave të normave të larta të rritjes ekonomike (prosperitetit). Kryesisht, kjo ndodh për shkak të dëshirës së paskrupullt për profite. Është e njohur tashmë se shteti nuk është treguar pronar dhe menaxher i suksesshëm në ekonomi. Për këtë do të duhet të bëhen mjaft përpjekje, që masat antirecesive të cilat po ndodhin, të jenë efikase. Këtë e garanton vetëm suksesi. Në rastin e kundërt, po qe se suksesi është i pamjaftueshëm, atëherë është i mundshëm thellimi i krizës ekonomike dhe vazhdimi i recesionit me pasoja katastrofike për ekonominë globale (Selmani 2, 2009).

Një ndër mundësitë për dalje nga kriza financiare dhe ekonomike në vendet e ndryshme, është unifikimi për daljen nga kriza. Kështu, duke aplikuar politika të përbashkëta, mund të arrihet deri te një situatë më e mirë. Vendet në zhvillim kanë mundësi më shumë për t'u përballur me krizën, dhe normalisht, deri tani ia kanë dalë mirë të përballen me të, por kjo nuk mjafton për të mundur krizën. Kështu që, këto vende duhet të rikrijojnë politika dhe të forcojnë rregullatorët financiarë.

Përmirësimi i situatës ekonomike globale do të varet nga suksesi dhe kohëzgjatja e masave antirecesive, të cilat po i ndërmarrin ekonomitë e vendeve më të fuqishme në botë. Kjo njëkohësisht, është një ndër mënyrat më të rëndësishme për të dalë nga kriza ekonomike që ka përfshirë botën. Duhet të merren të gjitha masat për daljen nga kriza, edhe pse askush nuk mund të dijë se sa do të zgjasë kjo gjendje e rëndë ekonomike, por është e rëndësishme marrja e masave antirecesive përmes programeve të stabilizimit, në mënyrë që të shpëtohet ajo çka është e mundshme të mbrohet.

2.7.1. Koordinimi ndërkombëtar dhe implikimi i organizatave ndërkombëtare financiare në krizën globale

Meqenëse kriza aktuale është një krize globale, e cila edhe efektet e ka po globalisht, është i rëndësishëm dhe i domosdoshëm një koordinim ndërkombëtar i tyre. Tani, më shumë se kurrë, kjo është e nevojshme pasi për shkak të rritjes së tregtisë, politika fiskale nuk ka pasur atë efekt në kërkesën agregate.

Thirrjet për të koordinuar iniciativat e politikës fiskale janë të shumta, duke përfshirë këtu deklaratat nga G 20⁷ në nëntor 2008 dhe nga plani i shpëtimit të BE-së:

Ndikimi i një koordinimi inteligjent shton forcën për të penguar tendencën drejt një recesioni më të thellë. Një Europë e gatshme për të ndërmarrë shpejt aksione ambicioze dhe të synuara mirë, do të ishte një Europë në gjendje për t'i vendosur frenat rënies dhe për të ndërruar valë.

“O mbytemi, ose notojmë së bashku!, ishin fjalët e Jose Manuel Barroso, Presidentit të Komisionit Europian në mbledhjen e nëntorit të vitit 2008, për Planin e Rimëkëmbjes Ekonomike Europiane, ku i vihej theksi një politike të targetuar dhe të koordinuar mirë. Duke ndjekur politika fiskale kombëtare dhe të pakoordinuara, ndikohet në kërkesë - ofertën dhe rrjedhimisht do të ketë efekte në partnerët tregtarë.

Rrjedhjet e kërkesës mund të zvogëlojnë nxitjen për të ndjekur politika ekspansioniste të tipit rritje të eksportit, për shkak se këto nuk janë marrë parasysh në procesin e krijimit të politikave. Megjithatë, nuk është e thënë që është stabilizuar një deficit dhe ai nuk mund të ndryshojë më. Në fakt shohim dy tendenca të politikave fiskale (Vrioni, 2013).

Nga njëra anë, shohim tendencën që kanë paketat stimuluuese fiskale për të nxitur kërkesën për produktet vendase, e ashtuquajtur politikë proteksioniste, e cila pengon tregtinë e lirë.

Nga ana tjetër, shohim një ndryshim të përbërjes së paketave stimuluuese fiskale që kanë për qëllim më tepër nxitjen e kërkesës publike sesa asaj private. Kërkesa publike i drejtohet

⁷G 20-a u formua në vitin 1999 dhe mbajti takimin e parë po atë vit. Deri në vitin 2008, G 20-a ishte lënë në hije nga G8-a e cila përfshinte Francën, Gjermaninë, Italinë, Japoninë, Britaninë e Madhe, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadanë dhe Rusinë. Gjithçka ndryshoi me krizën financiare të vitit 2008, vit në të cilin G 20-a praktikisht zëvendësoi G 8-en si forumi kryesor ekonomik në botë. Rritja shumë e madhe ekonomike e anëtarëve të G 20-ës si: Kina, India dhe Brazili, ka kontribuar në rritjen e rëndësisë së këtij grupimi. Aktualisht G 20-a mbledhet dy herë në vit, por duke filluar nga viti 2011 ajo do të mbledhet vetëm një herë në vit. Pjesëtarë të G 20-s janë: Afrika 1. Afrika e Jugut, Amerika e Veriut; 2. Shtetet e Bashkuara të Amerikës; 3. Kanadaja; 4. Meksika, Amerika e Jugut; 5. Brazili; 6. Argjentina, Azia; 7. Kina; 8. Japonia; 9. Koreja e Jugut; 10. India; 11. Indonezia; 12. Arabia Saudite, Euroazia; 13. Rusia; 14. Turqia, Oqeania; 15. Australia, Europa; 16. Franca; 17. Britania e Madhe; 18. Gjermania; 19. Italia; 20. Bashkimi Europian

sektorëve jo të tregtueshëm dhe si rrjedhim kjo lloj politike ka një efekt të dyfishtë midis aktivitetit të brendshëm dhe atij të jashtëm.

Nga moskoordinimi i politikave mund të ndodhë që politikat fiskale të vendeve të drejtohen më shumë drejt kërkesës publike se sa drejt asaj private.

- Një ndër pasojat ekonomike të krizës globale ka qenë ulja e kërkesës agregate. Duke qenë se nuk pritet që politika monetare të ketë shumë ndikim në të, vëmendja është kthyer më shumë drejt instrumenteve të politikës fiskale. Globalizmi ka qenë një ndër faktorët që ka ndikuar në krijimin e krizës dhe propagandimin e saj, njëkohësisht mund të jetë si një faktor që e bën politikën fiskale më pak efektive.
- Duhet të kemi një koordinim të politikës fiskale me politikën monetare dhe një koordinim ndërkombëtar me qëllim shmangien e efekteve të padëshiruara në marrëdhëniet tregtare.
- Në kushtet aktuale, instrumentet e politikës fiskale do të jenë efektive kundrejt kërkesës agregate, pasi niveli i saj është shumë i ulët dhe kemi mungesë likuiditeti në treg.
- Politika aktuale fiskale do të shkaktojë një nivel të lartë të borxhit publik në të ardhmen. Problemi kryesor është si do të ndryshojë ajo pas krizës dhe si do të bëjë të mundur normalizimin e gjendjes.

Termi “Securitisation” që shoqëroi këtë etapë kohore, ka të bëjë me një proces i cili ka si objekt kryesor ndryshimin e strukturës financiare të një kompanie. Me anë të këtij procesi, mbledhen instrumentet e borxhit në një portofol dhe më pas, gjenerohen letra me vlerë të cilat do të blihen nga investitorë të ndryshëm. Instrumentet e krijuar nga ky proces janë:

- “Term Asset - Backed Securities Loan Facility” (TALF)⁸
- “Mortgage - backed securities” (MBS)⁹

⁸Term Asset - Backed Securities Loan Facility (TALF) është një program i krijuar nga Rezerva Federale e SHBA-së për të nxitur kreditimin e kreditit të konsumatorit. Programi u njoftua më 25 nëntor 2008 dhe dedikohet për të mbështetur lëshimin e letrave me vlerë të aseteve të mbështetur (ABS)

⁹MBS është një lloj i sigurimit të aseteve të mbështetur se është siguruar nga një peng apo nga mbledhja e hipotekave.

Kjo praktikë dështoi. Bankat qendrore dhe qeveritë e vendeve të ndryshme filluan të blejnë asete të rrezikshme e të mbështesin sistemin bankar me programe të sigurimit të likuiditetit, duke u bërë ata vetë investitorët e fundit të letrave me vlerë, të gjeneruar nga procesi “Securitisisation”.

Disa nga organizatat më të rëndësishme financiare në botë, janë vënë në lëvizje për shkak të krizës, ndër të cilat mund të përmendim:

- Fondi Monetar Ndërkombëtar (FMN)
- Grupi i të 20-ve (G 20)
- Banka Botërore
- Grupi i të 7-ve (G 7)

2.7.2. Fondi Monetar Ndërkombëtar - FMN

Fondi Monetar Ndërkombëtar¹⁰ u konceptua në korrik të vitit 1944 në një takim në qytetin e Bretton Woods, New Hampshire, SHBA, ku morën pjesë përfaqësuesit e 45 qeverive dhe u ra dakord për një bashkëpunim ekonomik ndërkombëtar. U legjitimua në vitin 1945 dhe sot ka anëtarësimin e 185 vendeve. Tre qëllimet kryesore, që përbëjnë aktivitetin e saj, janë:

- Monitorimi i zhvillimeve kombëtare, globale dhe rajonale ekonomike e financiare të vendeve anëtare, si dhe këshillimi në lidhje me politikat e tyre ekonomike.
- Dhënia e kredive vendeve me qëllim mbështetjen e politikave për rregullimin e bilancit të pagesave.
- Ofrimi i eksperiencës dhe trajnimit të zyrtarëve të qeverive dhe bankave qendrore.

Që nga themelimi, FMN gjithnjë është përmbajtur në qëllimin për të cilin u themelua, por teknikat e veprimit dhe mënyrat e reagimit ndaj problemeve të shteteve të ndryshme, si dhe numri i shteteve pjesëmarrëse gjatë viteve, ka ndryshuar.

¹⁰Fondi Monetar Ndërkombëtar (shkurt: FMN, anglisht: IMF) është një organizatë ndërkombëtare e 184 vendeve me seli në Washington D.C. Qëllimi primar i themelimit të Fondit Monetar Ndërkombëtar ka qenë që të krijohet një bashkëpunim monetar mes vendeve, stabilitet monetar në këmbim dhe marrëveshje të rregullta të këmbimit monetar për të shpejtuar rritjen ekonomike, për të ngritur nivelin e punësimit, d.m.th zvoglimin e nivelit të papunësisë, për të krijuar asistencë të përkohshme të shteteve të varfëra e për të balancuar sistemin pagesor.

Puna e FMN-së është e tre llojeve të ndryshme. Mbikëqyrja përfshin monitorimin e zhvillimeve financiare dhe ekonomike në dhënien e këshillave mbi politikat e ndjekura që synojnë të shmangin krizat ekonomike. FMN-ja gjithashtu iu huazon pará vendeve me vështirësi në balancën e pagesave, për t’iu dhënë atyre financim të përkohshëm dhe mbështetje në korrigjimin e problemeve; huatë për vende me të ardhura të ulëta jepen për të reduktuar varfërinë. FMN-ja iu jep vendeve asistencë teknike dhe trajnim në fushat e saj të ekspertizës. Gjithashtu, për të mbështetur këto tre aktivitete, FMN-ja punon në kërkime ekonomike dhe statistikë.

Vitet e fundit, në kuadër të përpjekjeve për të forcuar sistemin financiar ndërkombëtar dhe për të rritur efektivitetin në parandalimin dhe zgjidhjen e krizave, FMN-ja ka aplikuar mbikëqyrjen dhe asistencën teknike në zhvillimin e standardeve e kodeve të praktikës në fushat e saj të përgjegjësisë, si dhe në forcimin e sektorëve financiarë. FMN-ja luan gjithashtu një rol të rëndësishëm në luftën kundër pastrimit të parave dhe terrorizmit.

Për të promovuar stabilitetin ekonomik global nëpërmjet kooperativeve multilateralë, FMN-së i është dhënë një mandat për të mbikëqyrur sistemin monetar ndërkombëtar dhe për të monitoruar politikat ekonomike e financiare të 185 vendeve anëtare. Mbikëqyrja e FMN-së ofron vlerësim të specializuar të zhvillimeve ekonomike dhe financiare globale e rajonale. Ajo jep këshilla rreth rreziqeve që i kanosen stabilitetit dhe rritjes ekonomike. Në këtë mënyrë FMN-ja ndihmon sistemin monetar ndërkombëtar që t’i shërbejë qëllimit të tij primar, duke dhënë kështu një kornizë që lehtëson shkëmbimin e të mirave, shërbimeve dhe kapitalit ndërmjet vendeve, si dhe të mbajë një rritje ekonomike të mirë.

Në ekonominë e sotme globale, ku politikat ekonomike dhe financiare të një vendi mund të ndikojnë në shumë vende të tjera, bashkëpunimi ndërkombëtar në shkallë globale për të monitoruar dhe influencuar zhvillimet ekonomike, është e domosdoshme. Me pjesëmarrjen pothuajse universale të 180 vendeve, mbikëqyrja e FMN-së përbën mekanizmin e duhur për këtë bashkëpunim.

2.7.3. Grupi i të 20-ve, G 20

G 20-ta¹¹ është një forum informal, i cili nxit diskutime të hapura dhe konstruktive midis pjesëmarrësve në lidhje me ekonomitë e vendeve me tregje të zhvilluara, rreth çështjeve thelbësore për sa i përket ekonomisë globale dhe stabilitetit të saj. Takimet e këtij formacioni janë një zhvillim i ri, që mori shtysë nga kriza aktuale globale. Në takimin e 15 nëntorit 2008 në Washington, u përcaktuan një sërë objektivash dhe hapash që duhen ndërmarrë në kuadrin e krizës, objektiva të cilat duhet të implementoheshin brenda marsit të vitit 2009.

Në Prill 2009 u mbajt një takim i dytë në Londër, ku u vendos një bashkëpunim i ngushtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar (IMF) për të ndërmarrë disa hapa për stabilizimin e gjendjes. Liderët e G 20-ës, edhe pse nuk ranë dakord mbi paketat stimuluese shtesë të vendeve, pranuan rolin kyç të fondeve të IMF-së. Liderët theksuan se i duhej rezistuar proteksionizmit dhe duhej bërë promovimi i tregtisë globale dhe investimeve (G-20, 2009).

Disa nga principet që do të udhëhiqnin tregjet financiare, mbi të cilat ra dakord G 20-ta në takimin saj, ishin:

- Rritje e transparencës dhe përshtatja e standardeve ndërkombëtare të kontabilitetit.
- Rregullimi dhe menaxhimi i riskut të tregjeve, produkteve dhe pjesëmarrësve.
- Sigurimi i integritetit në tregjet financiare, duke parandaluar mashtrimet dhe vjedhjet, parandalimin e konfliktit të interesit, mbrojtjen nga përdorimi i sistemit financiar për qëllime kriminale.
- Forcimi i bashkëpunimit ndërkombëtar, duke bërë që rregullat dhe ligjet kombëtare të jenë më konsistente, koordinimi i bankave qendrore me njëra - tjetrën.
- Forcimi i institucioneve financiare ndërkombëtare, duke modernizuar qeverisjen dhe përbërjen e tyre me qëllim që vendet në zhvillim të kenë një përfaqësim më të mirë të interesave, si dhe koordinimin e përpjekjeve për t'iu përgjigjur krizave të mundshme.

¹¹G 20, i njohur edhe si Grupi i të 20-ve (herë pas here G 21, G 23, G 20 +) është një bllok i vendeve në zhvillim, i themeluar në 20 gusht 2003. Dallimet dhe të veçantat nga ekonomitë e vendeve në G 20 janë të mëdha, ndaj grupi u shfaq në Konferencën e 5-të Ministrore të OBT-së, mbajtur në Kankun, Meksikë, nga 10 shtatori deri në 14 shtator 2003. G 20 llogarit për 60 % të popullsisë së botës, 70 % e fermerëve të saj dhe 26 % e eksporteve bujqësore në botë.

Për të zbatuar principet e mësipërme, G 20-ta hartoi një plan veprimi i cili konsistonte në sigurimin që kompanitë të mbajnë kapitalin e nevojshëm për aktivitetin e tyre dhe zhvillimin e praktikave më të mira të menaxhimit të rrezikut nga bankat.

- Zgjerimi i Forumit të Stabilitetit Financiar për të përfshirë më shumë përfaqësues nga ekonomitë në zhvillim
- Gjetja e pikave të dobëta në standardet e kontabilitetit. Duhet rishikuar standardet e kontabilitetit dhe metodat, të cilat duhet të marrin parasysh edhe rrezikun. Metodatat aktuale të kontabilitetit, për shembull PPPK, që do të thotë: Parimet Përgjithësisht të Pranuara të Kontabilitetit¹², janë të fokusuar në vlerën që rezulton nga të ardhurat dhe shpenzimet, pa marrë parasysh konceptin e “riskut të bilancit” (Taylor, 2008:39), risku i aseteve dhe detyrimeve që rezultojnë nga luhatjet e çmimeve të tregut.

Liderët ranë dakord që këto reforma mund të jenë efektive vetëm në kushtet e një tregu të lirë, në të cilin zbatohen ligjet për pronën private, në një treg ku ekziston tregtia e lirë dhe nxitja e investimeve, në një treg konkurrues dhe eficient ku ka liri dhe qasje në informacion.

Kështu që u ra dakord që:

- Të kundërshtohet proteksionizmi i cili përkeqëson sfidat financiare dhe ekonomike.
- Të përmbahen nga çdo imponim në lidhje me vendosjen e barrierave tregtare apo investimeve për 12 muajt e ardhshëm.

¹² PPPK (Parimet Përgjithësisht të Pranuara të Kontabilitetit) është një term i përgjithshëm për një grup standardesh të kontabilitetit financiar dhe udhëzimeve të raportimit që përdoren për përgatitjen e llogarive në një mjedis të dhënë. PPPK në UK, PPPK në SHBA janë terma më specifikë. Termi mund të ketë ose jo autoritet ligjor në një vend të caktuar. Ai është një koncept dinamik.

KAPITULLI I TRETË

3. TRANZICIONI DHE EFEKTET E

KRIZËS FINANCIARE GLOBALE NË EKONOMINË E KOSOVËS

3.1. Ekonomia e Kosovës - tranzicioni dhe kriza

Ndryshimet që ndodhën në mbarë globin, duke përfshirë këtu edhe Europën Lindore në vitet e fundit, bënë të befasohen edhe ekspertët gjeopolitikë. Kolapsi i papritur i sistemit ku qeveritë e vendeve të ndryshme vendosnin sa do të kursejnë njerëzit, sa produkte do të prodhojnë bizneset dhe sa do të paguhen punëtorët, bëri që ekonomitë e vendeve të ndryshme të futen në vakuum.

Krizat janë një mundësi për të mësuar. Për 200 vitet e fundit, me përjashtim të Depresionit të madh, krizat e mëdha financiare janë të krijuara në vendet e varfra dhe të paqëndrueshme, të cilat pastaj kanë nevojë për ndryshime të mëdha politike. Kriza e sotme ka filluar në vendet e pasura industriale, jo vetëm me hipotekat më kryesore në Shtetet e Bashkuara, por edhe me keqmenaxhimin e bankave dhe të borxhit publik në Europë (Merovci, 2008:185). Gjithashtu, duhet potencuar që kriza globale financiare ka prekur gjithë sistemin financiar dhe ekonominë e vendit. Kriza financiare globale, që momentalisht ka vërshuar pothuajse gjithë botën, ka shokuar disa nga ekonomitë më të fuqishme botërore. Shumë korporata të mëdha, institucione financiare, madje edhe disa vende, kanë bankrotuar ose janë në pikën kritike për shkak të efekteve që po shkakton kjo krizë (GAP, 2010-2011). Ndaj ekonomia globale ka përjetuar krizën më të rëndë financiare në 80-të vitet e fundit.

Kriza ekonomiko - financiare globale, më shumë se sa ndikimi i drejtpërdrejtë i saj në ekonominë ose financat publike, nxori në pah edhe disa probleme kardinale, duke vendosur para nesh disa pyetje tepër përmbajtësore dhe domethënëse:

- Sa e qëndrueshme është rritja jonë ekonomike?
- A kemi modelin e përshtatshëm ekonomik për të garantuar ritmet e rritjes në vitet e ardhshme?

- A kemi një ekonomi të strukturuar, me të cilën mund të shkonim drejt një zhvillimi të qëndrueshëm e afatgjatë?

Këto dilema të shkaktuara janë gjithashtu edhe problem i një ekonomie të brishtë, kur kemi parasysh se vendi përballët me tranzicionin dhe pasojat e një ekonomie të brishtë dhe të shkatërruar nga sistemi politik dhe lufta, apo nga eksplatinimi masiv i shkaktuar nga okupimi i fundit serb.

Në literaturën shkencore dhe profesionale, nocioni i tranzicionit nënkupton periudhën e zhvillimit, në të cilën patjetër duhet të ndërmerren procese gjithëpërfshirëse të ndryshimeve ekonomike dhe të strukturës kulturore të shoqërisë (Selmanaj, 2006:39).

Përvojat e vendeve të Evropës Qendrore dhe Lindore, në mënyrë të qartë tregojnë se procesi i tranzicionit mund të realizohet në dy mënyra:

së pari, nëpërmjet përvojës, rregullave dhe krijimit të një ambienti të volitshëm për ngritjen e proceseve spontane të kësaj kthese të madhe historike;

së dyti, nëpërmjet definimit të qëllimeve, në bazë të të cilave organizohet një kalim i vetëdijshëm nga ekonomia komanduese në ekonominë e tregut (Selmanaj, 2006:48).

Në rastin e parë, si bazë e tranzicionit konsiderohet tregu, ndërsa në rastin e dytë, si bazë e tranzicionit konsiderohet rregullativa shtetërore. Nga kjo rrjedh se koordinimi spontan i tregut konsiderohet si parim ekonomik (Selmanaj, 2006:68). Prandaj mund të theksojmë, duke u nisur nga konfiguracioni i ri i rrethinës ekonomike, rajonale dhe ndërkombëtare, si dhe i kushteve specifike, se ndërtimi i sistemit ekonomik të Kosovës duhet të mbështetet në:

- 1) privatizim dhe ndërmarrësi
- 2) liberalizim ekonomik
- 3) rregullim ekonomik sipas konceptit të ekonomisë së hapur dhe të tregut
- 4) parimeve të shtetit ligjor
- 5) drejtësi sociale
- 6) në trendet e globalizimit të ekonomisë

Lidhur me këtë nevojitet strategjia e përkufizuar qartë e transformimit të pronës shtetërore (shoqërore) në pronë private dhe për zhvillimin e ndërmarrësisë si filozofi zhvillimore me tërë infrastrukturën e saj të nevojshme. Kjo mundëson krijimin e një ambienti të volitshëm për zhvillimin e konkurrencës dhe të autonomisë së ndërmarrjeve, duke përfshirë kategorinë e rrezikut.

Kjo kërkon ndërtimin e tregut integral (tregu i mallrave dhe shërbimeve, tregu i punës dhe tregu financiar) me gjithë institucionet e tij. Roli i shtetit duhet të përqëndrohet në rregullimin bashkëkohor makro - ekonomik, që siguron stabilitet ekonomik dhe sendërtim të politikës zhvillimore.

Prandaj, duhet potencuar se kriza ka goditur të gjithë Europën Qendrore dhe Lindore më rëndë se çdo rajon tjetër të botës, duke përfshirë këtu edhe Kosovën si vend në tranzicion, që ende është duke u përballur me efektet e krizës globale financiare dhe që do të vazhdojë të përballët edhe në vitin e ardhshëm 2012-të. Kjo për shkak se shtetet e Eurozonës janë duke u ballafaquar me krizën e cila po kërcënon valutën e saj Euro dhe ekonominë europiane në përgjithësi. Kjo njëkohësisht do të ndikojë edhe në ekonominë familjare. Po ashtu, duhet potencuar që roli i shtetit duhet të përqëndrohet në rregullimin bashkëkohor makroekonomik, gjë e cila siguron stabilitet ekonomik dhe sendërtim të politikës zhvillimore. Këtu përfshihet: stabilizimi i valutës, kursi devizor, rregullimi i marrëdhënieve ekonomike me botën e jashtme, sendërtimi i politikës regjionale, sendërtimi i politikës agrare, asaj ekologjike dhe financat publike. Mendoj se është e nevojshme që shteti duhet t'i marrë mbi vete edhe funksionet e domosdoshme sociale, me qëllim që më lehtë të tejkalohen pasojat negative në fazën e tranzicionit drejt ekonomisë së tregut. Ndaj, sfidë e vazhdueshme për ekonominë e Kosovës në tranzicion, vazhdon të jetë norma e lartë e papunësisë, e cila paraqet nevojën për normë më të lartë të rritjes ekonomike dhe gjenerim më të madh të vendeve të punës, absorbimit të fuqisë punëtore, e cila karakterizohet me një normë të lartë të rritjes.

Kriza që përfshiu një pjesë të madhe të sistemit financiar amerikan, kreditë hipotekare, gradualisht u përhapën në sistemin bankar të sigurimeve, të fondeve si dhe në bursa. Rritja ekonomike globale BPSH (GDP) seriozisht është ngadalësuar, janë në rënie çmimet e patundshmërive (të të gjitha llojeve), disa prej sektorëve të industrive kanë filluar të pësojnë humbje të mëdha. Kanalet kryesore përmes të cilave kriza u reflektua në ekonominë e Kosovës janë të hyrat nga jashtë, kryesisht dërgesat e emigrantëve dhe direkt investimet e huaja, të cilat

u zvogëluar gjatë kësaj periudhe; po ashtu rënia e eksporteve të cilat edhe ashtu kishin nivel të ulët. Shkalla e ulët e prodhimit ndikoi negativisht në aktivitetin ekonomik në vend dhe bëri që Kosova të ketë defiçit të lartë të llogarisë rrjedhëse (UNDP, 2011). Prandaj, rregullimi makroekonomik do të bazohet në forcimin e faktorëve dhe institucioneve të ekonomisë së tregut, e në radhë të parë të konkurrencës, të efikasitetit, të liberalizimit dhe të rregullimit të disa proceseve ekonomike (Autoriteti i Konkurrencës, 2006).

Më konkretisht, kriza ekonomike globale e tanishme, rrjedhat e të cilës kanë filluar nga SHBA-të, brenda natës kanë përfshirë botën. Krejt kjo në mënyrë të dhimbshme, pasqyron faktin se sa e kanë pushtuar botën proceset e globalizuar. Prandaj, vlen të potencohet se çdo sistem ekonomik karakterizohet me disa veçori shquese. Ndër to, më shqueset janë: dinamizmi, liberalizmi dhe kompleksiteti. Secili sistem ekonomik përballet me ndryshime të përhershme, sisteme të cilat i mbajnë gjithmonë në gjendje joekuilibri. Por, në kushtet e zhvillimit bashkëkohor të ekonomisë së tregut, për një funksionim normal të çdo sistemi, fleksibiliteti, gjegjësisht nevoja e sistemit që të jetë i hapur, është komponentë e domosdoshme.

Ky kusht i funksionimit bashkëkohor të çdo ekonomie, reflekton një kompleksitet që flet për gërshetim të shumë nënsistemeve, gjegjësisht të elementeve të sistemit ekonomik. Ndër elementet më të rëndësishme është sistemi financiar (Merovci, 2008:50). Po ashtu sistemi financiar, si nënsistem i sistemit ekonomik dhe politik të çdo vendi, shquhet me veçoritë e tij specifike të cilat rezultojnë nga klima politike, nga karakteri i të drejtave të pronësisë, nga niveli i zhvillimit ekonomik, nga korniza legjislative, e cila favorizon ose jo krijimin e institucioneve të mirëfillta të ekonomisë së tregut, si dhe nga shumë faktorë e indikatorë të tjerë.

Sistemin financiar e përbëjnë shumë elemente: që nga institucionet dhe pjesëmarrësit financiarë (bankat qendrore, bankat komerciale, bankat e kursimeve, asociacionet kreditore dhe të kursimit, kompanitë e sigurimeve, fondet e pensioneve etj.), e deri te tregjet dhe institucionet financiare (Merovci, 2008:87).

Ndaj, elementet më të rëndësishëm të sistemit financiarë janë:

- tregjet financiare
- pjesëmarrësit dhe ndërmjetësit financiarë
- instrumentet financiare

Sistemi financiar transferon fondet e kursimtarëve të huamarrësit dhe iu siguron kursimtarëve pagesat për shfrytëzimin e fondeve të tyre (Luboteni, 2007:163). Sistemi financiar, këtë transferim e bën përmes instrumenteve financiare që paraqesin mjete për kursimtarët dhe detyrime për huamarrësit. Po ashtu, fondet mund të transferohen mes kursimtarëve dhe huamarrësve në disa mënyra. Njëri opsion është që qeveria të alokojë mjetet në sektorët e ekonomisë (Luboteni, 2007:128).

Sistemi financiar siguron tri shërbime kryesore financiare:

- ndarjen e rrezikut
- likuiditetin
- informimin

Ndër të tjera, duhet vënë theks i veçantë në faktin se rritja ekonomike e krijuar në rezonin ekonomik për të prodhuar, për të shitur, për të shpenzuar më shumë se të tjerët, më së shumti që është e mundshme, më me efikasitet, është e krijuar në imperativ të padiskutueshëm ekonomik të krijimtarisë, si dhe i udhëhequr në garën për maksimalizim të profitit, gjë e cila ka krijuar polarizimin në shtete të pasura dhe të varfra, si dhe hendekun gjithnjë e më të madh ekonomik dhe teknologjik mes tyre. Në iluzionin e vetë garës së pakufi, ka ngritur mistifikimin e rritjes, hiperproduksionin e mallit dhe shërbimeve, imperinë e shoqërisë konsumuese, kultin e shteteve nacionale si dhe pasurinë apo varfërinë e tyre (Selmani, 2006:98).

Kështu është krijuar paradigma e rritjes ekonomike, e cila është ngritur në etikë të efikasitetit dhe në përkrahje të saj me çdo çmim. Çështje me rëndësi të posaçme tek zhvillimi i qëndrueshëm bashkëkohorë është padyshim çështja e kualitetit të zhvillimit. Përgjigja për këtë çështje kërkon njohuri dhe respektim të trendeve globale socio - ekonomike.

Paradigma e “rritjes ekonomike”, në trendet e sotme globale dhe me pasojat që ka shkaktuar, ka ardhur në një pikë. (Selmani, 2009). Rritja ekonomike, vetëm nga vetja, nuk e zgjedh problemin e zhvillimit. Këtë më së miri e shpjegon thënia e një autori i cili me të drejtë thotë: “Zhvillimi ekonomik është diçka shumë më e gjerë dhe më e thellë se ekonomia. Rrënjët i ka jashtë sferës ekonomike: në arsimin, në organizim, në disiplinë, dhe mbi të gjitha këto, në pavarësinë politike dhe në vetëdijen nacionale mbi vetë besimin. Atë nuk mund ta

“prodhojnë” veprimet profesionale të transplantimit, të cilin do ta bënin ekspertët e jashtëm ose elita vendore që ka humbur kontaktin me njerëzit e rëndomtë.

Ai mund të ketë sukses vetëm në qoftë se aplikohet si lëvizje e gjerë popullore, lëvizje e “ristrukturimit”, që si primat vë theksin në shfrytëzimin e energjisë, në entuziazmin, në inteligjencën dhe në aftësinë punuese të të gjithëve. Suksesi nuk mund të arrihet me ndonjë formë “magjie” që do ta prodhonin dijetarët, teknikët ose “planifikuesit ekonomik” (Selmani, 2009).

Në brendinë e vetë, “zhvillimi i qëndrueshëm” është proces i ndryshimeve në të cilin eksploatimi i resurseve, drejtimi i investimeve, zhvillimi teknologjik dhe ndryshimet institucionale, janë në harmoni me qëllimin e përmbushjes së nevojave potenciale të tanishme dhe të ardhshme. Filozofia e zhvillimit të qëndrueshëm nisët nga kuptimi i interaksioneve ekonomike e ekologjike, dhe preferon pjesëmarrjen e politikës mbrojtëse (Selmani, 2009).

Trendi i “zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik”, zhvillimi i ri në vetvete, inkuadron: zhvillimin ekonomik (përmirësimin e kushteve materiale të jetës dhe pasurisë); zhvillimin social (mirëqenia në ushqim, shëndetësi, jetë të shëndoshë, arsimim, punësim, banim); zhvillimin politik, i krijuar në pranimin e të drejtave politike dhe demokratike, lirive politike, të drejtave njerëzore; zhvillimin kulturor (shprehja autonome specifike e kulturave të ndryshme); dimensionin ekologjik (mbrojtja dhe përparimi i ambientit, përkatësisht jetë të plotë dhe kualitative) dhe etikën e re globale, që nënkupton (përgjegjësinë e re ndërkombëtare dhe prosperitetin, drejtësinë dhe të ardhmen e sigurt). Kjo arrihet me bashkëpunimin ndërkombëtar në të gjitha nivelet dhe në të gjitha sferat e jetës shoqërore: në ekonomi, politikë, ekologji, kulturë, etikë (shih e.g. ëëë.ks-gov.net/esk/). Prandaj, tërë kjo ka të bëjë me qëllimin si ta rinjohim “zhvillimin e ri të qëndrueshëm”, në format e ndryshme të përmendura institucionale dhe jointitucionale të ekzistimit në pjesë të ndryshme të botës dhe në aspekte të dallueshme të zhvillimit, si ta rinjohim si shans objektiv të ri të ardhmërisë së përbashkët. Zhvillimi i ri nuk paraqet utopi! Ai është vizioni i së ardhmes që po ndodh sot, vizioni në të cilin civilizimi bashkëkohorë bazohet dhe po ndërton projektin e vet të qëllimit të ri!

Më fjalë të tjera, mund të themi se sfidë e vazhdueshme për ekonominë e Kosovës në tranzicion, vazhdon të jetë norma e lartë e papunësisë, e cila paraqet nevojën për normë më të

lartë të rritjes ekonomike, gjenerim më të madh të vendeve të punës dhe absorbimit të fuqisë punëtore, e cila karakterizohet me një normë të lartë të rritjes.

Gjithashtu vlen të theksohet se Kosova duhet të orientohej për ndërtimin e sistemit të ekonomisë, sipas kërkesave të një ekonomie të hapur ndaj tregut evropian dhe botëror. Ky duhet të jetë sistem ekonomik që krijon një ambient të përshtatshëm për integrimin e ekonomisë së Kosovës në rajon e më gjerë, stimulimin e bashkëpunimit ekonomik dhe që nxit investimet e përbashkëta me partnerët e jashtëm.

3.2. Ekonomia e Kosovës nën administrimin ish Jugosllavisë

Varësisht nga pozita ekonomiko - shoqërore që kishte Kosova në Konfederatën e ish Jugosllavisë, zhvillimin ekonomik të saj mund ta ndajmë në tri periudha:

1. Zhvillimi ekonomik gjatë periudhës 1947 - 1965
2. Zhvillimi ekonomik gjatë periudhës 1966 - 1989
3. Zhvillimi ekonomik gjatë periudhës 1989 - 1999

Zhvillimi ekonomik i çdo vendi, po ashtu edhe i Kosovës, shprehet nëpërmjet dinamikës së zhvillimit ekonomik, kurse dinamika përmes normave të shtimit të produktit shoqëror, si tregues më relevant makroekonomik.

Deri në vitin 1970 zhvillimi ekonomiko - shoqëror u koncentrua kryesisht në qendrat më të mëdha urbane, pasi ato dalloheshin me infrastrukturë ekonomike e shoqërore, në krahasim me qendrat e tjera. Ngritja e objekteve ekonomike dhe industriale në këto qendra, bëri të mundshëm zhvillimin më të shpejtë ekonomiko - shoqëror të tyre, në krahasim me qendrat e tjera komunale të Kosovës. Politika konkrete dhe aktive e zhvillimit rajonal në Kosovë, fillon nga Plani shoqëror në pesë vjetorin 1971 - 1975, dhe prej kësaj periudhe Kosova ndërmoi masa konkrete dhe të ndryshme në kuadër të politikës së vet ekonomike për zhvillimin harmonik territorial.

Masa kryesore e politikës së zhvillimit ekonomik që zbatoi Kosova ishte Fondi për nxitimin e zhvillimit më të shpejtuar të komunave ekonomisht jo mjaft të zhvilluara. Për realizimin e zhvillimit rajonal të tyre në këtë pesë vjeçar, Kosova nxorri dy ligje kryesore:

- Ligji mbi Fondin për nxitimin e zhvillimit më të shpejtuar të komunave ekonomikisht jo mjaft të zhvilluara.
- Ligjin për përcaktimin e komunave jo mjaft të zhvilluara.

Koeficienti relativ i zhvillimit është llogaritur në bazë të këtyre treguesve kryesorë ekonomik:

- a) Të të ardhurave kombëtare për një banor.
- b) Të pjesëmarrjes së të ardhurave të industrisë në të ardhurat kombëtare të përgjithshme.
- c) Të vlerës së fondeve kryesore të sektorit shoqëror për një banor.
- d) Të normës së punësimit në sektorin shoqëror (numri i të punësuarve në 100 banorë).
- e) Në bazë të lartësisë së të hyrave vetjake buxhetore për një banor.

3.3. Zhvillimi ekonomik i Kosovës në periudhën e pasluftës (1999)

Proceset ekonomike të pasluftës në Kosovë (1999), kishin trende kryesisht negative, po ashtu mjaft të ndërlikuara. Rezultatet konkrete tregojnë se zhvillimi ekonomik është përballur me shumë sfida. Duke pasur parasysh rrjedhat, proceset dhe të arriturat ekonomike, zhvillimi ekonomik në këtë periudhë kalon nëpër dy faza kryesore:

- Faza e emergjencës
- Faza substanciale (normale) e zhvillimit

Në fazën e emergjencës u arritën rezultate të konsiderueshme në zhvillimin ekonomik - shoqëror, duke pasur parasysh vitet e para të pasluftës, që ishin rrjedhojë e angazhimit të UNMIK-ut dhe të institucioneve të tjera qeveritare e joqeveritare që vepronin në Kosovë, si dhe ndihmës së donatërove të huaj.

Në fazën e zhvillimit substancial (normal) zë fill formimi i sitemit të ri ekonomik, i bazuar në elementet e ekonomisë së tregut, në fillim nëpërmjet Këshillit për Politikë Ekonomike, e më vonë nëpërmjet Shtyllës së IV, ku bartës i vetëm i politikave zhvillimore ekonomike ishte

UNMIK-u¹³, i cili krijoi infrastrukturë juridike dhe ekonomike me çka filloi funksionimi i ekonomisë së tregut. Në analizën e mëtejme për nivelin e zhvillimit ekonomik të Kosovës, ne do të shërbelemi me të dhëna publike të treguesve globalë makroekonomik që prezantohen si të tilla nga Enti i Statistikës së Kosovës:

Tabela 1. Bruto Produkti Vendor 2004 – 2014

Vitet	Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) (në milionë euro)	Prodhimi i Brendshëm Bruto (PBB) për një banor (në euro)
2004	3.006,1	1.473,0
2005	3.068,3	1.482,0
2006	3.191,6	1.520,0
2007	3.433,6	1.612,0
2008	3.940,3	1.824,2
2009	4.007,8	1.830,0
2010	4.291,1	1.941,7
2011	4.776,1	2.132,1
2012	4.916,4	2.165,8
2013	5.125,0	2.757,0
2014	5.446,0	2.884,0

Burimi: Ministria e Financave, Buletinet nga viti 2004 - 2014

Niveli i ulët i zhvillimit ekonomik të Kosovës në periudhën e pasluftës, ndikoi që në marrëdhëniet ekonomike të dominojë importi i mallrave dhe shërbimeve, i cili ishte dukshëm më i madh se eksporti dhe u reflektua në defiçitin e madh të bilancit të pagesave.

¹³UNMIK - United Nation Mission in Kosovo, Mision i OKB-së i vendosur në Kosovë, me qendër në Prishtinë. Në bazë të Rezolutës 1244, UNMIK-u funksionon që të: mbështesë funksionimin themelor administrativ. Puna e UNMIK-ut është e ndarë në katër “shtylla”: Shtylla I: Policia dhe Drejtësia (udhëhequr nga OKB-ja); Shtylla II: Administrimi civil (udhëhequr nga OKB-ja); Shtylla III: Demokratizimi dhe ngritja e institucioneve (udhëhequr nga Organizata OSCE-a); Shtylla IV: Restarurimi dhe zhvillimi ekonomik (udhëhequr nga BE-ja)

3.4. Kosova dhe rezistenca e saj ndaj krizës

Kosova është prekur pak nga kriza globale ekonomike, duke pasur parasysh faktin se ajo ka një shkallë shumë të ulët të integritit ekonomik në ekonominë ndërkombëtare. Kosova eksporton shumë pak në pjesën tjetër të botës. E ndodhur përballë krizës financiare dhe recesionit që përfshiu ekonominë globale, ekonomia e Kosovës ka arritur t'i rezistojë valës së parë të krizës. Rritja reale e PBB-së për vitin 2008, vlerësohet të ketë qenë 5.4 përqind, kryesisht e mbështetur nga konsumi privat dhe investimet publike. Gjatë vitit 2009 efektet e krizës globale janë shfaqur edhe në Kosovë, gjë e cila u reflektua me një normë më të ulët të rritjes ekonomike.

Gjendja në tregun e punës mbetet e vështirë. Vazhdon të mbizotërojë një normë e lartë e papunësisë. Gjatë pjesës së parë të vitit 2008, do të thotë në periudhën e krizës globale, ekonomia e Kosovës u përball me presione inflacioniste, të cilat ndikuan negativisht në fuqinë blerëse të konsumatorëve dhe pozicionin e jashtëm. Sidoqoftë, presionet inflacioniste u zbutën gjatë gjysmës së dytë të vitit, si rezultat i rënies së kërkesës në nivel global dhe i rënies së çmimeve të naftës. Rënia e nivelit të përgjithshëm të çmimeve, vazhdoi edhe gjatë vitit 2009, gjë e cila mund të vërehet edhe në Raportin vjetor të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK, 2009).

Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2010 vazhdoi të shënojë rritje, mbështetur kryesisht në rritjen e konsumit dhe të investimeve. Përmirësimet në ekonominë globale patën ndikim të rëndësishëm në rritjen e eksporteve të Kosovës dhe të dërgesave nga emigrantët. Presionet inflacioniste në rrafshin global u reflektuan edhe në ekonominë e Kosovës, si pasojë e varësisë së lartë të ekonomisë sonë nga importet. Pavarësisht rritjes së eksporteve, defikiti tregtar vazhdon të mbetet tepër i lartë, gjë që shtrën nevojën për gjetjen e një modeli më të qëndrueshëm të rritjes dhe zhvillimit ekonomik të Kosovës. Ekonomia e Kosovës vazhdoi të ketë normë pozitive të rritjes ekonomike edhe gjatë vitit 2010. Vlerësimet tregojnë për një rritje reale të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) prej 4.6 % në vitin 2010, ndërsa për dallim prej vitit 2009, kur gjeneratori kryesor i rritjes ishte sektori publik, gjatë vitit të kaluar sektori privat konsiderohet të ketë qenë kontribuuesi kryesor në rritjen ekonomike. Norma mesatare e inflacionit në vitin 2010 ishte 3.5 përqind, ndërsa presionet inflacioniste ishin më të theksuara në pjesën e dytë të vitit 2010.

Ekonomia e Kosovës ka performuar mirë në përballje me erërat e kundërta që fryjnë nga kriza globale financiare si dhe turbulencat në Eurozonë. Në vazhden e krizës financiare globale, rritja ekonomike e Kosovës u ngadalësua por mbeti pozitive, ndërsa pjesa më e madhe e Ballkanit Perëndimor rrëshqiti në recesion. Për më tepër, norma mesatare e rritjes vjetore ka qenë nga më të lartat në Ballkanin Perëndimor, qysh prej fillimit të krizës financiare në vitet 2007 - 2008.

Vlerësimi i efekteve nga goditjet e jashtme. Në aktivitetin ekonomik të Kosovës, efektet nga tronditjet në vendet pritëse të diasporës, vlerësohen duke përdorur një model të korigjimit të gabimit të vektorit (VECM) për treguesit me frekuencë të lartë disponibël për ekonominë e Kosovës (importet, kreditë e sektorit privat dhe depozitat bankare) dhe GDP-në e Gjermanisë (si përafri “proxy” për kushtet ekonomike të vendeve pritëse të diasporës).

Modeli VECM kufizon sjelljen afatgjate të variablave endogjene për t’u konverguar në marrëdhëniet e tyre kointegruese, ndërsa lejojnë dinamikën e përshtatjes afatshkurtër¹⁴.

Rezultati mbështetet nga një test Engel dhe Granger, që hedh poshtë hipotezën nul se mbetjet e vektorit kointegrues kanë rrënjë njësie. Sipas supozimit (të përkohshëm) të kointegrimit midis serive, rëndësia e GDP-së të Gjermanisë për importet e Kosovës, konfirmohet nga testi i kauzalitetit (shkakësisë) Granger¹⁵.

Sikur edhe në vitet e kaluara, inflacioni në Kosovë ishte kryesisht rezultat i rritjes së çmimeve për produktet ushqimore, të cilat kanë shënuar rritje në nivel global, dhe si rezultat i mbështetjes së lartë të ekonomisë së Kosovës në importe, ngritja e çmimeve në nivel global është reflektuar mjaft shumë edhe në ekonominë e Kosovës (BQK, 2010). Efektet e krizës financiare ndikuan shumë edhe në Kosovë, sidomos në sektorin e punësimit ku rreth 45 % e fuqisë punëtore të regjistruar janë të papunë. Në nivelin global, aktiviteti ekonomik gjatë vitit 2013 u karakterizua me rritje. Sipas vlerësimeve të FMN-së (BQK, 2013), norma reale e rritjes

¹⁴Termi i kointegrimit njihet si korigjimi i gabimit, meqenëse deviacioni nga ekuilibri afatgjatë korigjohet gradualisht nëpërmjet një sërë rregullimesh të pjesshme afatshkurtra. Të gjithë variablat integrohen me rendin një në nivele dhe të palëvizshme në diferencat e para. Përzgjedhja e strukturës “lag” bazohet në testin e përjashtimit të “lag”.

¹⁵ Testi i kauzalitetit (shkakësisë) Granger, që siguron njohuritë paraprake në lidhjet e mundshme “kazuale” midis variablave, hedh poshtë me forcë hipotezën nul se GDP-ja e Gjermanisë nuk shkakton granger të importeve të Kosovës

së PBB-së ishte 3.0 % kundrejt rritjes prej 3.2 % në vitin 2012. Për ekonominë e Kosovës, zhvillimet gjatë vitit 2013 ishin të favorshme.

Norma reale e rritjes së PBB-së u përshpejtua dhe arriti në 3.1% nga 2.5 % sa ishte në vitin 2012. Konsumi i përgjithshëm ka pasur rritje solide, që është nxitur nga remitancat, nga kreditë konsumuese të sektorit bankar, nga pagat e sektorit publik dhe privat etj. Sa i përket investimeve, për dallim nga viti paraprak që ishte karakterizuar me rënie, gjatë vitit 2013 investimet u rritën si rezultat i rritjes së IHD-ve dhe kredive investuese për sektorin privat, ndërsa investimet e sektorit publik gjatë vitit 2013 kishin ndikim negativ.

Kosova tashmë si pjesë e Eurozonës, si dhe pjesa e vendeve të Europës Juglindore në përgjithësi, vlerësohet që në vitin 2013 të ketë pasur një vit të rekuperimit ekonomik. Kjo si rezultat i normave pozitive të rritjes ekonomike në shumicën prej këtyre vendeve. Ky nivel ekonomik tashmë është arritur duke zbutur paksa normën e papunësisë gjatë vitit 2013. Edhe pse llogaritet si pozitiv në shumicën e aktiviteteve ekonomike si dhe në përmirësimin e bilancit buxhetor, në vitin 2013 borxhi publik ka vazhduar të rritet, duke ngelur megjithatë nën nivelin e Eurozonës. Gjatë këtij viti, gjithashtu shtrëngohet edhe kredidhënia. Kjo ndodh për arsye se banka nuk sigurohet për dhënien e kredisë, kurse në anën tjetër edhe depozitat nuk janë rritur shumë, pra vlerësohet një trend i ngadalshëm i rritjes së depozitave. Historitë kreditore kanë vazhduar të përkeqësohen, kurse treguesi i mjaftueshmërisë së kapitalit ka shënuar një përmirësim.

Viti 2013 mund të karakterizohet si vit i përmirësimit të ekonomisë në rajon, dhe mund të thuhet se kjo përgjithësisht ishte e pranishme edhe në Kosovë.

Norma reale e rritjes prej 3.4 %, vazhdon ta mbajë Kosovën një ndër vendet më të zhvilluara në rajon, edhe pse fatkeqësisht kjo normë e rritjes ekonomike adresohet shumë pak tek ulja e nivelit të papunësisë, sepse kjo sfidë e cila thjesht mund të quhet edhe sfida kryesore e ekonomisë së Kosovës, kërkon norma edhe më të larta të rritjes ekonomike në mënyrë që të zbutet papunësia dhe niveli i varfërisë së skajshme.

Kjo rritje ekonomike e cila shfaq shenja të një rikuperimi ekonomik, pritet të vazhdojë edhe këtë vit. Pritet që deri në përfundimin e këtij viti të kemi rritje të konsumit e cila deri tani është vërejtur, ndërsa niveli i investimeve konsiderohet të jetë neutral, të paktën deri tani.

Në procesin e transformimit të një vendi me ekonomi të centralizuar në një vend me ekonomi të mbështetur në tregun e lirë, krahas problemeve madhore si përballimi i inflacionit dhe sigurimi i ritmeve të qëndrueshme të rritjes ekonomike, që përbëjnë kushte bazë të një transformimi të suksesshëm, një vend qendror zë transformimi dhe reforma e sistemit financiar, veçanërisht në sektorin bankar.

Tranzicion, teorikisht është quajtur procesi historik gjatë të cilit shoqëritë ish komuniste kryejnë transformimet radikale të regjimit politik e ekonomik socialist në atë të demokracisë pluraliste e të ekonomisë së tregut. Pra, në aspektin ekonomik, përgjatë periudhës së tranzicionit, sistemi ekonomik është më socialist, por ende nuk është as tërësisht kapitalist. Integrimi në Bashkimin Evropian përbën një anëtarësim politik dhe ekonomik në grupimin e vendeve më të zhvilluara të botës, atyre të Europës Perëndimore, që dallohen si për nivelin e konsoliduar të demokracisë liberale, ashtu dhe për shkallën e funksionalitetit të tregut të tyre e të konkurrueshmërisë së ekonomive të tyre (Ruli, 2010).

Në fillim të viteve 1990, mjaft studiues e analistë të tranzicionit postkomunist, parashikonin një afat optimal prej 10 vjetësh për kryerjen e transformimeve të sistemit ekonomik, dhe afërsisht 4 - 5 vjet për transformimin e sistemit politik.

Por në realizimin praktik, tranzicioni rezultoi një proces tej mase kompleks dhe me një variacion të madh në performancat e vendeve të ndryshme. Rezultatet dhe ecuria e tij u ndikuan ndjeshëm si nga kushtet specifike të nisjes së çdo vendi, ashtu edhe nga modeli i transformimeve që u ndoq, si dhe konsistenca në kryerjen e reformave (Ruli, 2010).

Në mjaft vende, procesi i tranzicionit u mpleks dhe me fenomene të tjera të natyrës jotranzicionale si: luftërat civile, konfliktet etnike apo formimi i shteteve kombëtare.

Ndërsa vendet e tranzicionit nuk mund të cilësohen si të varfëra në shumë aspekte të tyre, mjaft prej tyre (përfshirë vendet e Ballkanit, pra dhe Shqipërinë), u përballën edhe me një sërë problemesh që janë karakteristike për vendet e varfëra si (Ruli, 2010).:

1. Institucione të dobëta
2. Pabarazi në rritje
3. Paaftësi e elitës politike

Pra, simptoma të nënzhvillimit (under development) të shfaqura më dukshëm gjatë viteve të tranzicionit, kanë sjellë një demodernizim të shoqërive tona, që shfaqet në këto drejtime:

1. Deindustrializim (riagrarizim) i ekonomive kombëtare.
2. Prani e ndjeshme e veprimit të institucioneve joformale (paramoderne).
3. Dobësim i kapitalit social (polarizim i thelluar i pasurive, urbanizim i egër, korrupsion i lartë, margjinalizim i grupeve sociale, rritje e kriminalitetit).
4. Varfërimi i kapitalit human (rrënim i ndjeshëm i sistemit arsimor, përkeqësim i shërbimeve shëndetësore, dobësi e sistemit të mbrojtjes sociale, brain - drain etj.).


Politikat që duhet të ndërmerren për përballimin e këtyre problemeve, nuk janë të natyrës tranzicionale, por përbëjnë politika të mirëfillta zhvillimi.

Kohën sa kriza globale ishte shumë aktive, në periudhën 2008 - 2012, ekonomitë e rajonit së bashku kanë pasur një rritje shumë modeste, për të mos thënë të pakënaqshme, ku rritja mesatare në vit brenda kësaj periudhe ka qenë vetëm 1.04 %.

Në të gjithë rajonin apo 13 shtetet e analizuara gjatë krizës, vetëm tri vende, brenda periudhës 2008 - 2012 kanë pësuar rënie mesatare vjetore, pra rritja e tyre ka qenë negative.

Gjegjësisht, aty bëjnë pjesë dy shtete anëtare të BE-së dhe Eurozonës, pra Greqia dhe Sllovenia, ku e para ka shënuar rënie mesatare në vit prej - 4.26 % ndërsa e dyta rënie prej - 1.04 %; ndërsa shteti i tretë dhe i fundit që ka shënuar rënie ekonomike në rajon brenda këtyre 5 viteve është shteti i ardhshëm anëtar i BE-së dhe i Eurozonës, Kroacia, e cila ka shënuar rënie mesatare në vit prej -1.60 % brenda kësaj periudhe (shih figurën më poshtë):


Grafiku 1. Inflacioni në rajon (mesatarja për vitet 2008 - 2012, sa ishte koha e krizës më agresive)



Burimi: “The World Bank”, vlerat e rritjes së PBB-së për të gjithat shtetet e rajonit, 25.06.2013

Inflacioni në rajon, në anën tjetër, për 5 vite me rradhë brenda periudhës 2008 -2012, ka shënuar rritje mesatare vjetore prej 4.48 %, siç shihet edhe në grafikun 1 dhe 2. Dy shtetet e rajonit të cilat brenda kësaj periudhe 5 - vjeçare kanë shënuar inflacionin më të lartë mesatar vjetor, janë Serbia me 8.78 % dhe Turqia me 8.18 %. Kosova rradhitet e katërta për nga niveli mesatar vjetor i inflacionit brenda kësaj periudhe me 5.22 %, e cila është përmbi mesataren e rajonit.

Grafiku 2. Rritja e PBB-së dhe inflacioni në rajon (mesatarja për vitet 2008 - 2012)



Burimi: The World Bank, 2013

Kosova po ashtu dallohet nga të gjitha shtetet e tjera të rajonit, për faktin se është i vetmi shtet i cili që nga deflacioni i vitit 2009, që ishte - 2.40 %, ka shënuar rritje konstante të inflacionit, i cili në vitin 2010 ishte 3.50 %, në vitin 2011 ishte 7.30 %, dhe në vitin 2012 arriti në 8.30 %. Asnjëra nga shtetet e rajonit, përfshirë edhe ato të BE-së në këtë rajon, nuk e kanë plotësuar standardin e Eurozonës për inflacion, i cili në vitin 2012 do të duhej të ishte rreth 1.53 %, përpos Greqisë e cila në vitin 2012 kishte një inflacion prej 1.1 %. (KIPRED, 3:2013)

3.5. Prirjet e zhvillimit ekonomik në Kosovës

Ekonomia e Kosovës gjatë viteve të 90-ta ishte shumë sfiduese, sepse përveç problemeve reale kishte edhe probleme politike, ku Kosova si pjesë e ish Jugosllavisë u përball me sanksionet e OKB-së. Gjatë zhvillimit të ngjarjeve deri në konfliktin e vitit 1999, ekonomia e përkeqësua dhe u shoqërua me humbje të tregjeve të eksportit dhe kolapsin e shumë ndërmarrjeve shoqërore. Mungesa tepër e madhe e investimeve, politikat e dobëta ekonomike, sanksionet ndërkombëtare dhe lënia anash e ndërmarrjeve, shkaktoi deindustrializimin substancial. Nxjerrja e mineraleve, energjia dhe bujqësia, që ishin shtyllat kyçe të ekonomisë së Kosovës, pësuan rënie të konsiderueshme (SCOK, 2014).

Kosova pas çlirimit (viti 1999) bëri një përparim të konsiderueshëm drejt rimëkëmbjes ekonomike, me rritje të shpejtë që është e zakonshme në vitet e para të rimëkëmbjes dhe rindërtimit pas konfliktit. Reforma e politikave ekonomike dhe ndërtimi i institucioneve, ndihmuan në përshtatjen e domosdoshme drejt ekonomisë së tregut.

Donatorët ndërkombëtarë luajtën një rol pozitiv duke mobilizuar me sukses dhe duke shpenzuar gjithsej 1.96 miliardë euro për Kosovën në mes të viteve 1999 dhe 2003.

Prezenca e madhe ndërkombëtare në Kosovë gjithashtu u rikonfigurua në mbështetje të procesit për anëtarësim në BE, si financiarisht ashtu edhe me vëllim të lartë të këshillimit dhe asistencës teknike. Vetëm BE-ja siguroi mbi 1.0 miliardë euro për Kosovën në mes të viteve 2000 dhe 2006 përmes programit CARDS (Asistenca e Komunitetit për Rindërtim, Zhvillim dhe Stabilizim) dhe mbi 426 milionë euro përmes Instrumentit të Paraanëtarësimit (IPA) prej vitit 2007 deri në vitin 2010 (SCOK, 2014).

Gjatë kësaj periudhe po ashtu u transferuan edhe shuma të larta të remitancave, që papritur u bënë faktor i rëndësishëm në procesin e rimëkëmbjes. Paratë e ardhura këssoj, së bashku me ndihmat ndërkombëtare, u shpenzuan për rindërtimin e shtëpive si dhe për infrastrukturën fizike dhe sociale (siç janë rrugët, shkollat dhe qendrat shëndetësore). Mbështetja e ndërlidhur me remitancat ishte aq e përhapur sa që u bë pothuajse universale. Prej atyre që kanë familjarë jashtë vendit, 82 për qind e shqiptarëve marrin mbështetje financiare, në krahasim me 14 për qind të serbëve (SCOK, 2014).

Tabela 2. Rezultatet e pyetësorit mbi remitencat

Familjarët e mi që jetojnë jashtë vendit më mbështesin financiarisht			
Nacionaliteti	Shqiptarë %	Serbë %	Të tjerë %
Rregullisht	30.4	1.3	14.9
Herë pas here	51.5	12.3	41.8
Kurrë	16.2	85	40.3
ND/PP	1.9	1.3	3.0
Gjithsej	100.0	100.0	100.0

Burimi: Raporti i zhvillimit njerëzor në Kosovë, 2010

Remitencat dhe financimi i donatorëve, i kontribuan së bashku shkallës dyshifrore të rritjes vjetore të Produktit të Brendshëm Bruto (PBB) nga viti 2000 deri më 2001. Megjithatë, me rënien e këtij lulëzimi të paskonfliktit, rritja në periudhën 2002 - 2005 u ngadalësua dukshëm. Ulja e mbështetjes financiare ndërkombëtare dhe zvogëlimi i pranisë së Kombeve të Bashkuara, goditi rritjen e BPV-së nga ndërtimi dhe tregtia. Gjithashtu u prekën edhe sektori i bujqësisë dhe i industrisë në Kosovë, që kurrë nuk u rimëkëmbën plotësisht (BB, 2012).

Në periudhën prej vitit 2005 - 2008, rritja e BPV u përshpejtua edhe njëherë me rritjen mesatare vjetore prej mbi 4 %, duke arritur në 5.4 për qind në vitin 2008.

Rritja kryesisht u shkaktua nga kërkesa e madhe brenda vendit (konsumi dhe investimi), rritja e kredisë vendore, rritja e konsiderueshme në investime publike dhe nivelet e qëndrueshme të dërgesave të parave nga jashtë dhe aktivitetet donatore.

Procesi i privatizimit gjithashtu dha kontributin e vet në ngritjen e investimeve dhe në zhvillim gjatë viteve të kaluara. Privatizimi i investimeve (vendore dhe të huaja) dhe rritja e eksportit (shih tabelën 3). Rënia e ekonomisë globale e kohëve të fundit, preku Kosovën përmes rënies së eksporteve, investimeve të huaja dhe remitanecave.

Eksportet rregjistruan rënie prej 18 % (nga 198.5 milionë euro në vitin 2008 në 162.6 milionë euro në vitin 2009). Megjithatë, pasi eksportet e mallrave përbëjnë vetëm rreth 5 % të BPV së, ndikimi ishte i vogël në krahasim me ndikimin që ato kishin në vendet fqinje.

Sipas të dhënave nga BQK, në vitin 2009 investimet e huaja direkte (IHD) në Kosovë ranë për 20.5 % (nga 366 milionë euro në vitin 2008, në 291 miliona euro në vitin 2009) pasi kriza globale financiare ndikoi negativisht në destinacionet kryesore për IHD, përfshirë këtu edhe sektorin e energjisë. Remitancat, kategoria e vetme më e madhe e të hyrave në bilancin e pagesave, ende nuk ka pësuar ndonjë rënie të madhe, rënie së cilës disa i frikësoheshin.

Megjithatë, Kosova i iku ndikimit më të keq të krizës, për shkak të integritit të kufizuar të saj në ekonominë globale. Rritja e BPV-së u rikthye rreth 4 % në vitin 2009 (MF, 2011).

Tabela 3. Indikatorët kryesorë Makroekonomikë 2008 - 2013

	<i>(në milion €)</i>					
	2008	2009	2010	2011	2012	2013
BPV me çmime aktuale	3.882,8	4.069,6	4.402,0	4.814,5	5.058,7	5.326,6
Shpenzimet e konsumit final	4.172,2	4.221,6	4.516,5	4.975,5	5.320,4	5.539,3
Shpenzimet e konsumit final të ekonomive shtëpiake	3.488,9	3.528,5	3.768,2	4.142,3	4.458,1	4.652,4
Shpenzimet e konsumit final të Qeverisë	659,8	668,1	722,3	802,1	842,1	863,9
Qeveria e Kosovës	358,0	407,2	495,7	578,4	625,0	658,8
Donatorët (pagat)	301,8	260,8	226,6	223,7	217,1	205,2
Të punësuar të huaj	196,9	178,7	157,4	155,5	150,9	142,6
Të punësuar vendor	104,9	82,1	69,2	68,2	66,2	62,6
Shpenzimet e konsumit final të IJPSHESH	23,6	25,0	26,0	31,1	20,2	23,0
Formimi i bruto kapitalit	1.208,7	1.267,4	1.450,6	1.632,4	1.465,1	1.470,9
Formimi i bruto kapitalit fiks	1.052,7	1.129,8	1.301,2	1.475,9	1.316,8	1.322,6
Ndryshimet në inventar	156,0	137,6	149,4	156,5	148,3	148,3
Eksporti neto	-1.498,2	-1.419,4	-1.565,2	-1.793,3	-1.726,8	-1.683,6
Eksporti i mallrave dhe shërbimeve	608,9	694,9	878,0	943,4	922,1	927,1
Eksporti i mallrave	216,6	177,2	305,0	324,9	287,0	305,1
Eksporti i shërbimeve	392,4	517,6	573,0	618,5	635,1	622,0
Importi i mallrave dhe shërbimeve	2.107,1	2.114,2	2.443,1	2.736,7	2.648,8	2.610,7
Importi i mallrave	1.866,3	1.828,9	2.057,1	2.383,9	2.360,0	2.297,1
Importi i shërbimeve	240,8	285,3	386,1	352,8	288,8	313,7
BPV për kokë banori	2.258	2.329	2.480	2.672	2.799	2.935

Burimi: Enti Statistikor i Kosovës, Vjetari statistikor 2015

Nëse marrim për bazë ecurinë e parakrizës dhe shohim sipas indikatorëve ekonomik dhe zhvillimor, kjo na tregon se ajo u përshpejtua në vitin 2005 pas një fillimi shumë të ngadalshëm në vitin 2004. Kjo çoi në ngritjen e nivelit të përgjithshëm të Shpenzimeve publike, në veçanti për investime kapitale. Ato gjithashtu u ngritën gjatë periudhës 2008 - 2009.

Ndërrimet e Qeverisë dhe politikave makrofiskale në Kosovë bënë që të rriten shpenzimet e veta publike për 20 % apo rreth 188 milionë euro nga 950.5 milionë euro në vitin 2008, në 1138.6 milionë euro në vitin 2009.

U regjistruan rritje të rëndësishme në të gjitha kategoritë e shpenzimeve publike në vitin 2009. Rrogat dhe pagat u ngritën nga 221.7 milionë euro në 264.4 milionë euro; mallrat dhe shërbimet nga 157.9 në 216.7 milionë euro; transferimet dhe subvencionet nga 218.5 në 257 milionë euro; dhe në fund shpenzimet kapitale nga 347.1 në 400 milionë euro (UNKT, 2012).

Duhet të theksohet se rritja e shpenzimeve publike nuk ishte rezultat i rritjes së qëndrueshme të tatimeve apo shtimit të ndihmave ndërkombëtare, por për shkak të shfrytëzimit të tepricës nga vitet paraprake dhe nga e vetmja dividendë e të ardhurave të patatimuara nga ndërmarrja publike Posta dhe Telekom i Kosovës (PTK), në shumën prej 200 milionë €, apo 5 % e BPV-së (UNKT, 2012).

Ndikimi i dëmshëm i zhvillimit jo të barabartë të Kosovës, ose thënë më mirë themelet e saj të brishta për rritje, mund të shihen qartë në gjendjen e tregut të saj të punës. Konsumi privat i nxitur nga remitancat dhe ndihmat e huaja, nuk janë platformë e besueshme për zhvillimin e sektorit privat.

Në Kosovë sektori privat mbetet kryesisht joformal, i parregulluar, dhe çdo herë e më shumë përpiqet që të ofrojë punësim të qëndrueshëm, afatgjatë dhe të paguar mirë.

Përkundër vlerave pozitive në BPV dhe IHD, tregu i punës së Kosovës mbetet i kufizuar dhe në stagnim (MF, 2011). Në bazë të anketës së fundit të fuqisë punëtore, rreth 48 përqind e fuqisë punëtore llogaritet se është e papunë, përderisa 73 për qind e rinisë ishte e papunë në vitin 2008. Papunësia ka tendencë që të jetë afatgjatë, ku afro 82 % e të papunëve nuk kanë punuar për më shumë se 12 muaj. Sipas disa anketave të opinionit publik, papunësia shihet nga kosovarët si çështja më e rëndësishme me të cilën përballet Kosova (UNKT, 2012).

Masat e shfrytëzimit të fuqisë punëtore në Kosovë, siç është shkalla e pjesëmarrjes së fuqisë punëtore (përqindja e personave të moshës së punës në një ekonomi të cilët janë të punësuar, dhe që janë të papunë por kërkojnë punë), dhe shkalla e punësimit (përqindja e të rriturve që punojnë me pagesë dhe që janë në gjendje që të fitojnë të ardhura dhe të kujdesen për veten

dhe familjet e tyre), janë më të ulëtat në rajonin e Ballkanit perëndimor (46 % dhe 24 % përkatësisht) dhe janë shumë më të ulëta sesa mesatarja në Bashkimin Europian.

Të njëjtat nivele tek femrat janë tepër të ulëta (26.1 % dhe 10.5 %). Më shumë se gjysma e popullatës së moshës së punës në Kosovë në vitin 2008 ishte joaktive, përderisa 58 për qind e femrave (15 - 64 vjeçare) ishin joaktive (MF, 2011).

Tabela 4. Treguesit kyç të tregut të punës, përqindjet (2004 - 2008)

Treguesit kyç të tregut të punës, përqindjet (2004 - 2008)			
Viti	2004	2006	2008
Shkalla e pjesëmarrjes në fuqinë punëtore	46.2	52.3	46.0
Shkalla e punësimit	27.9	29.0	24.1
Shkalla e papunësisë	39.7	44.9	47.5

Burimi: Raporti i Fondit Monetar Ndërkombëtar për Kosovë, 2009

Shkalla e lartë e papunësisë çon në shkallë të lartë, të vazhdueshme dhe të përhapur të varfërisë. Raporti i vlerësimit të varfërisë i Bankës Botërore i vitit 2007, vlerësoi në bazë të të dhënave nga viti 2005 dhe 2006 se rreth 45 % e popullatës në Kosovë është e varfër dhe e ka të pamundur të përmbushë nevojat e saj njerëzore, përderisa 18 % e saj jeton në varfëri të skajshme që nuk mund të përmbushë madje as nevojat themelore të mbijetesës. Nga ana tjetër, 18 % e popullatës jeton pak mbi kufirin e varfërisë. Këto norma të varfërisë janë shumë të larta në krahasim me vendet fqinje (UNKT, 2012).

Madje, ato nuk janë duke rënë me kalimin e kohës. Raporti i Bankës gjithashtu identifikon se niveli i varfërisë dhe i cënueshmërisë, do të ishte shumë më i lartë po të mos ishte siguria që ofron migracioni dhe remitancat.

Varfëria në Kosovë mbetet fenomen kryesisht rural, që ndikon në mënyrë joproporcionale te familjet e mëdha, tek ekonomitë familjare me gra vetëushqyese, personat me aftësi të kufizuara, personat e papunë, mbajtësit e vendeve të pasigurta të punës (kryesisht punëtorët “me pagesë ditore”) dhe ekonomitë familjare bujqësore të vetëpunësuar (UNKT, 2012).

Specifikat e kontekstit ekonomik të Kosovës, ngritja e BPV-së por stagnimi i shkallës së varfërisë dhe papunësisë, tregojnë përjashtimin si faktorë që shkatërrojnë rritjen ekonomike me përfshirje. Meqë përjashtimi ekonomik është doemos më i ndërlikuar sesa privimi ekonomik (varfëria), ky kapitull bën përpjekje që të kuptojë mekanizmat që mbështesin dhe e shtyjnë atë, para se të shikojnë në gjetjen e zgjidhjeve (UNKT, 2012).

Sikurse në hulumtimet pararendëse që nga korriku 2008, rezultatet e hulumtimit të prillit 2010, qershorit 2012 tregojnë se problemet dominuese me të cilat përballet Kosova janë papunësia (e zgjedhur nga 42 % e të intervistuarve) dhe varfëria (31 %). Këto dy probleme kryesore pasohen nga korrupsioni (5 %).

Sipas rezultateve të hulumtimit të tanishëm, të cilat shihen në tabelën e poshtëshënuar, kosovarët që nga korriku 2008 theksojnë qartë mungesën e zhvillimit ekonomik (që duket nga papunësia e lartë dhe varfëria), si problemi kryesor me të cilin përballet Kosova.

Tabela 5. Problemet kryesore me të cilët përballet Kosova

	Regjioni							
	Prishtinë	Mitrovicë	Prizren	Pejë	Ferizaj	Gjakovë	Gjilan	Gjithsej
Infrastruktura rrugore	1.3%		.4%		5.0%	3.3%	1.5%	1.2%
Furnizimi me rrymë	.9%		1.5%	3.6%	1.7%	8.2%		1.6%
Problemet e hapësirës urbane (ndërtimet e egra)	.3%	.5%		.5%	1.7%		2.2%	.6%
Ndotja e ambientit	2.2%	.5%	.4%	.5%	11.8%			1.9%
Varfëria	31.0%	34.0%	27.8%	42.3%	21.8%	42.6%	16.3%	30.7%
Çmimet	.9%	.5%	1.5%	1.5%	2.5%			1.1%
Shërbimet shëndetësore	.3%		.8%		2.5%			.5%
Siguria publike dhe personale	4.4%	2.0%	2.3%				7.4%	2.6%
Arsimi			1.1%	9.3%	.8%			1.7%
Marrëdhënie ndëretnike	5.0%	2.5%	.4%	.5%	.8%		.7%	1.9%
Papunësia	45.8%	52.0%	49.4%	33.0%	23.5%	37.7%	31.9%	41.7%
Rezultatet e padëshiruara për statusin final			2.7%		.8%		8.9%	1.5%
Problemet sociale (pensionet, invalidët, fëmijët bonjak etj.)	1.6%	.5%	4.2%	2.1%	1.7%		3.0%	2.1%
Fati i personave të pagjetur	.6%		.4%	1.0%	.8%	1.6%	6.7%	1.2%
Krimi i organizuar	.9%		1.9%	.5%	5.0%		3.7%	1.5%
Vrasjet e pazgjidhura	.3%		.8%		2.5%		3.0%	.8%
Korrupsioni	2.5%	4.0%	1.5%	5.2%	10.9%	4.9%	14.8%	5.1%
Dukuritë asociale (prostitucioni, narkomania, alkoolizmi)	.3%		1.9%		2.5%			.7%
Pa përgjigje	1.6%	3.5%	1.1%		3.4%	1.6%		1.5%
Gjithsej	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%	100.0%

Burimi: Raporti i paralajmërimit të hershëm në Kosovë 2008.

Kosova mbetet vendi me ekonominë më të varfër në rajon. Ajo përballlet me nivele të larta të varfërisë, me papunësi masive (që në mesatare llogaritet të jetë 45 %), nga varësia e rëndë nga importet dhe me sektorë shumë të vogël të eksportit, me mungesë të energjisë etj.

Bruto të hyrat kombëtare (BHV) për kokë banori llogariten në 3,520 \$. Ekonomia ka vazhduar me normën e rritjes prej 3 - 5 % për afro një dekadë gjer në vitin 2011. Megjithatë ritmi i rritjes, nuk mjafton për të pasur efekte të dukshme në varfëri dhe papunësi. Për shembull, Banka Botërore përlllogarit se Kosova do të duhej që së paku të dyfishojë normën e rritjes dhe të arrijë së paku 12 % rritje në vit për një dekadë të tërë. Thënë shkurt, hendeku në të ardhura mes Kosovës dhe shteteve të tjera të Europës Juglindore, ka gjasë që të mbetet i thellë, përkundërt rritjes më të madhe.

Kosova është duke bërë përparim të qëndrueshëm dhe të rëndësishëm makroekonomik, si në ristrukturimin e fazës së parë (liberalizimi i çmimit, reformat në tregti dhe në shkëmbime të huaja si dhe privatizim), ashtu edhe në atë të fazës së dytë (politikat konkurruese dhe reformat në ndërmarrje, sistem bankar, infrastrukturë dhe reforma financiare jashtë bankare).

Tabela 6. Treguesit e përzgjedhur makroekonomikë

	Jan-Mar 2005	Kor-Sht 2005	Jan-Qer 2006	Tet-Dhj 2006	Pri-Qer 2007	Nën-Dhj 2007	Kor-Sht 2008	Pri-Qer 2009	Jan-Mar 2010	Trendi
Popullsia (në ,000) (a)	1,999*		2,033 **		2.07**	2.1**	2.1**	2.2*	2.2*	◀▶
Norma e rritjes së BPV-së (vjetore), % (a)	0.3		3.0			3.5	3.5	5.4(a)	3.8** (a)	▼
BPV për kokë banori, € (a)	1,120 (a)		1,117 (a)			1,150 (q)	1,150	1,784(a)	1,731**(a)	▼
BKK (vjetor), miliona € (b)	641.5		713.2 (l)		553 (m)		862.13	862.13	895.9 (m)	▲
Dërgesat e parave nga punëtorët, miliona €	281.0 (a)		318.0 (a)			398	467 (p)	535.8 (q)	535.8 (q)	◀▶
Ndihma e huaj, miliona € (a)	462.0 *		465.0 *			352 (r)	275**			
Fondi TKPK, miliona € (c)	145.8		167.5 (Maj) (d)	213.0 (Dhj) (k)					380.7	▲
Fondi i APK, miliona € (e)	113.1 (Dhj)		234.9 (Pri)	275.0 (Dhj)		399.9 (Nën-Dhj 2007)	426.1 (Maj)		451.0	▲
Depozitat bankare, miliona €	704.8 (Shk)	765.8 (Gus)	844.6 (Pri) (e)	926.4 (Dhj)	967.6 (Pri)	1.228 (Dhj)(s)	1.183 (p) (Maj)	1.513 (q) (Qer)	1.65 (q) (Sht)	▲
Huat nga bankat komerciale, miliona €	356.5 (Shk)	401.8 (Gus)	459.7 (Pri) (e)	490.5 (Dhj)	560.2 (Pri)	891.2 (Dhj)(t)	1,052.8 (p) (Maj)	1,281 (q) (Qer)	1,281 (q) (Sht)	◀▶
Bilanci tregtar, miliona € (j)	-219.1 (Jan-Mar)	-723.4 (Jan-Gus)	-537.5 (Jan-Qer)	-1235.3 (Jan-Dhj)	-400 (Jan-Pri)	-264.6 (Nën-Dhj) (n)	-142 (Maj)		-152 (Sht)	▼
Punëkërkesit e regjistruar	303,095 (Jan)	314,446 (Gus)	323,201 (Maj)	326,026 (Dhj)		334.595 (Dhj)	336.366 (Mar 2008) (n)	338.6 18 (Maj 2009) (q)	339.418 (Sht 2009) (q)	▲
Indeksi i çmimit të konsumatorit, % (në krahasim me majin 2002) ***	101.4 (Maj)	98.5 (Gus)	102.9 (Maj)	102.6 (Nën)	99.4 (Pri)	102.8 (Dhj)	112.8 (Qer)		108.8 (Sht)	▼
Pensionet bazike (për muaj), €	40	40	40	40	40	40	40		70	
Kthimet vullnetare		2,126		1,608 (g)						

* Llogaritur

** Projektuar

*** Në janar 2006, ESK ka ndryshuar metodologjinë për përpilimin e IÇK. Prandaj krahasimi i IÇK-së së prodhuar me IÇK-në para janarit 2006, nuk është i mundshëm

3.6. Specifikat e tranzicionit dhe privatizimit në Kosovë

Gjatë dy dekadave të fundit, vendet e Ballkanit Perëndimor duke përfshirë Kosovën, kanë pësuar një shndërrim rrënjësor ekonomik, dhe shumë prej tyre nuk njihen po të krahasohen me pozicionin ku ndodheshin në kapërcyell të shekullit. Pas viteve '90 të dominuar nga konflikti, këto vende nisën rrugën e rindërtimit dhe reformimit të tërësishëm të ekonomive të tyre. Ato u hapën ndaj tregtisë globale dhe u shndërruan në vende të orientuara gjithnjë e më shumë drejt eksporteve; ato zgjeruan rolin e sektorit privat, çmontuan ato rregullore që pengonin zhvillimin e sipërmarrjeve, dhe filluan të ndërtojnë institucionet e nevojshme për të mbështetur sistemin e ekonomisë së tregut. Në disa raste sistemet bankare u ngritën tërësisht nga zeroja, të ndihmuara nga kapitali dhe përvoja e huaj. Këto përpjekje rezultuan në një rritje të fuqishme ekonomike, rritje të ndjeshme në të ardhurat dhe standardet e jetesës, si dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë makroekonomike. Megjithatë, në mesin e viteve 2000 procesi i transformimit strukturor filloi të ngadalësohet, sepse i shërbeu interesave personalë, si edhe lodhjes nga reformat, e kështu nuk ka përfunduar ende.

Privatizimi ka qenë komponent i rëndësishëm i reformës ekonomike dhe sociale në ekonominë në tranzicion të Europës Qendrore dhe Lindore në dy dekadat e fundit.

Kosova ka trashëguar trashëgiminë jugosllave të sistemit vetëmenaxhues dhe procesin e privatizimit të lancuar në vitin 1989 nga qeveria e Ante Markoviçit. Megjithatë, në Kosovë, vetëm një numër tejet i vogël i ndërmarrjeve ia dolën të futen në skemën e privatizimit, meqë procesi u ndërpre shumë shpejt kur Qeveria e Serbisë zbatoi masa të jashtëzakonshme në Kosovë, në Mars të vitit 1989.

Procesi i privatizimit filloi përsëri pas vitit 1999, nën patronazhin e Agjencionit Kosovar të Mirëbesimit (AKM) e cila u themelua në vitin 2002 nën ombrellën e Shtyllës së Katërt të BE-së, pjesë e Misionit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë. Pas shpalljes së pavarësisë, AKM-ja u transformua në Agjencionin Kosovar të Privatizimit (AKP) me Ligjin Nr. 03/L-067 dhe operon si trup i pavarur publik. Para vitit 1989, pothuajse të gjitha aktivitetet ekonomike në Kosovë zbatoheshin nga Ndërmarrjet Shoqërore, dhe vetëm sektorët strategjik ishin “pronë publike”, që mund të njihen edhe si “ndërmarrje të mëdha shtetërore”. Edhe pse privatizimi i Ndërmarrjeve Shoqërore filloi në vitin 2003, pas shtatë viteve ky proces është akoma në gjysmë të rrugës.

Nga rreth 500 ndërmarrje shoqërore në Kosovë (ky numër është i përafërt për shkak të paqartësive rreth definimit ligjor të “pronësisë shoqërore”, si dhe dokumentacionit të humbur, një pjesë dërrmuese e të cilit u shkatërrua gjatë luftës së vitit 1999), deri tani janë privatizuar më tepër se 2 / 3 e tyre.

Rreth 450 ndërmarrje posedojnë dokumentacion i cili tregon qartë statusin e pronësisë shoqërore, përderisa statusi i ndërmarrjeve të tjera mbetet i paqartë. Statistikat tregojnë që rreth një e treta e ndërmarrjeve të privatizuara, e kanë vazhduar biznesin e tyre të mëparshëm, derisa dy e treta e tyre e kanë ndryshuar natyrën e aktiviteteve apo nuk merren fare më me biznes. Numri i madh i ndërmarrjeve të privatizuara joaktive, fenomen ky i cili nuk është i rëndomtë në ekonominë e tjera në tranzicion, mbetet brengë alarmuese për procesin e privatizimit në Kosovë.

Rritja ekonomike në Ballkanin Perëndimor në kohën e krizës globale financiare, ishte më shumë rezultat i likuiditetit të gjerë global dhe hyrjeve të paqëndrueshme të kapitaleve, sesa i progresit të vërtetë në reformën ekonomike. Provë e qartë e dobësisë së modelit ekonomik rajonal, mund të jetë niveli tejet i lartë i papunësisë, që në shumë vende, madje edhe në kulmin e bumit të parakrizës, ishte në masën mbi 20 %. Rritja ekonomike gjatë periudhës së paskrizës në vendet e Ballkanit Perëndimor, ka qenë e dobët. Mjedisi i jashtëm ka qenë i pafavorshëm, mirëpo është pikërisht procesi i papërfunduar i reformave që po frenon arritjen e niveleve të të ardhurave të ekonomive më të pasura të Bashkimit European.

Kushtet specifike në të cilat zhvillohet tranzicioni në Kosovë, kanë të bëjnë para së gjithash me (Selmani, 2009):

1. Situatën politike
2. Strukturën ekonomike të pavolitshme, me ndërmarrje shtetërore të okupuara, prapambetje teknologjike dhe dëmtim të infrastrukturës ekonomike, që përmbliken me një veprim tipik kolonial
3. Nivelin e zhvillimit dhe problemet e theksuara sociale
4. Iniciativën private relativisht të zhvilluar, por që, nën presion të rrethinës në të cilën vepron, përjeton krizë konceptore dhe stagnim në zhvillimin e saj
5. Diasporën mjaft të madhe dhe me peshë ekonomike e socio - demografike
6. Nevojën e theksuar për asistencë teknike

Projektet e tranzicionit përmbajnë aktivitetet, kohën dhe resurset e tjera të nevojshme për kalimin nga sistemi i vjetër në sistemin e ri ekonomik dhe në Kosovë mund të themi që hapat konkretë u vendosën pas Luftës së 1999-tës. Ndërkaq, qeverisja e këtyre projekteve bën të mundur arritjen e qëllimeve të parashtruara për realizimin e projekteve të përmendura. Meqenëse tranzicioni nënkupton sendërtimin e qëllimeve shumëdimensionale në rrafsh të ndryshme, qeverisja e projekteve ka për detyrë të harmonizojë kohën e zhvillimit të projekteve të ndryshme, të ekonomizojë shpenzimet e tranzicionit, në mënyrë që ky proces të japë rezultatet e pritura (RIINVEST:1999).

Lidhur me projektet e tranzicionit, porositiçi dhe aprovuesi i projekteve duhet të jenë Qeveria dhe institucionet e tjera legjitime të Republikës së Kosovës. Ato do të siguronin edhe monitorimin e projekteve. Hartues të studimeve do të ishin ekspertët kosovarë (të jashtëm dhe të brendshëm), me një involvim të asistencës teknike. Realizues të projekteve do të ishin ekipet që i formon qeveria në kuadër të ministrive përkatëse. Personeli i realizimit të projekteve duhet të kalojë një periudhë të aftësimit, në kuadër të një Programi të asistencës teknike, nëpërmjet të cilit një numër kritik i kuadrove duhet të dërgohet për aftësim në institucione qeveritare dhe joqeveritare dhe fondacione ndërkombëtare në vendet e zhvilluara dhe në vendet në tranzicion: Hungari, Poloni, Slloveni, Çeki etj. Ky program i asistencës teknike duhet të fillojë të realizohet menjëherë, në mënyrë që ekipet të jenë të gatshme për implementimin e projekteve sapo ato të jenë gati dhe sapo të krijohen kushtet përkatëse. Projektet e tranzicionit duhet të konceptohen si tërësi e ndërlidhur që ka një veprim interaktiv dhe mund të krijojë sinergjinë e domosdoshme (RIINVEST kosova.com).

Ky kompleks duhet të përfshijë para së gjithash:

1. Projektin e sistemit të ri ekonomik
2. Projektin e rimëkëmbjes ekonomike
3. Projektin e privatizimit dhe të transformimit pronësor
4. Projektin e inkuadrimin në integrimet rajonale dhe më gjerë
5. Projektin e inxhinieringut social
6. Projektin e asistencës teknike

Në këtë tekst jepen vetëm disa nga komponentët themelorë të këtyre problemeve. Në punën e mëtejme, ato duhet të përpunohen më detajisht, e sidomos strategjia dhe parakushtet e implementimit të këtyre projekteve.

3.7. Orientimi për rregullimin makroekonomik në fazën e tranzicionit në Kosovë

Ekonomia e Kosovës, që të mbyllë me sukses procesin e tranzicionit, duhet të bazohet në kritere të qarta, dhe në forcimin e faktorëve dhe institucioneve të ekonomisë së tregut në radhë të parë, të konkurrencës, efikasitetit, liberalizimit dhe të rregullimit të disa proceseve ekonomike. Politika e konkurrencës është bazë e çdo ekonomie të tregut. Ky kriter është i rëndësishëm strategjik për proceset zhvillimore në Kosovë. Konkurenca nga tregu i jashtëm dhe tregu i brendshëm do të bëjë presion në ristrukturimin e ekonomisë sipas kriterëve të efikasitetit. Konkurenca në tregun e brendshëm të Kosovës duhet të nxitet nëpërmjet rregullimit të monopoleve natyrore, pronës publike, fenomenit të bankrotit, kufizimeve buxhetore dhe financiare. Konkurenca e jashtme, respektivisht ndikimi i saj në ekonominë e Kosovës, do të sigurohet kryesisht nëpërmjet liberalizimit të sistemit dhe politikës së marrëdhënieve me botën e jashtme. (ZK, 2011-14).

Krijimi i konkurrencës së brendshme dhe i ambientit të ri menaxherial, do të nxitet edhe me aplikimin e mekanizmave monetarë, fiskal, buxhetor, financiarë dhe doganor. Gjatë liberalizimit të disa kategorive ekonomike, e sidomos të çmimeve dhe pagave, duhet së pari të sigurohet një mbështetje materiale e shoqërisë për reduktimin e pakënaqësive të punëtorëve dhe të shtresave të varfra. Politika monetare dhe kreditore përbën boshtin kryesor për krijimin

e stabilitetit makroekonomik dhe arritjen e konvertibilitetit në kushtet e veprimit të transformimeve dhe integritimeve në ekonominë e Kosovës. Nëpërmjet agregateve monetare dhe mekanizmave të tjerë do të ruhet stabiliteti valutor dhe do të sigurohet zbatimi i një politike të zhvillimit ofensiv të Kosovës. Kjo politikë do të mbështetet dhe do të zbatohet në kushtet e konsolidimit të bilancit tregtar, të bilancit të pagesave dhe të servisimit të borxheve të jashtme. Banka Qendrore do të ushtrojë një ndikim rigoroz, sidomos në segmentin e sasisë së parasë në qarkullim. Gjatë zbatimit të politikës monetare duhet të ruhet ekuilibri në tregun e parasë, ngase çdo çrregullim në këtë segment do të shprehet negativisht në ecurinë e përgjithshme të çmimeve (BQK, 2014). Disiplina financiare rigoroze dhe konkurenca nga jashtë, sigurojnë një stabilitet monetar. Ky sistem duhet të jetë kompatibil me sistemin fiskal, sepse vetëm kështu krijohen parakushtet për veprimin e ligjeve të ekonomisë së tregut dhe vendosjen e rregullave të lojës për të gjithë akterët e zhvillimit. Zbatimi i politikës së kursit real dhe rezervës devizore, duhet të shprehet me ruajtjen e konvertibilitetit valutor (MTI, 2009).

Politikat buxhetore dhe fiskale paraqesin mekanizma të rëndësishëm, meqë me ta përcaktohet piramida e përgjegjësisë dhe e kompetencave në qeverisjen e rrjedhave financiare në ekonominë e Kosovës, duke pasur parasysh kërkesat dhe nevojat strategjike të ekonomisë, të popullsisë dhe të shtetit. Gjatë zbatimit të menaxhmentit buxhetor të Kosovës, kujdes i veçantë i duhet kushtuar eliminimit të vatrave të ndikimeve inflatore, siç janë: financimi defiçitar dhe problemi i defiçiteve buxhetore. Politika buxhetore duhet të harmonizohet me politikën fiskale sepse vetëm atëherë krijohen parakushtet e barabarta për realizimin e aktivitetit ekonomik të subjekteve ekonomike (MTI, 2009).

Sistemi i marrëdhënieve me botën e jashtme, të jetë shprehje e një shkalle të konsideruar e sistemit të liberalizimeve. Ekonomia e Kosovës duhet ta sanksionojë orientimin e përhershëm për hapje ndaj ndikimeve të tregut botëror. Vetëm në hapje ndaj ndikimeve teknologjike dhe shkencore, ekonomia e Kosovës do të mund t'i valorizojë potencialet dhe përparuesit e vet komparativ, si dhe të inkuadrohet në proceset e integritimeve. Pikërisht për këtë, edhe sistemi i ri ekonomik, institucionet dhe politika makroekonomike, zhvillimin e ardhshëm duhet ta mbështesin në vendosjen e një partneriteti me strukturë integruese në rajon dhe në botë (BQK, 2014). Me një infrastrukturë të re ligjore mund të nxiten transferet teknologjike dhe kapitale në forma të ndryshme në ekonominë e Kosovës. Politika e çmimeve ka rëndësi të madhe në vendosjen e ekuilibrit ekonomik, në kushtet e zbatimit të reformave të tranzicionit. Politikën e

çmimeve duhet shtruar në një aspekt më të gjerë. Në fazën e parë duhet të eliminohet roli arbitrar i shtetit në rregullimin e çmimeve, si dhe të eliminohen disparitetet ekzistuese (BB, 2014).

Eliminimi i dispariteteve duhet të bëhet gradualisht dhe në pajtim me dinamikën e liberalizimeve në kategoritë e tjera ekonomike. Shkalla e liberalizimit të çmimeve duhet të trajtohet në kontekst të liberalizimit të pagesave me botën e jashtme, të këmbimit me botën e jashtme dhe të kursit devizor. Në parim, duhet të funksionojë formimi i lirë i çmimeve, përveç te monopoleve natyrore dhe te veprimtaritë publike (ASK, 2012). Me qëllim të forcimit të komponentës së tregut, gjatë formimit të lirë të çmimeve, është e domosdoshme të respektohet dhe të zbatohet rregullativa e politikës antimonopolistike dhe të bëhet pengimi i konkurrencës jolojale dhe spekulimeve në treg (BQK 2014).

Politika sociale ka rëndësi të madhe për zbatimin e konceptit të zhvillimit dhe të ruajtjes së stabilitetit makroekonomik në kushtet e tranzicionit. Reformat shoqërore dhe ekonomike në disa vende kanë marrë kahje të padëshirueshme ngase në to nuk është analizuar dhe projektuar ndikimi i faktorëve socio-psikologjik, historik dhe tradicional. Me rrjetin e mbrojtjes sociale, gjatë zbatimit të fazës initiale të tranzicionit, duhet të përfshihet mbrojtja e tërë popullsisë, e sidomos e asaj pjese e cila do të mbetet jashtë vendeve të punës. Për zbatimin e kësaj politike është e nevojshme që të ndërmerren këto aktivitete (MTI, 2009):

1. Hartimi i programit social në nivel Kombëtar
2. Politika sociale të ketë karakter aktiv, të sigurojë parakushte për punësim të ri
3. Sigurimi i mjeteve për rikualifikimin e të papunëve
4. Bartja e politikës dhe funksioneve sociale nga ndërmarrjet në kompetencat e shtetit
5. Shteti të krijojë kërkesë e re për punësim në ndërmarrjet e vogla dhe në punët publike
6. Krijimi i parakushteve për fillimin e biznesit të vogël

3.8. Ndikimi i krizës globale në burimet e financimit në Kosovë

Në fillim kriza përfshiu ekonominë e vendeve më të zhvilluara kapitaliste, ku dhe ishte me vrull më të lartë. Globalizimi i ekonomisë, i tregjeve dhe i financave botërore. bëri që kriza,

edhe pse lindi e u zhvillua vetëm në disa shtete të pasura e të fuqishme, të përhapej shpejt dhe të mos kursejë asnjë shtet në tërë botën.

Kështu, kriza ekonomike globale në mënyrë direkte apo indirekte, ndikoi edhe në Kosovë, përkitazi me investimet e huaja. Tani vërehet mungesë e investimeve të huaja dhe gjendja ekonomike e sociale po rëndohet edhe më shumë.

Republika e Kosovës po përballlet me shumicën e problemeve, të cilat i kanë pasur edhe shtetet e tjera postkomuniste dhe shtetet që kanë dalë nga konflikti.

Republika e Kosovës është shteti më i varfër në Europë. Të bësh biznes është e vështirë, Kosova është klasifikuar si e 75 - ta nga Banka Botërore për bërjen e biznesit në vitin 2014 (BB, 2014).

Bankat komerciale në vend po përcillen me një trend negativ të kreditimit. Është shtuar përqindja e kredive të këqija joperformuese. Ka një rritje të kreditimit por në një masë shumë më të vogël se sa ajo e viteve të kaluara.

Marrëdhënia midis performancës së biznesit dhe performancës së bankave qëndron në raport proporcional. Përkeqësimi i gjendjes financiare dhe komerciale tek bizneset reflektohet në përkeqësimin e gjendjes financiare dhe komerciale edhe të bankave (BB, 2014).

Planifikimi joefikas i rrjedhës së parasë është rezultat i krizës, por edhe i mosplanifikimit të kompanive vendore. Kreditë janë zvogëluar, sepse bankat rezervohen në këtë kohë krize, meqë kanë informacione se kompanitë do të kenë vështirësi për kthimin e kredive, prandaj në kohë krizash bankat janë më konservative, e kjo gjë po ndodh edhe në Kosovë (Mustafa, 2010:41).

Në Kosovë nuk ka ndonjë përmirësim të financimit të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, e sidomos të financimit të bizneseve fillestare. Është një numër i vogël i bankave komerciale në Kosovë, prandaj ato kanë një sjellje monopoliste në dhënien e kredive, në afatin e kthimit të kredive, janë shumë të shtrenjta dhe joekonomike për shumë biznese që kanë nevojë për financim.

Sipas raportit të BQK-së në vitin 2009, 73.3 % të bizneseve janë pjesëmarrës në kredi bankare, ndërsa në vitin 2008 ka pasur 76.3 %. Nga kjo shihet se në vitin 2009 ka një rënie prej 3 % pjesëmarrje në kredi bankare.

Në kuadër të kredive aktive, kreditë për ekonomitë familjare shënuan rritje të përshpejtuar prej 12.7 përqind, krahasuar me rritjen prej 3.9 përqind në vitin 2013.

Sidoqoftë, përshpejtimi i rritjes nuk vërehet edhe te kreditë për ndërmarrjet të cilat u karakterizuan me një normë të ngjashme të rritjes me vitin paraprak. Kreditë për ndërmarrje shënuan rritje prej 2.1 përqind në vitin 2014, 2.0 përqind në vitin 2013 (BKQ, 2014:32).

3.9. Identifikimi i barrierave kryesore dhe ndikimi i tyre në burimet e financimit

Identifikimi i barrierave kryesore dhe ndikimi i tyre në zhvillimin e menaxhimit të burimeve të financimit të bizneseve të vogla dhe të mesme.

Agjencia për mbështetje si dhe institucionet e tjera, si ato vendore ashtu edhe ato ndërkombëtare, në bazë të hulumtimeve periodike që i kanë bërë, kanë arritur në përfundim se ekzistojnë barrierat të shumta dhe të natyrave të ndryshme. Agjencia për mbështetje të ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme, pas hulumtimeve ka arritur të bëjë sistemimin dhe adresimin e barrierave kryesore të cilat për vite të tëra adresohen nga sektori i bizneseve të vogla dhe të mesme në Kosovë, nga përfaqësues të biznesit dhe të autoriteteve publike shkencore, akademike dhe politike (Riinvest,2013).

Disa nga barrierat kryesore janë: barrierat e përgjithshme, ambienti ligjor, promovimi i ndërmarrësisë, financimi, teknologjia. Barrierat kryesore në financim janë: pjesëmarrja në kapital dhe kreditë (Mustafa, 2012).

Në pjesëmarrjen në kapital ndikojnë: padisponueshmëria e kapitalit personal, rrjedha e kufizuar e investimeve të huaja, fitimi i ulët në shumicën e bizneseve.

Te kreditë ndikojnë: lartësia e kolateralit dhe kërkesave për garanci, periudha të shkurtëra faljeje për kthim të kredive, shkalla e lartë e interesit, vështirësitë në qasje afatgjate financiare në institucionet kreditore etj.


3.10. Pasojat e normave të larta të interesit

“Normat e larta të interesit në kreditë e bankave komerciale në Kosovë vështirësojnë financimin dhe zhvillimin e bizneseve”, vlerësojnë përfaqësuesit e bizneseve në Prishtinë dhe

ekspertët e çështjeve ekonomike. “Bizneset në Kosovë, nuk mund të zhvillohen pa mbështetjen financiare të bankave komerciale, por sistemi i financimit të këtyre bizneseve është tejet i shtrenjtë për shkak të normave të larta të interesit nga kreditë e bankave”, vlerësojnë përfaqësuesit e bizneseve në Kosovë dhe ekspertët e çështjeve ekonomike. Agim Shahini, drejtues i Aleancës Kosovare të Bizneseve, thotë se ngritja e normave të interesit nga bankat komerciale në gjithë botën, është pasojë e krizës financiare botërore, por niveli i normave të interesit në Kosovë, sipas tij, është më i larti. “Në ato vende që ka krizë, e kanë gjetur rrugën që t’i ulin normat e interesit dhe të dalin nga kriza. Bankat në Kosovë e kanë gjetur mënyrën tjetër që t’i ndalojnë kreditë, t’i rrisin normat e interesit dhe kështu t’i detyrojnë bizneset që të shkojnë drejt falimentimit. Kjo do të thotë se bizneset gjenden në një pozitë të vështirë, duke marrë për bazë normat e larta të interesit prej 15 deri në 17 për qind të bankave, duke marrë parasysh politikat tregtare dhe fiskale jo të favorshme, dhe duke u nisur nga fakti bazë se fuqia konsumuese në Kosovë për çdo ditë po varfërohet”, thotë Shahini.

Me normat aktuale të interesit në kreditë bankare në Kosovë, është vështirë të ndërtohet konkurrenca e bizneseve. “Këto norma janë të larta edhe në aspektin e krahasimeve rajonale dhe ndërkombëtare, që do të thotë se kapitali në Kosovë e ka çmimin më të lartë në raport me të gjitha këto zhvillime në tregun rajonal” (Sadiku, 2012). “Kemi ardhur në një situatë, ku bankat janë akomoduar me norma të larta të interesit dhe flitet që kemi një sistem bankar të qëndrueshëm, ndërsa kemi biznese të dobëta. Do të thotë, i tërë sistemi bankar dhe formula e financimit të tyre janë joadekuate në raport me nevojat reale të bizneseve në Kosovë” (Sadiku, 2012). Vitin e kaluar, ne kemi pasur rreth një mijë biznese që janë mbyllur, gjë që është shqetësuese për të gjithë ne. Ky është një argument se duhet të ketë reforma të mëdha në të gjithë spektrin, qoftë ekonomik, qoftë në atë të ndryshimeve të politikave tregtare, financiare, fiskale.

Grafiku 2. Kreditë sipas sektorëve ekonomikë



Burimi: BQK, Raporti vjetor 2014

3.11. Mundësitë e financimit të bizneseve në Kosovë

Hulumtimi mbi qasjen në kapital nxorri në pah shumë çështje, të cilave ekspertët dhe përfaqësuesit e institucioneve bankare në Kosovë, duhet t'i kushtojnë rëndësi.

Bizneset në Kosovë, i shfrytëzojnë burimet e tyre të financimit, kryesisht përmes bankave, kursimeve të tyre dhe huamarrjes, duke mos pasur shumë informata rreth burimeve të tjera të financimit që do të ishin më të përshtatshme për ta. “Ende nuk është eksploruar i tërë sistemi financiar, do të thotë, burime të tjera të financimit, përveç atij bankar. Pastaj, si një problem kyç i zhvillimit ekonomik, është identifikuar edhe mungesa e financimit të bizneseve, të cilat sapo lindin (Lekë Musa¹⁶).

“Ndërsa nga sistemi bankar në vend, është kërkuar që të përmirësohet raportimi financiar, përkatësisht të përmirësohen raportet e pasqyrave financiare, me të cilat prezantohen bizneset”, thotë Musa. Ndërsa, sa i përket normave të interesit, hulumtimi thekson se ato janë të krahasueshme me të rajonit. “Si propozime për uljen e normave të interesit, është vetë zgjerimi i bazës së ofruesve të kredive, që do të thotë se duhet të zgjerohet tregu i kapitalit, të shtohet numri i bankave, liberalizimi i tregut, të jepet si një opsion edhe ndërhyrja nëpërmjet politikave të ndryshme qeveritare, ku ata do të bënin atë që është paraparë në ligjin e ri mbi Bankën Qendrore”, ka sqaruar Lekë Musa, nga Oda Ekonomike Amerikane në Kosovë. Ekspertë të kësaj fushe, thanë se, si burime të tjera të financimit, të cilat mund të përdorin bizneset, janë edhe investimet në aksione, si dhe përdorimi i instrumenteve të tjera financiare.

3.12. Kushtet ekonomike të kredive në fillimet e krizës

Kushtet ekonomike varen nga: lloji i kredive, maturiteti, interesi, shuma maksimale e kredisë, kushtet për marrje të kredisë etj. Për nga shuma e kredisë, klasifikimi i tyre mund të variojë ndërmjet bankave, por përgjithësisht ato ndahen në të vogla deri në 10. 000 euro, të mesme deri në 100. 000 euro dhe të mëdha mbi 100. 000 euro. Kreditë jepen bazuar në mundësinë që biznesi ka për kthimin e tyre, por gjithashtu përveç pengut të luajtshëm duhet të sigurohen me patundshmëri.

¹⁶Lekë Musa është Drejtor ekzekutiv i Odës Ekonomike Amerikane në Kosovë.

Struktura e kredive sipas sektorëve edhe në vitin 2008 ka mbetur e ngjashme me periudhat e kaluara. Pjesëmarrjen më të madhe në kredi e kanë ndërmarrjet me 76.3 % të gjithsej kredive (77.5% në 2007), ndërsa ekonomitë familjare 23.7% (22.5% në 2007). Në kuadër të kredive të ndërmarrjeve, dominojnë ndërmarrjet që merren me tregti, me një pjesëmarrje prej 42.6 %. Sektori me pjesëmarrjen më të ulët në kreditë e sektorit bankar vazhdon të jetë sektori i bujqësisë, përfaqësuar me vetëm 4.1 % në kreditë. Megjithatë, në vitin 2008 vërehet një rritje në kreditë e lëshuara ndaj këtij sektori.

3.13. Bizneset përballë krizës

Kriza aktuale financiare dhe ekonomike ofron një mundësi unike që të ridiskutojmë për modelin mbizotërues të menaxhimit të biznesit të zakonshëm. Koncepti i Homo Economicus nuk mund të konsiderohet si i vlefshëm për shkak të faktit se njerëzit nuk janë të interesuar vetëm për maksimizim të interesave të tyre. Ato gjithashtu marrin parasysh mirëqenien e të tjerëve gjatë proceseve vendimmarrëse të tyre. Probleme të ngjashme paraqiten në interpretimin e paradigmës së aksionarëve, për shkak të faktit se një kompani nuk është vetëm një institucion kontraktues, duke këmbyer inputet në rezultate. Në fakt, është një sistem në përgjegjësi shoqërore të personave që bashkëpunojnë. Prandaj, duhet të aplikohet më tepër perspektiva e palëve të interesuara, që të rezultojë në përshtatjen e parimeve të përgjegjësisë korporatave sociale, duke përfshirë barazinë gjinore. Në një kontekst më të gjerë, rimendimi i modelit materialistik mund të sjellë modifikimin të mekanizmave të qeverisjes globale në një sistem më të lokalizuar, duke rritur zhvillimin e qëndrueshëm dhe parandalimin e homogjenizimit ekologjik. Në përmbledhje, një mekanizëm i balancuar në shpërndarjen, duhet të zbatohet si një themel i ri moral i kapitalizmit, në vend të proceseve racionale në shpërndarjen e burimeve.

Kriza aktuale financiare dhe ekonomike jep një dritë të re në modelin e menaxhimit të mbizotëruesve të biznesit të zakonshëm. Occupy Wall Street dhe lëvizjet e tjera antibiznes, mosbesimi i përhapur në korporatat dhe sjellja e pasigurtë e shumë liderëve të biznesit, tregojnë krizën e modelit të menaxhimit materialist (Miszlivetz, 2012).

Në botën e sotme, morali i veprimeve ekonomike shpesh është shumë i diskutueshëm dhe në shumë aspekte i papranuar. Morali i ekonomisë duhet të përmirësohet në mënyrë të konsiderueshme, por këtu ka një paradoks. Nëse duam të zhvillojmë moralin në punët e tona ekonomike, vetëm si mjet për të rritur prodhimtarinë e lartë, në rezultatin e fundit do dështojmë. Kemi mundësinë të përmirësojmë cilësinë e përgjithshme të aktiviteteve tona ekonomike, vetëm nëse motivimi ynë është i moralshëm.

3.14. Efektet e krizës globale në bizneset private në Kosovë

Me gjithë shtrirjen e krizës, autoritetet kosovare thonë se ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2008, kishte një rritje reale të produktit të brendshëm bruto prej 5.4 %.

Rritja ekonomike në vitin 2008, sipas tyre, u gjenerua nga rritja e konsumit privat dhe e investimeve publike, të cilat në masë të madhe, u financuan nga kreditë e sektorit privat, dërgesat e emigrantëve, rritja e konsiderueshme e shpenzimeve publike, si dhe nga asistenca e jashtme.

Ahmet Shala, në një bisedë në kuadër të hulumtimit që jam duke bërë për këtë disertacion, potencoi se nga indikatorët ekonomikë që përcjellin në baza ditore trendet e krizës ekonomike, nuk ka pasur ndonjë shqetësim shumë të madh në indikatorët makroekonomikë, përveç në eksport, e që në fakt, sipas tij, kjo fushë nuk ka qenë një faktor shumë domethënës në strukturën ekonomike të Kosovës. Megjithatë, kështu nuk mendojnë përfaqësuesit e bizneseve, përveç ata të ndërmarrjeve të privatizuara në Kosovë, siç janë kompania “Llamkos”, “Ferronikeli” etj., të cilat tani janë prekur nga kriza ekonomike globale.

Ndërmarrja tregtare private “Eljesa” në Fushë Kosovë, e cila merret me shitjen e teknikës së bardhë, është një nga bizneset që ka ndjerë efektet e krizës globale. Përfaqësuesi i kësaj ndërmarrjeje, Adrian Gashi, në intervistën tonë shpjegon: “Viti 2009 ishte një vit ku ne si biznese private kemi ndjerë efektet e krizës ekonomike globale. Kemi pasur shitje shumë më të vogël, krahasuar me vitet e mëparshme. Qeveria ndoshta do të mund të na ndihmonte për të dalë nga e gjithë kjo”, shprehet zoti Gashi, në intervistën tonë gjatë hartimit të temës, dhe shton më tej: “Nëse do të vazhdohet kështu, atëherë pronarët do të jenë të detyruar ta mbyllin biznesin”.

“Shqetësim për kosovarët është mundësia e uljes së remitencave. Kjo do të vërehet varësisht se sa afekton kriza ekonomike te kosovarët që janë duke punuar në botën e jashtme, si dhe nga tkurrja e investimeve të huaja ndaj projekteve për Kosovën. Deri tani, nuk ka ndonjë shenjë të fuqishme që mund të paraqesë shqetësim. Ne kemi ndërtuar mekanizmat tanë intervenues për çdo rast, por shpresoj që kjo të mos ndodhë asnjëherë në vitet e ardhshme” (Shala, 2010).

“Shifrat e para të rritjes ekonomike kanë filluar të shihen në horizontet botërore. Unë shpresoj që nga pjesa e dytë e këtij viti, do të fillojë një rigjallërim apo një ndalje e trendit negativ botëror dhe me këtë Kosova do të kalojë më lehtë” (Shala, 2010).

Përkundër asaj që kriza ekonomike globale është në rënie e sipër, ekspertë për çështje ekonomike thonë se gjatë këtij viti, bizneset kosovare do të preken edhe më tepër nga kriza globale. Viti 2009 ka ende probleme me ekonominë botërore dhe me ekonominë rajonale, dhe interesi i këtyre vendeve për të investuar në Kosovë do të jetë më i vogël. Kështu që, bizneset dhe ekonomia kosovare do të ndiejnë akoma krizën ekonomike globale, pra ekonomitë e huaja nuk do të jenë të interesuara që produktet kosovare t’i pranojnë në tregjet e tyre, sepse secili shtet është duke zhvilluar moton “Konsumoni produktet vendore”.

Kriza e Greqisë do të ndikojë në Kosovë ndoshta jo në mënyrë të drejtpërdrejtë, por do të ndikojë në disa nga produktet apo shërbimet që ne i kemi lidhur me Greqinë. Shërbimet që Kosova i ka të lidhura nga Greqia janë transporti, nafta, produktet që Kosova i merr nga vendet e treta përmes portit të Selanikut dhe përmes korridorit të Maqedonisë” (Dado, 2009).

3.15. Kriza globale financiare dhe ndikimi i saj në bizneset në Kosovë

Më qëllim të nxjerrjes së një konkluzioni sa më të saktë, janë anketuar disa nga kompanitë më të rëndësishme në Kosovë. Atyre iu jemi drejtuar me pyetjet për të nxjerrë një konkluzion kyç dhe për t’i dhënë përgjigje pyetjes kërkimore (P2) se:

- “Sa dhe si janë prekur bizneset në Kosovë nga kriza globale financiare?”

Gjithashtu nga ky hulumtim argumentohet hipoteza (H2) se:

- “Kriza globale financiare ka ndikuar drejtpërdrejtë në zhvillimin e bizneseve, në procesin e privatizimit dhe në tranzicionin e ngadaltë të ekonomisë së Kosovës”


Kompanitë të cilat janë anketuar, përbëjnë një nga historitë e sukseseve në Kosovë, megjithatë edhe këtu e shohim se kemi të bëjmë me një tkurje të numrit të punëtorëve, si pasojë e frikës nga falimentimet e mundshme. Për ilustrim, po japim tabelën dhe grafikun e ndikimit të krizës globale te bizneset në Kosovë që janë marrë për mostër.

Tabela 7. Ndikimi i krizës në numrin e punëtorëve në vitet 2008 - 2012

Nr.	Kompania	Numër punëtorëve 2008	Numër punëtorëve 2012	Ndryshimi nga kriza
1	KONSONI	65	35	30
2	Mabetex Group dhe Co	1350	1220	130
3	ABI Corporation	384	320	64
4	DEVOLLI COMPANY	950	900	50
5	FETOSHI	40	32	8
6	KAMILLA	62	45	17
7	ETC	2200	2100	100
8	MINIMAX CENTER	650	580	70
9	VIVA FRESH STORE	980	950	30
10	RAIFFEISEN BANK	980	750	230
	Total	7661	6932	729

Burimi: Nga pyetësorët doktoralë

Grafiku 3. Ndikimi i krizës në numrin e punëtorëve në vitet 2008 - 2012



Burimi: Grafik i ndërtuar nga autori

3.15.1. Hulumtimi mbi ndikimin e krizës në biznese

Qëllimi kryesor i sondazhit është për të kuptuar sjelljen e firmave në kohë krize, motivimet, kufizimet dhe nevojat e politikës për tejkalimin e saj. Synimi është që të identifikojmë aktivitetet konkrete që kanë marrë drejtuesit dhe të vlerësojmë pengesat e politikave që mund të kufizojnë aftësinë e kompanive për inovacion në tejkalimin e krizës. Fokusi bie mbi përfaqësuesit apo menaxhmentin e lartë, të cilët janë të aftë për të siguruar informacione relevante.

Sondazhi është kryer përmes intervistave gjysmë të strukturuar, ballë për ballë, bazuar në një pyetësor të përgatitur sipas standardeve të njohura. Rezultatet e sondazhit janë prezantuar poshtë këtij punimi dhe shpresoj që të jenë një bazë e mirë për të diskutuar këtë çështje më tej në të ardhmen. Rezultatet nga sondazhi janë projektuar për të siguruar udhëzime për krijimin e një strategjie të besuar për kalimin e krizës dhe pasojave të saj.

Metodologjia. Sondazhi kishte si objektiv kompanitë private në Kosovë të cilat përbëjnë rreth 50 % të fuqisë ekonomike në Kosovë, bazuar në qarkullimin financiar vjetor. Pyetësi është dizajnuar për mbledhjen e informacioneve të përgjithshme për krizat e njësive ekonomike, pyetësi përmban gjithsejt 34 pyetje, të cilat mbledhin informacione të mjaftueshme për hulumtimin tonë. Realizimi i pyetësorëve është bërë në metodën e intervistave direkte sy me sy (face to face) me pronarët, menaxherët e ndërmarrjeve, ku secila përgjigje është shënuar në pyetësor.

Baza e të dhënave është dizajnuar mbi bazën e Microsoft Office Excel, me metodën likert.


Të dhënat bazë nga hulumtimi

Hulumtimi kishte si qëllim që informacionet e siguruar të jenë sa më kualitative, prandaj kemi zgjedhur menaxhmentin e lartë për të intervistuar. Intervistat u bënë sipas metodës sy me sy me drejtuesit e kompanive: nga 10 kompanitë e anketuara, 4 të anketuar ishin në pozitën: Menaxher financiarë, ndërsa 6 të tjerë në pozitën: Kryeshef ekzekutiv CEO. E konsideroj si mostër relativisht objektive dhe reprezentative, pasi këto biznese përbëjnë rreth 50 % të fuqisë ekonomike në Kosovë, në aspektin e xhiros së tyre vjetore.

Tabela 8. Cila është pozita në kompaninë ku punoni?

Pozita	n	%
Menaxher financiar	4	40.0
Kryeshef ekzekutiv CEO	6	60.0
Totali	10.0	100.0

Grafiku 4. Cila është pozita në kompaninë ku punoni?




Niveli i kualifikimit tuaj?

Niveli i arsimimit të menaxhmentit në Kosovë është rritur dukshëm viteve të fundit dhe vazhdon të jetë në rritje e sipër, siç rezulton edhe nga anketimi ynë. Katër nga të anketuarit ishin në nivelin e kualifikimit Bachelor, katër në nivelin Master dhe dy të nivelit të Doktoraturës.

Tabela 9 Niveli i kualifikimit tuaj

Kualifikimi	n	%
Shkolla e Mesme	0	0.0
Bachelor	4	40.0
Master	4	40.0
Doktoraturë	2	20.0
Totali	10	100.0

Grafiku 5. Niveli i kualifikimit



Faktorët e qeverisjes së kompanisë


Sistemet e qeverisjes së njësive ekonomike janë të ndara midis sistemeve me një ose dy nivele të bordit. Në terma ligjorë, ky diferencim mund të jetë i rëndësishëm, por për të punuarit praktik të menaxhmentit, nuk është e thënë që të jetë kështu.

Tabela 10. Faktorët e qeverisjes së kompanisë

Cilët janë faktorët që formojnë sistemet e qeverisjes së njësive ekonomike?	Mesatarja	%	Devijimi Standard
1. Personalitetet	4.2	84%	0.6
2. Pronësia	3.4	68%	0.9
3. Modeli themelor i biznesit	3.3	66%	1.3
4. Kuadri ligjor dhe kulturor	3.5	70%	1
Totali		General weighted Mean=3.6 Sample (N) = 10 Sig. $\alpha = 0.05$	

Në bazë të përgjigjeve nga tabela, shohim një mesatare aritmetike jo edhe aq të kënaqshme, pra një mesatare aritmetike prej (3.6) që na le të kuptojmë se menaxherët e kompanive nuk janë edhe aq të vetëdijshëm lidhur me faktorët që formojnë sistemet qeverisëse të njësive ekonomike.

Grafiku 6. Faktorët e qeverisjes së kompanisë



A i shton vlerë organizatës sistemi i qeverisjes së kompanisë?


Nuk ka vetëm një sistem të mirë qeverisjeje të korporatës, por në përgjithësi transparencia, përgjegjshmëria dhe bashkëpunimi në krye të organizatës, rrisin cilësinë e saj. Është përgjegjësia e anëtarëve të bordit, të sigurojnë që edhe në kohë të mira, sistemi i qeverisjes së korporatës së tyre po funksionon mirë, sepse në kohë krize do të tendoset në kufinj të saj.

Tabela 11. A i shton vlerë organizatës sistemi i qeverisjes së kompanisë?

Sa ndikon menaxhmenti i lartë (BtD) në qeverisjen e mirë dhe strategjitë mbrojtëse?	Mesatarja	%	Devijimi standard
5. I shton të dhëna të reja zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë	4.2	84%	0.7
6. Mundëson një bazë të gjerë informacioni, nëpërmjet diversitetit të drejtorëve, të cilët testojnë dhe provojnë supozimet në zbatimin e strategjisë	3.4	68%	0.7
7. Siguron zbulimin e hershëm të zhvillimeve negative	3.6	72%	1.1
Totali General weighted Mean=3.73 Sample (N) = 10 Sig. α = 0.05			

Në pyetjen: “Sa ndikon menaxhmenti i lartë (BtD) në qeverisjen e mirë dhe në strategjitë mbrojtëse?”, respondentët pajtohen me pohimet tona por jo bindshëm.

Grafiku 7. A i shton vlerë organizatës sistemi i qeverisjes së kompanisë?



Mesatarja e ponderuar është (3.37), dhe një devijim standard që nuk ka ndonjë ndryshim aq të madh në secilen pyetje.

Parandalimi dhe përballja me krizat ekonomiko - financiare


Krizat kanë shumë shkaqe, ndonjëherë të jashtme, ndonjëherë të brendshme, disa vijnë krejt befasisht, ndërsa të tjerat zhvillohen me kalimin e kohës, disa prekin ekonomi të tëra e të tjera vetëm një kompani, ose thjesht një departament ose njësi të biznesit. Kriza e vitit 2008 - 09 u transferua nga jashtë. Qeverisja e mirë e njësive ekonomike mund të këtë një vlerë të madhe, duke parandaluar ngjarjet e këqija që prekin kompaninë ose përshkallëzohen drejt një krize ose niveli shkatërrimi.

Tabela 12. Parandalimi dhe përballja me krizat

Si mund të ndihmojë menaxhmenti parandalimin apo pakësimin e krizës?	Mesatarja	%	Devijimi standard
8. Përcakton strategjinë e duhur dhe masën e riskut të dëshiruar	3.9	78%	1.2
9. Mbikqyr zbatimin dhe ekzekutimin e sistemeve të menaxhimit të riskut	3.5	70%	0.8
10. Shqyrton mjedisin dhe kupton faktorët shtytës të biznesit, në mënyrë që të ndihmojë për të zbuluar më herët krizën	3.6	72%	0.9
11. Eleminon shkaqe të caktuara të krizës së brendshme	3.1	62%	1.1
12. Rrit besimin për të ardhmen e kompanisë tek palët e jashtme të interesuara, veçanërisht tek investitorët dhe punonjësit	3.6	72%	0.8
Totali		General weighted Mean = 3.54 Sample (N) = 10 , Sig. α = 0.05	

Në pyetjen 3: “Si mund të ndihmojë bordi i drejtorëve parandalimin apo pakësimin e krizës?”, shohim rezultate jo aq të kënaqshme në krahasim me pohimet tona.

Grafiku 8. Parandalimi dhe përballja me krizat



Mesatarja aritmetike është (3.54) dhe devijimi standard nuk ka ndonjë ndikim të madh në këto pyetje.

Kriza të zakonshme të qeverisjes së korporatave


Kriza është një shmangie negative e rëndë, që mund të kërcënojë ekzistencën e një kompanie. Krizat mund të shfaqen në shumë forma dhe mund të kenë shumë shkaqe. Shumë nga krizat e korporatave burojnë nga mungesa e qeverisjes së korporatës në kompani.

Tabela 13. Kriza të zakonshme të qeverisjes së korporatave

Cilat janë llojet e konflikteve në drejtimin e kompanisë që krijojnë krizat e lidhura me qeverisjen e njësive ekonomike?	Mesatarja	%	Devijimi standard
13. Aksionarët kundër aksionarëve	4	80%	0.89
14. Aksionarët kundër menaxhimit	3.5	70%	0.9
15. Bordi kundër menaxhimit	3.2	64%	1.4
16. Anëtarët e bordit kundër anëtarëve të bordit	4.1	82%	0.7
Totali		General weighted Mean=3.7 Sample (N) = 10, Sig. α = 0.05	

Në pyetjen: “Cilat janë llojet e konflikteve në drejtimin e kompanisë që krijojnë krizat e lidhura me qeverisjen e korporatave?”, nga përgjigjet vërejmë se respondentët më tepër pajtohen me paragrafin e parë dhe të fundit. Mesatarja e ponderuar është (3.7) dhe devijimi standard nuk ka ndonjë dallim të madh nga pyetja në pyetje.

Grafiku 9. Kriza të zakonshme të qeverisjes së korporatave



Pra, në grafikun 9 shihet se cilat janë llojet e konflikteve në drejtimin e kompanisë që krijojnë krizat e lidhura me qeverisjen e korporatave, po thuajse nuk vërehet ndonjë dallim të madhe dhe të gjitha opsionet tona janë të pranueshme në masën të konsiderueshme, gjë e cila na thotë se problem serioz në administrimin e kompanive paraqesin të gjitha mundësitë e konfliktit të paraparë.

Pengesa e vendimmarrjes së shëndoshë


Është thelbësore që faktet e shëmtuara të mos fshihen, por të përballohen sa më herët dhe t'i jepet zgjidhje rrëmujave. Shpresa se problemet do të zgjidhen po të injorohen bie ndesh me çdo të dhënë empirike, përkundrazi ato priren të përkeqësohen nëse lihen pas dore.

Tabela 14. Pengesa e vendimmarrjes së shëndoshë

A mendoni se paragrafët e mëposhtëm flasin për tri pengesa tipike të vendimmarrjes së shëndoshë?	Mesatarja	%	Devijimi standard
17. Pengesat politike	4.1	82%	0.9
18. Pengesat e organizimit	3.7	74%	0.9
19. Pengesat psikologjike	2.7	54%	1.4
Totali		General weighted Mean=3.5 Sample (N) = 10 Sig. $\alpha = 0.05$	

Në pyetjen: “A mendoni se paragrafët e mëposhtëm flasin për tre pengesa tipike të vendimmarrjes së shëndoshë?”, shohim rezultate jo aq të kënaqshme në krahasim me pohimet tona. Mesatarja aritmetike është (3.5) dhe devijimi standard s'ka ndonjë dallim aq të madh.

Grafiku 10. Pengesat e vendimmarrjes së shëndoshë



Në pyetjet tona në të cilat vërtetohet hipoteza pozitive, shohim se pengesat e vendimmarrjes së shëndoshë janë: pengesat politike, pengesat e organizimit dhe pengesat psikologjike.

Shenjat paralajmëruese të krizës


Shumica e krizave zhvillohen me kalimin e kohës dhe shenjat janë të dukshme për ata që duan t'i shohin. Ky është momenti kur menaxhmenti duhet të tregohet veçanërisht i kujdesshëm, dhe anëtarët e jashtëm të bordit duhet të luajnë një rol të veçantë. Duke qenë më pak të përfshirë në operacionet e biznesit, ata mund t'i dallojnë më lehtë format e pazakonta, tendencat e reja, tabllonë në tërësi, dhe mund t'i vlerësojnë në mënyrë më neutrale implikimet e tyre të mundshme për kompaninë.

Tabela 15. Shenjat paralajmëruese të krizës

Cilat janë shenjat paralajmëruese të krizës?	Mesatarja	%	Devijimi Standard
20. Menaxhimi i lartë shfaq prirje psikologjike në marrjen e vendimeve	3.7	74 %	0.9
21. Ndryshimet në rregullat e kontabilitetit apo raportime, duke paraqitur një situatë më të favorshme financiare	3.4	68 %	1.4
22. Hyrjet e parave jo nga operacionet por nga burimet e pazakonshme	3.6	72 %	1.1
23. Kostot, sidomos ato administrative, rriten më shpejt sesa të ardhurat	2.7	54 %	1.3
24. Pakënaqësitë e dukshme nëpër klientë	4.3	86 %	1.27
Totali		General weighted Mean=3.54 Sample (N) = 10Sig. $\alpha = 0.05$	

Në pyetjen: “**Cilat janë shenjat paralajmëruese të krizës?**”, shohim rezultate jo shumë të kënaqshme në krahasim me pohimet tona. Mesatarja aritmetike është (3.54) dhe devijimi standard nuk paraqet ndonjë ndikim të madh.

Grafiku 11. Shenjat paralajmëruese të krizës




Nëse perceptoni apo realisht jeni në krizë, cilët hapa do t'i ndërmerrni?

Nëse perceptoni apo realisht jeni në krizë, cilët hapa do t'i ndërmerrni?	Mesatarja	%	Devijimi standard
25. Pranoni realitetin: jemi në krizë!	3.5	70%	1.4
26. Veproni shpejt për të frenuar krizën	3.4	68%	1.3
27. Ndryshoni bordin dhe proceset për t'iu përshtatur realitetit të ri	3	60%	1.3
28. Ndani qartë përgjegjësitë	3.7	74%	1
Totali		General weighted Mean=3.4 Sample (N) = 10 Sig. $\alpha = 0.05$	

Në pyetjen: “Nëse perceptoni apo realisht jeni në krizë, cilët hapa do t'i ndërmerrni?”, shohim rezultate jo aq të kënaqshme në krahasim me pohimet tona. Mesatarja aritmetike është (3.4) dhe devijimi standard sikurse në pyetjet e mëhershme, nuk ka ndonjë ndikim edhe aq të madh.

Grafiku 12. Nëse perceptoni apo realisht jeni në krizë, cilat hapa do t'i ndërmerrni?



Nëse pranoni realitetin se diçka po shkon keq, duhet ta gjeni saktësisht problemin në mënyrë që ta rregulloni vetë ose me ndihmën e të tjerëve. Në varësi të krizës, ju rrezikoni të mbeteni prapa konkurrencës për pak kohë, duke marrë masa. Por, duke mos pranuar krizën, ju rrezikoni të mbeteni për një kohë të gjatë prapa konkurrencës. Në të kundërt, nëse i merrni masat e duhura në kohë, fitorja juaj mund të jetë shumë e afërt.

Nga kush përbëhet skuadra përgjegjëse për krizën?


Në kohë krize, bordi mund të vendosë krijimin e një komiteti të veçantë, një grup pune ku mund të marrin pjesë edhe specialistë të jashtëm, për të kryer detyrën e skuadrës përgjegjëse për krizën. Përbërja e skuadrës përgjegjëse për krizën varet nga lloji i krizës, aftësitë e menaxherëve dhe veçoritë e sistemit të qeverisjes së korporatës.

Tabela 16. Nga kush përbëhet skuadra për krizën?

Nga kush përbëhet skuadra përgjegjëse për krizën?	Mesatarja	%	Devijimi standard
29. Drejtori egzekutiv / CEO-ja përfshirë Drejtorin e financës	3.8	76 %	1.3
30. Kryetari i bordit	3.4	68 %	1.4
31. Drejtorët e komitetit të bordit të ngarkuar me përgjigjen ndaj krizës	3.5	70 %	1.3
32. Këshilltari i përgjithshëm i kompanisë	3.6	72 %	1.42
33. Këshilltari i jashtëm	3.6	72 %	1.36
34. Ekspertë të industrisë	3.6	72 %	1.43
Totali General weighted Mean=3.58 Sample (N) = 10 Sig. $\alpha = 0.05$			

Nga rezultatet e tabelës nr. 12: “Nga kush përbëhet skuadra përgjegjëse për krizën?”, shuma e mesatares aritmetike është (3.58) dhe devijimet standarde në këtë pyetje, sikurse në pyetjet e tjera të mëhershme, nuk kanë ndonjë ndikim të madh në përgjigjet e marra.

Grafiku 13. Nga kush përbëhet skuadra përgjegjëse për krizën?



Duke u bazuar në këto rezultate, mund të themi se: Kompanitë e anketuara, direkt apo indirekt kanë hasur në efektet e krizës, madje edhe kanë marrë masa parandaluese dhe tejkaluese.

Secila kompani në raste krizash mundohet që në të gjitha mënyrat e mundshme të racionalizojë shpenzimet, cilado qofshin ato shpenzime, qofshin të stafit apo të produktit.

Tek kompanitë tregtare, pjesëmarrës të pyetësorit tonë janë përgjigjur se hapi i parë që kanë ndërmarrë për ulje të shpenzimeve ka qenë racionalizimi i stafit, ulja e pagave, ndryshimet e çmimeve përkatësisht rritja e tyre, si dhe kanë ndërmarrë strategji të reja.

Tek kompanitë prodhuese përveç racionalizimit të stafit, uljes së pagave të punëtorëve, po ashtu këtu është bërë edhe racionalizimi i kostos administrative, por tek këto kompani prodhuese, përveç ndaljes së projekteve investive e përdorimit të strategjive të reja, më së shumti ndikim ka pasur strategjia e rritjes së çmimeve për produkte.

Tek firma financiare, siç mund të shihet, kryesisht janë fokusuar në racionalizimin e stafit, në uljen e pagave për punëtorët si dhe në mundësinë e krijimit të strategjive të reja të korporatave.

Në fund të çdo pyetësi, është dhënë mundësia që vetë menaxherët të japin nga “Një mendim për krizën”. Përmbledhja është kjo:

“KONSONI” SHPK - “Të shpresojmë që kjo është një fazë rigjeneruese dhe se do të kalojë së shpejti, pasi populli po lodhet çdo ditë e më shumë nga kjo krizë. Por, mund të cekim që kjo gjë nuk varet vetëm nga ne, pasi kemi të bëjmë me një efekt mbarë botëror.”

“Mabetex Group” - “Tejkalimi i krizës në botë do të thotë këndellje e ekonomisë edhe tek ne.”

“ABI” - “Tejkalimi i krizës politike tek ne do të thotë fillim i tejkalimit të krizës financiare, edhe pse kriza financiare është botërore, ndikimi politik është shumë i madh, sidomos në tërheqjen e investitorëve të rinj të huaj.”

“DEVOLLI CORPORATION” - “Thjeshtë një fazë rigjeneruese!”

“FETOSHI” - “Kriza është në tejkalim e sipër, megjithatë kjo krizë është një ndikim botëror, por gjithashtu keqmenaxhim i buxhetit shtetëror nga politika vendore.”

“KAMILLA” - “E shoh si një fazë në tejkalim e sipër që duhet parë përtej saj.”

“ETC” - “Kriza, një pikë ndalimi e cila do të tejkalohet së shpejti.”

“MINIMAX SHOPPING CENTER” - “Duhet parë përtej krizës, megjithatë vështirë të thuhet që do të dalim së shpejti nga kriza sepse nuk varet vetëm nga Kosova, meqë bëhet fjalë për krizë mbarëbotërore.”

“VIVA FRESH STORE” - “Kriza ka ndikuar shumë në kapitalizimin e secilës organizatë fitimprurëse, qoftë ajo prodhuese, tregtare, shërbyese apo financiare. Kjo fazë nuk është tejkaluar akoma, por me punë të madhe mund të ndikohet në tejkalimin e saj, edhe pse është diçka që nuk varet vetëm nga ne.”

“RAIFFEISEN BANK KOSOVA” - “Tejkalimi i krizës mund të tejkalohet me tërheqjen e investitorëve të rinj në Kosovë, por së pari duhet të tejkalohen krizat vendore politike dhe duhet të krijohet një mjedis i përshtatshëm në të gjitha aspektet për këto biznese investuese”

3.16. Kriza globale dhe sektori bankar i Kosovës

Sektori bankar i Kosovës është një sektor relativisht i ri, i cili filloi të funksionojë në vitin 1999, përderisa para kësaj kohe në Kosovë nuk kishte sistem bankar modern në kuptimin e ofrimit të ndërmjetësimit financiar, bazuar në kushtet e ekonomisë së tregut. Si vendi i fundit në rajon që ka filluar procesin e tranzicionit, Kosova po vazhdon të kalojë nëpër sfida të shumta të rimëkëmbjes ekonomike dhe të konsolidimit të institucioneve për të krijuar kushtet për funksionimin e ekonomisë së tregut.

Përkundër reputacionit jo të mirë të trashëguar nga periudha e ish Jugosllavisë, kur klientët kosovarë humbën kursimet e tyre, sektori bankar në Kosovë ka rikthyer besimin, duke bërë që kjo industri të radhitet në mesin e tregimeve më të suksesshme të ekonomisë së Kosovës që nga përfundimi i luftës. Këtu rol të rëndësishëm ka luajtur BQK, e cila në rolin e rregullatorit të sistemit financiar, i ka prirë zhvillimit të këtij sektori, si dhe prezenca e bankave të huaja të cilat sollën reputacionin nga vendet prej nga vinin dhe vendosën bazat e bankut modern në Kosovë (MDA, 2014).

Tabela 17. Struktura e aseteve të sistemit bankar në Kosovë

Përshkrimi	Dhjetor 2009 Milionë euro	Dhjetor 2010 Milionë euro	Dhjetor 2011 Milionë euro	Dhjetor 2012 Milionë euro	Shtator 2013 Milionë euro
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	322.2	307.5	331.5	425.7	427.2
Bilanci me bankat komerciale	405.6	439.0	329.5	287.9	294.0
Letrat me vlerë	97.0	173.4	202.0	256.6	276.0
Kreditë dhe lizingu	1,289.0	1458.7	1698.1	1763.4	1798.0
Asetet fikse	43.1	44.0	47.4	57.7	54.4
Asetet tjera	47.7	32.3	41.3	38.1	26.1
Gjithsej	2,204.6	2454.9	2649.8	2829.4	2875.7

Burimi: BQK, Raporti vjetor 2012 dhe vlerësimi tremujor i ekonomisë nr. 4

Sistemi bankar i Kosovës karakterizohet me një pjesëmarrje të lartë të bankave të huaja të cilat përbëjnë rreth 90 përqind të të gjitha aseteve të këtij sektori. Prezenca e bankave me origjinë nga vendet me sektorë të avancuar financiar, ka qenë faktor shtytës në adaptimin e praktikave më bashkëkohore të veprimtarisë bankare në Kosovë, me theks të posaçëm në lansimin e vazhdueshëm të produkteve të reja bankare si dhe praktikave moderne për vlerësimin e rrezikut.

Më fjalë të tjera, bankat në Kosovë janë të varura nga tregjet lokale; ato kanë më shumë depozita se kredi, që në këtë rast është indikator pozitiv për të parandaluar krizën që të ketë ndikim në Kosovë. Raiffeisen Banka në Kosovë (RBKO) ka kapital prej 44 milion eurosh, 495 milion euro depozita dhe 394 milion euro kredi; ProCredit Banka në Kosovë (PCB) ka 560 milion euro depozita dhe 440 milion euro kredi (BQK 2012).

Tabela 18. Institucionet financiare në Kosovë

NUMRI I INSTITUCIONEVE FINANCIARE					
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	Qer-2014
Bankat Komerciale	8	8	8	9	10
Kompanitë e sigurimit	12	13	13	13	13
Fondet Pensionale	2	2	2	2	2
Ndihmësit financiar	28	34	34	38	41
Institucionet Mikrofinanciare	17	20	20	17	18
Gjithsej	67	77	77	79	84

Burimi: BQK - Raporti vjetor (2013) dhe Raporti i Stabilitetit Financiar nr. 6

Pavarësisht se kriza financiare vazhdoi me ndikimin e saj në gjithë sektorin financiar në botë, duke shkaktuar falimentimin e shumë ndërmarrjeve dhe bankave të fuqishme, sektori bankar

në Kosovë, fatmirësisht, vazhdon të jetë imun ndaj kësaj krize dhe nuk vërehet ndonjë ndikim i theksuar.

Sipas statistikave të BQK-së për bankat komerciale që operojnë në Kosovë, sektori bankar në përgjithësi ka performuar mirë dhe nuk është prekur nga kriza globale financiare.

Gjatë kësaj periudhe bankat kanë financuar sektorë të ndryshëm të ekonomisë. Sipas të dhënave të fundvitit rreth 38 % janë kredi në tregti, rreth 24 % kredi individuale, 12 % kredi të tjera, rreth 9 % shërbim, turizëm dhe hotelieri, rreth 6 % në kredi të paluajshmërisë.

Struktura e tregut në sistemin bankar të Kosovës karakterizohet me shkallë të lartë të koncentrimit. Sidoqoftë, trendet e fundit tregojnë për rënie të shkallës së koncentrimit në këtë treg, si rezultat i hyrjes së bankave të reja dhe konsolidimit të tregut, me një kontribut të theksuar në rritjen e shkallës së konkurrencës në këtë sektor. Si rezultat, vazhdimisht është vërejtur rënie e kostonë së ndërmjetësimit financiar, numër më i madh i produkteve bankare, zgjerim i rrjetit të bankave dhe lehtësim i qasjes së klientëve në shërbimet bankare. Sektori bankar i Kosovës, duke adaptuar vazhdimisht teknologji të re, po zhvillohet konform trendeve të bankingut modern duke iu përshtatur ndryshimit të sjelljes së konsumatorëve në drejtim të shërbimeve bankare.

Sektori bankar paraqet po ashtu njërin ndër faktorët kyç në stimulimin e zhvillimit ekonomik të vendit. Kreditë aktive të sektorit bankar kanë arritur në rreth 1.3 miliardë euro, që paraqet mbi 30 përqind të PBB-së së vendit. Financimi i kredidhënies nga bankat komerciale, në masën më të madhe financohet nga depozitat e mbledhura përbrenda Kosovës, të cilat kanë arritur në rreth 1.5 miliardë euro (BQK, 2011).

Me gjithë përmirësimet e vazhdueshme, kostoja e ndërmjetësimit në sistemin bankar vazhdon të konsiderohet e lartë. Në këtë kanë ndikuar faktorë të ndryshëm të ndërlidhur si me vetë bankat ashtu edhe me rrethinën afariste. Për shembull, normat e larta të interesit mund t'i atribuohen shpenzimeve të larta operationale, çka nënkupton nevojën për ngritje të efikasitetit në banka. Pastaj, historia e shkurtër kreditore e kredimarrësve, e cila buron nga periudha e shkurtër e funksionimit të sistemit bankar, paraqet vështirësi për matjen e rrezikut kreditor, gjë që ndikon në perceptim më të lartë të rrezikut kreditor dhe normë më të lartë të interesit në kredi. Ndër faktorët që do të mund të ndikojnë në uljen e nivelit të perceptuar të rrezikut kreditor, rrjedhimisht në normat e interesit në kredi dhe nivelin e ndërmjetësimit, janë zbatimi i mirëfilltë i ligjit mbi raportimin financiar të bizneseve, arsyeshmëria e projekteve investuese

si dhe ngritja e efikasitetit të sistemit gjyqësor, që do të lehtësonte ekzekutimin e kolateralit të kreditë e humbura (SCOK, 2014).

Sistemi bankar i Kosovës gjatë gjithë periudhës së funksionimit ka qenë i karakterizuar me nivel të lartë të qëndrueshmërisë, që ka buruar nga aplikimi i politikave konservative të kreditimit nga ana e bankave dhe mbikëqyrja konservative nga rregullatori.

Kjo shpjegohet edhe me faktin se pjesëmarrja e kredive të këqija në të gjithë portofolin kreditor të sektorit bankar, është në nivel të ulët. Ajo e rradhit sektorin bankar të Kosovës ndër sektorët me cilësinë më të mirë të portofolit kreditor në rajon (BQK, 2014).

Sektori bankar i Kosovës vazhdoi të ketë nivel të lartë të stabilitetit edhe përkundër zhvillimeve negative në sektorin financiar ndërkombëtar si rezultat i krizës financiare. Kësaj gjendjeje i ka kontribuar edhe jocompleksiteti i vetë sektorit bankar të Kosovës.

Me gjithë avancimin e vazhdueshëm, funksioni i bankave komerciale që operojnë në Kosovë vazhdon të jetë bazik, kryesisht i koncentruar në kreditimin e ekonomisë vendore, duke u financuar nga depozitat e mbledhura brenda vendit. Kjo ka bërë që bankat komerciale të cilat operojnë në Kosovë, të mos kenë nivel të lartë të ekspozimit ndaj sektorit të jashtëm, ndërsa financimi përmes depozitave të mbledhura brenda vendit ka bërë që niveli i kreditimit në Kosovë të mos jetë i varur nga oferta dhe kostoja e fondeve në sektorin e jashtëm (BQK, 2014).

Përkundër faktit që si kreditë, ashtu edhe depozitat, kanë treguar norma pozitive të rritjes gjatë tërë periudhës, trendet e fundit tregojnë për ngadalësim të këtyre normave, posaçërisht të kreditë, gjë që mund të interpretohet si kujdes i shtuar i bankave në rrethanat e reja që janë krijuar si pasojë e shtrirjes së krizës ekonomike globale. Duke marrë parasysh zhvillimet e deritanishme, mund të konsiderohet që sektori bankar i Kosovës është treguar imun ndaj krizës financiare globale. Megjithatë, si rrjedhojë e shtrirjes së vazhdueshme të krizës ekonomike, pritët një ngadalësim i aktivitetit ekonomik edhe në Kosovë, me implikime të mundshme negative edhe për performancën e sektorit bankar.

Rritja e normës së papunësisë në vendet e Europës perëndimore ka goditur edhe emigrantët kosovarë, duke zvogëluar kështu nivelin e dërgesave të emigrantëve drejt Kosovës, të cilat paraqesin një ndër burimet kryesore të financimit për ekonominë e vendit. Po ashtu, rënia e kërkesës në sektorin e jashtëm si rezultat i recesionit, është reflektuar negativisht edhe në

nivelin e eksporteve, duke goditur industrinë kryesore eksportuese. Nën këto rrethana, shtrëngimi i kredithënies drejt sektorit real të ekonomisë mund të kontribuojë në thellimin e mëtejshmë të ngadalësimit të aktivitetit ekonomik në vend.

Andaj, vazhdimi i kreditimit edhe në këtë kohë, duke respektuar parimet e kreditimit të shëndoshë, paraqet një faktor shumë të rëndësishëm për të stimuluar aktivitetin ekonomik në vend dhe për të mënjeluar në një masë efektet negative nga kriza.

3.17. Qëndrueshmëria e sistemit bankar në Kosovë dhe BE

Banka Qendrore Europiane është pjesë e një ekzaminimi më të gjerë që përfshin edhe një “Stress test” për të parë se si bankat reagojnë nën skenarët më të vështirë ekonomikë. Banka qendrore ka për qëllim të shmangë ndonjë surprizë, ndërsa merr në nëntor edhe përgjegjësitë për mbikëqyrjen e tyre. Bankat evropiane kaluan të ashtuquajturin “Stress Test”, ku kaluan në sitë të gjithë bankat. Si e shikoni gjendjen e financave evropiane? Po në raport me krizën globale? Dilema kryesore ishte për një zgjidhje apo përgjigje profesionale: Sigurisht, nuk mund të jetë më e mira e mundshme, por mund të kishte dalë edhe më keq. Besoj se një pjesë e mirë e bankave kryesore dhe më të mëdha evropiane, ia dolën të përballojnë provën e rezistencës (stress testin), edhe në situata të tilla të vështira të një stanjacioni apo recesioni të zgjatur ekonomik (Meka, 2012). Lidhur me krizën globale, ishte mëse e pritshme një situatë e tillë, pasi për vetë strukturën e organizmit të bankut evropian, në dallim nga ai amerikan, periudha e shëndoshjes së strukturës së bilancit të bankave evropiane do të vijojë të kërkojë dhe pak kohë dhe patjetër do të kërkojë një bazament më të fortë kapitali aksionar.

Banka Qendrore Europiane ka mbledhur të dhënat e 128 bankave më të mëdha të Eurozonës, që do të marrin pjesë në këtë Stress test. Ndërsa mbikëqyrësit kombëtarë kanë identifikuar edhe portofolet veçanërisht të rrezikshëm, që do të dëshironin të përfshiheshin në një hetim më të thellë. Morgan Stanley¹⁷ mendon se Italia, Holanda dhe Austria do të shfaqin probleme të mëdha në lidhje me kreditë e këqija.

¹⁷**Morgan Stanley** ([NYSE: MS](#)) është një korporatë amerikane e shërbimeve financiare shumëkombëshe me seli në Stanley Morgan ndërtesën e Midtown Manhattan, New York City. Morgan Stanley operon në 42 vende dhe ka më shumë se 1.300 zyra dhe 60.000 punonjës.

Krahas analizimit të gjendjes aktuale të ekspozimit të sektorit bankar ndaj rrezikut kreditor, rrezikut të solvencës, rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të tregut, analiza stress test paraqet një vegël shtesë përmes së cilës është vlerësuar qëndrueshmëria e sektorit ndaj tronditjeve të mundshme si në portofolin kreditor ashtu edhe në asetet likuide.

Analiza mbështetet në skenarin hipotetik se do të ketë krizë ekonomike në vendet e Bashkimit European, si dhe efektet e saj do të reflektohen në ekonominë e Kosovës përmes zvogëlimit të dërgesave të emigrantëve dhe eksporteve, duke dekurajuar kështu kërkesën e përgjithshme në vend¹⁸. Si rezultat, kjo supozohet të ndikojë negativisht në rritjen ekonomike në vend, duke zgjeruar kështu hendekun e prodhimit dhe duke ndikuar negativisht në cilësinë e portofolit kreditor.

Në këtë skenar është marrë parasysh norma mesatare e rritjes ekonomike në Kosovë prej rreth 3.3 % në pesë vitet e fundit si dhe është supozuar rënie ekonomike prej 2.7 % për vitin 2013, gjë që do bënë që hendeku i prodhimit të jetë 6.0 %. Për të vlerësuar ndikimin e hendekut të prodhimit në cilësinë e portofolit kreditor, gjegjësisht në kreditë joperformuese, janë shfrytëzuar koeficientët e elasticitetit nga një analizë e papublikuar e FMN-së për disa vende të Evropës qendrore dhe juglindore.

Rritja e pjesëmarrjes së NPL-ve në gjithsej kreditë, ndikon në rritjen e provizioneve, zhvlerësimi i euros ndikon në rivlerësimin e humbjes / fitimit nga pozicionet e hapura neto, si dhe zvogëlimi i normave të interesit ndikon në humbjet / fitimet e të hyrave neto nga interesi, duke marrë parasysh hendekun e maturiteteve të kredive dhe depozitave. Krahas supozimeve për tronditjet e lartpërmendura, po ashtu është marrë parasysh profiti i pritur si një absorbues i humbjeve nga këto tronditje. Në këtë kontekst, është supozuar se profiti për gjysmën e dytë të vitit 2013 do të jetë 60 përqind i profitit të realizuar në gjysmën e parë të vitit (kjo për shkak se është supozuar se nuk do të ketë rritje të kredive), përderisa komponentet e tjera të pasqyrës së të ardhurave janë supozuar të kenë nivel të ngjashëm me gjysmën e parë të vitit.

¹⁸Raporti i Stabilitetit Financiar fq. 64, Kufijtë për llogaritjen e rëndësisë sistematike në kriteret përkatëse ishin: Për kriterin e madhësisë, ku mesatarja e peshuar e indikatorëve ishte e barabartë apo më e lartë se 20 % (gjysma e 40 % të peshës së kriterit të madhësisë); për zëvendësueshmërinë ku mesatarja e peshuar e indikatorëve ishte e barabartë me 20 % (gjysma e peshës së kriterit prej 40%); për kriterin e ndërlidhshmërisë ku mesatarja e peshuar e indikatorëve ishte e barabartë me 5 % (gjysma e peshës së kriterit prej 10 %); dhe për kriterin e kompleksitetit ku mesatarja e peshuar e indikatorëve ishte e barabartë me 10 % meqenëse u vlerësua nga një indikator i vetëm.

Rritja e supozuar e NPL-ve është shprehur përmes migrimit të kredive nga kategoritë performuese (standarde, në vëzhgim, nënstandarde) drejt kategorive joperformuese (të dyshimta dhe të humbura). Rritja e NPL-ve është shpërndarë proporcionalisht në kuadër të kategorisë së kredive të dyshimta dhe të kredive të humbura, duke marrë për bazë pjesëmarrjen fillestare të këtyre kategorive në gjithsej NPL-të. Rritja e NPL-ve reflektohet në nivelin e provizioneve bazuar në rregulloren e BQK-së për provizionimin e kredive sipas klasifikimit. Supozimi për rritjen e NPL-ve aplikohet edhe te zërat jashtëbilancor që përfshijnë zotimet e pashfrytëzuara, garancionet, letër kreditë në dispozicion, dhe letër kreditë komerciale.

Me gjithë faktin se në skenarin e analizuar është konsideruar zhvlerësimi i euros ndaj valutave të huaja për të vlerësuar rrezikun e normës së këmbimit valutor, është me rëndësi të potencohet se ndikimi i këtij rreziku në bilancin e gjendjes së sektorit bankar vazhdon të jetë shumë i vogël. Pjesa dërmuese e portofolios së kredive është në euro, kreditimi në valutë të huaj është në nivel minimal, duke bërë që rreziku nga norma e këmbimit valutor të mbetet minor. Skenari mbi rrezikun nga norma e interesit nënkupton zvogëlimin e normave të interesit për 2pp, si për asetet ashtu edhe për detyrimet në bilancin e gjendjes (BQK, 2014).

Zvogëlimi i normave të interesit mund të ndikojë në marginën neto të interesit, duke marrë parasysh afatin e maturimit të kredive dhe depozitave.

Spektori bankar i Kosovës ka ekspozim të ulët edhe ndaj këtij rreziku, meqë pjesa dërmuese e kredive dhe depozitave në sektorin bankar të Kosovës, kanë normë fikse të interesit. Andaj, sektori bankar është shumë pak i ndjeshëm ndaj lëvizjeve të normave të interesit në periudhë afatshkurtër (BQK, 2015).

Gjendja ekzistuese e sektorit bankar të Kosovës, për sa i përket kapitalizimit të bankave është mjaft e favorshme, me treguesin e mjaftueshmërisë së kapitalit në 15 %¹⁹. Gjithashtu, sektori bankar vazhdon të qëndrojë mirë edhe për sa i përket nivelit të kredive joperformuese në raport me gjithsej kreditë (7.8%) dhe mbulueshmërisë së humbjeve eventuale nga këto kredi me anë të provizioneve, të cilat mbulojnë NPL-të me 113.2 %. Andaj, sektori bankar tregon nivel të lartë të qëndrueshmërisë ndaj rrezikut kreditor, edhe nën kushtet e paraqitjes së skenarëve hipotetikë të përshkruar më lart.

¹⁹ Për qëllime të analizës stress-test, janë përfshirë ndryshimet e bëra në Rregulloret bankare të cilat janë efektive nga muaji korrik 2013.

Nën supozimin se pjesëmarrja e NPL-ve në portfolion e kredive të sektorit do të rritet për 4.8 pp, euro do të zhvlerësohet ndaj valutave të tjera për 20 përqind, dhe normat e interesit do të zvogëlohen për 2.0 pp, në nivel të sektorit bankar në tërësi CAR do të mbetet mbi 12 %, përderisa në nivel të bankave individuale CAR i vetëm dy prej bankave do të zbriste nën nivelin prej 12 % të kërkuar nga Banka Qendrore. Megjithatë, në mënyrë që niveli i CAR-së të këtyre dy bankave të ngrihet në minimumin rregullativ prej 12 %, do të duhej një injektim kapitali ekuivalent me vetëm 0.19 % të vlerës së PBB-së së parashikuar për vitin 2013. Nën këtë skenar, pjesëmarrja e NPL-ve në gjithsej kreditë e sektorit bankar do të arrinte në 12.6 përqind, përderisa në nivel të bankave individuale kjo pjesëmarrje e NPL-ve do të sillej brenda intervalit 4.8 % deri në 16 %. Supozimet e sipërpërmendura të tronditjeve, rritja e pjesëmarrjes së NPL-ve, zhvlerësimi i euros ndaj valutave të tjera, si dhe zvogëlimi i normave të interesit, do të bënte që gjithsej humbja e sektorit bankar të arrinte vlerën prej 53.4 milionë euro. Megjithatë, jo e tëra kjo vlerë mund të konsiderohet si humbje eventuale, meqë duhet të merret parasysh fakti se një pjesë e madhe e kësaj humbje do të absorbohej nga profiti i pritur për periudhën e konsideruar. Supozimi i dështimit të tre kredimarrësve më të mëdhenj në secilën nga bankat, do të kishte ndikim në CAR të disa nga bankat individuale, përderisa CAR i sektorit bankar do të vazhdonte të qëndronte mbi nivelin rregullativ. CAR i tri prej bankave do të zbriste nën nivelin prej 12 përqind, ndërsa një bankë tjetër do të shënonte CAR prej 12.0 %. Në mënyrë që niveli i CAR i tri bankave të ngritet në minimumin rregullativ prej 12 %, do të duhej një injektim kapitali prej 25 milionë euro, vlerë kjo ekuivalente me vetëm 0.47 % të PBB-së. Nën supozimin e dështimit të pesë kredimarrësve më të mëdhenj në secilën bankë, CAR i katër bankave do të zbriste nën 12 % dhe vlera e kapitalit të nevojshëm për injektim do të ishte 38 milionë euro apo 0.7 % të vlerës së PBB-së.

Në kuadër të analizimit të pozitës së likuiditetit të sektorit bankar, në pjesët më të hershme të këtij publikimi është cekur se sektori bankar i Kosovës konsiderohet të jetë mjaft likuid, gjë që vërtetohet edhe nga niveli mjaft i lartë i indikatorëve të likuiditetit.

Asetet themelore likuide dhe ato gjithëpërfshirëse përbëjnë 27.9 %, përkatësisht 29.3 % të gjithsej aseteve të sektorit bankar. Andaj, edhe në rast se skenarët e lartpërmendur do të shfaqeshin në praktikë, sektori bankar do të tregonte një qëndrueshmëri mjaft të lartë kundrejt rrezikut të likuiditetit. Në përgjithësi, rezultat e stress testit, bazuar në skenarin e tërheqjes së vazhdueshme pesë ditore të depozitave, sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës paraqitet të

ketë nivel të kënaqshëm të qëndrueshmërisë, edhe në rast se do të paraqiteshin norma më të larta të tërheqjes së depozitave.

Nën supozimin hipotetik të tërheqjes së depozitave në mënyrë të vazhdueshme për pesë ditë me radhë me normën prej 8 përqind të supozuar më lart, problemet e para të likuiditetit në banka fillojnë të shfaqen vetëm pas ditës së katërt, dhe atë vetëm në njërin prej bankave. Shuma e mjeteve të nevojshme likuide shtesë për bankën e afektuar do të ishte 8.35 milionë euro (0.16 % e PBB-së), ndërsa raporti kredi / depozita do të arrinte në 115.2 % (duke supozuar se niveli i kredive nuk do të vazhdonte të rritej gjatë kësaj periudhe). Pas ditës së pestë, problemet me mjetet likuide do të shfaqeshin edhe në dy banka të tjera, duke e sjellë numrin e bankave të afektuara në tri. Në këtë rast, vlera shtesë e mjeteve likuide të nevojshme për tejkalimin e problemeve me likuiditet do të arrinte në 37.97 milionë euro (0.72 % e PBB-së). Në këtë fazë, që nënkupton tërheqjen e 34.1 % të gjithsej depozitave dhe nën supozimin se vlera e kredive nuk ndryshon, raporti kredi / depozita do të arrinte në 125.2 % në nivel të sektorit bankar.

Supozimi i dështimit të depozitorëve më të mëdhenj në secilën nga bankat sjell rezultate që sugjerojnë se sektori bankar i Kosovës nuk ka koncentrim të theksuar të burimeve të financimit, ndaj tërheqja e menjëhershme e depozitave nga individë apo kompani me ekspozime të mëdha në secilën nga bankat, nuk paraqet rrezik për sektorin. Përjashtim në këtë kontekst bën vetëm njëra nga bankat, në të cilën në rast të tërheqjes së depozitave nga të gjithë depozitorët me ekspozime të mëdha, mjetet e nevojshme për tejkalim të problemeve të likuiditetit do të ishin 17.5 milionë euro (0.33% e PBB-së).

Tabela 19. Përmbledhje e rezultateve të stress testit: Rreziku i likuiditetit

Përshkrimi	Numri i bankave	Mjetet likuide shtesë të nevojshme (000 euro)	Raporti kredi - depozita (%)
Pas ditës së parë	0	0	89.7
Pas ditës së dytë	0	0	97.5
Pas ditës së tretë	0	0	105.9
Pas ditës së katërt	1	8349	115.2
Pas ditës së pestë	3	37972	125.2

Burimi: BQK (2013) Shënim. Numri i bankave të cilat do të kishin nevojë për mjete likuide shtesë.

Nivelet përballuese të tërheqjes së depozitave për secilën bankë, para se të shfaqen probleme me likuiditet, duken të jenë mjaft të larta gjithashtu. Sektori bankar është në gjendje të përballojë një tërheqje të depozitave deri në afër 29 përqind, pa pasur probleme në mirëmbajtjen e mjeteve të nevojshme likuide (BQK, 2014a). Në këtë rast, raporti kredi / depozita do të arrinte në 115.7 %, nën supozimin se vlera e kredive mbetet e pandryshuar. Kriza e fundit financiare ndikoi që iniciativat ndërkombëtare të përqëndrojnë një pjesë të madhe të aktiviteteve të tyre në forcimin dhe konsolidimin e infrastrukturës financiare, për të nxitur dhe mirëmbajtur stabilitetin financiar. Përderisa sistemet e pagesave paraqesin shtyllën kryesore në infrastrukturën financiare të një vendi, këto sisteme duhen të kenë një bazë të qëndrueshme legale që siguron ekzekutimin e sigurt të transaksioneve të pagesave, si dhe mekanizma që kontrollojnë rreziqet financiare dhe operacionale, të cilët mund të pengojnë mbarëvajtjen e sistemit. Gjithashtu, mundësia e qasjes në informatat kreditore në kohë reale dhe historikut kreditor përmes rregjistrimit të kredive, është dëshmuar të ketë kontribuar në menaxhimin më të mirë të rrezikut dhe stabilitetin financiar të një vendi.

KAPITULLI I I KATËRT

4. NGE CJET EKONOMIKE NË KOSOVË, SI PASOJË E KRIZËS FINANCIARE

4.1. Rritja e ngadalshme dhe kriza

Aktiviteti ekonomik në nivel global gjatë vitit 2014 u rikuperua me një ritëm më të ngadalshëm, përderisa rritja ekonomike mbeti e pabarabartë dhe me diferenca të dukshme në mes të rajoneve. Eurozona shënoi normë pozitive të rritjes ekonomike, megjithëse vetëm tremujori i parë i vitit u karakterizua me rikuperim më të fuqishëm të rritjes ekonomike, ndërsa në dy tremujorët vijues rimëkëmbja u ngadalësua (BQK:2:2015). Përkundër uljes së vazhdueshme të normës bazë të interesit nga Banka Qendrore Europiane, Eurozona u karakterizua me kërkesë më të ulët dhe rënie të normës së inflacionit gjatë vitit 2014, duke ngritur kështu shqetësimet rreth mundësisë së hyrjes në një periudhë deflacioni. Rajoni i Ballkanit Perëndimor gjatë vitit 2014 u karakterizua me rritje më të dobët ekonomike krahasuar me vitin paraprak.


Performanca e dobësuar e aktivitetit ekonomik në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë vitit 2014, ka ndikuar që vlerësimi për rritjen ekonomike të jetë vetëm 1.8 % (2.5 % në vitin 2013). Shkalla e ulët e inflacionit në nivel global, si pasojë e rënies së çmimeve në tregjet ndërkombëtare, si dhe kërkesa përgjithësisht më e ulët në rajon, ka rezultuar në norma më të ulëta të inflacionit në vendet e Ballkanit Perëndimor. Karakteristikë e përbashkët e vendeve të Ballkanit Perëndimor mbetet deficiti i llogarisë rrjedhëse, që gjatë vitit 2014 shënoi rritje të mëtejme. Sektori fiskal në vendet e Ballkanit Perëndimor është karakterizuar me përmirësim të bilancit buxhetor, ndërkohë që borxhi publik ka vazhduar të mbetet i lartë. Sektori bankar në vendet e Ballkanit Perëndimor gjatë vitit 2014 u karakterizua me zhvillime të ndryshme, ku kreditimi në disa prej vendeve shënoi rritje e në disa të tjera u zvogëlua. Sa i përket depozitave, trendi i rritjes së tyre është përshpejtuar në shumicën e vendeve të rajonit (BQK:2:2015).

Norma reale e rritjes ekonomike në Kosovë gjatë vitit 2014, sipas vlerësimeve të BQK-së ishte 3.0 %, që përkon me një ndër normat më të larta të rritjes ekonomike në rajon. Kjo rritje u përcaktua nga ecuria pozitive e konsumit, përderisa investimet dhe neto eksportet vlerësohet të kenë ndikuar negativisht në normën reale të rritjes ekonomike. Rritja e konsumit gjatë vitit

2014 i atribuohet kryesisht rritjes së remitencave dhe kredive konsumuese, si dhe rritjes së shpenzimeve rrjedhëse të qeverisë. Investimet në vitin 2014 u karakterizuan me rënie të konsiderueshme, kryesisht për shkak të rënies së investimeve publike. Në të njëjtën periudhë, thellimi i deficitit tregtar të mallrave ka ndikuar që neto eksportet gjatë vitit 2014 të kontribuojnë negativisht në rritjen e PBB-së. Përkundër rritjes së eksportit të mallrave gjatë vitit 2014, niveli shumë më i lartë i importit ka bërë që neto eksportet të kontribuojnë negativisht në rritjen ekonomike.

Rritja e dobët reale që karakterizoi disa nga rajonet e mëdha në gjysmën e parë të vitit 2014 ndikoi që FMN të revidojë projeksionet për rritjen ekonomike globale dy herë gjatë këtij viti. Parashikimet paraprake të FMN-së sugjeronin rritje ekonomike globale prej 3.6 % në vitin 2014, përderisa në korrik dhe përfundimisht në tetor të këtij viti, FMN uli parashikimet e saj në 3.4, përkatësisht 3.3 %. Pritjet për një aktivitet më të dobët ekonomik edhe në vitin 2015 u pasqyruan në rishikimin e normës së parashikuar paraprakisht prej 4.0 % në 3.8 % në tetor të vitit 2014. Parashikimet ekonomike ndryshojnë ndërmjet rajoneve dhe sidomos ndërmjet vendeve edhe për vitin 2014. Rritja e aktivitetit ekonomik në nivel global është nxitur kryesisht nga ekonomia e SHBA-së dhe Mbretërisë së Bashkuar, përderisa Japonia dhe Eurozona u karakterizuan me rritje modeste ekonomike gjatë kësaj periudhe.

Grafiku 14. Rritja reale e PBB - së



Burimi: IMF WEO (Tetor 2014)

Rikuperimi ekonomik që e karakterizoi Europën Juglindore gjatë vitit 2013 rezulton të ketë qenë i brishtë, meqenëse performanca e aktivitetit ekonomik në gjashtëmuajorin e parë të vitit 2014 në këto vende rezulton të jetë përkeqësuar. Rritja ekonomike për vendet e Europës Juglindore në vitin 2014 është vlerësuar të jetë 1.8 %, që paraqet një rritje më të ulët krahasuar me parashikimin fillestar. Rishikimi i rritjes ekonomike për vendet ballkanike kryesisht i është atribuar rikuperimit të dobët ekonomik në Bashkimin Europian gjatë vitit 2014 dhe zhvillimeve jo të favorshme në disa nga vendet e Europës Juglindore.

Tabela 20. Norma e rritjes së PBB - së reale në vendet e Ballkanit Perëndimor

Vendet	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Kosova	7.2	3.6	3.3	4.4	2.8	3.4	3.0
Maqedonia	5.0	-0.9	2.9	2.8	-0.4	2.9	3.4
Serbia	3.8	-3.5	1.0	1.6	-1.5	2.5	-0.5
Shqipëria	7.5	3.4	3.5	2.3	1.1	0.4	2.1
Mali i Zi	6.9	-5.7	2.5	3.2	-2.5	3.5	2.3
Bosnja e H.	5.6	-2.7	0.8	1.0	-1.2	2.1	0.7

Burimi: FMN (WEO, 2014) për Kosovën, të dhënat e ASK-së dhe vlerësimi i BQK-së për vitin 2014

4.1.1. Pasqyra ekonomike e Kosovës

Kosova, si dhe vendet e tjera të Europës Juglindore, pas vitit 1999 gjendej në fazën e tranzicionit dhe ishte nën protektoratin ndërkombëtar, e udhëhequr nga UNMIK-u. Për dallim prej vendeve të tjera të rajonit, Kosova nuk kishte pavarësinë politike, që dukshëm është shprehur në zgjidhjen e problemeve politike - shoqërore dhe ekonomike (Limani, 2010:279).

Kriza financiare ka forcuar edhe më tej gjurmët e varfërisë në Kosovë! Direkt apo indirekt ajo ka atakuar edhe të varfërit edhe të pasurit. Sipas portalit të CIA-s i cili i përmbledh faktet për shtete të ndryshme, raporti ndërmjet të dhënave të publikuara në 2009 për popullsinë që jeton në Kosovë dhe ato të paralajmëruara ditë më parë gjatë regjistrimit të popullsisë në vendin tonë, janë deri diku të përafërta.

Fakti që përdorim euron, është një ndër faktorët që ne të ndihemi si pjesë e Europës, por duke qenë se sektori financiar kosovar është i limituar në ekspozimin ndaj tregjeve botërore, vendi ynë nuk është prekur në masë të madhe nga kriza, krahasuar me vendet e tjera, megjithëse po, por jo në masën ekstreme.

Nëse marrim si faktor prodhimin e brendshëm bruto, sipas FMN-së (IMF, 2013), Kosova është me GDP-në më të ulët në Ballkan, por që ka normëm më të lartë së GDP rritjes në Ballkan. Turqia mund të quhet vendi më i pasur i Ballkanit, nëse si faktor marrim prodhimin e brendshëm bruto. Sipas CIA-s i cili i përmbledh faktet për shtete të ndryshme dhe në këtë rast për Turqinë, GDP-ja atje është 888 miliardë dollarë. Greqia renditet e dyta nga vendet e Ballkanit që kanë GDP-në më të lartë. Më pas, me një diferencë jo shumë të madhe vjen Rumania. Në listën e vendeve të Ballkanit që kanë GDP-në më të lartë, Shqipëria renditet e teta. Kosova, renditet në vendin e fundit për sa i përket nivelit të Prodhimit të Brendshëm Bruto. GDP e Kosovës rezulton 4 miliardë dollarë. Dhe për sa i përket rritjes ekonomike, Kosova është në vend të fundit, me 2,6 për qind (Erëbara, 2009).

Ekonomia e Kosovës ishte dëmtuar apo më mirë të themi ishte shkatërruar e tëra gjatë luftës, ndërsa pas luftës ishte e pamundur që të rimëkëmbet pa ndihmën e donacioneve nga vendet e ndryshme. Menjëherë pas luftës u desh që të investohet në riparimin dhe ndërtimin e shumë shtëpive, të cilat ishin shkatërruar nga ushtria dhe policia serbe. Më pastaj, kemi investimin në infrastrukturë duke u munduar kështu që të sigurojmë gjërat elementare të nevojshme për jetën e qytetarëve. E gjithë kjo, bëhej falë ndihmave dhe donacioneve nga vendet e jashtme. Shumë shpejt u vendosën bazat kryesore juridike dhe ekonomike për funksionimin e ekonomisë së tregut dhe të jetës ekonomike e shoqërore në Kosovë.

Gjatë kësaj kohe nuk kishte zhvillim ekonomik. Zhvillimi ekonomik është një rritje në standardin e jetesës, përmirësimin e nevojave vetanake dhe liri nga shtypja, si dhe mundësi më të mëdha për zgjidhje. Po ashtu duhet theksuar se gjatë kësaj kohë nuk kishte rritje ekonomike, ne e dimë se rritja ekonomike paraqet rritjen e nivelit real të prodhimit kombëtar të vendit, si rezultat i një rritje në cilësinë e resurseve (p.sh.: edukim më i mirë etj.), rritjen e sasisë së burimeve dhe përmirësimeve në teknologji (EDE Growth). Me fjalë të tjera, një rritje në vlerën e mallrave dhe shërbimeve të prodhuara nga çdo sektor i ekonomisë. E gjithë kjo ishte e vështirë të arrihet për një kohë të shkurtër, sepse gjithcka duhej të fillojë nga zero, sepse ekonomia e vendit tonë ishte shkatërruar nga lufta dhe ishte e domosdoshme një ndihmë nga vendet e jashtme, në mënyrë që ekonomia të krijonte një bazë, që do t'i mundësojë të veprojë dhe të zhvillohet ngadalë, duke e marrë veten me ndërtimin e të gjitha institucioneve publike, duke nënkuptuar këtu edhe ndërtimin e Autoritetit Qendror Fiskal, e që do të mundësojë

mbledhjen e te hyrave përmes doganave, tatimeve, taksave etj. Kështu do të mundësohej edhe funksionimi ekonomik në mënyrë të rregullt.

Kosova, si shteti më i ri, po ballafaqohet me shumë sfida të rëndësishme, ndër to është edhe zhillimi i ekonomisë në një nivel që do të sigurojë një jetë më të mirë për qytetarët e Kosovës. Që nga viti 2000, procesi i tranzicionit të një ekonomie të ndikuar nga socializmi, në një ekonomi të tregut me konkurrencë të lirë, është përcjellur nga BE-ja. Ndërsa sot, mund të themi se Kosova është një vend me një ekonomi të lirë të tregut.


Pjesa më e madhe e ndërmarrjeve shoqërore deri tani janë privatizuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP)²⁰. Edhe në vendet më të zhvilluara kemi pasur një sistem të tillë të privatizimit, por privatizimet duhet të ndodhin në një formë tjetër, duke bërë një analizë të thellë të atyre aseteve që privatizohen, sepse në vendin tonë shumë ndërmarrje shoqërore nuk janë shitur sipas vlerës që kanë, por këtu ka edhe faktorë të tjerë që ndikojnë në privatizime të tilla.

Fondi Monetar Ndërkombëtar ka vlerësuar se rritja ekonomike në Kosovë ka qenë 2.7 %. Rritja ekonomike nuk ka ndikuar në përmirësimin e standartit jetësor të qytetarëve, gjë që e tregon shumë mirë niveli i lartë i papunësisë dhe fakti se një pjesë e qytetarëve jetojnë në varfëri të skajshme.

Ndërsa, sipas Raportit të Bankës Qendrore të Kosovës (BQK) në vitin 2012 ekonomia e Kosovës ka pasur një rritje prej 2.9 %, por kjo tregon se kemi një ritëm më të ngadalshëm se sa vitin e kaluar. Këto zhvillime janë paraqitur më poshtë më anë të grafikut.

²⁰ Agjencia Kosovare e Privatizimit themelohet si një organ i pavarur publik i cili i ushtron funksionet dhe përgjegjësitë në mënyrë plotësisht të pavarur, në bazë Ligjit të Kuvendit të Kosovës ligjit **Nr. 05/L-80** për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit **Nr. 04/L-034** i plotësuar dhe ndryshuar me ligjin **Nr. 04/L-115** për përfundimin e mbikëqyrjes ndërkombëtare të pavarësisë së Kosovës. AKP ka zotësi të plotë juridike, posaçërisht për të bërë kontrata, për të marrë, mbajtur ose shitur pronën, si dhe ka të gjitha kompetencat e vetëkuptueshme për përmbushjen në tërësi të detyrave dhe kompetencave të dhëna me këtë ligj; si dhe të padisë e të paditet në emër të saj.

Grafiku 15. Rritja reale e PBB-së²¹



Burimi: *ASK (2012) dhe Vlerësimi i BQK-së

Sipas grafikunit, vërejmë se në vitin 2012 kemi pasur rritje ekonomike prej 2.9 %, ndërsa krahasuar me vitin 2011 vërehet një rënie gjatë rritjes ekonomike. Kjo rënie është pasojë e shumë faktorëve të cilët kanë ndikuar në rënien ekonomike gjatë vitit 2012.

Treguesi kryesor dhe më i rëndësishëm makroekonomik në Sistemin e Llogarive Kombëtare është Bruto Produkti Vendor BPV²² (Publikimet ASK 2013), i cili paraqet rezultatet finale të prodhimit në të gjitha aktivitetet e njësive prodhuese rezidente.

BPV në Kosovë për vitet 2004 - 2010 është rritur në vlerën prej 2.912,5 në 4.215,6 milion euro. BPV për kokë banori është rritur prej 1.822 € në vitin 2004, në 2.721 € në vitin 2012.

²¹Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) është një tregues i vlerës së tregut të të gjitha të mirave dhe shërbimeve përfundimtare të prodhuara në një shtet. PBB përfshin gjithë prodhimet e shërbimet aktuale të destinuara për treg, si dhe ato të prodhuara për konsum për vete nga të gjitha njësitë rezidente që veprojnë në territorin e një shteti.

PBB = VSHB + TP + TD - SP ku:

VSHB Vlera e Shtuar Bruto (me çmime bazë)


TP Taksat mbi Produktet përfshirë Taksën e Vlerës së Shtuar

TD Taksat doganore

SP Subvencionet mbi produktet dhe importet

²²Bruto produkti vendor (BPV) sipas qasjes së shpenzimeve është shuma e të gjitha shpenzimeve finale të mallrave dhe shërbimeve. Këto shpenzime ndahen në tri grupe kryesore: konsumi final (KF), formimi i kapitalit bruto (FKB), neto eksporti dhe importi (EI). Meqë bruto prodhimi vendor (BPV) mat prodhimin e brendshëm, vlera e të gjitha shpenzimeve të importit zbritet nga të gjitha shpenzimet, duke përdorur formulën: $BPV = KF + FKB + (E - I)$

Grafiku 16. BPV për frymë (Euro)



Burimi: Enti i Statistikës së Kosovës, Prishtinë 2013

Në bazë të grafitit, mund të konkludojmë se BPV-ja për kokë banori ka pasur trende rritëse deri në vitin 2008, ndërkohë vërehet një rënie në vitin 2009, ndërsa në vitin 2010 prapë kemi përmirësim i cili paraqitet edhe në grafitin me rritje të BPV-së, duke arritur në 2.383 euro për vitin 2010. Ndërsa gjatë vitit 2011, BPV-ja për kokë banori ka qenë 2.668 €, duke vazhduar kështu me rritje edhe gjatë vitit 2012, rritje e cila ka arritur të jetë 2.771 €. Norma reale e rritjes së Bruto Produktit Vendor në Kosovë ishte 2.5 për qind në vitin 2012. Rritja reale për vitin 2012 u ndikua nga rritja e shpenzimeve të Konsumit Final i Ekonomive Shtëpiake (KFESH)²³ me 1.9 për qind; rritja e eksportit të mallrave dhe shërbimeve me 0.8 për qind dhe rënia e importit të mallrave dhe shërbimeve me (- 7.2 për qind). Rritja u neutralizua nga rënia e shpenzimeve të Konsumit Final të Qeverisë (- 0.9 për qind) dhe rënia e Formimit Bruto (të përgjithshëm) të Kapitalit me -10.9 përqind.

Gjatë vitit 2012, sipas vlerësimeve të BQK-së, norma reale e rritjes ekonomike në vend, arriti në 2.9 përqind. Në terma nominal, Produkti i Brendshëm Bruto (PBB) gjatë vitit 2012 tejkaloi shumë prej 5.0 miliardë euro. Kjo pasi konsumi ka vazhduar të rritet, i nxitur nga sektori privat dhe publik. Përveç konsumit, gjatë vitit 2012, ndikimin më të madh në rritjen ekonomike


²³Konsumi final i ekonomive shtëpiake (KFESH) është vlerësuar si shumë e konsumit të ekonomive shtëpiake rezidente në Kosovë, duke i shtuar blerjet e mallrave dhe shërbimeve në botën e jashtme nga ekonomitë shtëpiake rezidente (import i shërbimeve në Kosovë), dhe duke i zbritur blerjet e mallrave dhe shërbimeve nga ekonomitë shtëpiake jorezidente në Kosovë (eksport i shërbimeve). KFESH i gjithsej ekonomive shtëpiake rezidente në Kosovë është marrë nga Anketa e buxhetit familjar të ekonomive shtëpiake (ABFESH) dhe nga të dhënat administrative. Kjo paraqet blerjen e mallrave e shërbimeve si dhe konsumin e prodhimit vetanak.

në vend e kishte përmirësimi i pozicionit tregtar të Kosovës në mallra dhe shërbime (BQK, 2012).

Lëvizjet e çmimeve në Kosovë në masën më të madhe shkaktohen nga çmimet e importit. Presionet inflacioniste të cilat arritën kulmin në vitin 2011, filluan të zbuten në vitin 2012. Indeksi i Çmimeve të Konsumit²⁴ në vitin 2012 shënoi rritje mesatare vjetore prej 2.5 %, që paraqet një normë relativisht më të ulët të inflacionit krahasuar me vitin paraprak, kur inflacioni shënoi një normë mesatare vjetore prej 7.3 %.

Zbutja e presioneve inflacioniste gjatë vitit 2012, kryesisht i adresohet dobësimit të kërkesës si dhe zhvillimeve të përgjithshme të çmimeve në nivel global. Çmimet e produkteve si buka dhe drithërat, perimet si dhe vajrat e yndyrat, kishin ndikimin kryesor në zbutjen e inflacionit. Ndërsa, çmimet e naftës vazhduan edhe më tutje të kenë ndikim pozitiv në rritjen e nivelit të përgjithshëm të çmimeve në vend (BQKa, 2012).

Grafiku 17. Norma vjetore e çmimeve të konsumit, importit dhe prodhimit



Burimi: ASK (2015); Kalkulimet e BQK-së

Ndryshimi i çmimeve në Kosovë në masë të madhe është pasojë e ndryshimit të çmimeve në tregjet e jashtme, të cilat reflektohen nëpërmjet Indeksit të Çmimeve të Importit (BQKa, 2012).

Në vitin 2012, norma mesatare vjetore e rritjes së IPI-së ishte 5.2 % (BQK, 2012). Në figurë vërehet ndjeshmëria e lartë e nivelit të çmimeve në Kosovë nga lëvizjet e çmimeve në tregjet globale. Trendi i CPI-së dhe Indeksit të Çmimeve të Prodhimit, kanë ndjekur trend shumë të

²⁴ Indeksi i Çmimeve të Konsumit (IÇK) mat ndryshimin e çmimeve të konsumit të një shporte fikse mallrash e shërbimesh në periudhën korrente krahasuar me një periudhë tjetër, e konsideruar si periudha bazë.

ngjashëm me IPI-në. Trendi i ngjashëm i çmimeve të importit dhe çmimeve të prodhimit, tregon për një mbështetje mjaft të madhe të prodhimit vendor në importin e lëndës së parë nga jashtë. Përkundër kësaj, në vitin 2012, CPI-ja ka qenë dukshëm më e ulët se sa IPI-ja (2.8 pp diferencë).

Duke e analizuar gjendjen e përgjithshme ekonomike në Kosovë, mund të themi se gjendja ekonomike nuk është e mirë, përkundër rritjes që kishte gjatë vitit 2011 dhe gjatë vitit 2012, pra nuk ka ende stabilitet ekonomik afatgjatë. Edhe pse në Kosovë kemi pasur rritje ekonomike 4.5 % në vitin 2011 dhe 2.9 % në vitin 2012, nuk mund të jemi të kënaqur me këtë rritje, kur kemi parasysh që vendi ynë gjendet në një pikë të ulët të zhvillimit ekonomik. Vendi ynë vazhdon të ketë probleme të shumta. Një ndër sfidat kryesore dhe të vazhdueshme në Kosovë paraqitet të jetë norma e lartë e papunësisë. Papunësia në Kosovë vazhdon të jetë në përqindje të lartë, ndërsa një përqindje e popullsisë janë në varfëri të skajshme. Sipas rezultateve të Anketës së Fuqisë Punëtore të publikuar nga ASK-ja, shkalla e papunësisë në Kosovë, në gjysmën e parë të vitit 2012 ishte 35.1 %. Sipas rezultateve të kësaj ankete, shkalla e papunësisë është më e theksuar në zonat rurale (40.1 %) krahasuar me zonat urbane (28.5 %).

Kosova, si shtet i ri, duhet që të aplikojë politika të cilat ndikojnë në përmirësimin e mjedisit afarist. Duhet të bëjmë zhvillimin e tregjeve financiare, anëtarësimin në institucionet ndërkombëtare financiare etj. Ekonomia e Kosovës në vitin 2013 ka pasur problemet e njëjta të vitit 2012, sepse mungojnë zgjidhjet adekuate të këtyre problemeve ekonomike.

Problemeve të tilla si papunësia dhe varfëria, defiçiti i lartë tregtar, rënia e investimeve të huaja, i është shtuar edhe një problem që po vazhdon të brengosë së tepërmi. Ai është korrupsioni i lartë.

Më qëllimin e krijimit të një pasqyre më të detajuar mbi treguesit e zhvillimit ekonomik - social të Kosovës në 30 vitet e fundit, në tabelën e mëposhtme janë paraqitur rezultatet statistikore dhe krahasimi i tyre veç e veç.

Tabela 21. Krahasimi i treguesve të zhvillimit ekonomik - socialë në Kosovë

Nr.	Kosova Përshkrimi i analizuar	Viti bazë 1984	Viti i evidencës	Viti Krahasues 2014	Viti i evidencës
1	Popullsia	1.719.000	1981	1.780.021	2011
2	Totali i familjeve	229.000	1981	297.000	2011
3	Mesatarja e anëtarëve të familjeve	6.92	1981	5.68	2013
4	Të punësuar	206.000	1984	338.364	2013
5	Përqindja e grave të punësuar	21.20%	1981	22.40%	2013
6	Punëkërkesit e rregjistruar	101.000	1984	274.487	2014
7	Fëmijët parashkollorë të rregjistruar	8600	1984	26768	2014
8	Studentët në Arsimin e lartë	37900	1984	52.159	2014
9	Infrastrukturë rrugore e kompletuar	903 km	1984	1.666 km	2014
10	Shtëpi banimi	162.000	1984	412.884	2014
11	Shtretër në sistemin spitalor	5.000	1981	3.862	2013
12	Qytetarët në skemat sociale	34.487	1984	350.000	2014
13	Jetëgjatësia mesatare	69 vite	1982	76.6 vite	2011
14	Analfabetizmi	17.60%	1981	8.20%	2003
15	Vdekshmëria e foshnjeve në 1.000 lindje	24.1	1984	9.5	2013

Burimi: Buletini vjetor statistikor i Republikës së Kosovës, 2015, Zyra Federale e Statistikave të RSFJ 1986, (Jugosllavi 1945 - 1985) dhe AFBK (Banka Botërore 2013).

Në bazë të rezultateve dhe krahasimeve në tabelën e lartshënuar, mund të nxjerrim këto konstatime:

1. Popullsia në Kosovë për 30 vitet e fundit nuk ka shënuar ndonjë rritje të theksuar, konkretisht në vitin 1981 ishin rregjistruar si rezidentë 1.719.000 banorë, ndërsa në vitin 2011 kemi 1.780.021, pra ndryshimi (shtimi i popullatës) është për 612.012 banorë.
2. Numri i të punësuarve në vitin 1984 ishte 206.000 punëtorë ndërsa në vitin e krahasimit tonë, viti 2014, numri i të punësuarve është 338.364, që d.m.th se kemi një rritje prej 132.364 që na thotë se mesatarisht janë punësuar 4.412 punëtorë më shumë në vit.

3. Studentët e përfshirë në Arsimin e Lartë në Kosovë, për 30 vitet e analizuar, janë rritur për 14.259, që i bie se në vitin 1984 kemi të rregjistruar 379.000 studentë, ndërsa në vitin 2014 kemi 52.159 studentë.
4. Rritja më e theksuar ka ndodhur në shtëpitë e banimit. Në vitin 1984 numërohen 162.000 shtëpi banimi, ndërsa në vitin 2014 kemi 412.884 shtëpi, pra kemi 250.884 më shumë, apo i bie të kemi mesatarisht 8.663 shtëpi të ndërtuara më shumë në çdo vit.
5. Interesant është se sistemi shëndetsor në Kosovë, për 30 vite të analizës sonë, ka një rënie të numrit të shtretërve, ku nga 5.000 shtretër sa kishte në vitin 1984, në vitin 2014 numërohen 3.862 apo 1.138 shtretër më pak.
6. Qytetarët e përfshirë në skemat sociale në vitet e krahasuar janë rritur dukshëm, ku nga 34.487 sa ishin në vitin 1984, në vitin 2014 kemi rreth 350.000 qytetarë që shfrytëzojnë skemën sociale në Republikën e Kosovës.
7. Jetëgjatësia mesatare në Kosovë, për 30 vite është rritur për 7.6 vite, nga 69 vjet në vitin 1984 në 76.6 vjet në vitin 2014. Po ashtu edhe vdekshmëria e foshnjeve është zvogluar dukshëm, ku nga 24.1 vdekje në 1981 ka mbërritur në 9.5 në 2014, në 1.000 lindje.
8. Analfabetizmi është ulur për rreth 10 %. Në vitin 1984 kishim 17.6 % analfabetë, ndërsa në vitin 2003 kur kemi rezultatet e fundit, kemi 8.2 % në nivel Republike (ky numër kryesisht është nga komunitetet RAE).

4.2.Ndikimi i krizës në financat e Kosovës

Termi krizë financiare përdoret për të përshkruar një seri të gjerë situatash, në të cilat disa institucione financiare apo mjete humbasin në mënyrë të menjëhershme një pjesë të madhe të vlerës së tyre. Duke analizuar përhapjen e krizës ekonomike dhe financiare që preku Eurozonën, është bërë një analizë për ekonominë e Kosovës, se në çfarë mase është ndikuar nga kriza ekonomike dhe financiare. Rënia e rritjes ekonomike në Eurozonë ka pasur disa efekte negative në ekonominë e Kosovës. Ekonomia e Kosovës i ka rezistuar mirë krizës financiare dhe recesionit që ka përfshirë ekonominë globale. Ekonomia e Kosovës e ka pasur më të lehtë që të përballojë krizën financiare, për faktin se ekonomia jonë njëherë është e kufizuar dhe nuk është ekonomi që merr pjesë në tregjet evropiane dhe pikërisht për këtë arsye

i ka rezistuar më mirë krizës financiare. Nëse e analizojmë rritjen ekonomike për disa vite, vërejmë ngritje dhe gjithashtu rënie ekonomike. Gjatë vitit 2008, rritja reale e PBB-së vlerësohet të ketë qenë 5.4 %, kryesisht e mbështetur nga konsumi privat dhe investimet publike. Gjatë vitit 2009 kemi pasur rritje ekonomike të shprehur në përqindjen 3.5 %, që do të thotë se efektet e krizës globale janë ndjerë dhe në Kosovë, dhe kjo është shprehur me një normë më të ulët të rritjes ekonomike.

Ndërsa gjatë vitit 2010, po ashtu kemi një rritje ekonomike më të ulët, e shprehur në përqindje 3.2 % që do të thotë, se efektet e krizës vetëm se kanë vazhduar të përhapen edhe më shumë gjatë vitit 2010. Ndërsa gjatë vitit 2011, kemi pasur një rritje ekonomike prej 4.5 %, që paraqet një përmirësim të gjendjes ekonomike, e që në realitet shumë pak është ndjerë tek përmirësimi i jetës së qytetarëve. Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2012, pothuajse është ndikuar nga kriza financiare, e cila krahasuar me vitin 2011, vërehet me një ngadalësim ekonomik. Në ngadalësimin ekonomik në Kosovë, kanë ndikuar zhvillimet në sektorin e jashtëm, e që mund të kenë efekt negativ në nivelin e eksporteve, po ashtu efekti negativ shfaqet edhe në investimet e huaja direkte si dhe në rënien e dërgesave nga bashkatdhetarët, të cilët jetojnë dhe veprojnë në shtetet evropiane, siç janë: Gjermani, Zvicër, Itali etj. Këto vende janë prekur nga kriza ekonomike dhe financiare, e kjo ndikon me humbjen e vendeve të punës së emigrantëve. Edhe tek ne në Kosovë ndikon në mënyrë indirekte, pra ndikon me uljen e të ardhurave nga diaspora, për shkak se shumë familje në Kosovë varen nga remitancat, apo më mirë të themi nga të ardhurat që ju dërgojnë të afërmit e tyre me punë në shtete të ndryshme të Europës.


Sipas disa anketave që janë bërë me qytetarët rreth krizës ekonomike, se sa ka ndikuar dhe në çfarë mase e kanë ndjerë ata krizën në buxhetin e tyre familjar, shumica nga të anketuarit janë përgjigjur duke thënë, se në krizë janë prej shumë vitesh, pasi shteti ynë nuk po krijon vende të reja të punës në mënyrë që të zbutet papunësia, e cila po vazhdon të jetë gjithnjë në rritje. Sipas të anketuarve, efektet e krizës janë ndjerë që nga viti 2008 deri në vitin 2012, dhe po ashtu ka vazhduar në vitin 2013. Efektet janë vërejtur si në rritjen e çmimeve për të mirat e domosdoshme, po ashtu edhe në shërbime të ndryshme, gjë e cila ka ndikuar negativisht në fuqinë blerëse të konsumatorëve dhe pozicionin e jashtëm. Kriza financiare që ka prekur Eurozonën ka ndikuar me uljen e remitencave, si i vetmi burim financiar për shumë familje në Kosovë. Kjo është njëra nga përgjigjet e të anketuarve.

Kriza financiare dhe ekonomike në vendet e Bashkimit European ka ndikuar apo më mirë të themi është bartur edhe në ekonominë e Kosovës, pasi Kosova mban qarkullim të mallrave dhe shërbimeve me 27 vende të Bashkimit European, ndaj efektet e krizës janë paraqitur në mënyrë indirekte. Ka ndikuar me rënien e drejtpërdrejtë të investimeve të huaja, me rënien e eksportit, me rënien e remitencave dhe po ashtu ka ndikuar përmes importit.

Për këto dhe shumë arsye të tjera që lidhen me Kosovën, është e vështirë të ketë zhvillim të mirë ekonomik, edhe pse këto vite kemi pasur një rritje të vogël ekonomike, por sigurisht se kjo nuk mjafton për të pasur një ekonomi të qëndrueshme dhe stabile. Rëniat ekonomike kanë qenë më të ashpra në shtetet më shumë të lidhura me Eurozonën, si në aspekt tregtar, ashtu dhe atë financiar (Pula, 2013). Që nga vit 2008, Kosova ka qenë kursyer nga goditjet më të rënda të krizës për shkak të ndërvvarshmërisë së ulët të ekonomisë së saj me atë të Eurozonës dhe të BE-së në përgjithësi. Shtete të cilat eksportojnë shumë në BE, janë prekur më shumë nga kriza europiane, ndërsa Kosova eksporton shumë pak dhe kriza ka ndikuar në mënyrë indirekte. Sidoqoftë, ngadalësimi i rritjes ekonomike në shumicën prej vendeve të rajonit, si dhe në ato të Eurozonës, ka ndikuar që ekonomia e Kosovës të ngadalësojë ritmin e rritjes në krahasim me vitin paraprak.

Spektori i jashtëm konsiderohet si faktor më me ndikim në ngadalësimin e rritjes ekonomike. Sikurse thamë më lart, si rrjedhojë e rënies së eksporteve, rënies së theksuar të investimeve të huaja direkte si dhe rënies së lehtë që kanë shënuar dërgesat e emigrantëve, ndikimi i krizës ka qenë prezent edhe këtu.

Grafiku 18. Rritja reale ekonomike



Burimi: BQK, Raporti vjetor 2014

Grafiku është paraqitur për të kuptuar më lehtë se si ka ndryshuar rritja ekonomike nëpër vite. Viti 2009 nuk është paraqitur, por duhet cekur se gjatë vitit 2009 ka pasur rritje ekonomike

prej 3.5 %, ndërsa në vitin 2010 kemi ngadalësim të rritjes ekonomike e cila është e paraqitur edhe në grafik me 3.2 %, që do të thotë një rritje më e vogël se sa ajo e vitit 2009. Ndërsa gjatë vitit 2011, kemi rritje ekonomike prej 4.5 %, që paraqet një përmirësim të gjendjes ekonomike nga viti 2010 në vitin 2011. Ekonomia e Kosovës gjatë vitit 2012 ka pasur rritje ekonomike 2.9 %, dhe gjithashtu për vitin 2013 parashikohet një rritje që do të jetë afër 3 %. Kosova ka pasur një rritje pozitive gjatë gjithë viteve të fundit, megjithatë efektet e krizës kanë qenë të ndjeshme.

4.3. Rritja më e ngadalësuar e eksporteve

Efektet e krizës ekonomike në Kosovë janë ndjerë edhe në rënien e eksporteve. Tendenca e rënies së tyre ka të bëjë me konkurrencën e madhe në tregjet rajonale dhe europiane, por në anën tjetër, kemi të bëjmë me rënien e çmimeve të disa produkteve të metaleve në bursat botërore, që automatikisht reflektohet në uljen e vlerës së eksporteve. Kosova kryesisht eksporton metale dhe minerale. Dy eksportuesit më të mëdhenj të Kosovës që eksportojnë metale janë: “Ferronikeli” dhe “Trepça”. Përfaqësuesit e këtyre dy kompanive kishin deklaruar se ka pasur rënie të eksportit. Kjo rënie, sipas tyre, kishte ndodhur për shkak të krizës ekonomike botërore, e cila ka goditur industrinë e metaleve.

Mungesa e Marrëveshjes për Tregti të Lirë me vendet e Bashkimit Europian ka bërë që produktet kosovare të jenë shumë pak të pranishme në tregjet e evropiane. Për të përmirësuar nivelin e eksportit të produkteve vendore në vendet e BE-së, duhet të punohet më shumë nga institucionet e Kosovës dhe po ashtu të punohet më shumë nga ana e prodhuesve vendorë.

Prodhuesit kosovar duhet të prodhojnë produkte me kualitet të lartë, produkte të nivelit europian, nëse dëshirojnë të bëhen pjesë e tregjeve europiane. Po ashtu, duhet të përpiqemi të avansojmë në aspektin teknologjik, sepse përdorimi i teknologjisë së avansuar ka një rëndësi primare për të qenë prodhues i produkteve kualitative dhe produkteve konkurruese.

Nëse nuk mund të ofrojmë produktet të cilat janë konkurente me produktet e shteteve të tjera, atëherë është e kotë Marrëveshja për Tregti të Lirë me vendet e Bashkimit Europian. Kosova ka një nivel shumë të ulët të eksportit, ndaj me arritjen e marrëveshjeve të tilla, mund të ketë ngritje të eksportit dhe përmirësim të bilancit tregtar. Rreth 80 për qind e mallrave të huaj

importohen në Kosovë, ndërkaq afro 10 përqind e produkteve kosovare mund të kalojnë në tregjet e rajonit apo të vendeve të Bashkimit Europian.

Njëra nga vështirësitë për të eksportuar prodhimet kosovare në vendet e BE-së, ka të bëjë me standardet teknike apo vërtetimin e cilësisë së prodhimit. Ekonomia vendore konsiderohet se ka mungesë të konkureshmërisë në tregtinë me mallra, veçanërisht kur merret parasysh niveli i lartë i defiçitit tregtar. Fakti që ekonomia e Kosovës ka nivel të ulët të prodhimit, bën që të jemi më shumë të varur nga importet, kështu që niveli i çmimeve të produkteve kryesore të importura, janë të theksuara në kuadër të çmimeve vendore.

Eksportet e Kosovës gjatë vitit 2012 arritën shumën prej 286.9 milionë euro, që paraqet një rënie prej 11.7 % në terma nominalë. Në terma realë, rënia e eksporteve ishte më e lartë duke arritur në rreth 13 %.

Rënia e eksporteve nga Kosova, përveç se është shkaktuar nga rënia e përgjithshme e kërkesës në rajon dhe në vendet e BE-së, është ndikuar edhe nga rënia e çmimeve të komponentëve kryesorë të cilët Kosova i eksporton. Mbi 60 % e mallrave të eksportuar nga Kosova, përbëhet prej produkteve të metaleve bazë dhe ndryshimet në çmimet e metaleve reflektojnë në vlerën nominale të eksporteve.

Gjatë vitit 2012 ka pasur rënie në çmimet e metaleve bazë. Kjo ishte një rënie e përafërt me rënien e eksporteve vendore. Rënie të çmimeve kemi te plumbi, alumini, zinku dhe bakri. Rënia arriti ndërmjet 7 - 9 %, ndërsa nikeli kishte rënien më të theksuar për 20 %. Ndërsa, vlera e importeve gjatë vitit 2012 arriti në 2.36 miliardë euro, duke paraqitur kështu një rënie prej 1.0 % . Rritja më e ngadalshme e importeve gjatë kësaj periudhe, mund të jetë shkaktuar si rezultat i stabilizimit dhe rënies së çmimeve të produkteve kryesore që importon Kosova, siç janë produktet ushqimore dhe produktet minerale, të cilat kryesisht përbëhen nga derivatet e naftës. Autoritetet kosovare duhet të punojnë rreth largimit të barrierave ekonomike dhe të kërkojnë nga BE-ja që Kosova t'i gëzojë preferencat si subjekt shtetëror e të mos jetë pjesë e kuotave globale, por të integrohet në rrjedhat ekonomike europiane. Vetëm në këtë mënyrë, mund të ndryshojmë bilancin negativ tregtar si dhe mund të rrisim eksportet.

Kosova vazhdon të jetë e varur nga importi i produkteve të huaja. Pa përmirësimin e politikave fiskale, produktet kosovare nuk do të mund të jenë konkuresuese, dhe në këtë mënyrë nuk mund të eksportohen.

Tabela 22. Partnerët tregtarë të Kosovës në eksport

Shtetet	2008	2009	2010	2011	2012
Shqipëria	1	1	1	1	1
Maqedonia	2	2	2	2	2
Greqia	3	10	11	11	11
Serbia	4	4	6	4	4
Sllovenia	5	6	5	6	9
BeH	6	9	9	10	7
Mali i Zi	7	5	7	5	3
Turqia	8	3	3	3	5
Bullgaria	9	7	4	9	8
Kroacia	10	8	8	7	6
Rumania	11	11	10	8	10
Moldavia	12	12	12	12	12

Burimi: KIPRED, Analizë e Politikave 2013

Tabela 23. Partnerët tregtarë të Kosovës në imp

Shtetet	2008	2009	2010	2011	2012
Maqedonia	1	1	1	1	1
Serbia	2	2	2	2	2
Turqia	3	3	3	3	3
Greqia	4	4	4	4	5
Sllovenia	5	5	7	7	8
Shqipëria	6	8	6	5	4
Bullgaria	7	9	9	9	9
Kroacia	8	7	8	8	7
BeH	9	6	5	6	6
Mali i Zi	10	10	11	11	11
Rumania	11	11	10	10	10
Moldavia	12	12	12	12	12

Burimi: KIPRED, Analizë e Politikave 2013

Tabela 24. Eksporti i Kosovës në rajon (2008 - 2012)

Eksport	2008			2009			2010			2011			2012			2008-2012		
	2008	krahas të përgjithshëm	krahas të rajonit	2009	krahas të përgjithshëm	krahas të rajonit	2010	krahas të përgjithshëm	krahas të rajonit	2011	krahas të përgjithshëm	krahas të rajonit	2012	krahas të përgjithshëm	krahas të rajonit	2008-2012	krahas të përgjithshëm	krahas të rajonit
Shqipëria	21,113,000.00	10.64%	25.01%	26,182,000.00	15.84%	39.63%	30,841,000.00	10.42%	33.37%	34,566,000.00	10.83%	34.89%	40,164,000.00	14.94%	34.16%	152,866,000.00	12.25%	33.27%
Maqedonia	20,046,000.00	10.10%	23.75%	17,355,000.00	10.59%	26.27%	26,308,000.00	8.89%	28.46%	30,949,000.00	9.70%	31.24%	26,322,000.00	9.79%	22.39%	120,980,000.00	9.70%	26.33%
BeH	5,919,000.00	2.98%	7.01%	1,206,000.00	0.73%	1.83%	1,847,000.00	0.62%	2.00%	612,000.00	0.19%	0.62%	1,897,000.00	0.71%	1.61%	11,481,000.00	0.92%	2.50%
Kroacia	793,000.00	0.40%	0.94%	2,151,000.00	1.30%	3.26%	2,744,000.00	0.93%	2.97%	2,794,000.00	0.88%	2.82%	2,276,000.00	0.85%	1.94%	10,758,000.00	0.86%	2.34%
Bullgaria	2,632,000.00	1.33%	3.12%	2,709,000.00	1.64%	4.10%	6,765,000.00	2.29%	7.32%	936,000.00	0.29%	0.94%	1,698,000.00	0.63%	1.44%	14,740,000.00	1.18%	3.21%
Rumania	43,000.00	0.02%	0.05%	232,000.00	0.14%	0.35%	272,000.00	0.09%	0.29%	987,000.00	0.31%	1.00%	1,228,000.00	0.46%	1.04%	2,762,000.00	0.22%	0.69%
Turqia	3,044,000.00	1.53%	3.61%	6,512,000.00	3.94%	9.86%	9,357,000.00	3.16%	10.12%	7,831,000.00	2.45%	7.91%	11,358,000.00	4.22%	9.66%	38,102,000.00	3.05%	8.29%
Greqia	10,851,000.00	5.47%	12.86%	240,000.00	0.15%	0.36%	222,000.00	0.08%	0.24%	194,000.00	0.06%	0.20%	319,000.00	0.12%	0.27%	11,826,000.00	0.95%	2.57%
Serbia	9,893,000.00	4.98%	11.72%	3,504,000.00	2.12%	5.30%	3,941,000.00	1.33%	4.26%	7,198,000.00	2.26%	7.27%	14,274,000.00	5.31%	12.14%	38,810,000.00	3.11%	8.45%
Mali i Zi	3,770,000.00	1.90%	4.47%	3,084,000.00	1.87%	4.67%	3,920,000.00	1.32%	4.24%	6,988,000.00	2.19%	7.05%	16,629,000.00	6.19%	14.14%	34,391,000.00	2.76%	7.48%
Sllovenia	6,304,000.00	3.18%	7.47%	2,882,000.00	1.74%	4.36%	6,203,000.00	2.10%	6.71%	6,001,000.00	1.88%	6.06%	1,396,000.00	0.52%	1.19%	22,786,000.00	1.83%	4.96%
Moldavia		0.00%	0.00%	2,892.33	0.00%	0.00%	5,440.09	0.00%	0.01%	6,291.46	0.00%	0.01%	155.65	0.00%	0.00%	14,779.53	0.00%	0.00%
Eksporti në rajon	84,408,000.00	42.53%	100.00%	66,059,892.33	39.96%	100.00%	92,425,440.09	31.23%	100.00%	99,062,291.46	31.04%	100.00%	117,561,155.65	43.73%	100.00%	459,516,779.53	36.83%	100.00%
Eksporti jashtë rajonit	114,055,000.00			99,268,107.67			203,531,559.91			220,102,708.54			151,278,844.35			788,236,220.47		
Eksporti i përgjithshëm	198,463,000.00			165,328,000.00			295,957,000.00			319,165,000.00			268,840,000.00			1,247,753,000.00		
Eksporti në rajon (%)				-21.74%			39.91%			7.18%			18.67%			39.28%		
Eksporti jashtë rajonit (%)				-12.96%			105.03%			8.14%			-31.27%			32.64%		

Burimi: KIPRED, Analizë e Politikave 3/13. 2013

Shkaqet kryesore të rënies së eksportit janë politikat e disfavorshme ekonomike në krijimin e kushteve për një konkurrencë të mirëfilltë në treg.

4.4. Remitencat dhe investimet e huaja direkte

4.4.1. Remitencat dhe ecuria e tyre gjatë krizës

Qytetarë të shumtë të Kosovës, për shumë vite me radhë, kanë punuar dhe vazhdojnë të punojnë në shtete të ndryshme nëpër Europë. Realisht, edhe sot po vazhdon një trend rritës i daljes së të rinjve nga Kosova për në Europë.

Arsyet janë të shumta, por arsyeja kryesore se pse këta të rinj po marrin rrugët e Europës, është për të gjetur një vend pune dhe për të pasur një jetë më të mirë. Për shumë vite me radhë,

emigrantët kanë kontribuar në shumë mënyra për vendin e tyre, ndërkohë edhe sot po vazhdojnë duke mbështetur familjet e tyre në mënyrë financiare, sepse ende në Kosovë vazhdon të ketë varfëri dhe papunësi të lartë.

Sipas intervistave të realizuara me qytetarë, del se të gjitha investimet që kanë bërë deri sot dhe që po vazhdojnë të bëjnë ende kësaj dite, janë të financuara në pjesën më të madhe nga të ardhurat që ua dërgojnë familjarët e tyre. Pra, rëndësia e remitencave²⁵ është shumë e rëndësishme, dhe po ashtu këto të ardhura kanë ndihmuar në hapjen e bizneseve të shumta të vogla dhe të mesme duke ndihmuar hapjen e bizneseve, ndihmojnë edhe në krijimin e vendeve të reja të punës. Në bazë të të dhënave, struktura e remitencave sipas kanaleve të dërgimit, si dhe sipas shteteve prej nga vijnë, mbetet kryesisht e njëjtë.

Rreth 65 për qind e remitencave vijnë përmes kanaleve formale, që do të thotë përmes bankave komerciale dhe agjencive për transferën e mjeteve, përderisa pjesa tjetër vjen në forma të tjera, si: në formën e parave të gatshme dhe remitenca në mall.

Ndërsa sa i përket shteteve, remitencat vijnë kryesisht nga vendet e Europës perëndimore si: Gjermani, Zvicër, Angli, Austri etj.

Remitencat, apo të ardhurat që vijnë në Kosovë nga emigrantët, në 12 vitet e fundit, kanë qenë me shumë domethënie për ekonominë e Kosovës. Ndonëse pjesa më e madhe e tyre ka shkuar për konsum dhe jo për investime kapitale, një gjë e tillë edhe në këtë mënyrë ka ndikuar në ekonominë kosovare, sidomos në ngritjen e Bruto Produktit Vendor (Zogaj, 2011). Siç u cek më lart, pjesa më e madhe e të ardhurave që dërgohen nga jashtë në Kosovë, përdoren për konsum, por po ashtu një pjesë përdoret për investime; një pjesë e dërgesave

²⁵**Përkufizimi i dërgesave në para të emigrantëve.** Sipas Organizatës Ndërkombëtare për Migracionin, dërgesat në para të emigranteve (remitancat), në kuptimin e gjerë të fjalës, janë transfera monetare që emigrantët i kryejnë në vendin e origjinës. Pra, këto dërgesa janë prurje financiare të lidhura me imigracionin. Në shumicën e rasteve, këto dërgesa janë transfera personale në ‘cash’ nga një emigrant tek të afërmit e tij në vendin e origjinës. Por, ato mund të jenë fonde të investuara, të depozituara ose të dhuruara nga emigrantët në vendin e origjinës. Përkufizimi mund të zgjerohet me kuptime lidhur me transfera personale të të mirave “në natyrë” dhe dhurime. Disa shkolla mendimi, përfshijnë dhe transfertën e dijeve, ekspertizën dhe teknologjinë, si dhe “remitencat sociale”. Në përgjithësi, me termin “remitenca” nënkuptohen tre lloje të transferave monetare në vendet e origjinës të cilat gjenden të publikuara në Vjetarin Statistikor të Bilancit të Pagesave të FMN-së. Këto janë: dërgesat e punëtorëve, kompensimet e punëdhënësve dhe transferat e migrantëve.

janë përdorur për hapjen e bizneseve e pjesa tjetër ndihmon në aspektin e ngritjes së kapacitetit në edukim.

Të kuptuarit e faktorëve që venë në lëvizje dërgesat është me rëndësi kritike për analizën e dinamikës së rritjes, duke marrë parasysh rolin që luajnë dërgesat në mbështetjen e të ardhurave dhe aktivitetin ekonomik në Kosovë.

Tabela 25. Vendet nga vijën remitencat në Kosovë


	2008	2009				2010				2011				2012			
		TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4	TM1	TM2	TM3	TM4
Gjermani	38%	35%	39%	37%	38%	35%	35%	33%	34%	33%	33%	34%	34%	31%	37%	35%	34%
Zvicër	16%	21%	20%	21%	22%	21%	21%	21%	22%	24%	23%	23%	22%	24%	26%	23%	21%
Itali	13%	11%	11%	10%	10%	9%	8%	7%	7%	7%	7%	6%	7%	5%	8%	8%	9%
Austri	6%	5%	6%	6%	5%	6%	4%	7%	5%	6%	6%	6%	5%	6%	6%	6%	6%
Belgjikë	3%	4%	3%	3%	3%	3%	3%	3%	3%	3%	2%	3%	3%	1%	7%	3%	3%
SHBA	3%	3%	3%	3%	2%	4%	5%	5%	3%	5%	4%	2%	4%	6%	4%	4%	4%
Suedi	4%	3%	3%	4%	3%	3%	3%	3%	4%	4%	3%	4%	3%	4%	1%	3%	3%
Francë	4%	3%	4%	4%	4%	3%	4%	4%	4%	4%	4%	4%	4%	3%	0%	3%	3%
Norvegji	2%	3%	2%	3%	3%	3%	3%	3%	3%	3%	3%	3%	3%	5%	1%	3%	2%
Kanada	2%	2%	2%	2%	2%	1%	2%	2%	2%	2%	2%	2%	2%	1%	0%	1%	2%
Britani e Madhe	1%	2%	1%	1%	1%	2%	2%	2%	1%	2%	1%	1%	1%	3%	2%	2%	2%
Danimark	2%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	0%	1%	1%
Finlandë	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	0%	1%	1%
Holandë	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	1%	0%	0%	1%	0%
Slloveni	1%	1%	1%	2%	1%	3%	4%	6%	4%	4%	4%	3%	4%	5%	5%	4%	4%
Vendet tjera	3%	4%	1%	2%	2%	4%	6%	3%	5%	3%	6%	7%	5%	5%	1%	4%	6%

Burimi: BQK (2013)

Në këtë seksion, vlerësohet elasticiteti i dërgesave ndaj ndryshimeve të kushteve në atdhe dhe vendin pritës, duke përdorur të dhënat e panelit për 6 vende të Ballkanit në vitet 1999 - 2011. Konkretisht, dërgesat janë regresuar në masat e GDP-së së atdheut dhe vendit pritës për frymë. GDP e vendit pritës përafrohet me GDP-në e Eurozonës (EA), meqenëse emigrantët e Ballkanit janë të përhapur në mënyrë jo të barabartë në vende të ndryshme të EA. Gjermania ishte burimi kryesor për dërgesat në Kroaci, në Kosovë dhe më pak në Bosnje - Hercegovinë e Maqedoni, ndërsa pjesa më e madhe e dërgesave të Serbisë e kanë origjinën në Austri. Përveç dërgesave, ka të dhëna për komplementaritetin midis emigracionit dhe FDI-së. Disa kanale janë në veprim. Së pari, prania e një diaspore të edukuar siguron investitorë të huaj me njohuri shumë të nevojshme për tregjet vendase, gjë që ndihmon në thyerjen e pengesave për investimet e huaja të brendshme afatgjata. Së dyti, emigrantët e pakualifikuar mund të rrisin FDI-në duke shpalosur karakteristika të krahut të punës, si produktivitetin e krahut të punës

dhe uljen e remitencave. Shumë familje janë të varura vetëm nga remitencat sepse nuk kanë asnjë burim tjetër të të ardhurave. Kjo vjen si rezultat i një papunësie të lartë dhe të vazhdueshme e cila e përkeqëson gjendjen ekonomike në përgjithësi. Kriza ekonomike dhe financiare ka bërë që shumë firma të mbyllën dhe kështu të ndikojnë në humbjen e vendëve të punës. Pranimet e dërgesave të emigrantëve konsiderohen si mjet mjaft i rëndësishëm për ekonominë e Kosovës dhe për ngritjen e standartit jetësor të qytetarëve. Ato gjatë vitit 2010 - 2011, kanë shënuar rënie të theksuar për shkak të krizës ekonomike në Eurozonë. Thënë ndryshe, rënia e dërgesave të emigrantëve, shkakton ulje të Bruto Produktit Vendor. Pranimet e dërgesave të emigrantëve në milionë euro, janë paraqitur edhe përmes figurës, duke treguar lëvizjet e dërgesave nëpër vite.

Grafiku 19. Pranimi i dërgesave të emigrantëve në milionë euro



Burimi: BQK (2013)

Dërgesat e emigrantëve vazhdojnë të jenë komponenti kryesor në kuadër të transferave të sektorit privat (67.7 % e gjithsej transfereve të sektorit privat).

Të hyrat nga dërgesat e emigrantëve në vitin 2012 arritën në 605.6 milionë euro, që krahasuar me vitin 2011 paraqet rritje prej 3.6 % (BQK, 2012). Burimi kryesor i dërgesave të emigrantëve vazhdon të jetë Gjermania, Zvicra, Austria, Belgjika, SHBA dhe Suedia.

Gjermania me 34 %, Zvicra me 23 % të gjithsej dërgesave të pranuar në Kosovë, Italia dhe Austria përbëjnë 7 %, përkatësisht 6 % të gjithsej dërgesave, pasuar nga Belgjika me 3 %, SHBA 4 % dhe Suedia 3.0 %. Rreth 20 % e dërgesave të emigrantëve, transferohen përmes sistemit bankar, ndërsa 36 përqind transferohen përmes agjensioneve për transferimin e parave. Ndërsa pjesa tjetër e dërgesave, dërgohen përmes kanaleve të tjera që përfshijnë edhe kanalet joformale, çka do të thotë se një përqindje e madhe e remitencave nuk dërgohen përmes

sistemit bankar apo përmes agjensioneve të tjera transferuese. Nëse analizojmë se një pjesë e dërgesave nga jashtë i dërgojnë ato në forma të ndryshme, duke i ikur bankave apo edhe agjencive për transferën e mjeteve, të cilët si qëllim të ikjes mund të kenë edhe koston shumë të lartë për dërgimin e mjeteve financiare, atëherë nuk mund të jemi shumë të sigurtë për rritje apo rënie të remitencave. Ndërsa, nëse analizojmë figurën e paraqitur për remitencat, atëherë del se gjatë vitit 2012, kemi një rritje të theksur në krahasim me vitin 2011, por duhet të cekim se kjo e dhënë është bazuar vetëm në pranimet e dërgesave që bëhen përmes kanaleve formale, siç janë bankat komerciale dhe ato të agjencive për transferimin e mjeteve.

Përgjatë 10 viteve emigracion, shqiptarët e Kosovës iu dërguan familjeve të tyre 5 miliardë e 347 milionë e 800 mijë euro. Ndërkohë, në tremujorin e parë të këtij viti, janë dërguar 130.8 milionë në Kosovë nga mërgata. “Krahasuar me tremujorin e parë të 2013-ës, kur kishim 127.8 milionë, vërehet një rritje për 3 milionë”, thuhet në një raport të Bankës Qendrore të Kosovës. Muajt e verës janë ata që frekuentohen më së tepërmi dhe ndikohen nga mërgimtarët. Bashkë me ardhjen e tyre, Kosova përfiton në dy forma: diaspora sjelle shumë të mira për vendin si dhe rrit fuqinë blerëse (BQK, 2013b).

4.4.2. Hulumtimi mbi remitencat

Anketa mbi Remitencat e Ekonomive Familjare u realizua me qëllim për nxjerrjen e informacioneve bazë dhe në kerkim të përgjigjeve nga pyetjet kërkimore. P3. A ka ndikuar kriza në remitencat dhe në investimet e huaja direkte? Të dhënat e gjeneruara nga anketa me ekonomitë familjare të Kosovës vërtetojnë se remitencat e dërguara nga emigrantët kosovarë, vazhdojnë të luajnë rol shumë të rëndësishëm për mirëqenien e një numri të madh të qytetarëve të Kosovës, si dhe për ekonominë e vendit në tërësi, gjë e cila vërteton hipotezën H1. Kriza financiare globale ka prekur Kosovën duke ngadalësuar remitencat. Realizimi i pyetësorëve është bërë në metodën e intervistave direkte me qytetarë të rastit, ku secila përgjigje është shënuar në pyetësor, e baza e të dhënave është dizajnuar mbi bazën e metodës likert.

Zgjedhja e mostrave ishte e rastit (200 të anketuar), duke përfshirë vende të ndryshme të Kosovës, përfshirë fshatra dhe qytete.


Tabela 26. Tabela e pyetjeve bazë mbi remitencat

Të dhënat bazë të anketimit mbi Remitencat			
Pyetja 1	A pranoni të ardhura nga bashkëatdhetarët tanë që gjenden në vendet e perëndimit?	Pergjigjet e të anketuarve	
Nr	A pranoni të ardhura nga bashkëatdhetarët tanë që gjenden në vendet e perëndimit?	Numëri	Përqindja
1	Po, gjithmonë	53	26.50
2	Po, ndonjëherë	133	66.50
3	Jo, asnjëherë	14	7.00
Total		200	100.00
Pyetja 2		Pergjigjet e të anketuarve	
Nr	Nga kush pranoni më së shpeshti të ardhura?	Numëri	Përqindja
1	Familjarët e gjakut	46	23.00
2	Familjarët e fisit	123	61.50
3	Miqtë, shokët	21	10.50
4	Burime tjera	10	5.00
Total		200	100.00
Pyetja 3		Pergjigjet e të anketuarve	
Nr	Mesatarisht sa të ardhura ju dërgojnë në muaj	Numëri	Përqindja
1	100 – 200 euro/muaj	56	28.00
2	200 – 400 euro/muaj	134	67.00
3	Më shumë se 400 euro/muaj.	10	5.00
Total		200	100.00
Pyetja 4		Pergjigjet e të anketuarve	
Nr	Dërgesa e të hollave në çfarë menyre bëhet, cila është rruga e dergesave?	Numëri	Përqindja
1	Me para të gatshme, keshe ne dorë	150	75.00
2	Me anë të Western Union dhe agjensive si motra	44	22.00
3	Përmes transfertave bankare	6	3.00
Total		200	100.00
Pyetja 5		Pergjigjet e të anketuarve	
Nr	Paratë që merrni për cka i përdorni më së shumti?	Numëri	Përqindja
1	Ushqim, veshëmbashtje e gjëra të tjera konsumuese	104	52.00
2	Pagesa të ndryshme	71	35.50
3	Investim në shkollimin tuaj apo të fëmijëve tuaj.	25	12.50
Total		200	100.00
Pyetja 6		Pergjigjet e të anketuarve	
Nr	A Ka ndikuar Kriza financiare ne dergesa tuaja?	Numëri	Përqindja
1	Po	70	35.00
2	Jo, nuk është vërejtje	56	28.00
3	pak	74	37.00
Total		200	100.00
Pyetja 7		Përgjigja	
Nr	Cilët faktorë mendon që kane ndikuar në uljen e remitancave	Numër	Përqindja
1	Papunësia	20	10
2	Kriza financiare ne vend	89	44.5
3	Ulja e pagese si pasoji e krizës	10	5
4	Bashkimi i familjes, rritja e familjes	53	26.5
5	Shkollimi I fëmijëve	12	6
6	Mungesa e lejes se qëndrimit	9	4.5
7	Rritja e kustosë se jetese	7	3.5
Total		200	100

PYETJA 1: A pranoi të ardhura nga bashkëatdhetarët tanë që punojnë jashtë vendit?

1. Po, gjithmonë
2. Po, ndonjëherë
3. Jo, asnjëherë

Grafiku 20. Pranimi i remitencave nga bashkëkombasit që punojnë jashtë vendit




Nga 200 të anketuar që morën pjesë në anketë, 26.5 % prej tyre marrin gjithmonë të ardhura nga jashtë, 66.5 % ndonjëherë pranojnë remitenca kurse vetëm 7 % nga të anketuarit asnjëherë nuk kanë marrë apo nuk marrin ndonjë ndihmesë nga jashtë.

PYETJA 2: Nga kush pranoi më së shpeshti të ardhura?

1. Familjarët e gjakut (vëllai, motra, prindërit, bashkëshorti, xhaxhai etj.)
2. Familjarët e fisit (daja, teza, halla etj.)
3. Miqtë, shokët
4. Të tjerë

Grafiku 21. Prej kujt vijnë remitencat?




Nga pyetja se nga kush pranojnë të ardhura të anketuarit tanë, domethënë ata të cilët në pyetjen e parë deklaruan që pranojnë remitenca, morëm këto përgjigje nga figura lart.

PYETJA 3: Mesatarisht sa të ardhura ju dërgojnë në muaj?

1. 100 - 200 euro/muaj
2. 200 - 400 euro/muaj
3. Më shumë se 400 euro/muaj

Grafiku 22. Shuma e remitencave të pranuar në muaj




Nga kjo shihet se 67 % e të anketuarve tanë, nga remitencat kanë të ardhura mujore në shumë prej 100 - 200 €, kurse 28 % prej tyre pranojnë të ardhura prej 200 - 400 € në muaj, ndërsa 5 % e tyre marrin më shumë se 400 € në muaj nga remitencat

PYETJA 4: Në çfarë mënyre bëhet dërgesa e të hollave, pra cila është rruga e dërgesave?

1. Me para të gatshme ('cash')
2. Me anë të Western Union dhe agjencie simotra
3. Përmes transferave bankare

Grafiku 23. Si ju vijnë remitencat?




Rreth 75.26 % apo ndryshe 140 prej të anketuarve tanë, mjetet i pranojnë në para të gatshme, pra me para në dorë. Një gjë e tillë ndodh kur vijnë në Kosovë personat që japin, apo përmes familjarëve të tjerë të cilën vijnë këtu; 21.51 % e tyre pranojnë mjete me anë të Western Union apo Many Gramme dhe vetëm 3.23 % e të anketuarve pranojnë mjete përmes bankave.

PYETJA 5: Për çfarë i përdorni më shpesh paratë që merrni?

1. Ushqim, veshmbashtje e gjëra të tjera konsumuese
2. Pagesa të ndryshme
3. Investim në shkollimin tuaj apo të fëmijëve

Grafiku 24. Për çfarë përdoren remitencat e marra?




Për çfarë përdoren më së shumti remitencat e ardhura? Kjo ishte pyetja e radhës e pyetësorit, nga përgjigja e së cilës del se 52.15 % e këtyre mjeteve dedikohen për blerjen e ushqimit, veshmbathjeve të ndryshme e gjëra të tjera të përditshme; 34.95 % e tyre përdoren për pagesat që zakonisht janë pagesa e rrymës, ujit, domethënë obligimeve të ndryshme komunale, si dhe 12.90 % e të ardhurave nga jashtë përdoren për shkollimin e fëmijëve të të anketuarve tanë apo personalisht për shkollimin e tyre.

PYETJA 6: A Ka ndikuar kriza financiare në dërgesat tuaja?

1. Po
2. Jo, nuk ka ndikuar
3. Pak

Grafiku 25. A ka ndikuar kriza financiare në shumën e remitencave të marra?



Shihet se kriza financiare ka pasur një ndikim në remitenca, edhe pse jo në atë masë sa është menduar në fillim. Këtu vërehet se nga 200 respondentë, 48 % e tyre nuk e kanë vërejtur fare sa ka pasur krizë financiare, sepse atyre dërgesat i kanë ardhur rregullisht. Diagrami në vijim paraqet në mënyrë origjinale funksionin e remitencave dhe ndikimin e tyre në segmente të shoqërisë.


Mirëpo synim i këtij punimi është të argumentohet hipoteza H1. Kriza financiare globale ka prekur Kosovën, ka ngadalësuar remitenca dhe ka ndikuar direkt në uljen e investimeve të huaja në Kosovë. Këtu kemi shtruar një pyetje të veçantë: Cilët faktorë mendon që kanë ndikuar në uljen e remitencave? Përgjigjet i japim më poshtë në tabelën 26-1, që është pjesë e tabelës kryesore mbi remitenca.

Tabela 27. Faktorët që ndikuan në uljen e remitencave

Nr.	Pyetja	Përgjigja	
		Numër	Përqindja
1	Papunësia	20	10
2	Kriza financiare në vend	89	44.5
3	Ulja e pagesës si pasojë e krizës	10	5
4	Bashkimi i familjes, rritja e familjes	53	26.5
5	Shkollimi i fëmijëve	12	6
6	Mungesa e lejes së qëndrimit	9	4.5
7	Rritja e kostos së jetesës	7	3.5
		200	100

Burimi: Nga pyetësorët doktorale

Grafiku 26. Cilët faktorë mendon që kanë ndikuar në uljen e remitencave?



4.4.3. Investimet e huaja direkte dhe Kosova

Ekonomitë në zhvillim, sidomos ekonomitë e dala nga luftërat apo ekonomitë e shteteve të vogla janë shumë të varura nga Investimet e Huaja Direkte. Investime direkte në kuptimin klasik quhen aktivitetet komerciale kur kompanitë nga një vend investojnë apo më thjesht ndërtojnë repart përpunimi në një vend tjetër. Përfitimet e investitorit janë: tregjet e reja, fuqia e lirë punëtore, infrastruktura e mirë për prodhim, teknologjia ose edhe aftësitë e klasës punëtore për prodhime të caktuara apo financat.

Përfitimet e vendit tonë nga investimet e huaja janë:

1. Punësimi më i madh
2. Përfitimet e teknologjisë së avansuar
3. Zhvillimi i vendit në aspektin ekonomik
4. Përfitimi i njohurive dhe teknikave drejtuese të kompanive etj.

Pengesë më e madhe për investime direkte në vend janë: zbatimi i ligjit, korrupsioni i lartë, politikat fiskale etj.

Të gjitha efektet negative me të cilat po përballlet ekonomia e Kosovës, në radhë të parë konkludojnë me rënie drastike të prodhimit industrial dhe të produktit kombëtar; pastaj niveli i lartë i papunësisë, rënia e interesit për prodhimtarinë bujqësore, prezenca e ekonomisë joformale, defiqiti i lartë tregtar etj. (Kongjeli, Për të tejkaluar këtë gjendje të jostabilitetit ekonomik, nëpërmjet sigurimit të një bilanci të ekuilibruar tregtar, për të siguruar pozitë konkurruese në tregun botëror, Kosovës i nevojitet një fluks i kapitalit të ri në formë të investimeve të huaja direkte).

Investimet e huaja direkte ndahen në katër lloje kryesore:

1. Investimet e huaja direkte në kërkim të resurseve natyrore
2. Investimet e huaja direkte në kërkim të tregjeve të reja
3. Investimet e huaja direkte në kërkim të efikasitetit më të lartë të kapitalit të angazhuar
4. Investimet e huaja direkte në kërkim të të mirave kapitale dhe avancim të strategjisë regjionale ose globale

Që të jetë një vend konkurues dhe shtet tërheqës i investimeve të huaja direkte, Kosova duhet të bëjë reforma dhe të ofrojë kushte të favorshme për investorët e huaj. Do të ishte e favorshme për tërheqjen e investorëve të huaj, nëse vendi ynë do të ofronte lehtësi si:

- lirim nga tatimi
- lirim nga doganat për import të imputeve
- baza tatimore të favorizuara
- norma tatimore të leverdisshme
- donacione dhe subvencione

Të gjitha këto do të ndikonin pozitivisht në sjelljen e sa më shumë investorëve të huaj. Po ashtu, do të krijohen më shumë vende të reja pune dhe do të kemi teknologji më të avancuar. Në këtë mënyrë do të rritet edhe eksporti. Investimet e huaja direkte janë shumë të rëndësishme për zhvillimin ekonomik të vendit. Me prurjen e investimeve të huaja në Kosovë do të mundësohej që të kemi më shumë mundësi për punësim dhe gjithashtu përfitime të shumta ekonomike.


Por, këtu duhen analizuar disa çështje. Përse investuesit e huaj nuk po investojnë dhe çka është më e rëndësishmja të ceket këtu, se edhe ata pak investues që dëshirojnë të investojnë, po tërhiqen. Arsyet që kanë ndikuar në largimin e investuesve të huaj nga Kosova tashmë dihen, siç janë: klima e papërshtatshme për investime, moszbatimi i ligjeve në fuqi, aprovimi i ligjit të mangët për investorët e huaj, pasi deri tani kemi pasur Ligjin për investimet e huaja, që ka qenë vetëm ligj inkurajues dhe jo ligj që siguron mbrojtje e stimulim për investorët; gjithashtu niveli i lartë i korrupsionit, ekonomia joformale, e shumë shumë çështje të tjera të cilat duhet të përmirësohen.

Kosova ka mundësi të shumta, përkundër këtyre disavantazheve që u cekën më lart, pra vendi ynë ka pasuri natyrore duke përfshirë këtu pasuri të mëdha nëntoksore, ka popullsinë më të re në Europë, gjithashtu investorët e huaj mund të investojnë duke u bazuar edhe në fuqinë e lirë punëtore. Shteti ynë duhet të ofrojë më shumë mundësi rreth krijimit të një ambienti të favorshëm për investime, pra të luftojë të gjitha dukuritë negative, të krijojë sa më shumë lehtësira si në politikat ekonomike, tregtare, fiskale etj. Ndryshimet në politiken fiskale do të

ndikonin edhe më shumë, në mënyrë që vendi ynë të jetë vend konkurent me vendet e Ballkanit, duke ofruar kështu, kushte të mira dhe politika mbrojtëse e stimuluese për investitorët e huaj të cilët me siguri që shumë shpejt do të investojnë në Kosovë. Nuk mund të themi se vetëm politika fiskale është arsyeja se përse nuk po investohet në Kosovë. Shikuar nga aspekti i politikës fiskale të vendeve të rajonit, ne qëndrojmë më mirë në këtë pikë, por problem kryesor është korrupsioni i lartë dhe pasiguria për të investuar në Kosovë. Gjithashtu kriza ekonomike në Eurozonë ka pasur ndikim edhe në Kosovë, duke pasuar me rënie të ndjeshme të investimeve të huaja. Investimet e huaja kanë rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendit. Pa investimet e huaja direkte nuk mund të kemi zhvillim ekonomik. Këtë vit dhe vitet e kaluara kemi pasur një përqindje më të vogël të investimeve të huaja. Disa nga arsyet i cekën më lart, siç ishte: pasiguria, korrupsioni i lartë dhe po ashtu, që nga paraqitja e krizës financiare dhe ekonomike në Evropë, kemi rënien e investimeve të huaja edhe tek ne në Kosovë. Në mungesë të ligjeve për investitorët e huaj, dhe në mungesë të përkrahjes me lirime nga obligimet fiskale, shumë nga investitorët potencialë po largohen në vende më të sigurta, vende ku kanë më shumë lehtësira tatimore dhe përkrahje nga shteti ku investojnë. IHD-të në Kosovë gjatë periudhës 2008 - 2011, kanë mbajtur një nivel të ngjashëm prej mesatarisht 8.3 % të PBB-së. Si rezultat i paraqitjes së krizës globale financiare, gjatë vitit 2009 IHD-të shënuan rënien më të theksuar, ndërsa në vitet 2010 - 2011 vlera e këtyre investimeve filloi të rritet përsëri, megjithëse me një ritëm të ngadalshëm (BQK, 2013c). Ndërsa gjatë vitit 2012 kemi përkeqësim të trendit, duke arritur në rreth 5 përqind të PBB-së. E gjithë kjo ka ardhur si pasojë e problemeve ekonomike që po ndodhin që nga viti 2007 - 2008 e gjer më sot. Kriza që u përhap në vendet e Eurozonës ka ndikuar në uljen e investimeve të huaja direkte në Kosovë. Vendet e BE-së, deri tani paraqesin burimin kryesor të IHD-ve në Kosovë. Britania e Madhe gjatë vitit 2011 ka prirë në investime, ndërsa në vitin 2012 Turqia paraqet vendin prej nga kanë ardhur më së shumti IHD në Kosovë (BQK, 2013c). Investimet nga Turqia, gjatë vitit 2012 kanë qenë të orientuara kryesisht në sektorin e transportit dhe telekomunikacionit (53.8%), shërbime financiare (19.6%), prodhim (14.2%) etj. Rritje të theksuar të IHD-ve ka pasur edhe nga Zvicra, që gjatë kësaj periudhe paraqet vendin e tretë për nga shuma e IHD-ve në Kosovë (18.9%). Për dallim nga Turqia, IHD-të nga Zvicra gjatë vitit 2012 ishin të koncenturara kryesisht në patundshmëri (66.1%) dhe në ndërtim (18.5%). Nga shumica e vendeve të BE-së, përfshirë edhe Gjermaninë, ka pasur rënie të IHD-ve, mirëpo për shkak se rënia e IHD-ve nga

Britania e Madhe ishte mjaft e madhe, tek disa prej vendeve të tjera vërehet rritje e pjesëmarrjes në strukturën e IHD-ve.

Grafiku 27. Struktura e IHD-ve sipas shteteve kryesore, në përqindje



Burimi: BQK (2013)

Një numër i madh vendesh në botë, deri para një kohe të shkurtër, nuk kishin disponim ndaj investimeve direkte të huaja, madje me të madhe krijonin lloj -lloj bllokadash për mospranimin e IDH-ve në vendet e tyre. Kështu, me anën e barrierave të ndryshme, ata jua ndalonin ndërmarrjeve të vendit të ndërmerrnin ndonjë hap rreth bashkimit me ndonjë firmë të huaj (formimin e “joint ventures”) ose eventualisht shitjen e tërësishme të ndërmarrjes blerësve të huaj. Gjithashtu ekziston kufizimi sasi, i shitjes së aksioneve të ndërmarrjes (Xhepa & Agolli, 2004). Ky kufizim i blerjes së aksioneve nga investitorët e huaj, e vështirësonte dhe vinte në pikëpyetje suksesin afarist të ndërmarrjes.

Sa i përket faktorëve të cilët ndikojnë në vëllimin dhe efikasitetin e investimeve të huaja, në literaturën ekonomike ekzistojnë kategorizime të ndryshme. Kohëve të fundit, këtyre iu kushtohet një kujdes i posaçëm si në vendet e zhvilluara, po ashtu edhe në ato në zhvillim.

Marrë në përgjithësi, faktorët që ndikojnë në vëllimin dhe efikasitetin e IDH-ve, mund t'i ndajmë në dy grupe kryesore:

1. (Pa)Qëndrueshmëria e masave makroekonomike
2. (Jo)Stabiliteti institucional ose (Jo) siguria politike në vend

Në grupin e parë të faktorëve që janë si rezultat i masave të luhatshme të makroekonomisë dhe të cilët ndikojnë në investimet e huaja, mund t'i numërojmë:

- Kushtet e tregut
- Inflacioni
- Kursi i këmbimit real etj.

Grupi i dytë i faktorëve që ndikojnë në efikasitetin dhe vëllimin e investimeve të huaja e që janë si rezultat i jo stabilitetit politik të vendit mund t'i klasifikojmë në:

Treguesit e (jo)stabilitetit të qeverisë - Këta tregues vënë në dukje historinë e ndërrimit të garniturës qeverisëse. Ndërrimet qeveritare mund të ndodhin në përputhje me Kushtetutën ose në mospërputhshmëri me Kushtetutën e vendit. Ndërrimet jokushtetuese janë me pasoja të paparashikueshme. Çdo ndryshim qeveritar përmban në vetvete një dozë të pasigurisë dhe rrezikut në kuadër të institucioneve të shtetit. Sa më i madh të jetë jostabiliteti qeveritar, aq më e madhe është pasiguria institucionale. Elemente të rëndësishme të këtij grupi të faktorëve janë: (BQK, 2014a)

- Numri i revolucioneve
- Numri i grushtshteteve
- Numri i demonstratave gjatë vitit
- Probabiliteti i marrjes së pushtetit nga ana e opozitës etj.

Të gjitha këto elemente kanë efekt negativ në vëllimin dhe efikasitetin e investimeve direkte të huaja, por duhet theksuar se revolucionet dhe grushtshtetet kanë ndikim më tepër negativ se numri i demonstratave të ndodhura dhe probabiliteti i marrjes së pushtetit nga ana e opozitës.

Dhuna politike përfshin të gjitha ndodhitë që për bazë kanë dhunën në proceset politike të një vendi. Në këto raste janë prezente pasiguria personale dhe pasiguria e pronës. Sa më e madhe të jetë dhuna politike, aq më e madhe është pasiguria personale dhe ajo e pronës. Si madhësi me të cilat mund të matet dhuna politike, konsiderohen këto:

- Numri mesatar vjetor i vrasjeve politike
- Numri i grevave

- Numri i rebelimeve
- Numri i sulmeve me armë
- Numri i ekzekutimeve politike
- Numri i pasojave të luftës
- Numri i akteve terroriste etj.

Të gjitha këto kanë ndikim negativ shumë të madh në vëllimin dhe efikasitetin e investimeve direkte të huaja, por ekzekutimet politike dhe pasojat e luftës janë më të fuqishmet.

Pasiguria shoqërore ndodh atëherë kur përdhunohen institucionet shtetërore sikurse mund të jenë: Numri i ndryshimeve kushtetuese, jostabiliteti i normës së inflacionit etj.

Treguesit më të rëndësishëm të kësaj kategorie janë:

- Lulëzimi i tregut të zi
- Devijimi i inflacionit të standardizuar
- Ndryshimi i shpeshtë i kursit valuator
- Ndryshimi i kornizës së institucioneve etj.

Të gjitha këto madhësi makroekonomike, kanë ndikimin e vet negativ në vëllimin dhe efikasitetin e IDH, por ndikim më të fortë kanë tregu i zi dhe ndryshimi i shpeshtë i kursit valutor (BQK, 2014a).

Moszbatimi i ligjeve paraqitet në rastet kur në një vend nuk zbatohet ligjshmëria nga burokratët shtetërorë. Dukuri e shpeshtë kur tretmani i firmave private nuk është i barabartë me tretmanin e atyre shtetërorë. Investitorët e huaj hezitojnë të investojnë nga shkak i prezencës së një shtrese të korruptuar të njerëzve qeveritarë, zbatueshmëria e nivelit të ulët të ligjeve shtetërorë etj.

Përveç faktorëve të sipërpërmendur, në vëllimin dhe efikasitetin e investimeve direkte të huaja, ndikojnë edhe një numër i faktorëve të tjerë. Në vijim do të japim edhe disa barrierat e tjera të

cilat patjetër duhet të paktën të minimizohen, nëse ne si shtet duam që investimet e huaja të rriten.

Depërtimin e investimeve direkte të huaja, vendet e ndryshme e realizojnë me anën e disa rregullave dhe ligjeve të posaçme. Kështu p.sh., disa vende ndalojnë që investorët të mund të investojnë në disa sektorë “të rëndësishëm”, për të cilët mendojnë se janë me interes të posaçëm shtetëror. Madje ka edhe të atillë të cilët nuk lejojnë investimet e huaja në rajone të caktuara gjeografike, sikurse ato rreth kufinjëve shtetërorë, në afërsi të metropoleve etj. Barriera të ngjashme ishin edhe pengesat e vonesat administrative shtetërore, zbatimi i lartë i taksave apo tarifave doganore të kapitalit, rregullat e posaçme lokale, ndalimi i shitjes së tokës investorëve të huaj etj. Në fillim të dekadës së fundit të shekullit njëzet, vendet në zhvillim e sidomos vendet e tranzicionit, filluan me të madhe që t’i shmangen këtyre restriksioneve për investimet e huaja direkte, gjë që solli një rritje rapide të IDH-ve. Ekziston një numër i madh i faktorëve të tjerë të cilët ndikojnë në vëllimin dhe efikasitetin e IDH-ve. Ndër ato më të rëndësishmet janë:

- Hulumtimi për tregje të reja dhe rritja e fuqisë tregtare
- Shtimi i fitimit nëpërmjet fuzionit
- Zmadhimi i madhësisë së firmës
- Diversifikimi (shpërndarja) e rrezikut
- Motivet financiare
- Motivet personale

Regjimi liberal i tregtisë dhe sistemi ndërkombëtar i pagesave, janë faktorë të rëndësishëm të cilët ndihmojnë në rritjen e investimeve direkte të huaja. Kompanitë e mëdha gjithmonë synojnë të përfitojnë treg sa më të madh për prodhimet e veta, jo vetëm brenda kufinjve shtetërorë, por edhe jashtë tyre. Kjo ndodh për shkak të ngopjes së tregut të brendshëm me prodhimet e veta, prandaj zgjidhja më e mirë është plasmani në tregun ndërkombëtar. Vetë prezenca e firmës, në vendin jashtë kufirit, i mundëson asaj që më së afërmi të njoftohet me kërkesat, kushtet dhe mundësitë e plasmanit të prodhimeve të veta në atë vend. Njëkohësisht,

firma duke qenë prezente vetë në atë vend, do të ketë kontroll më të madh në udhëheqjen e afarizmit të ndërmarrjes.

Shtimi i fitimit nëpërmjet fuzionit të ndërmarrjeve mundëson arritjen e rezultateve më të larta në domenë të ndryshëm të veprimtarisë së vet. Kështu, aktivitetet sikurse ndryshimi i shpejtë i teknologjisë, informimi, zgjerimi i tregut, rrjeti i distribuimit, shitja, hulumtimi dhe zhvillimi në rastin e fuzionit, kërkojnë shpenzime më të vogla, kurse efektet nga këto veprime janë të mëdha.

Në ekonominë e globalizuar, madhësia e madhe e kompanisë është një parametër krucial, sidomos në sferën e kostove të hulumtimeve dhe zhvillimit, zgjerimin e rrjetës së shpërndarjes, krijimit të shërbimeve financiare, udhëheqjes dhe aktiviteteve të tjera. Një përparësi e dukshme e kompanive të mëdha është fakti se duke patur mundësi për veprim në një hapësirë më të madhe gjeografike dhe në më tepër segmente, ato kanë përparësi në grumbullimin dhe zbatimin më të madh të informatave të inovacioneve.

Faktori tjetër, i cili ndikon në vëllimin dhe efikasitetin e investimeve direkte të huaja, është zvogëlimi i rrezikut nëpërmjet shpërndarjes gjeografike të tregut. Bashkimi apo blerja e një firme jashtë kufinjve, mundëson shmangien e një numri të tarifave doganore dhe barrierave jodoganore. Motivet financiare dhe fitimet personale, gjithashtu luajnë rol vendimtar në vëllimin dhe efikasitetin e investimeve direkte të huaja.

4.4.4. Përfitimet nga IHD-ja në vendin mikpritës

Vendi mikpritës ka një numër të përfitimeve nga IDH-të. Ndër përfitimet më të rëndësishme sipas Ch.Hill do të numërojmë këto:

1. Përfitimi nga shpërndarja e resurseve
2. Përfitimi nga rritja e punësimit
3. Përfitimi në përmirësimin e bilancit të pagesave
4. Përfitimi në zhvillimin e konkurrencës dhe rritjen ekonomike

Përfitimi nga shpërndarja e resurseve. Vendi mikpritës me pranimin e IDH-së përfiton në rritjen e tre segmenteve:

1. Kapitalit
2. Teknologjisë
3. Resurset e menaxhmentit

Kapitali paraqet njërën prej faktorëve më të rëndësishëm të prodhimit. Mungesa e këtij faktori të prodhimit ngadalëson zhvillimin ekonomik të vendit, dhe e kundërta, hyrja e kapitalit në vend, ndikon në rritjen ekonomike të vendit. Kompanitë multinacionale kanë kapital të madh, andaj ato e shfrytëzojnë atë me rastin e investimeve. Po ashtu, këto kompani gëzojnë besim më të madh në banka, kështu që mund të huazojnë kredi të ndryshme me kushte kreditore më të volitshme.

Transferimi i teknologjisë vlerësohet si një nga benificionet më të mëdha nga investimet direkte të huaja. Në këtë transferim të teknologjisë, padyshim se roli i kompanive multinacionale është vendimtar dhe i pazëvendësueshëm.

Ato në kuadër të filialeve të tyre, zbatojnë teknologji të re dhe më produktive. Kjo i jep impuls të posaçëm zhvillimit ekonomik të vendit mikpritës. Kompanitë multinacionale, gjithashtu duke shfrytëzuar shërbimet e avancuara të hulumtimeve, stimulojnë edhe inovacionet në kuadër të vendeve mikpritëse. Resurset e menaxhimit paraqesin menaxherët me eksperiencën, njohuritë dhe aftësitë e tyre, të cilët vijnë në vendin mikpritës. Transferimi i njohurive dhe përvojave të tyre paraqet një përfitim të madh për vendin mikpritës. Trajnimi i punëtorëve, asistenca teknike dhe ngritja e aftësive profesionale, janë po ashtu veprime të cilat ndërmerren me rastin e investimeve direkte të huaja. Rezultate shumë më efikase dhe më të shpejta në këtë lëmi, arrihen atje ku ekziston shkalla më e lartë e edukimit të njerëzve. Aftësia dhe adaptimi i punëtorëve me rrjedhat shkencore teknike, nga ana tjetër është parakusht i domosdoshëm i globalizimit ekonomik. Në globalizmin ekonomik kanë sukses vetëm ato ndërmarrje e individë të cilët ndjekin dhe zbatojnë të arriturat e larta shkencore - teknologjike.

IDH-të luajnë rol krucial në riformimin dhe ristrukturimin organizativ të ndërmarrjeve, në këto kushte të ndryshimeve dinamike dhe në kontest të tregut global të mallrave dhe shërbimeve. IDH-të me siguri do të vazhdojnë të luajnë rol të madh në ekonominë botërore.

Përfitimi nga rritja e punësimit është njëra prej përfitimeve të vendit mikpritës nga IDH-të. IDH-të në vendin mikpritës ndikojnë në rritjen e punëtorëve në dy forma:

1. Rritja direkte e numrit të të punësuarve
2. Rritja indirekte e numrit të të punësuarve

Në rritjen direkte të të punësuarve kemi shtimin e numrit të të punësuarve me rastin e fillimit të veprimtarisë së kompanisë. Kompania e cila investon krijon vende të lira të punës dhe punëson numrin e nevojshëm të punëtorëve. Hyrja e IDH-ve dhe zhvillimi i veprimtarisë së kompanisë investuese, kërkon edhe furnizim me material dhe logjistikë, të cilën e merr nga firmat vendase. Kështu edhe firmat vendase rrisin numrin e punëtorëve në rradhët e tyre. Ndodh që kjo rritje e punëtorëve, në formë të tërthortë të jetë më e madhe se sa numri i punëtorëve, i punësuar drejtpërdrejtë në kompaninë investive.

IDH-të kanë ndikim të madh në rritjen e punësimit në vendin ku ato investojnë. Rritja e numrit të të punësuarve është një ndër qëllimet kryesore të globalizmit ekonomik. Pagat e të punësuarve në kompaninë që investojnë në vendin mikpritës janë më të mëdha se pagat e punëtorëve në firmat vendore. Po ashtu puna është më e sigurt, sepse kompanitë multinacionale prodhojnë sasi më të mëdha të prodhimit dhe kanë treg më të gjerë për plasmanin e prodhimeve të tyre. Punëtorët janë më të kënaqur edhe me kushtet e punës të cilat sigurohen nga kompanitë shumëkombëshe.

Vendi mikpritës ka përfitime nga IDH-të edhe në aspektin e përmirësimit të bilancit të pagesave të tregtisë së jashtme të vendit. Kur bëhet fjalë për bilancin e pagesave të një vendi, duhet të theksuar se shqetësimi i përhershëm i vendit është që të mos ketë bilanc defiqitar të pagesave. Vendi, i cili në fund të vitit shënon bilanc negativ të pagesave, ka pasoja dhe reperkurse negative në zhvillimin e ekonomisë. Në rast se kompanitë transnacionale (KTN) nëpërmjet degës së vet, rrisin sasinë e prodhimit të vendit mikpritës, atëherë rriten shanset për zmadhimin e eksportit të mallrave dhe shërbimeve, si dhe rritjen e hyrjes e daljes së devizave në vend. Po ashtu, përmirësimi i bilancit të pagesave të vendit mikpritës do të ndodhë nëse dega e kompanive transnacionale prodhon mallra ose jep shërbime të cilat më parë janë importuar. Kështu, vendi mikpritës nuk do të ketë detyrime devizore ndaj shteteve furnizuese të mallit konkret.

Përfitimi në rritjen e konkurrencës dhe shtimit ekonomik të vendit mikpritës paraqet njërin nga përfitimet e vendit mikpritës nga IDH. Prodhuesi vendor, duke e parë rrezikun nga konkurrenca e prodhuesit të jashtëm, do të jetë i detyruar të angazhohet më tepër në mënyrë që të jetë konkurent në treg.

Konkurrenca rrit kualitetin dhe kuantitetin e mallrave. Nëse oferta e prodhimeve rritet kur kërkesa është konstante, atëherë kemi të bëjmë me zvogëlim çmimesh të mallrave dhe shërbimeve. Zvogëlimi i çmimeve është në favor të konsumatorëve dhe mundëson rritjen e mirëqenies dhe standardin e qytetarëve. Shembull tipik i zvogëlimit të çmimeve në tregun e vendit është zvogëlimi i çmimeve dhe shërbimeve të telekomunikimit. Me privatizimin e kompanive të telekomunikacionit, në vendet e tranzicionit, çmimi i shërbimeve të telefonisë kishte zvogëlim dhe rënie permanente.

Në Kosovë kemi rastin e telefonisë mobile “Vala 900”²⁶ e cila ishte monopole në treg dhe i vendoste çmimet sipas dëshirës së saj, kurse në momentin kur erdhi konkurenti i saj “IPKO”²⁷ dhe vendosi oferta të ndryshme për konsumatorët, atëherë “Vala 900” u detyrua të zbriste çmimet e saj, ose përndryshe do të humbiste tregun, edhe pse një pjesë të saj ajo veçse e humbi. Pasi në treg u fut edhe telefonia “Z mobile”²⁸, që të treja kompanitë telefonike shtyhen

²⁶Operatori i telefonisë mobile “Vala” ofron shërbime të llojllojshme për konsumatorët e saj. “Vala” ka shtrirë rrjetin e saj në tërë territorin e Kosovës dhe që një kohë të gjatë ofron për të gjithë konsumatorët e saj shërbimet më të avancuara të telefonisë mobile, brenda dhe jashtë operatorit “Vala”. Lansimi i produkteve të reja, atraktiviteti i shërbimeve të ofruara, çmimet tejet joshëse si dhe kualiteti i lartë, ka bërë që Operatori Publik “Vala” të jetë lider i shërbimeve të telekomunikimit në vend, duke shërbyer mbi 1.2 milionë konsumatorë.

²⁷Me hyrjen e saj në treg, IPKO ka sjellë konkurrencë në tregun e telefonisë mobile dhe përfitime të shumta për konsumatorët. Depërtimi i telefonisë mobile IPKO në treg, ka ulur çmimet, ndërsa ka ngritur cilësinë e shërbimeve, në nivelin më të lartë të mundshëm. Gjatë një viti operimi, IPKO ka arritur të mbulojë me rrjetin e telefonisë mobile, më shumë se 99.7 për qind të popullatës së vendit. Për më pak se një vit, telefonia mobile IPKO ka 35 për qind të tregut të telefonisë mobile në Kosovë, i cili gjithnjë është në rritje. IPKO vazhdon të jetë ofruesi kryesor i internetit, edhe nga shtrirja e rrjetit, edhe nga numri i konsumatorëve. IPKO ka një rrjet shumë të gjerë tokësor - fikse me 230.000 mijë porta, ndërsa numri i konsumatorëve të telefonisë fikse është në rritje të vazhdueshme

²⁸“Devolli” Group, në kuadrin e gjerë të produkteve që ofron, ka edhe shërbimin telefonik, i njohur me emrin komercial **Z MOBILE**. Ai ka filluar të funksionojë që nga Janari i vitit 2008. “Dardafone” është kompani kosovare me kapital të përzier, me bashkëpronarë të përbërë nga Korporata “Devolli” dhe K - com Group, kompani amerikane. E licencuar nga Autoriteti Rregullativ i Kosovës, “Dardafone”, në bashkëpunim me Postën dhe Telekomunikacionin e Kosovës, ushtron aktivitetet e telefonisë mobile virtuale, me pajisjet më moderne të kompanisë Nokia - Siemens, lidere në teknologjinë e telefonisë mobile në botë. Zmobile qëndron fuqishëm në tregun e Kosovës, gjithmonë duke sjellë risi për klientët e saj.

njëra me tjetrën me anë të ofertave, nga e cila përfiton qytetari i cili mund të zgjedhë atë ofertë që e përballon xhepi i tij. Por mbi të gjitha, nga përparimi i teknologjisë me hapa shumë të shpejtë dhe me thirrjet telefonike që po bëhen nëpërmjet programeve të lidhura me internet me anë të ‘smart phone’ (telefonave të mençur), të gjitha këto kompani kanë filluar të kenë rënie të qarkullimit.

4.4.5. Anët negative të IHD-ve në vendin mikpritës

Vendet mikpritëse, përveç përfitimeve që kanë nga IDH-të, ato kanë edhe anët negative. Efektet negative mund t’i radhisim në disa segmente:

1. Efektet negative në treg
2. Efektet negative në bilancin e pagesave
3. Humbja e sovranitetit dhe autonomisë kombëtare

Efektet negative në treg mund të jenë katastrofale, si për firmat vendore ashtu edhe për ekonominë e vendit mikpritës. Një situatë e tillë mund të ndodhë sidomos në vendet jo mjaft të zhvilluara dhe ato të tranzicionit, ku firmat vendore zakonisht janë të vogla dhe nuk janë në gjendje t’i përballojnë konkurrencës së fortë të kompanive të fuqishme multinacionale.

Hyrja e kompanive transnacionale (KTN-ve) në vendin mikpritës ka për qëllim përfitimin e konsumatorëve dhe dominimin në treg. KTN, nëse e do nevoja, do të prodhojë me humbje, vetëm e vetëm që të eliminojë konkurentët. Mbasi që fiton tregun dhe fiton pozitën monopoliste, KTN i rrit çmimet e prodhimeve. Kështu, konsumatorët e vendit dëmtohen.

Për të mos lejuar një situatë të këtillë, vendi mikpritës duhet t’i ketë parasysh të gjitha këto pasoja negative dhe të njëjtat t’i parandalojë, para se të nënshkruhet kontrata për IDH. Gjithashtu, evitimi i këtyre mundësive duhet të mënjanohet me ligjet dhe rregullat kundër pozitës monopoliste të KTN. Rregullimi i drejtë i këtyre ligjeve në vendin mikpritës dhe

zbatimi rigoroz i tyre, nuk lejon mundësinë e spekulimeve dhe keqpërdorimeve të pozitës së KTN në vendin mikpritës.

Vendi mikpritës gjithashtu mund të ketë pasoja negative nga IDH në bilancin e pagesave. Kjo mund të ndodhë kur KTN, tërë fitimin e realizuar nga dega, e kalon në vendin e origjinës.

Meqenëse kjo reflektohet negativisht në ekonominë e vendit mikpritës, paraprakisht gjatë nënshkrimit të kontratës me KTN, i duhet ta rregullojë këtë çështje. KTN po ashtu mund të ndodhë që të inportojë inputet (lëndën e parë) nga vendi i origjinës. Kjo shkakton derdhjen e madhe të devizave nga vendi mikpritës, gjë që e përkeqëson bilancin e pagesave. Sovraniteti dhe autonomia kombëtare e vendit mikpritës të zbehet, sepse vendi mikpritës nuk mund të ndikojë në vendimet e KTN. Në sjelljen e vendimeve të MNC, vendi mikpritës nuk ka ndikim.

4.4.6. Përfitimet dhe humbjet e vendit të origjinës nga IHD-ja

Ngjashëm sikurse vendi mikpritës i cili kishte përfitime dhe humbje nga IHD, edhe vendi i origjinës ka përfitime dhe humbje nga IHD. Përfitimet nga IHD në vendin i origjinës janë:

1. Përmirësimi i bilancit të pagesave
2. Rezultatet pozitive nga punësimi
3. Fitimi i njohurive plotësuese nga transferimi i resurseve njerëzore

Përmirësimi i bilancit të pagesave tek vendi të origjinës arrihet nëse KTN e kalon fitimin nga dega e vet në vendin e origjinës. Me transferimin e fitimit nga dega në vendin e origjinës, rritet hyrja e devizave në vend gjë e cila ndikon pozitivisht në ekonominë e vendit të origjinës. Rezultatet pozitive nga punësimi, po ashtu janë përfitime të vendit të origjinës e që rezultojnë nga angazhimet e punëtorëve të vendit të origjinës jashtë vendit. Fitimi i njohurive plotësuese nga transferimi i resurseve njerëzore është një nga përfitimet të cilat mund t'i ketë vendi i origjinës.

4.4.7. Investimet e huaja direkte në Kosovë dhe në Europën Juglindore

Kosova ka një ekonomi të re dhe dinamike. Baza e saj është transformuar nga një ekonomi centraliste e dirigjuar në një ekonomi të hapur të tregut, cila transformimin e saj të thellë e ka përjetuar pas vitit 1999, me çlirimin e Kosovës nga Serbia. Një ndër sfidat me të cilat ajo u përball gjatë dekadës së fundit është edhe procesi i privatizimit. Në përpjekje për të krijuar një mjedis sa më të përshtatshëm për investitorët, AKP-ja vazhdon me një program të përsheptuar të privatizimit të Ndërmarrjeve dhe Aseteve përmes një procesi të tenderimit transparent dhe konkurues, sipas praktikave më të mira ndërkombëtare. Ky proces është atraktiv për investitorët sepse i mundëson pronarit të ri të bëjë investime të menjëhershme si dhe të bëjë përzgjedhjen e fuqisë së re punëtore, duke ofruar pronësi të pastër pa ndonjë borxh të trashëguar, pa ndërhyrje të kreditorëve dhe pretendentëve të mundshëm.

E ndodhur në Europën Juglindore, ekonomia e Kosovës është bërë pjesë e integritimeve ekonomike të këtij rajoni, të cilat ofrojnë mundësitë e zgjerimit të tregut në një hapësirë mjaft të gjerë. Qëllim në vete, tashmë është rritja e konkurrueshmërisë së kësaj ekonomie, duke rritur kapacitetin e saj eksportues për të zvogëluar defiçitin tregtar që ka Kosova aktualisht. Si vend i rëndësishëm për zhvillimin e biznesit, Kosova ofron një sërë përparësish komparative si: popullsinë re dhe mjaft mirë të kualifikuar, ku mosha mesatare e saj është mjaft e re, resurset natyrore, kushtet e volitshme klimatike, infrastruktura e re, politika fiskale me taksat më të ulëta tatimore në rajon, pozita gjeografike me qasje në tregun rajonal të CEFTA-s dhe në atë të Bashkimit Evropian.

Kosova përveç se është anëtare e CEFTA-s, në Qershor të këtij viti u anëtarësua edhe në Fondin Monetar Ndërkombëtar dhe në Bankën Botërore, dhe po ashtu aspiron në mekanizma të tjerë të fuqishëm ekonomik - financiar si BERZH²⁹, në Bankën për Zhvillim e Këshillit të Evropës CEB. Kosova gjatë muajit qershor 2013 është pranuar si anëtare e plotë në CEB. Kjo

²⁹Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim - BERZH (EBRD), Fondi për zgjerimin e ndërmarrjeve – ENEF. BERZH në bashkëpunim me partnerët e tjerë si Bashkimi Evropian, Banka KfV dhe Fondi Evropian për Investime (EIF) kanë krijuar një fond investiv që do të ofrojë përkrahje financiare dhe teknike në formë të ekuiteteve dhe kuazi-ekuiteteve për ndërmarrjet nga Ballkani Perëndimor që kanë potencial të zgjerimit të aktiviteve të tyre afariste.

Kriteret dhe përfitimet

- NMV-të me potencial të lartë të rritjes
- Ofron finansim në formë të ekuiteteve për zgjerimin e ndërmarrjeve të tyre
- Ndërmarrjet e kualifikuara mund të marrin investime nga 1 deri 10 mil. EUR
- Asistencë në këshillim nga ekspertët e BERZH-it.

bankë është degë autonome e Këshillit të Evropës. Po ashtu aspiron në mekanizma të tjerë të fuqishëm ekonomik - financiar si Organizata Botërore e Tregtisë OBT etj (BQK, 2013).

Si ilustrim gjatë vitit 2013, sistemi financiar i Kosovës në përgjithësi u karakterizua me rritje të aktivitetit. Gjithsej asetet e sistemit, deri në dhjetor 2013, arritën vlerën prej 4.2 miliard euro, duke shënuar rritje vjetore prej 10.5 % (BQK, 2014).

Gjatë vitit 2013, Mali i Zi dhe Kosova shënuan normën më të lartë të rritjes ekonomike (3.4% secila), pasuar nga Maqedonia (3.1 %), Serbia (2.5%) dhe Bosnja e Hercegovina (1.2 %), ndërsa Shqipëria shënoi nivelin më të ulët të rritjes (0.7%). Bazuar në të dhënat për vitin 2014 nga FMN-ja dhe Komisioni European, sugjerohet se aktiviteti ekonomik në EJT pritet që në përgjithësi të jetë i ngjashëm me vitin 2013. Mirëpo, për shkak të dëmeve të shkaktuara nga kushtet klimatike në B.H. dhe Serbi gjatë muajit maj 2014, këto parashikime mund të ulen. Shkalla më e lartë e papunësisë vazhdon të jetë në Bosnje e Hercegovinë (44.5%), Kosovë (42%), Maqedoni (29.0%), dhe Serbi (22.1%), ndërsa shkallën më të ulët të papunësisë vazhdojnë ta kenë Mali i Zi (15.0%) dhe Shqipëria (16.0%).

Tabela 28. Partnerët kryesorë të Kosovës në eksport dhe import gjatë vitit 2013

Vendet	Eksporti (000) €	Pjesëmarrja në total %	Importi (000) €	Pjesëmarrja në total %
Italia	71.351	25.8	213.469	8.5
Shqipëria	40.180	14.6	110.528	4.4
Maqedonia	26.376	9.6	287.739	11.5
Zvicra	15.133	5.5	22.664	0.9
Gjermania	14.995	5.4	304.195	12.1
Serbia	14.968	5.4	278.388	11.1
Turqia	11.380	4.1	199.881	8.0
Kina	3.266	1.2	159.651	6.4
Totali	276.100	71.6	2.507.609	62.9

Burimi: ASK - Raporti për vitin 2013

Nga ky raport vërehet një defiçit i madh në shkëmbimin e mallrave në Republikën e Kosovës. Edhe pse për nga niveli i ngritjes ekonomike për këto 5 vite Kosova radhitet e para me një

mesatare vjetore prej 4.50 %, inflacioni i saj ishte i lartë. Kosova radhitet e katërta nga të gjitha shtetet e rajonit për nivelin e inflacionit, i cili brenda kësaj periudhe ishte mesatarisht 5.22 % në vit.

Asnjëri nga shtete e rajonit, duke përfshirë edhe ato të BE-së dhe Kroacia e cila është në prag të hyrjes në BE dhe Eurozonë, nuk e plotësojnë minimumin e standardit të inflacionit të përcaktuar për Eurozonë, gjegjësisht në BE, i cili ishte 1.53 % për vitin 2012.

Të gjitha shtetet e rajonit, përpos Malit të Zi, shënojnë defiçit buxhetor. Kosova e tejkalon për pak mesataren e rajonit, gjegjësisht edhe atë të lejuar sipas standardeve të Eurozonës, gjegjësisht BE-së.

Tabela 29. Investimet (IHD) në Kosovë nga vendet e origjinës

Rajoni/Vendi	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Austria	35.39	51.3	15.5	21.14	19.56	0.38	10.7	30.3
Gjermania	48.14	43.97	75.15	91.54	66.64	49.51	21.67	29.4
Sllovenia	56.17	44.34	50.78	33.97	16.21	9.29	7.03	-9.4
Britania e Madhe	116.16	36.65	6.16	38.86	80.1	14.31	10.66	-39.5
Zvicra	9.74	32.09	22.71	35.1	30.93	43.77	41.68	38.2
Turqia	5.44	23.78	14.49	4.9	34.69	65.55	82.73	20
Holanda	41.24	22.47	15.07	14.54	14.19	-25.98	-15.48	-7.8
Shqipëria	3.44	21.85	23.32	20.25	11.19	4.74	19.28	20.4
Serbia		5.54	0.63	0.43	0.36	0.37	5.69	2.4
Shtetet e Bashkuara	8.81	4.79	11.85	12.58	14.32	10.78	12.7	14.7
Franca	8.56	3.48	6.03	3.85	0.21	6.3	3.8	3.3
Maqedonia	0.39	1.98	1.52	1.8	5.79	1.19	4.65	3.2
Kroacia	5.78	0.65	0.67	1.8	2.88	0.38	1.34	1.1
Qipro	0.1	0.25	0.31	0.02	1.01	0.31	0.26	-0.3
Norvegjia	0.55	0.13	2.47	3.3	2.47	2.86	4.7	5.9
Itali	5.47	0.06	5.97	6.6	1.68	4.38	8.73	3.3
Greqi	2.31	0.03	0.02	5.89	0.37	0.28	-0.38	-0.6
Te tjera	93.03	73.08	34.78	69.25	91.27	40.23	39.27	36.6
TOTALI	440.74	366.45	287.41	365.82	393.86	228.64	259.02	151.2

Burimi: BQK 2015

Gjatë periudhës 5 - vjeçare (2008 - 2012), Kosova gradualisht dhe për një nuancë është integruar më shumë me vendet jashtë këtij rajoni. Përderisa në vitin 2008 tregtia me rajonin përbënte 53.57 % të tregtisë së përgjithshme të Kosovës, në vitin 2012 ajo u tkurr në 50.41 %.

Kjo do të thotë se tregtia me vendet jashtë rajonit që në vitin 2008 përbënte 46.43 % të tregtisë së përgjithshme të Kosovës, në vitin 2012 ajo përbënte 49.59 %. Pra, përfaqësimi i vendeve jashtë këtij rajoni në portofolion e përgjithshme tregtare të Kosovës, është rritur me 3 %.

4.5. Investimet në Kosovë

Të rregjistrosësh një biznes në Kosovë është e thjeshtë dhe në të njëjtën kohë edhe falas. Të gjitha bizneset dhe markat tregtare janë të shënuar në listën e Rregjistrimit të Organizatave të Biznesit dhe Emrave Tregtar. Kështu informatat themelore në lidhje me kompanitë e rregjistruara, mund të gjenden lirisht dhe në mënyrë të hapur përmes internetit. Bizneset që veprojnë në Kosovë duhet të rregjistrohen në Agjencinë e Rregjistrimit të Bizneseve të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë (www.arbk.org). ARBK vepron në bazë të një databaze elektronike, si një proces më i thjeshtë dhe më i shpejtë i rregjistrimit pa pagesë të bizneseve të reja. Ekzistojnë 22 Qendra komunale të regjistrimit të njohura si zgjidhje “one-stop shop” me zyrën kryesore të ARBK-s në Prishtinë. Tashmë bizneset rregjistrohen pa pagesë dhe brenda afatit të shkurtë kohor: një (1) ditë për biznese individuale dhe tre (3) ditë për biznese të shoqërive aksionare. Kjo është mundësuar me integrimin e sistemit, me ç’rast bizneset marrin një certifikatë me dy numra: Numrin e biznesit dhe Numrin fiskal. Gjithashtu, është larguar kapitali fillestar dhe janë thjeshtësuar procedurat e rregjistrimit. Mbrojtja e investitorëve, në Kosovë e ka përmirësuar dukshëm mbrojtjen e aksionarëve, duke përmirësuar ndër të tjera kërkesat për publikimin e transaksioneve në rast të konfliktit të interesit në mes të zyrtarëve të korporatave, duke iu mundësuar aksionarëve të mbulojnë dëmet që vijnë si pasojë e transaksionit, si dhe duke ia mundësuar gjykatës t’u zhvlerësojë transaksionin, nëse aksionarët e realizojnë kërkesën me sukses.

Kosova, pas pavarësimit së saj, ka arritur progres të madh në shumë fusha të zhvillimit të saj si: në rritjen e stabilitetit politik, në ngritjen e nivelit të sigurisë, në ekonomi stabile me rritje të vazhdueshme, me plotësim të legjislacionit etj.

Ajo është bërë pjesë e rëndësishme e iniciativave të bashkëpunimit regjional, përmes të cilave është arritur krijimi i tregut të përbashkët rajonal, eliminimi i tarifave doganore, eliminimi i barrierave tregtare si dhe hapja e perspektivave të reja. Institucionet e Kosovës kanë punuar

dhe vazhdojnë të punojnë me hapa të shpejtë në përmbushjen e standardeve të nevojshme për anëtarësim në Bashkimin European.

Është krijuar mjedis stabil makroekonomik, sistem i qëndrueshëm financiar, janë bërë reforma në politikën fiskale në aplikimin e normave më të ulëta tatimore në rajon. Ndër objektivat e rëndësishme që vendi ynë ka vënë para vetes është edhe rritja e konkureshmërisë së ekonomisë së vendit në tregun rajonal.

Është arritur progres në ngritjen e infrastrukturës moderne, si brenda Kosovës e po ashtu edhe në lidhjen me rajonin. Vlen të përmendet këtu, lidhja me Shqipërinë përmes autostradës së ndërtuar si dhe zotimet e Shqipërisë që në një të ardhme jo të largët, të ndërtojë vijën hekurudhore që lidh këto dy vende.

Të gjitha këto e veçojnë Kosovën si një vend mjaft atraktiv, me mundësi investimi për secilin investitor të sektorëve të ndryshëm, dhe po ashtu në privatizim ku tashmë pritet privatizimi dhe dhënia në koncesion i kompanive të mëdha publike si: Posta dhe Telekomit të Kosovës dhe Sistemi i Distribuimit të Energjisë Elektrike, investimi në fushat e gjelbëra në të cilat parqet industriale ofrojnë mundësi mjaft të favorshme në ofrimin e infrastrukturës fizike.

Kosova po punon në krijimin tregut të kapitalit financiar, në të cilin do të gjenin plasman investitorët të cilët duan të investojnë në aksionet e kompanive të ndryshme.

Investimet në sistemin bankar paraqesin vlerën më të madhe financiare me kapital të huaj. Kapitali i huaj ka një shpërndarje gjeografike të gjerë, nga mëse 80 vende të botës, ku Shqipëria zë vendin e parë për nga numri i bizneseve të regjistruara.

Agjencia për Investime dhe Përkrahje të Ndërmarrjeve në Kosovë (KIESA) e cila vepron në kuadër të Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, në fushëveprimtarinë e saj ka përveç të tjerash edhe promovimin e investimeve. KIESA, iu ofron mbështetje investitorëve vendorë dhe të huaj në grumbullimin e informatave lidhur me fushën e investimeve që ata synojnë për të investuar në Kosovë, në procedurat e regjistrimit të biznesit, në dhënien e informatave për legjislacionet që kanë të bëjnë me Investimet e Huaja Direkte (IHD), në nxjerrjen e informatave specifike makro - ekonomike, si dhe në ofrimin e shërbimeve të tjera të nevojshme për realizimin e investimit të tyre.

Kosova ofron ambient të përshtatshëm të të bërit biznes, siç janë fuqia punëtore e re dhe e motivuar, tregu i lirë dhe qasja pa tarifa doganore në tregun e Bashkimit European, taksat ndër më të ulëtat në rajon si dhe procedurat e lehta të të bërit biznes.

Tabela 30. Shpërndarja e kompanive të huaja investuese sipas sektorëve të ekonomisë në Kosovë

Nr.	Sektori	Nr. Kompanive	% në total
1.	Tregti	1952	38.9%
2.	Prodhim	791	15.8%
3.	Aktivitete shërbyese	764	15.2%
4.	Konstruksion	607	12.1%
5.	Turizëm dhe hoteleri	350	7.1%
6.	Transport	181	3.6%
7.	Sektori financiar	141	2.8%
8.	Telekomunikim	121	2.4%
9.	Shëndetësi	68	1.3%
10.	Edukim	43	0.8%
	TOTALI	5018	100%

Burimi: Raporti Vjetor i ESK 2013

4.5.1. Sektorë kyç të ekonomisë së Kosovës

Energjia dhe minierat - Kosova ka pasuri të mëdha nëntokësore. Me 14,700 milion tonë, ajo zë vendin e pestë në botë për rezerva të linjtit prej të cilit ajo edhe prodhon sasinë më të madhe të energjisë elektrike. Kosova gjatë vitit 2008 ka prodhuar 4738 miliard kv/h dhe ka shpenzuar 5156 miliard kv/h energji elektrike. Rezervat e këtij minerali që përdoret si burim kryesor i prodhimit energjetik në Kosovë, vlerësohet se do të zgjasin për 650 vjet të tjera, me ritmin e nxjerrjes momentale.

Rezerva linjiti janë të shpërndara edhe në legenin e Dukagjinit dhe atë të Drenicës, por nxjerrja e mineralit momentalisht është kufizuar vetëm në legenin e Kosovës. Pos linjtit Kosova është

e pasur edhe me zink, plumb, ari, kadmium dhe bismuth, boksit, nikel etj. Kultura e nxjerrjes së linjtit daton që nga koha romake, nxjerrja moderne e mineraleve në Kosovë fillon në vitet 1930-të, me themelimin e Kompleksit të Trepçës.

Bujqësia dhe blegtoria - Kosova është e pasur me tokë bujqësore, 53 për qind të sipërfaqes totale janë tokë e punueshme. Momentalisht, sektori i bujqësisë kontribuon vetëm 19 për qind në NVP-në e përgjithshme dhe 15 për qind në vlerën e eksportit. Procedimi i ushqimit në Kosovë, tradicionalisht është udhëhequr nga ndërmarrjet shoqërore, derisa sot këto janë joaktive; kompani të reja private kanë filluar të operojnë në këtë fushë. Pjesa më e madhe e këtyre kompanive janë të vogla dhe nuk janë ende të afta për të mbuluar pjesën më të madhe të kërkesave në treg. Investimi në këto kompani, sigurimi i teknikave të reja të menaxhmentit, do të mund të rilindte industrinë e agropronësimit në Kosovë, deri në atë pikë që ajo do të mund të garonte në tregjet ndërkombëtare.

Vreshtat - Rritja e rrushit dhe prodhimi i verës është një traditë e vjetër në Kosovë. Gjatë viteve të arta, industria e verës vetëm në Rahovec ka pasur kapacitet prodhimi deri në 50 milionë litra në vit. Në vitin 1989, eksporti i verës së Rahovecit ka arritur në 40 milionë litra në vit, që kryesisht janë shpërndarë në tregun gjerman. Pas privatizimit të një pjese të vreshtave dhe Fabrikës së verërave në Rahovec, është arritur të mbulohet një pjesë e mirë e tregut vendor, e po ashtu ka gjetur plasman të suksesshëm në tregun ndërkombëtar, posaçërisht në atë evropian.

Ndërtimtari - Viteve të fundit, industria e ndërtimit është bërë njëri ndër sektorët më të rëndësishëm në ekonominë kosovare. Ky sektor vazhdon të jetë një potencial shumë i madh ekonomik për Kosovën, duke marrë parasysh nevojën për ndërtime të vendbanimeve të reja dhe infrastrukturën rrugore. Vetë Qeveria e Kosovës, ka vendosur kështu me qëllim që të lidhë vendin me korridoret më të rëndësishme në Maqedoni, Shqipëri dhe Serbi.

Industria e tekstilit - Tekstili ka qenë sektori i dytë për nga madhësia në Kosovë, ndërsa në kulmin e zhvillimit të vendit, 15 ndërmarrje shoqërore të prodhimit të tekstilit kanë punësuar më shumë se 1,000 njerëz dhe kanë arritur shitje deri në 35 milionë euro. Përkundër zhvillimeve të fundit në rajon që kanë prishur lidhjet e tregtisë, analizat tregojnë se nga 55 deri në 65 milionë euro mund të arrihen me eksportim, në rast të rikthimit të këtyre lidhjeve. Në

këtë sektor, ka mjaft hapësirë për investitorë, që edhe njëherë Kosova të prodhojë rroba të përbëra nga tekstili i prodhuar në rajon.

Turizmi - Potenciali turistik i Kosovës lidhet ngushtë me pozitën gjeografike të Kosovës, e rrethuar nga të gjitha anët me male, dhe në qendër të Ballkanit vendi ka potencial për turizëm dimëror. Malet në jug të Kosovës, vendpushimet si Brezovica dhe Malet e Sharrit, janë mundësi shumë të mira dhe interesante për investitorët.

4.5.3. Investimet e huaja direkte në Kosovë gjatë viteve të fundit

Investimet e huaja direkte në Kosovë, gjatë vitit 2013 ishin 258.9 milionë euro ose 13.1 përqind më të larta se sa ato të vitit 2012. Investimet e rezidentëve të Kosovës në vende të tjera shënuan rritje prej 13.2 përqind dhe arritën vlerën prej 17.9 milionë euro. Investimet direkte të rezidentëve kosovarë jashtë ekonomisë së Kosovës janë kryesisht investime kapitale, të cilat në të shumtën e rasteve lidhen me blerjen e patundshmërive (BQK, 2014).

Si rezultat i krizës globale financiare, IHD-të në raport me PBB-në kanë shënuar rënie të vazhdueshme që nga viti 2008, ndërkohë që në vitin 2013 është shënuar përmirësim i këtij treguesi nga 4.7 % në 5.0 % të PBB-së. Rritja e IHD-ve paraqet një zhvillim shumë të rëndësishëm edhe në kuptimin e qëndrueshmërisë së financimit të defiçitit të llogarisë rrjedhëse.

Në kuadër të IHD-ve, rritje ka shënuar kategoria e kredive ndërmjet ndërmarrjeve dhe fitimi i riinvestuar (64.4, përkatësisht 26.0 milionë euro më shumë se sa në vitin 2012), ndërsa kapitali aksionar ishte për 60.4 milionë euro më i ulët sesa ai i vitit 2012.

IHD-të në patundshmëri kanë shtuar dominimin në strukturën e gjithsej IHD-ve edhe gjatë vitit 2013. Me rritje janë karakterizuar edhe sektori i transportit dhe i telekomunikacionit, i shërbimeve financiare, energjetikës dhe tregtisë, ndërsa IHD-të në sektorin e ndërtimtarisë dhe prodhimit kanë shënuar rënie në strukturë. Sa i përket origjinës së IHD-ve, Turqia paraqet vendin prej nga vjen pjesa më e madhe e IHD-ve (33.6 %), pasuar nga Zvicra (16.1 %), Gjermania (8.4 %), Shqipëria (7.9 %) etj. Përderisa investimet nga Turqia kanë shënuar rritje

prej 32.3 % gjatë vitit 2013, investimet nga Gjermania dhe Zvicra kanë shënuar rënie për 56.2, përkatësisht 4.8%.

Gjithashtu, vlen të theksohet se investimet nga Shqipëria janë trefishuar në vitin 2013, krahasuar me vitin 2012.

4.6. Raporti i investime të huaja direkte dhe remitencave në Kosovë

Lidhur me Investimet e Huaja Direkte në Kosovë dhe raportin apo peshën që zë vlera e remitencave tek Investimet e Huaja Direkte, në vazhdim do të bëjmë një përmbledhje. Të dy këta indikatorë, mund të thuhet se janë flukse hyrëse të bilancit të pagesave dhe janë dy tregues shumë të rëndësishëm për rritjen ekonomike të vendit në fjalë. Investimet e huaja direkte, përfshijnë investimet e individëve dhe institucioneve të huaja në ekonominë vendase, nëse investimi e bën investitorin pronar të më shumë se 10 % të kapitalit të një ndërmarrje.

Gjatë viteve në Kosovë vlera e Investimeve të Huaja Direkte ka vazhduar duke u ulur ndër vite. Duke filluar nga viti 2008, ku vlera e investimeve ishte 366 milionë euro, ka pësuar rënie në 259 milionë euro, shifër kjo e shënuar në vitin 2013.

Në vazhdim, po i paraqesim në tabelë këto të dhëna:


Tabela 31. Investimet e Huaja Direkte në Kosovë në vitet 2008 - 2013

Vlera në milionë euro

Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Kosovë	366.45	287.41	365.80	393.86	228.64	259.02

Burimi: Banka Qendrore e Kosovës 2014

Grafiku 28. Investimet e huaja direkte në Kosovë gjatë viteve 2008 - 2013



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës 2014


Përmes metodës së trendit, zbulohen tendencat e ecurisë dhe zhvillimit të dukurisë në një periudhë të caktuar kohore. Kjo arrihet duke i përcjellur ndryshimet sasiore dhe cilësore gjatë periudhës zhvillimore të dukurisë (2008 -2013). Përmes aplikimit të metodave dinamike tentohet të eliminohet apo të zbuten ndryshimet a variacionet që luhaten në afate të gjatë. Prej të gjitha metodave të analizës dinamike, më e përshtatshmja është metoda e trendit. Pra, shpreh nivelin mesatar të ecurisë së dukurisë në periudhë të gjatë kohore.

Përmes aplikimit të trendit, fitohen seri me të dhëna të reja të rregulluara nga seria faktike. Kur të dhënat e rregulluara nxirren në mes të serisë me të dhëna origjinale, themi se bëhet procesi i interpolimit, ndërsa me veprimin e kalimit nga të dhënat origjinale në parashikimin e tendencës së ecurisë dhe zhvillimit të dukurisë me të dhëna të rregulluara, atë veprim e quajmë **ekstrapolim** të trendit. Ndaj në bazë të ekstrapolimit bëhet edhe parashikimi apo prognozomi i tendencës së dukurisë, e cila nuk posedon të dhëna origjinale (Nimani 227: 2012). Në vijim paraqiten të dhënat e analizuara përmes metodës së trendit limeare ($Y_c + Y_i$) dhe funksionit të tij $Y_c = a + bx$

Tabela 32. Llogaritja e Trendit Lineare IHD në Kosovë në vitet 2008 -2013. Vlera në milionë euro

Viti	Të dhënat (IHD) y_i	Shenjat e periudhës x_i	$x \cdot y$	x_i^2	yc
2008	366.45	-2.50	6.25	-916.125	376.67
2009	287.41	-1.50	2.25	-431.115	352.75
2010	365.8	-0.50	0.25	-182.9	328.82
2011	393.86	0.50	0.25	196.93	304.90
2012	228.64	1.50	2.25	342.96	280.98
2013	259.02	2.50	6.25	571.6	257.06
	1901.18		17.5	-418.65	1901.18

Grafiku 29. Investimet e huaja direkte në Kosovë në vitet 2008 - 2013. Paraqitje në diagram




Burimi: Banka Qendrore e Kosovës 2014

Investimet e Huaja Direkte në Kosovë nuk janë në nivel të kënaqshëm, kryesisht sepse Kosova nuk vlerësohet si mjedis i sigurt për të investuar. Kosova është vendi me shkallën më të ulët të investimeve të huaja direkte në Europë.

Rrjedhimisht pa investime nuk ka as transferim të dijes e teknologjisë moderne, nuk ka kapital të freskët, vende të reja të punës e prodhim vendor.

Tabela 33. Remitanca në Kosovë në vitet 2008 - 2013*Vlera në milionë euro*

Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Kosove	608.72	585.70	584.33	584.81	605.63	620.83

Grafiku 30. Paraqitja grafike e Remitencave në Kosovë 2008 - 2013**Tabela 34. Llogaritja e trendit linear, remitenca në Kosovë në vitet 2008 -2013. Vlera në milionë euro**


Viti	Të dhënat Remitencat y_i	Shenjat e periudhës x_i	$x * y$	x_i^2	Y_c
2008	608.72	-2.50	6.25	-1521.8	595.14
2009	585.7	-1.50	2.25	-878.55	596.42
2010	584.33	-0.50	0.25	-292.165	597.70
2011	584.81	0.50	0.25	292.405	598.98
2012	605.63	1.50	2.25	908.445	600.26
2013	620.83	2.50	6.25	1514.075	601.54
	3590.02		17.5	22.41	3590.02

Burimi: Autori

Përmes Analizës dinamike, konkretisht metodës së trendit, vërejmë se në vitin 2008 pati 18.1 % rritje në remitenca në krahasim me vitin 2007, në vitin 2009 kishim rënie prej 3.8 % të remitencave në krahasim me vitin 2008, në vitin 2010 ka pasur rënie prej rreth 0.24 % në krahasim me vitin 2009. Kjo është periudha kur në vendet e zhvilluara vazhdonte kriza

ekonomike, e cila pati dhe vazhdon të ketë ndikim edhe sot në vlerën e remitencave që dërgohen në vend. Në vitin 2011 pati rritje shumë të lehtë të remitencave të dërguara në krahasim me vitin 2010, trendet rritesë janë edhe për vitin 2012. Gjatë këtij viti, shuma e remitencave të dërguara u rrit për 3.6 % krahasuar me një vit më parë. Të gjithë këto të dhëna, më së miri mund të vërehen edhe nga grafiku i lartëshënuar dhe në tabelën përkatëse, ku është paraqitur ecuria e remitencave që nga viti 2008 e deri në vitin 2013

Grafiku 31. Diagrami i pranimi të remitencave gjatë viteve 2008 - 2013



Pra, mund të themi se në këto gjashtë vitet e fundit, vlera e IHD-ve në Kosovë është reduktuar për 29 %. Analiza që krahason se si pozicionohen remitencat kundrejt IHD-ve, nxjerr në pah rolin e secilit indikator dhe të dyve së bashku në ekonominë e brendshme. Për Kosovën, kjo situatë paraqitet në favor të remitencave. Kjo tregon një opcion jo fort interesant të tërheqjes së investimeve të huaja në vend, dhe shfaq shenja të një ekonomie ku niveli i jetesës dhe konsumi janë të lidhura ngushtë me kontributin e diasporës si një kategori e rëndësishme në jetën ekonomike të vendit.

4.7. Raporti i investimeve të huaja direkte sipas sektorëve ekonomikë

Investimet e huaja direkte janë një burim shumë i rëndësishëm i flukseve të kapitalit dhe zhvillimit të ekonomisë. Pjesën më të madhe të IHD-ve në Kosovë në vitin 2013 e përbënin sektori i patundshmërisë (35%), i ndjekur nga ndërtimi (15%), transporti dhe

telekomunikacioni (14%), shërbimet financiare (11%), energjetika (8%), prodhimi (7%) etj. Ndër vite, situata në Kosovë ka ndryshuar. Në vitin 2007, peshën kryesore e zinin IHD-të në sektorin e transportit dhe të telekomunikacionit. Gjatë këtij viti janë investuar 129.24 milionë euro në këtë sektor, nga gjithsej 440.74 milionë euro Investime të Huaja Direkte. Sektorë të tjerë të rëndësishëm gjatë këtij viti kanë qenë edhe shërbimet financiare, me mbi 100 milionë lekë të investuara. Në Kosovë, gjatë periudhës 2008 - 2011, investimet e huaja kanë mbajtur një nivel të ngjashëm prej mesatarisht 8.3 për qind të brutoproduktit të brendshëm. Ndërkaq, në vitet 2010 - 2011, vlera e këtyre investimeve filloi të rritet përsëri, megjithëse me një ritëm të ngadalshëm. Në harkun kohor të viteve 2008 - 2013, IHD për Republikën e Kosovës thuhet të jenë mesatarisht 317 milionë euro. Ndërkohë, trendi u përkeqësua dukshëm në vitin 2012, duke arritur në vetëm 5 për qind të GDP-së. Në vitet 2008 dhe 2009 situata ndryshon në favor të sektorit të shërbimeve financiare të cilat përbënin përkatësisht 35 % dhe 25 % të investimeve të huaja direkte në total. Në vitet 2010 dhe 2011 merr përparësi sektori i ndërtimit. Në këtë fushë janë investuar përkatësisht 91.06 dhe 134.97 milionë euro. Në dy vitet e fundit kryeson sektori i patundshmërisë.

Gjatë vitit 2012 vlera e Investimeve të Huaja Direkte për këtë sektor shënon një vlerë prej 72.57 milionë euro ose 32 % të totalit të IHD-ve në këtë vitin 2013.


4.7.1. Investimet e Huaja Direkte në Kosovë sipas sektorëve ekonomikë në vitet e krizës

Investimet e huaja direkte, janë një tregues i rëndësishëm i besimit të investitorëve të huaj në një vend. Ato ulen në kushtet e krizave ekonomike dhe politike, rriten në kushtet e përmirësimit të ambientit ekonomik dhe politik. Në harkun kohor ndërmjet viteve 2007 – 2013, Investimet e Huja Direkte në Kosovë kanë shënuar tkurrje. Krahësuar me vitet e mëparshme, në vitin 2013, pesha e IHD-ve në sektorët e industrisë përpunuese dhe shërbimeve sanitare është ulur ndjeshëm, ndërsa pesha e sektorëve të energjetikës dhe ndërtimit është rritur.

Tabela 35. Investimet e Huaja Direkte në Kosovë sipas sektorëve ekonomikë gjatë viteve 2007 – 2013 Vlera në milionë euro

Grafiku 32. Investimet e huaja direkte në Kosovë sipas sektorëve ekonomikë 2013

Përshkrimi	2007	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Shërbime financiare	101.96	128.01	73.21	71.17	35.11	23.79	28.59
Prodhimi	39.67	21.99	49.19	72.31	50.50	27.63	17.78
Patundshmëria	30.85	61.59	42.71	48.86	64.23	72.57	91.73
Transporti dhe telekomunikacioni	129.24	50.49	21.32	14.57	24.52	18.11	36.84
Energjetika	2.47	16.53	8.46	0.42	0.03	3.07	19.81
Minierat	41.54	17.23	6.81	10.03	2.95	10.47	2.28
Ndërtimi	5.18	13.42	34.54	91.06	134.97	47.47	39.19
Industria përpunuese	35.14	31.27	6.81	25.08	1.93	1.01	0.05
Bujqësia	7.93	8.43	12.72	2.31	0.35	0.16	0.36
Shërbime tregtare, pastrimi, mbledhja	12.70	10.04	15.72	11.96	8.19	8.25	15.96
këshillimi, operimi, hulumtimi	4.50	2.04	2.61	8.50	7.76	3.72	1.89
Shërbimet sanitare	12.67	2.04	2.34	2.56	0.13	0.74	0.25
Të tjera	16.89	3.37	10.97	6.98	63.17	11.65	4.29
TOTAL	440.74	366.45	287.41	365.80	393.86	228.64	259.02
Burimi: BQK, 2014							



Burimi: Banka Qendrore e Kosovës, Raport 2014

4.7. Masat shtrënguese në ekonomi

Një nga problemet më të rëndësishme me të cilët po përballlet ekonomia e Kosovës është mungesa e masave adekuate për mbrojtjen e ekonomisë nga ekonomia jo formale dhe problemet e shumta të cilat ende janë të pazgjidhura. Po ashtu mungojnë masat për mbrojtjen e prodhuesve vendorë nga prodhuesit e jashtëm, të cilët paraqesin konkurrencë të padrejtë në treg. Gjithashtu, probleme kemi edhe në administratën tatimore, me mashtrimet të cilat i bëjnë bizneset dhe me mungesën e masave ndëshkuese nga ana e ATK-së për këto biznese, të cilat bëjnë evazion fiskal apo mashtrime të tjera gjatë deklarimeve. Ekziston dallimi midis shmangies së tatimit dhe evazionit tatimor. Shmangia tatimore, të cilën John Maynard Keynes e ka quajtur dikur “i vetmi aktivitet intelektual që sjell ndonjë shpërblim” është ndryshimi nga i sjelljes në mënyrë të tillë, që të ulni detyrimin tatimor. Nuk ka asgjë ilegale rreth shmangies tatimore (Harvey, 2010:379). Evazoni tatimor është mospagim i detyrimeve tatimore që rrjedhin nga ligji. Evazoni tatimor nuk është problem i ri. Shekuj më parë, Platoni vuri re: “Kur ekziston një tatim mbi të ardhurat, njeriu i drejtë do të paguajë më shumë, dhe ai jo i drejtë do të paguajë më pak për të njëjtën shumë të ardhurash.”

Njerëzit bëjnë mashtrime tatimore në lloj - lloj mënyrash:

- Mbajnë dy libra rregjistrimi të transaksioneve të biznesit (dy bilance)
- Njëri rregjistron biznesin e vërtetë dhe tjetri i paraqitet organeve tatimore
- Disa evazues përdorin dy rregjistra arke
- Bëjnë një punë të dytë kundrejt të ardhurave me para në dorë

Sigurisht, të punosh një punë shtesë është plotësisht e ligjshme. Megjithatë, e ardhura e marrë nga një punë e tillë, shpesh paguhet me para në dorë dhe jo me çek. Kështu që, nuk ekziston asnjë regjistrim ligjor dhe të ardhurat nuk u raportohen organeve tatimore.

Ekzistojnë dhe shumë e shumë mënyra të tjera të evazionit tatimor të cilat shpeshherë është shumë vështirë të luftohen dhe të ndalohen.

Ngushtimi i hapësirës për evazionin fiskal dhe zhdukja e tij do të bëhej me efikasitet përmes eliminimit në masë sa më të madhe të ekonomisë joformale dhe futjen e saj në rrjedha legale, mbrojtjen e administratës tatimore nga ndikimet dhe kërcënimet e jashtme, mbulimin e kufijve doganorë dhe zbatimin e preferencave të njëjta doganore ndaj fqinjëve. Lufta kundër evazionit fiskal meriton të jetë në epiqendër të ndërtimit të politikës fiskale, sepse ashtu do të mbrohen kushtet për një ekonomi të tregut dhe për barazi në treg, si themele të një ekonomie të qëndrueshme dhe stabile.

Qeveria e Kosovës kishte bërë disa ndryshime në uljen e shkallëve tatimore, me qëllim të stimulimit të bizneseve dhe që këto biznese të akumulojnë më shumë fitim, në mënyrë që të parandalohet edhe evazoni fiskal. Sa më e lartë që të jetë norma tatimore, bizneset janë më të prira për të bërë evazion fiskal. Rritja e normës së TVSH-së nga 15 % në 16 %, ishte ngritje që preku qytetarët pasi kjo ngritje e TVSH-së nuk e ngarkon fitimin e kompanisë, por i ngarkon apo i godet konsumatorët sepse është tatim indirekt. Edhe pse Tvsh-ja është tatim indirekt, prapë bizneset bëjnë ikjen e pagimit të këtij tatimi. Me masat e shumta që duhet të merren në ekonomi, duhet të luftohet edhe korrupsioni që paraqitet si kategori e dëmshme për zhvillimin ekonomik. Mbështetja e Kosovës në taksat indirekte është në pajtim me natyrën e ekonomisë që mbështetet rëndë në importet dhe transfertat.

Të ardhurat e qeverisë priren të mbështeten thellë në drejtim të taksave indirekte, me më tepër se 80 për qind të prurjeve që vijnë nga TVSH-ja, akcizat dhe taksat doganore. Struktura e të ardhurave është e drejtuar mirë me natyrën e ekonomisë së Kosovës, me një pjesë të importeve, GDP -në prej rreth 60 për qind, një defiçit tregtar prej afërsisht 40 për qind dhe dërgesat e rregjistruara prej rreth 14 % të GDP-së, më të mëdhatë në Ballkanin Perëndimor. Një pjesë e madhe e taksave indirekte vilet në kufi, që është provuar se është mjaft efektiv për sa i përket të ardhurave. Vjelja e të ardhurave në dogana kontribuon në 80 për qind të të ardhurave tatimore totale, konkretisht të gjitha akcizat dhe $\frac{3}{4}$ e TVSh-së. Kjo bën që, vjelja e taksave të

jetë mjaft produktive dhe të pakësojë rrezikun e evazionit. Vjelja e TVSh-së pritet të forcohet, çdo gjë tjetër është e barabartë në ekonominë me një mbështetje më të madhe në tregtinë ndërkombëtare. Produktiviteti i TVSh-së në Kosovë, i matur nga efienca-c, është mbi mesataren si të rajonit ashtu dhe modelit të ekonomive të vogla të hapura (përfshirë një model të 31 vendeve me popullsi nën 5 milion dhe një sistem TVSh-je).

Struktura e të ardhurave të Kosovës është e prirur shumë ndaj taksave indirekte, dhe në veçanti ende mbështetet mjaft në detyrimet doganore. Evidenca empirike sugjeron se zëvendësimi i të ardhurave tatimore tregtare të humbura mund të jetë i vështirë.

Opsionet afatshkurtra përfshijnë forcimin e mëtejshëm të TVSh-së dhe taksës së akcizës. Humbjet në të ardhurat nga detyrimet doganore, të cilat marrëveshjet e tregtisë së lirë ka të ngjarë t'i shkaktojnë gradualisht, mund të zëvendësohen nga TVSh dhe akcizat, të dyja taksat ende do të mbeten në norma relativisht të ulëta në Kosovë. Ndërkohë që zgjerimi i bazës tatimore është i dëshirueshëm, ulja e pragut të regjistrimit të TVSh-së do të konsiderohet sapo administrata tatimore të ketë ndërtuar kapacitetin e nevojshëm për të shmangur krijimin e barrës së panevojshme, pa fitime të qarta nga pikëpamja e të ardhurave.

Një kalim gradual drejt taksimit direkt duket se është i nevojshëm në një afat të mesëm e të gjatë, me rritjen e prodhimit vendas. Një pjesë më e madhe e taksave direkte është e dëshirueshme, po të kemi parasysh nevojën për zëvendësimin e humbjes potenciale nga taksat tregtare, dhe potencialisht në përputhje me kalimin gradual të strukturës së ekonomisë drejt prodhimit më të madh vendas. Struktura e normave tatimore mund të rishikohet, si për normat e taksave mbi të ardhurat korporative dhe ato personale të cilat janë të ulëta në krahasim me standardet rajonale, krahas progresivitetit në strukturën e taksave mbi të ardhurat personale. Zgjerimi i bazës tatimore, duke shmangur përjashtimet e panevojshme të taksave është e domosdoshme (shih FMN, 2011). Përmirësimi i mëtejshëm i sistemit të taksave mbi pronën është një domosdoshmëri veçanërisht në kontekstin e rritjes së decentralizimit, i cili mund të rezultojë i penguar në rast se qeveritë lokale nuk janë efektive në forcimin e administrimit dhe në kapacitetin e pajtueshmërisë. Vendosja e arkave fiskale ka qenë shumë e nevojshme për luftimin e ekonomisë joformale dhe dukurive negative në ekonomi. Ky projekt ka hasur në shumë pengesa dhe vështirësi të shumta, së pari financiare për arsye të çmimit të lartë për vendosjen e këtyre arkave, dhe si pasojë e kësaj ka hasur në vështirësi nga mosgatishmëria e tatimpaguesve për paisjen me këto arka. Por, pajisja me arka nuk ka arritur rezultatet e pritura.

Shumica e qytetarëve nuk i japin rëndësi kuponit fiskal dhe kjo iu ndihmon bizneseve, sepse ata vazhdojnë me mosdeklarim korrekt të transaksioneve të ndryshme që ndodhin.

Shumë biznese ende janë të papajisura me arka fiskale. Kjo vërehet më shumë në zonat rurale. Arsyeja se pse ndodh kjo është se atje nuk kanë ndonjë kontroll të rregullt nga ATK-ja dhe padyshim që çmimi i lartë për t'u pajisur me arka fiskale është një nga faktorët që ka ndikuar te mospajisja e bizneseve me arka fiskale.

Aplikimi i arkave fiskale në harmoni me Ligjin mbi TVSh-në paraqet mburojë kundër ekonomisë joformale. Në vazhdimësi të aktiviteteve, OEK-u me përkrahjen e Komunitetit të Biznesit dhe Administratës Tatimore të Kosovës, është duke organizuar kohëve të fundit, takime që kanë për qëllim sensibilizimin dhe implementimin e Ligjit mbi TVSh-në. Futja në funksion e arkave fiskale, ka mundësuar efektin e plotë të ligjit mbi TVSh-në, pra implementimi i tij nuk kishte për të pasur efektin e vet të plotë sikur të mos kishte ndodhur edhe futja në funksion e arkave fiskale. Aplikimi i arkave fiskale ka qenë i domosdoshëm për luftimin e ekonomisë joformale dhe shumë dukurive të tjera negative që kanë qenë dhe ende janë të pranishme në ekonominë kosovare. Është mirë që të punohet rreth vetëdijësimit të qytetarëve për marrjen e kuponit fiskal gjatë çdo blerjeje, sepse në çdo blerje kalkullohet edhe pagesa e TVSh-së prej 16 %. Që të gjitha këto mjete financiare derdhen në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës, dhe deri tani kontribuesi më i madhe i të hyrave në Buxhetin e Konsoliduar të Kosovës është pikërisht TVSh-ja. Sistemi doganor i Kosovës dhe institucionet e tjera, u përballën me problemet e krizës, pasi ata janë të parët që takojnë bizneset e ardhura nga jashtë. Doganat janë institucion i grumbullimit të të hyrave (taksave dhe tarifave), që me rastin e hyrjes së tyre në regjionin doganor të një vendi apo të një rajoni të caktuar, në formë të parasë arkëtohen në mallra.

4.8. Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës³⁰

Në kuadër të institucioneve financiare kontraktuese përfshihen edhe fondet e pensioneve. Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës është institucion i themeluar në gusht të vitit 2002

³⁰Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës (FKPK) është institucion publik i pavarur dhe joprotitabil, i themeluar nga Kuvendi i Republikës së Kosovës. FKPK është krijuar sipas modelit të kontributeve pensionale të definuara, që nënkupton se secili kontribues kursen për pension në një llogari personale. FKPK është institucion i themeluar në dhjetor të vitit 2001 dhe ka filluar aktivitetin në gusht të vitit 2002 për të administruar dhe

për të administruar dhe menaxhuar kontributet e obligueshme pensionale (dhe vullnetare) të të punësuarve në Kosovë.

Trusti është i angazhuar kryekëput për mbajtjen e kontributeve pensionale të kursyera nga qytetarët e Kosovës gjatë marrëdhënies së punës, të cilat ruhen nëpër llogari individuale të kontribuesve. Administrimi i këtyre llogarive individuale është përgjegjësi ligjore e Trusti-t, përderisa paratë mbesin pronë vetanake e kontribuesve. Edhe pse pronë private, mandati i këtyre kursimeve është specifik. Ato fonde mund të përdoren vetëm pas pensionimit.

Investimet bëhen në mënyrë që kursimtarët kosovarë, në afate të gjata të kenë rritje sa më të madhe të vlerës së llogarisë, ashtu që t'iu sigurohet një pension sa më i mirë. Investimet e Trusti-t janë të bëra në klasat e aseteve, në tregjet botërore dhe industri nga më të ndryshmet, në mënyrë që të shpërndahet dhe kështu të zvogëlohet rreziku i mundshëm nga investimet. Ligji nr. 03/L-084 për Fondin Pensional, i cili e ndryshon Rregulloren nr. 2005/20 për Pensionet në Kosovë, duke i dhënë Trusti-t kompetencat dhe të drejtat e administruesit të besuar për fondet pensionale (Neni 6.1), i përcakton atij përgjegjësitë dhe të drejtat e mëposhtme (Neni 6.2) : Udhëheqjen e tenderëve për përzgjedhjen e menaxhuesve të mjeteve, kujdestarin e mjeteve dhe instrumenteve për investime të hapura në pajtim me këtë Ligj; Zbatimin e marrëveshjeve me menaxhuesit e mjeteve, kujdestarinë, instrumentet për investime të hapura, llogaritarët, revizorët, avokatët dhe ofruesit e tjerë të shërbimeve; Kërkimin dhe pranimin e informatave nga menaxhuesit e mjeteve, instrumentet për investime të hapura, kujdestarin e mjeteve dhe të ofruesit të shërbimeve për të gjitha transaksionet në emër të Fondit, duke përfshirë edhe votimin e aksioneve që mban Fondi; Miratimin e parimeve për investime të Fondit; Shkarkimin dhe zëvendësimin e menaxhuesve të mjeteve, instrumenteve për investime të hapura, kujdestarin e mjeteve dhe ofruesve të tjerë të shërbimeve për Fondin; Transferimin e bilancit të llogarive individuale, përfshirë këtu kthimin nga investimet, për pensionet e kursyera tek ofruesit e anuiteteve, me qëllim të blerjes së pensioneve për pjesëmarrësit që pensionohen në përputhje me këtë Ligj; Lidhjen e marrëveshjeve për blerjen,

menaxhuar kontributet e obligueshme pensionale (dhe vullnetare) të të punësuarve në Kosovë. Aktivitetin e përgjithshëm të FKPK-së e rregullon Kuvendi i Kosovës, ndërsa e mbikqyr Banka Qendrore e Kosovës (BQK). FKPK është e angazhuar kryekëput për mbajtjen dhe investimin e kontributeve pensionale të kursyera nga qytetarët e Kosovës gjatë marrëdhënies së punës.

shitjen, dhënie ose marrjen me qira të patundshmërive ose pajisjeve të nevojshme për funksionimin e Fondit; Punësimin e personelit ekzekutiv dhe joekzekutiv të Fondit; Lidhjen e marrëveshjeve të sigurimeve, duke përfshirë edhe sigurimin fiduciar për kompensimin e këshillit drejtues, me kompanitë e sigurimeve të licencuara në Kosovë ose në shtetet anëtare të Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik; Përgatitjen e buxhetit të cilin e miraton Bordi Udhëheqës; Caktimin e tarifave të arsyeshme të bazuara në shpenzime të çdo pjesëmarrësi për administrimin e llogarive individuale në pajtim me orarin të cilin e përcakton Kuvendi dhe ndaljen e shumave të tilla nga kontributet e marra para derdhjes së tyre në llogaritë individuale.

Kur theksojmë Trustin, duhet po ashtu të theksojmë planin pensional, fond i cili krijohet për pagimin e përfitimeve pensionale. Pra, është një shoqëri, një kompani financiare e cila grumbullon kontribute me pagesa javore ose mujore nga individë a subjekte biznesi, nga të cilat do të paguhen pensionet e tyre apo të punëtorëve të tyre (Merovci, 2008:45).

Entitetet të cilat krijojnë plane pensionale që shumë shpesh quhen sponsorë të planit, janë:

- a) entitetet nga biznesi private që veprojnë për punonjësit e tyre
- b) entitetet shtetërore (nivel qendror dhe lokal) që veprojnë në emër të punonjësve të tyre
- c) unione, në emër të anëtarëve të tyre, dhe individë që japin kontribute për benificione pensionale (Merovci, 2008:78)

4.8.1. Sistemet pensionale në Kosovë

Ekzistojnë dy lloje kryesore të sistemeve pensionale: ai i bazuar në transferën (PAYG) dhe sistemi i bazuar në investime ose i definuar. Sistemi pensional i bazuar në transferën (njihet si PAYG - Pay As You Go)³¹ është program shtetëror që financohet nga tatimet ose kontributet

³¹“Paguaj aq sa shkoni!” (PAYG). Ky është një sistem për bizneset dhe individët për të paguar kështet e detyrimit të tij tatimor, të pritshëm të të ardhurave të tyre nga punësimi, biznesi apo investimet për vitin e të ardhurave aktuale. Kur përdoret si një mbiemër, ai është shkruar shpesh në formën “pay-as-you-go”

që mblidhen nga popullata. Sipas kësaj skeme, punëtorët financojnë pensionistët. Në Kosovë sistemi i transferës është eliminuar. Të hyrat e përgjithshme të Buxhetit të Kosovës financojnë pensionin bazë (ËB, 2010). Për të financuar këtë nuk janë fuqizuar ndalesa të tjera në të ardhura; prioritet i strategjisë ka qenë që të mbahen tatimet dhe ndalesat në paga të ulëta, në mënyrë që punëtorët kosovarë të jenë konkures në rajon si dhe të mos nxitet fshehja në ekonominë gri.

4.8.2. Kriza financiare globale dhe TRUSTI

Shqetësimi më i madh i publikut në përgjithësi, që mori koncentrimin më të madh të mediave, është Trusti Pensional dhe aksionet e tyre. Pasi Trusti një pjesë të fondeve i ka investuar në tregun ndërkombëtar, aksionet e tyre kanë pasur ndikim nga kjo krizë. Sidoqoftë, fakti që aksionet e tyre kanë pasuar rënie në vlerë, nuk do të thotë se Trusti ka pasur humbje, meqë ata nuk i kanë shitur këto aksione, për këtë arsye nuk ka nevojë për panik (ËB, 2010). Vetëm 5 % e aksioneve janë të investuara, ndërsa pjesa tjetër është në qarkullim.

Krahasuar me institucionet regjionale ndërkombëtare të kursimeve pensionale, Trusti Kosovar është në nivelin e njëjtë negativ (diku në mes të Austrisë me vetëm 5 % humbje negative të investimeve, dhe Irlandës me 20 % humbje në investime). Në pyetjen se pse Trusti nuk ka investuar në Kosovë, vjen përgjigja: “Kosova ofron vetëm depozita të investimeve, përderisa tregjet ndërkombëtare ofrojnë më shumë mundësi investimi, dhe kjo s’do të thotë se investimi në tregun kombëtar është i sigurt, p.sh.: Kroacia 80 % të investimeve i ka në tregun lokal por megjithatë ka një përqindje mjaft të lartë të investimeve negative” (Trust, 2012).

Koncepti “i investuar” i referohet secilit program në të cilin kontributet mblidhen dhe vendosen në llogari individuale përgjatë periudhës që individët kontribuojnë, e më pas investohen në tregje të kapitalit për të siguruar të ardhura në të ardhmen. Kështu tentohet që mjeteve t’u rritet sa më shumë vlera, deri në kohën kur kontribuesit të pensionohen. Dallimi kryesor, mes sistemit tipik të bazuar në transferë dhe sistemit të investuar, është se paratë e grumbulluara në sistemin e investuar kursehen dhe investohen e nuk shpenzohen menjëherë. Paratë e mbledhura tek sistemi i investuar janë plotësisht të ndara nga buxheti shtetëror. Ky sistem është më transparent ndaj pjesëmarrësve, pasi lejon definimin e qartë të të drejtave të

pronësisë mbi kontributet dhe të akumuluarat (TRUST, 2013). Kur pjesëmarrësit pensionohen, pensioni i tyre do të varet nga kontributet që ata i kanë bërë në llogarinë e tyre si dhe nga kthimi në investim. Në Kosovë, sistemi i tillë përfaqësohet nga Llogaritë Individuale të Kursimeve Pensionale që mirëmbahen nga Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës.

Sipas Ligjit në fuqi mbi pensionet, Trusti-t nuk i është lënë mundësia të bëjë vetë investime në tregjet financiare. Për këtë arsye, Trusti patjetër duhet të angazhojë menaxhues të mjeteve për të ndërmarrë investime. Këta menaxhues mjetesish janë ndërmarrje të specializuara të cilat merren me investimin e mjeteve në tregjet financiare. Ato kanë një produkt financiar në formën e fondit investues i cili duhet t'i përmbushë kriteret e përcaktuara nga Bordi Udhëheqës i Trusti-t për fondin investues (TRUST, 2013).

Bordi si minimum kërkon që fondi investues i menaxhuesit të mjeteve të jetë i mirëdiversifikuar, që menaxhuesi i mjeteve të ketë përvojë të mjaftueshme dhe performancë të kënaqshme si menaxhues i mjeteve, që fondi investues të jetë në instrumente financiare të lejuara me ligjin mbi pensionet, që fondi ta përmbushë raportin rrezik/kthim si dhe fondi investues të jetë i regjistruar e i listuar në bursat e shteteve anëtare të OECD-së.

Këto fonde investuese të menaxhuesve të mjeteve në të cilat anëtarësohet Trusti në vetvete janë shumë mirë të diversifikuara. Sipas financierëve, në mënyrë që një produkt financiar të jetë mirë i diversifikuar, duhet të përmbajë së paku 30 plasmane të ndryshme përbrenda fondit. Si shembull, investimet e Trusti-t në Vanguard Global Index Fund nuk janë investime në kompaninë Vanguard, por investime përmes menaxhuesit të mjeteve Vanguard. Ndërkohë që ky fond investues mban pozicione, domethënë i investon mjetet e Trusti-t në më shumë se 1,600 kompani botërore.

Pra, mjetet janë shumë mirë të shpërndara. Ato kështu minimizojnë rrezikun që do të kishte investimi në një kompani të vetme. Për më tepër, këto fonde investuese në të cilat është anëtarësuar Trusti, kryesisht nuk kanë datë maturimi (ose përfundimi), por janë të ashtuquajtura Instrumente me Investime të Hapura (Open-end vehicles), që do të thotë se ato mund të mbahen nga Trusti për aq kohë sa ai fond investues ekziston. Si të tilla, ato edhe janë instrumente shumë likuide, ku premtohet që në afat prej 1 - 30 ditësh të tërhiqet i gjithë investimi i Trusti-t në to (TRUST, 2014). Depozitat bankare të Trusti-t në dy bankat që veprojnë në Kosovë, NLB Prishtina dhe Raiffeisen Bank, janë plasmane direkte e jo përmes

menaxhuesve të mjeteve, sepse janë depozitim dhe nuk klasifikohen si investime në kuptimin e mirëfilltë të fjalës. Ajo në Raiffeisen përmban datë maturimi dhe, edhe pse likuid, likuidimi i tij para afatit të paraparë nënkupton ndëshkime nga banka kundrejt mjeteve të investuara nga Trusti. Në anën tjetër, depozitimi në NLB Prishtina nuk ka datë maturimi por ka periudhë njoftimi prej 30 ditësh, ndërkohë që Bordi Udhëheqës nuk planifikon t'i tërheqë ato në të ardhmen e afërt (TRUST, 2012). Tregjet financiare në të cilat investon Trusti duhet të jenë tregje me rregullativa dhe mbikqyrje të mirë, ndërkaq klasat e aseteve në të cilat investon Trusti janë: aksionet e korporatave botërore; fletëobligacionet (Bonot) qeveritare dhe të korporatave botërore; borxhet e korporatave si dhe tregjet e parasë së gatshme ose kredidhënia afatshkurtër.

4.8.3. Performanca e instrumenteve të TRUSTI-t

Shumica e instrumenteve përmes të cilave investon Trusti, më saktësisht 6 nga 9 të tilla, kishin performancë pozitive të kthimit në investime në vitin 2011. Janë Vanguard GSIF, Schroders ISF SB dhe ECM-DEC, tre instrumentet që kishin performancë negative. Krizat dhe ngjarjet negative në tregjet financiare kanë ndikuar në forma të ndryshme në investimet e Trusti-t. Tregu i aksioneve preket më së shumti nga krizat, ashtu sikurse është sektori me rritjen më të madhe gjatë periudhave. Kjo reflektohet në performancën e Vanguard GSIF, i cili u prek më së shumti me - 6.09 % kthim në investime. Vanguard GSIF investon në rreth 1,600 korporatat më të mëdha të botës së zhvilluar, dhe bashkë me mundësitë që sjell globalizimi rritet edhe ndjeshmëria e korporatave ndaj krizave, qofshin ato edhe në një pjesë të globit. Në vitin 2012, FKPK-ja kishte një kthim neto nga investimet prej 7.96 % Krahësuar me vendet e rajonit, kjo performancë e investimeve ishte më e mirë se sa performanca investuese mesatare e fondeve pensionale në Rumani prej 6.71 % dhe se sa mesatarja investuese e fondeve pensionale në Bullgari 7.39 % (TRUST, 2012).

4.9. Performanca e menaxhuesve të mjeteve dhe investimet e Trustit gjatë krizës

Bordi Udhëheqës ishte aktiv gjatë vitit 2010 në fushën e investimeve. U plasuan 39 milionë euro shtesë në Vanguard GSIF, neto 70.5 milionë euro në Fortis GLF, dhe po ashtu u zgjeruan

investimet në një fond investues shtesë, përkatësisht AXA GILB, ku u investuan 45 milionë euro. Në tregun vendor, Bordi ka riafatizuar mjetet e maturuara me Raiffeisen Bank duke shtuar edhe 7 milionë euro të tjera, si dhe ka depozituar për herë të parë në Bankën kosovare NLB Prishtina, duke plasuar aty gjithsej 15 milionë euro.

Në anën tjetër, nuk është vazhduar afatizimi prej 5 milionë eurove në ProCredit Bank, mjete të cilat janë tërhequr me një fitim neto të realizuar prej 539,626 euro për dy vjet. Gjatë vitit 2010 pesë menaxhues mjetesh ndërkombëtarë janë kujdesur për shpërndarjen e investimeve në tregjet financiare globale. Këta kanë qenë: Vanguard, Schroders, European Credit Management (ECM), Fortis (tash BNP Paribas) dhe AXA Investment Managers (TRUST, 2011). Më shumë informacione për secilin menaxhues mjetesh mund të gjeni në vijim.

Në vitin 2010 Trusti pati kthim bruto nga investimet përmes menaxhuesve të mjeteve dhe depozitave bankarë mbi 26 milionë euro. Ky njëkohësisht ishte viti i dytë më i mirë në vlerë nominale në historikun e shkurtër të deritanishëm të Trusti-t.

Të gjithë menaxhuesit e mjeteve patën performancë pozitive për vitin 2010, por investimet e Trusti-t pësuan rënie vetëm në AXA GILB, për shkak të momentit kur u investuan mjetet. Portofoli ECL i ECM-së rezulton se ishte fondi investues me kthimin më të mirë për vitin 2010, me 12.1 për qind kthim.

Më pas është pjesa tjetër e portofolit të ECM, DEC, me 11.8 për qind kthim pozitiv. Në radhë, i treti ishte Schroders Strategic Bonds, me kthim pozitiv prej 8.9 për qind. Në tabelë ilustruhet kthimi bruto si dhe performanca neto e menaxhuesve të mjeteve dhe depozitave sipas efektit në investimet e Trusti-t (TRUST, 2011).

Në vitin 2010 Trusti pati kthim bruto nga investimet përmes menaxhuesve të mjeteve dhe depozitave bankare mbi 26 milionë euro. Ky ishte viti i dytë më i mirë në vlerë nominale në historikun e shkurtër të Trusti-t.

Të gjithë menaxhuesit e mjeteve patën performancë pozitive për vitin 2010, por investimet e Trusti-t pësuan rënie vetëm në AXA GILB për shkak të momentit kur u investuan mjetet (shih 6.5.5). Portofoli ECL i ECM-së rezulton se ishte fondi investues me kthimin më të mirë për vitin 2010, me 12.1 për qind kthim. Më pas është pjesa tjetër e portofolit të ECM, DEC, me 11.8 për qind kthim pozitiv. Në radhë i treti ishte Schroders Strategic Bonds, me kthim pozitiv

prej 8.9 për qind (TRUST, 2011). Në tabelë ilustruhet kthimi bruto si dhe performanca neto e menaxhuesve të mjeteve e depozitave sipas efektit në investimet e Trusti-t.

4.9.1. Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës gjatë krizës

Kriza financiare ka tronditur rëndë deri edhe ekonomitë më të përparuara të globit, ndërsa kursimet pensionale vazhdojnë të mos jenë të rrezikuara dhe rëniet eventuale mund të rikthehen shumë shpejt nga ngritja e tregjeve. Njëkohësisht gjendja aktuale e tregjeve paraqet edhe një shans të volitshëm që të blihen aksione të kompanive më të forta botërore me çmime gati historikisht të ulëta, që në periudha afatgjata do të ishin mjaft të leverdisshme për kontribuesit. Gjithashtu, duke vazhduar politikën disavjeçare që Trusti të ngarkojë sa më pak kontribuuesit, Bordi i ka propozuar Kuvendit të Kosovës uljen e mëtejme të taksës menaxhuese. Kuvendi e miraton këtë propozim, dhe duke filluar nga 1 janari 2011 kontribuesit e Trusti-t do të paguajnë vetëm 0.60% të kontributeve për operimin dhe menaxhimin e mjeteve të tyre (TRUST, 2011). Kështu Trusti do të vazhdojë të jetë ndjeshëm institucioni me taksën menaxhuese më të ulët në rajon e më gjerë, gjithmonë duke u krahasuar me institucionet e ngjashme pensionale të vendeve si: Bullgari, Kroaci dhe Maqedoni.

Performanca e investimeve - Sa i përket performancës tremujore dhe vjetore të investimeve të Trusti-t, të paraqitura në tabelën e mësipërme, Bordi vlerëson se megjithëse deri në fund të muajit shtator investimet pësuan rënie, gjatë gjysmës së tetorit tregjet kanë njohur rritje të fortë. Kjo ka bërë që prej fillimit të vitit 2011 e deri më 15 tetor, Trusti të ketë kthim nga investimet prej vetëm - 5.3 milionë euro dhe çmimi i aksionit të jetë rreth 1.02 euro, nga rreth 1.03 euro sa ishte në fillim të vitit.

Megjithëse performanca e investimeve në këtë periudhë nuk ishte e kënaqshme, mjetet që Trusti i ka nën menaxhim për këtë periudhë nëntëmuajore, vazhduan të rriten. Mjetet në menaxhim u rritën për rreth 62 milionë euro për vitin 2011. Nga rreth 495 milionë euro që ishin në fillim të janarit të këtij viti, kjo vlerë arriti në rreth 557 milionë euro në mes të këtij muaji. Tashmë është e ditur se rënia e vlerës në tregjet financiare globale, erdhi kryekëput nga kriza e borxheve në Bashkimin Europian (BE), e veçanërisht Greqisë. Kurse rreziqet për krizë

të ngjashme edhe në Portugali, Itali e Spanjë vazhdojnë të jenë potenciale dhe t'i mbajnë nën tension tregjet financiare dhe bankat komerciale.

Frika e investitorëve se Greqia nuk do të mund të shlyejë borxhet, por edhe pamundësia e institucioneve ndërkombëtare që ta ndihmojnë me borxhe shtesë, bëri që tregjet të kenë tremujorin më të keq qysh prej krizës së vitit 2008. Megjithatë, portofoli investues i Trustit arriti ta amortizojë rënien e tregjeve falë shpërndarjes në disa instrumente financiare, që njihet si diversifikim i portofolit investues. Si shembull mund të marrim indeksin e bursës DAX³² së Gjermanisë, që në këtë nëntëmujor ka rënë më shumë se - 20 %, kundrejt - 3.2 % të portofolit investues të Trustit (TRUST, 2012).

Prandaj duhen theksuar disa të dhëna në bazë të buletinit mujor statistikor të BQK-së. Deri në qershor 2011, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK-së) realizoi kthime pozitive në vlerë prej 14.5 milionë euro. Kthimet pozitive të investimeve të TKPK-së në këtë periudhë mund t'i atribuohen si diversifikimit të strukturës së investimeve të këtij institucioni, ashtu edhe përmirësimit të performancës së tregjeve globale gjatë kësaj periudhe.

Gjatë tremujorit të dytë të vitit 2011, TKPK rriti investimet drejt instrumenteve të tjera, si bonot dhe letrat me vlerë, meqë këto instrumente shënuan norma më të larta të kthimit.

Deri në qershor 2011, pjesa më e madhe e aseteve të fondeve pensionale ishin të investuara në aksione dhe bono të lidhura me normën e inflacionit (rreth 50.9 përqind të mjeteve), ndërsa një pjesë tjetër u investua në bono dhe tregun e parave rreth 22.6 përqind (BQK, 2014a).


Ndërsa në bazë të të dhënave nga buletini tremujor i Trustit Pensional të Kosovës, duhet potencuar që kthimet nga investimet e Trustit të Kursimeve Pensionale të Kosovës (TRUST, 2011) gjatë tremujorit të parë 2011 ishin në vlerë tejet të kënaqshme pozitive, prej rreth 11.5 milionë euro bruto (për më shumë, ju lutem shihni tabelën sipër). Ndërsa, e shprehur në përqindje, ky kthim nga investimet ishte 2.13 % neto. Rezultati nga investimet ka ndikuar më pas edhe në çmimin e aksionit, i cili u rrit nga 1.0327 euro që ishte në fund të vitit të kaluar, në 1.0548 euro në fund të këtij tremujori. Gjithashtu, kthimi pozitiv nga investimet ndikoi edhe

³²The DAX (Deutscher Aktienindex (German stock index) është një bursë e fuqishme gjermane

në vlerën e mjeteve nën menaxhim që Trusti kishte para këtij tremujori, ku prej rreth 448 milionë euro ajo arriti në rreth 519 milionë eurove.

Krejt në fund, edhe numri i aksioneve të emetuara nga Trusti për këtë periudhë referuese u ngrit nga rreth 473 milionë në rreth 492 milionë euro (TRUST, 2011).


Grafiku 33. Performanca komulative e Trustit nga themelimi



Periudha	1 muaj	3 muaj	Viti 2011	1 vit	5 vjet	Nga themelimi
Rezultati	-0.40%	2.13%	2.13%	4.55%	-7.56%	5.48%

Burimi: Trusti Pensional i Kosovës 2013

Grafiku 34. Investimet e mjeteve në tremujorin e parë të vitit 2011



Burimi: Trusti Pensional i Kosovës

Viti 2013 u mbyll me një kthim bruto nga investimet prej rreth 71 milionë euro. Në vlerë nominale ky është rezultati më i mirë në fushën e investimeve që FKPK-ja ka arritur

ndonjëherë. Vetëm për dy vitet e fundit, 2012 e 2013, kthimi bruto nga investimet e FKPK-së është rreth 125 milionë euro.

Tejkalimi i krizës, konkretisht asaj të vitit 2012, e kishte përforcuar më 3,567 llogari të reja nga të cilat u tërhoqën mjetet, ndërkohë vlera e mjeteve që në tërësi u tërhoqën gjatë vitit arriti në 10.7 milionë euro. Numri i përgjithshëm i llogarive me tërheqje prej themelimit të Trustit arriti në 20,503, ndërsa vlera e përgjithshme e tërhequr iu afrua 39 milionë eurove.

KAPITULLI I PESTË

5. TEJKALIMI I KRIZËS FINANCIARE DHE MUNDËSITË PËR ZHVILLIM EKONOMIK NË KOSOVË

Nxjerrja e vendit nga kriza ekonomike dhe mundësia për të pasur një zhvillim ekonomik të qëndrueshëm është sa e thjeshtë për ta thënë, aq dhe e vështirë për ta realizuar. Rolin primar e zënë investimet në sistemin ekonomik, të cilat garantojnë një rritje të eficiencës ekonomike dhe produktivitetit në punë (pra rritja e rrogave dhe cilësia e jetesës). Mbi të gjitha krijohen kushtet e nevojshme për ndryshimin e strukturës ekonomike, duke realizuar një vizion strategjik të ri, që u jep jetë sektorëve prodhues me një përdorim më të gjerë të teknologjisë. Nevojitet një intensifikim dhe një stimulim i sektorëve prioritarë të ekonomisë, siç mund të jetë bujqësia për të rritur produktivitetin, prodhimin e më vonë edhe punësimin. Gjithashtu, rritja e prodhimit dhe e produktivitetit në punë do të kthejë një ndikim më të madh në rritjen e buxheteve familjare të qytetarëve dhe për rrjedhojë, sjell një rritje të ndjeshme të nivelit të jetesës të konsumatorëve shqiptarë, pse jo dhe të uljes së varfërisë në zona të ndryshme të vendit. Për më tepër, rritja e prodhimit dhe e produktivitetit do të shkaktonte ulje të importeve dhe njëkohësisht ulje të çmimeve në treg, gjë që do të shoqërohej me një rritje të konkurrencës por edhe të stimulimit të produkteve vendore, pra me një përmirësim të balancës tregtare. “Ekonomistët janë anatomistë premtues dhe kirurgë zhgënjyes, pasi operojnë në mënyrë të përkryer të vdekurin dhe masakrojnë të gjallin” (Chamfort). Nga kjo konstatojmë se është e vështirë të japësh recetën e saktë për daljen nga kriza, pasi është njëloj si të dish diçka para se të ndodhë. Megjithatë, mund të them se zgjidhja e krizës nuk mund të jetë as çështje makroekonomike as mikroekonomike. Ajo është çështje ekonomiko - politike, apo e politikave publike, pra një ndërthurje komplekse dhe natyrale midis familjeve, shoqërisë, tregut, institucioneve civile dhe atyre formale. Për të dalë nga kriza ekonomike, duhet me çdo kusht të stimulohen investimet në ata sektorë të ekonomisë që gjenerojnë punësim dhe prodhojnë për konsumin vendas, falë tyre do të hapen vende të reja pune dhe do të ketë rritje rroge, të cilat të dyja bashkë do të mbështesin konsumin në veçanti e kërkesën agregate në tërësi.

5.1. Dalja nga kriza financiare

Ekonomia e Kosovës është ndikuar nga kriza që u përhap shumë shpejt në shtetet e Eurozonës, edhe pse ndikimet e shumta kanë qenë në mënyrë indirekte prapë është ndjerë efekti i krizës ekonomike. Shumë vende të zhvilluara dhe vende në zhvillim kanë marrë masa të shpejta për dalje nga kriza, kështu që Kosova edhe pse nuk është ndikuar në masë të madhe nga kriza, prapë e ka të nevojshme marrjen e masave mbrojtëse dhe masave për dalje nga kriza ekonomike, e cila në disa mënyra ka prekur edhe Kosovën.

Kosova ka qenë dhe vazhdon të jetë në krizë. Këtë e tregon niveli i ulët ekonomik në vend, standardi jetësor shumë i ulët, papunësia shumë e lartë, varfëria gjithnjë e në rritje.

Të gjithë këta janë faktorë që tregojnë për gjendjen e vështirë ekonomike në vend, e kjo nuk është gjë tjetër veç se krizë ekonomike. Ekonomia e Kosovës është një ekonomi e vogël, nëse mund ta quajmë kështu. Duke u bazuar në gjithë ekonominë e Kosovës kemi shumë pak eksport, kemi një përqindje të lartë të importit, që do të thotë që ne si vend me një ekonomi të mbyllur apo më mirë të themi të kufizuar, nuk kemi qenë pjesë e tregjeve europiane ku ishte prezente kriza financiare që nga viti 2008 e tutje. Për këtë arsye, nuk kemi qenë të ndikuar në masë të madhe nga kriza ekonomike dhe financiare që preku shtetet e Eurozonës.

Kjo gjendje e krijuar në ekonominë tonë kërkon marrjen e masave adekuate, ndryshime ligjore, përmirësim të politikës fiskale, marrjen e masave shtrënguese si dhe zbatimin e politikave stimuluese e nxitëse të rritjes ekonomike dhe të punësimit.

Vendi ynë ka qenë dhe është në një krizë ekonomike. Këtë e konfirmojnë tregues të shumtë siç janë: papunësia, mungesa e investimeve direkte, varfëria e shumë e shumë faktorë të tjerë.

Duhet krijuar kushtet e nevojshme për zhvillimin e shumë aktiviteteve ekonomike, të cilat kërkojnë mjete financiare dhe menaxhim efikas. Ndër masat që duhet të merren për daljen nga kriza, apo më mirë të themi për përmirësimin e gjendjes ekonomike, janë:

Siguria, zbatimi i ligjeve dhe vënia e drejtësisë ekonomike. Këto janë çështje esenciale për zhvillimin ekonomik në vend. Nuk mund të presim investime as nga investitorë vendor e as nga investitorë të jashtëm, përderisa nuk ka siguri për të investuar. Kemi largimin e shumë të

interesuarve për të investuar në Kosovë, dhe arsyeja pse janë larguar e kanë vendosur që kapitalin e tyre ta investojnë në vende të tjera, është siguria dhe ofrimi i lehtësirave tatimore nga ana e shteteve të tjera.

Krijimi i infrastrukturës është një ndër problemet e shumta, se përse në Kosovë nuk investohet. Mungesa e infrastrukturës bën që të kemi probleme ekonomike. Ndërtimi i Autostradës “Ibrahim Rugova” ka qenë e një rëndësie të veçantë, e cila ofron kushte më të mira për zhvillimin e marrëdhënieve ekonomike dhe normalisht me shpenzime më të vogla. Kjo i ndihmon edhe prodhuesit vendor që produktet e tyre t’i plasojnë në tregun e Shqipërisë, i cili tani e ka më të lehtë për të qenë pjesë e tregut shqiptar. Ky investim ka qenë shumë i rëndësishëm, dhe po ashtu duhet të ndodhin më shumë investime në infrastrukturë sepse janë jetike për zhvillimin e ekonomisë.

Luftimi i ekonomisë joformale është çështje e rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe konkurrencë të barabartë në treg. Menjëherë pas përfundimit të luftës, kemi hasur në shumë probleme të cilat është dashur të zgjidhen, por zgjedhja e tyre ka kërkuar kohë dhe mjete financiare. Normalisht, këtë e ka vështirësuar edhe statusi i pazgjidhur i Kosovës në atë kohë. Ndër problemet që kanë qenë të pranishme, është mungesa e pikave doganore dhe mungesa e funksionimit të tyre në mënyrë të rregullt. Pikat 1 dhe 31 kanë qenë problem i vazhdueshëm për ekonominë e Kosovës, duke i bërë dëme të mëdha ekonomisë dhe Buxhetit të Kosovës. Kur kemi ekonomi joformale, normalisht kemi problem tek prodhuesit vendorë që ballafaqohen me konkurrencë të padrejtë në treg dhe që nuk mund të përballojnë uljen e çmimeve nga ana e prodhuesve të tjerë. Patjetër se këtu duhet të cekim luftimin e korrupsionit i cili është shumë i pranishëm në vendin tonë në të gjithë sektorët, e po ashtu edhe në ekonomi.

Furnizimi me rrymë elektrike është po ashtu shumë i rëndësishëm për zhvillimin e veprimarive ekonomike. Kemi probleme të shumta të cilat i sjell mungesa e energjisë elektrike. Biznese të shumta ankohen në çmimin e lartë dhe në reduktime të shumta, çështje këto që krijojnë shpenzime shtesë për ta. Normalisht që për zhvillimin e ndonjë biznesi nga ana e investitorëve të huaj kërkohen kushte të volitshme për të tërhequr atë investitorë. Politika fiskale jo shumë e favorshme, mungesa e sigurisë dhe mungesa e kushteve të domosdoshme, siç janë energjia elektrike, infrastruktura rrugore, probleme me zbatimin e ligjeve etj., janë çështje që ndikojnë në zhvillimin ekonomik. Përmirësimi i këtyre kushteve do të ndikojë shumë pozitivisht tek zhvillimi dhe përmirësimi i gjendjes ekonomike në vend.

Subvencionimi i bujqësisë, blegtorisë dhe bletarisë duhet të ndodhë sa më parë dhe në mënyrën më të mirë të mundshme. Nuk mund të ketë ekonomi të qëndrueshme përderisa nuk kemi zhvillimin e bujqësisë me degët e tjera të saj. Nëse një vend nuk ka prodhime vendore, nuk mund të jetë vend me ekonomi të qëndrueshme sepse është i varur dhe i ndikuar gjithmonë nga jashtë. Kosova varet shumë nga importi për arsye të mungesës së produkteve vendore dhe kjo ndikon edhe tek çmimet më të larta. Normalisht arrihet tek ikja e parasë në vendet e tjera, sepse kur ne kemi mundësi të blejmë produkte vendore, paraja mbetet prapë në vend dhe ndikon në përmirësimin e jetës së qytetarëve, e nga ana tjetër kur ne blejmë më shumë nga prodhuesit e jashtëm, paraja ikën nga ne dhe kjo ndikon negativisht për ekonominë e vendit tonë.

Zhvillimi dhe përkrahja e turizmit po ashtu është një mundësi e mirë për të ndikuar në ekonominë e vendit. Kosova ka shumë mundësi të mira për zhvillimin e turizmit. Ka mundësi reale për realizimin e projekteve të shumta në këtë drejtim, duke u bazuar në zhvillimin e turizmit dimëror dhe në atë veror, për të cilin ka interes kërkesa. Këtë e mundësojnë kushtet optimale, bukuritë natyrore, klima e cila është e kërkuar nga grupmoshat e ndryshme, ushqime natyrore dhe po ashtu ka mundësi për zhvillimin e sporteve të ndryshme sepse këtë e mundësojnë terrenet e përshtatshme. Çelësi kryesor për zhvillimin ekonomik të Kosovës është Turizmi, i cili mund të zhvillohet në shumë komuna të Kosovës.

Dhënia e kredive të buta nga sektori bankar dhe mikrofinanciar është shumë e nevojshme për zhvillimin e bizneseve të vogla dhe të mesme që paraqesin zemrën e ekonomisë në vendin tonë. “Edhe pse bankat në Kosovë nuk janë prekur nga kriza financiare, prapë aplikojnë norma të interesit shumë të larta, apo ndoshta arsyeja pse nuk janë prekur nga kriza është edhe fakti se këto banka aplikojnë normat më të larta në Europë. Kjo ndoshta është edhe formula përse nuk janë ndikuar nga kriza financiare.”

Normat e interesit të kredive që ofrohen për zhvillimin e bizneseve janë shumë të larta dhe të papërbalueshme. Bankat në Kosovë nuk ofrojnë kurrfarë mundësie për zhvillim të suksesshëm të bizneseve sepse aplikojnë norma shumë të pavolitshme, dhe jo kredi të leverdisshme për zhvillimin e biznesit. Po ashtu, kreditë për zhvillimin e bujqësisë janë shumë të larta dhe të papërbalueshme. NLB-ja aplikon 9 - 11 % interes për kredi bujqësore, KRK-ja 16 - 24 %, RAIFFEISEN BANK 10.5 % minimumi, ndërsa bankat e tjera nuk kanë deklaruar se çfarë normash aplikojnë. Kur i analizojmë këto të dhëna, nuk është e vështirë të konkludohet

se bizneset janë shumë të pakënaqura për bankat dhe mundësitë që iu ofrohen. Çdo biznes kërkon marrjen e kredive në mënyrë që të zhvillohet sepse mundësia e zhvillimit me vetëm mjete vetanake është shumë e vështirë.

Investimi në arsimin e lartë duhet të jetë prioritet i Qeverisë së Kosovës, sepse pa investime në këtë drejtim nuk mund të ecim përpara si vend i cili kërkon zgjidhjen e shumë problemeve, siç janë problemet me ekonomi -papunësi, varfëri, korrupsion, pasiguri, mungesë të investimeve etj. Këto zgjidhje të problemeve mund t'i bëjnë kuadrot e reja të përgatitura për një të ardhme të sigurtë dhe më të mirë. Është shumë i rëndësishëm investimi në dije dhe mund të themi se është një ndër investimet më të rëndësishme. Është e nevojshme për të rinjtë e vendit tonë që të studiojnë në vende të jashtme sepse ata marrin përvoja të mira të cilat mandej i sjellin në Kosovë, duke kontribuar në zhvillimin e vendit me prurjen e modeleve nga vendet e suksesshme europiane. Zhvillimi ekonomik mund të arrihet vetëm me anë të rritjes së cilësisë në arsim. Të gjitha këto masa që u cekën më lart janë shumë të nevojshme për një ekonomi të qëndrueshme dhe për krijimin e më shumë vendeve të punës, por njëkohësisht për hapjen e perspektivës së të rinjve në vendin e tyre.

5.2. Krijimi i kushteve për tërheqjen e investimeve të huaja

Ekonomitë në zhvillim, sidomos ekonomitë e dala nga luftërat apo ekonomitë e shteteve të vogla, janë shumë të varura nga investimet e huaja direkte. Kosova është një vend që ka pasuri të shumta tokësore e nëntokësore, dhe pasurinë më të madhe që është rinia e Kosovës e cila paraqet të ardhmen e këtij vendi. Kosova ka mundësi të shumta për t'u zhvilluar, por ekzistojnë probleme që e pengojnë çarjen e vendit drejt zhvillimit. E trajtojmë këtë temë për arsye se krijimi i kushteve për tërheqjen e investimeve të huaja, duhet analizuar me një rëndësi të veçantë për ngritjen e ekonomisë dhe përmirësimin e standartit jetësor. Investimet e huaja janë kruciale për zhvillimin e ekonomisë së vendit tonë. Asnjë vend deri më sot nuk është zhvilluar pa ndihmën e investimeve të huaja, por për prurjen e investimeve të huaja duhet punuar më shunë në krijimin e kushteve ideale.

Qëllimi i kësaj teme është që të kontribuojë me disa ide rreth zgjidhjes së këtyre problemeve, duke ofruar kështu një analizë sa më të qartë se çfarë duhet të bëjë Kosova për të qenë një ndër

vendet me prioritare për investimet e huaja. Për realizimin e këtyre investimeve duhet të zbatohen disa rregulla apo masa stimuluese të cilat janë cekur në vijim:

- ✓ Siguri për të investuar
- ✓ Lehtësira tatimore - Lirim nga tatimi, norma të leverdisshme, lirim nga doganat për import të imputeve etj.
- ✓ Ofrimi i kredive të favorshme
- ✓ Përkrahje me subvencione etj.

Këto favore janë shumë të rëndësishëm për investorët e jashtëm që dëshirojnë të investojnë kapitalin e tyre në Kosovë. Për ne, është shumë e rëndësishme ardhja e investorëve të jashtëm, sepse ndikon shumë pozitivisht tek krijimi i vendeve të reja të punës, prurje e teknologjise së re e të avancuar, ofrimin e produkteve të reja dhe mundësi më shumë për kërkesën në treg. Po ashtu krijohet një ekonomi më konkurruese në treg.

Të gjitha masat që u cekën më lart si të domosdoshme për sjelljen e investimeve të huaja, duhet të aplikohen duke filluar në rend të parë me sigurinë. Siguria është pika e parë që çdo investor kërkon t'i ofrohet nga ana e shtetit. Vendi ynë është vend i dalë nga lufta dhe deri tani ka pasur probleme të shumta, që fatkeqësisht ende janë të pranishme. Për shkak të sigurisë së ulët, kemi ikjen e shumë investorëve të huaj, por këtu duhet të cekim edhe pakënaqësinë e bashkatdhetarëve tanë që jetojnë me vite të tëra në perëndim, ku kanë krijuar një kapital që dëshirojnë ta investojnë në vendin e tyre, dhe i pengon mungesa e sigurisë për të investuar. Kur një vend nuk ofron siguri, nuk vjen asnjë investor të investojë kapitalin e tij në një vend ku i rrezikohet kapitali. Pra, duhet të mendohet që të bëhet më shumë nga ana e institucioneve tona për çështjen e sigurisë. Duhet të kemi ligj inkurajues dhe stimules për investorë dhe po ashtu ligj që i mbron ata nga rreziqe të ndryshme.

Lehtësira tatimore - Lirim nga tatimi, norma të leverdisshme, lirim nga doganat për import të imputeve... të gjitha këto do të ishin një politikë e mirë nga ana e shtetit, nëse ai dëshiron prurjen e sa më shumë investimeve të huaja, duke bërë kështu Kosovën vend atraktiv për investorë të huaj. Këtë e mundëson stimulimi me lehtësira tatimore dhe doganore nga ana e një vendi. Kështu që, edhe Kosova është mirë që si shtet i ri që është, t'i aplikojë këto metoda të tërheqjes së investimeve të huaja, sepse me këtë e ndihmon zhvillimin e brendshëm ekonomik.

Ofrimi i kredive të favorshme është faktor i rëndësishëm dhe me ndikim në hapjen e bizneseve të reja dhe në përkrahjen e investimeve profitabile. Pa marrjen e kredive të favorshme është vështirë për t'u zhvilluar një biznes apo projekte të ndryshme. Bashkatdhëtarë të shumtë, të cilët kanë biznese të ndryshme në perëndim, nuk e zhvillojnë biznesin e tyre edhe në Kosovë pasi edhe fuqia punëtore është më e lirë për t'u paguar. Ata i brengos fakti se kreditë janë të pafavorshme për të zhvilluar biznesin e tyre, ndërsa në shtetet europiane atyre iu mundësohen kredi dhe kushte të favorshme për zhvillimin e çdo biznesi. Po ashtu kanë edhe subvencione nga ana e shtetit. Në Kosovë kemi mungesë të këtyre nxitjeve dhe stimulimeve për zhvillimin e bizneseve. Këto kushte që u cekën si të domosdoshme për të tërhequr investitorë të huaj, janë esenciale dhe mundësi e mirë për ta bërë vendin tonë vend atraktiv dhe konkurues për të investuar.

5.3. Eleminimi i barrierave ekonomike

Eleminimi i barrierave ekonomike nënkupton integrimin e tregut kosovar në tregun evropian. Barrierat ekonomike janë çfarëdo demarkacioni apo pengese, nëpërmes së cilave zvogëlohet mobiliteti aktual dhe potenciali i të mirave, shërbimeve dhe faktorëve të prodhimit, si dhe rrjedha e komunikacionit (BQK, 2012).

Rëndësia fundamentale e integritetit është se ai ndikon në rritjen e konkurrencës aktuale dhe potenciale.

- ✓ Rritet sasia e ofruar në tregun e integruar
- ✓ Zvogëlohen çmimet
- ✓ Rritet mirëqenia për shoqërinë
- ✓ Krijohet një treg më i madh

Në parim, procesi i integritetit nxitet nga motivet ekonomike, por nuk mund të përjashtohen edhe ato politike në raste të caktuara.

- Integrimi ekonomik
- Integrimi ekonomik përfshin integrimin e tregut dhe të politikave ekonomike
- Integrimi i tregut është dhe mbetet esenca e integritetit

- Politikat ekonomike ndërlidhen direkt me funksionimin e tregut ose strukturën, performancën dhe rezultatet e tregut
- Integrimi i tregut përfshin eliminimin e barrierave fizike në mes shteteve që krijojnë zonën e lirë tregtare, tregun unik ose unionin. Integrimi i politikave ekonomike përfshin:
- Bashkëpunimin
- Koordinimin mes shteteve

Plotësimi i kriterëve ekonomike

Lidhur me këtë kriter, vlerësimi i Komisionit udhëhiqet nga Konkluzionet e Kopenhagës të KE-së (Këshilli European) të vitit 1993, e cila për vendet që aspirojnë për t'u bërë anëtarë të BE-së, që kanë nënshkruar dhe po zbatojnë MSA-në, apo kanë aplikuar apo marrin statusin e vendit kandidat, kërkohej:

Së pari, ekzistenca dhe funksionimi i ekonomisë së tregut;

Së dyti, kapacitetet për t'u përballur me presionet konkurruese dhe forcat e tregut brenda unionit (Angjeli, 2012:249).

5.4. Procesi i stabilizim - asociimit, Kosova dhe mekanizmi përcjellës i stabilizim asociimit (MPSA)

Qëllimi i MSA-së është që të përkrahë Kosovën në reforma strukturale të nevojshme për përafrim me BE-në. Po ashtu, pjesë e Stabilizim - Asociimit është tregtia e lirë në masën e afro 70 për qind të përmbajtjes, sa përbën negociimi i kësaj marrëveshjeje. Autoritetet kosovare duhet t'i përmbushin kriteret afatshkurtra të përcaktuara në Studimin e Fizibilitetit për Marrëveshjen e Stabilizim - Asociimit.

Ndër to janë edhe çështja e marrëdhënieve tregtare me Bashkimin Evropian dhe sundimi i rendit dhe ligjit, respektivisht forcimi i rolit të gjykatave ekonomike.

Integrimi ekonomik dhe marrëdhëniet tregtare janë të rëndësishme dhe të domosdoshme për integrimin e gjithëmbarshtëm të vendit në strukturat e BE-së. Vendi ynë nuk mund të integrohet në strukturat e BE-së, derisa në vendin tonë kemi mungesë të sundimit të ligjit, dhe po ashtu kemi nivel të lartë të korrupsionit, i cili do ishte mirë të luftohet më shumë. Tek eliminimi i

barrierave ekonomike nënkuptojmë edhe bërjen e reformave të politikës monetare, fiskale dhe tregtare. Reformimi i këtyre politikave është hap crucial për integrimin e tregut kosovar në ekonominë evropiane.

Deri tani nuk është punuar sa duhet rreth përmbushjes së kriterëve për integrim ekonomik. Duhet të bëhen reforma në politikat tregtare, politikat integruese reformuese; politika që i sigurojnë investitorit ambient të mirë për investime. Politikat duhet të jenë të harmonizuara me ato të BE-së. Shteti ynë nuk ka punuar shumë në luftimin e dukurive negative në ekonomi, të cilat paraqesin pengesën më të madhe për ekonominë e vendit tonë. Në këtë kapitull është trajtuar eliminimi i barrierave ekonomike, me qëllim të ndërlidhjes së këtij punimi me tema të tjera të rëndësishme për të ardhmen e vendit, siç është integrimi ekonomik i Kosovës, i cili duhet të ndodhë sa më shpejt që të jetë e mundur, sepse pa integrim ekonomik nuk mund të kemi as zhvillim ekonomik në vend. Si mund të ndodhë integrimi ekonomik? Integrimi ekonomik ndodh atëhere kur vendi përgatitet për tregun evropian, përgatitje e cila në fakt kërkon punë dhe drejtësi të përgjithshme. Duhet të luftohet në rend të parë evazioni fiskal, korrupsioni. Nëse autoritetet kosovare punojnë më shumë rreth eliminimit të këtyre dukurive negative, atëhere edhe vendi ynë mund të bëhet pjesë e tregut evropian.

Kosova duhet të bëhet vend i përshtatshëm për investime, të krijojë ambient të favorshëm dhe të sigurtë për investitorë vendor dhe të jashtëm. Raporti i progresit është një nga dokumentet më të rëndësishëm i cili vlerëson gjendjen ekonomike, politike dhe sociale në vend. Sipas raporteve të progresit, krimi i organizuar dhe korrupsioni janë sfida shumë të mëdha për Kosovën dhe është bërë shumë pak progres në luftimin e krimeve ekonomike dhe të shpëlarjes së parasë. Gjithashtu ka mangësi edhe në kornizën fiskale. Sipas raporteve të progresit, deri tani kemi shumë pak progres në përmbushjen e kriterëve ekonomike.

Kosova si shtet i ri duhet të punojë shumë rreth plotësimit të kriterëve, të cilat nga dita në ditë janë më rigorozë dhe numerikisht më të mëdha. Mirëpo të gjitha këto mund të realizohen shumë shpejt, nëse institucionet e Kosovës angazhohen me një përkushtim të veçantë për përmbushjen e të gjitha kriterëve. Kriteret ekonomike nuk është vështirë të përmbushen në aspektin formal apo të hartimit të legjislacionit, por sfida mbetet zbatimi i këtij legjislacioni në praktikë. Kushtet ekonomike që duhet të përmbushë secili vend që synon të integrohet në BE, janë që vendi të ketë një ekonomi funksionale të tregut, që prodhuesit e këtyre vendeve të kenë aftësi për të përballuar presionet konkurruese në tregun evropian, dhe krijimit të

legjislacionit të doganave dhe tregtisë në përgjithësi. Nga të gjitha kriterët që u cekën më lart, të cilat patjetër duhen plotësuar, sfida kryesore mbetet sundimi i rendit dhe i ligjit. Vetëm në këtë mënyrë mund të vijmë deri te përshpejtimi i proceseve integruese nga aspekti ekonomik. Funksionimi i gjykatave të mirëfillta ekonomike për zgjedhjen e çështjeve të bizneseve mbetet një sfida tjetër.

Tregtia ndërkombëtare luan rol të rëndësishëm në zhvillimin ekonomik të vendeve. Ekonomitë e vendeve që lidhen me njëra - tjetrën nëpërmjet eksportit dhe importit, quhen ekonomi të hapura. Shkalla e hapjes së një ekonomie shprehet nëpërmjet raportit të vëllimit të eksport - importit ndaj GDP-së. Sa më i madh të jetë ky raport, aq më e hapur është ekonomia e një vendi. Zakonisht vendet më të zhvilluara kanë shkallë më të lartë të hapjes së ekonomisë (Kule & Qirici & Mancellari & Hadëri, 2008:408). Sipas raporteve për tregtinë e jashtme për muajin qershor të publikuar nga Agjencia e Statistikave të Kosovës (ASK), Departamenti i Statistikave Ekonomike dhe Llogarive Kombëtare, Kosova në këtë aspekt është shumë mbrapa pasi ka një disavantazh të madh të eksportit në raport me importin. Publikimi për Tregtinë e Jashtme është i bazuar në të dhënat e Shërbimit Doganor të Kosovës dhe Korporatës Energjetike të Kosovës për energji elektrike.

Kjo pasqyrë e Tregtisë së jashtme tregon se Kosova ende nuk është e përgatitur për tregtinë e jashtme. Këtë e vërejmë tek raporti ndërmjet eksportit dhe importit. Në këtë aspekt kemi një disekuilibër. Kjo varësi e lartë nga importi, e shprehur në përqindje, tregon se kemi mungesë të prodhimit të mirave të ndryshme që nënkupton se jemi shumë të varur nga importi. Përderisa nuk kemi kapacitete prodhuese dhe teknologji të avansuar për prodhim, atëherë nuk mund të jemi konkurentë dhe as të jemi pjesë e tregjeve evropiane. E vetmja mënyrë për të qenë pjesë e tregjeve të jashtme është prodhimi i produkteve cilësore, duke qenë të nivelit të barabartë me produktet e shteteve të tjera evropiane. Nuk duhet menduar se kur do jemi pjesë e tregjeve evropiane, apo vetëm duke shpresuar se një ditë do të hiqen të gjitha pengesat. Pengesat janë të shumta dhe ato duhet të zgjidhen dhe jo të presim.

Nuk ka aspak vlerë integrimi ekonomik nëse vendi nuk është i përgatitur për tregje evropiane, sepse duhet paraparë që aty duhet ballafaquar me një konkurrencë të fortë nga prodhues të ndryshëm të shteteve evropiane. Kështu që, integrimi ekonomik ndodh atëherë kur punohet me përkushtim në atë drejtim, si dhe bëhet përgatitja për tregjet evropiane si në aspektin e

cilësisë , ashtu edhe në aspektin e teknologjisë. Vetëm në këtë mënyrë përgatitemi për konkurrencën.

5.5. Kriza globale financiare dhe dalja nga ajo

Kalimi i krizës financiare globale në sektorin real të ekonomisë, e cila konkretisht po përcillet me rënie të prodhimit, me rritje të papunësisë dhe rënie të GDP-së (bruto prodhim vendor), ka shënuar fillimin e krizës ekonomike globale. Përmasat e këtij recesioni global, gjithnjë e më shumë po bëhen të pakontrolluara, kurse kohëzgjatjen tashmë askush nuk e di. Prandaj, tronditja e bursave dhe e tregjeve financiare gjatë gjithë tremujorit të tretë të vitit 2007, i bëri të gjithë të mendojnë me frikë për përsëritjen e skenarit të tmerrshëm të krizës më të madhe në historinë e kapitalizmit modern, atë të viteve 1929 -1932 në SHBA. Aq kritike dukej gjendja në shumë institucione financiare amerikane, evropiane, kineze e japoneze, sa shumë nga drejtuesit dhe aksionerët e tyre iu referuan katastrofës së kapitaleve që ndodhi në Azi dhe Lindjen e Mesme në vitet e 90-të të shekullit XX-të (Civici, 2010:307). Barometrat kryesorë të botës financiare qëndruan disa javë rresht në kuotat më të ulëta historike të aktivitetit të tyre, në ato që u cilësuan si “séance katastrofike”. Bursat e Frankfurtit, Parisit, Londrës, Milanos, Amsterdamit, Madridit, Zyrihut, Ëall Streetit, Doë Jones, Nasdaq, Moskës, Torontos, Sao Paolos, Buenos Airesit, Santiagos, Bogotas, Meksikos, Hong Kongut, Shangait, Tokios, Xhakartës, Suelit, Bombeit, Dubait, Dohas etj., u hapën dhe vazhduan të funksionojnë duke humbur deri në 20 % të kursit të tyre normal. Shifra prej miliarda dollarësh, paundësh, jenësh ose eurosh të humbura nganjëherë brenda ditës ose brenda disa orësh nga bankat më të mëdha amerikane, evropiane, kineze e japoneze, shkaktuan një panik dhe frikë të përgjithshme për atë që mund të ndodhë në muajt në vazhdim: recesion apo krizë ekonomiko - financiare botërore. Brenda një periudhe të shkurtër, humbjet u vlerësuan në 40 - 50.000 miliardë dollarë, shumë kjo e barabartë me Prodhimin e Brendshëm Bruto të të gjithë botës në një vit. Asnjëherë institucionet financiare nuk ishin ndeshur me një situatë të tillë kaq problematike e me kaq shumë pikëpyetje për të ardhmen e tyre (Civici, 2010:307). A është e mundshme të mendohet që ekonomia globale të përmirësohet pas masave antirecesive të Presidentit Obama për ringjalljen e ekonomisë amerikane, e cila pritet të jetë lokomotiva e ringjalljes për ekonominë globale? Ngjarjet e fundit tregojnë që implementimi i masave nga ana e administratës amerikane, nuk është duke dhënë rezultatet e dëshirueshme në bursat amerikane, të cilat nga

momenti i parë i lajmërimit të programit, ka rënie në minimumin e ri. Kështu Don Jones ka shënuar rënie 10 %, kurse bursat europiane po vazhdojnë me rënie rapide pas lajmërimit të rezultateve bankiere për vitin e kaluar afarist (Selmani, 2009). Këtu kemi të bëjmë me një situatë të reagimit normal të tregut, për të cilin në 25 vitet e kaluara, nuk ka qenë shprehi intervencionizmi shtetëror i përmasave kaq të gjëra.

Tregu i cili i beson vetëm mekanizmit të tregut nuk është i përgatitur t'i pranojë masat shtetërore si zgjidhje të krizës, para se këto masa të tregojnë rezultate konkrete. Pse suksesi i masave amerikane antirecesive është aq i rëndësishëm për ekonominë europiane dhe për pjesën tjetër të ekonomisë globale? Para se gjithash, kemi të bëjmë me rezultatet e mundshme pozitive të SHBA-ve, prej së cilës mund të fillohet numërimi i kohës për dalje nga recesioni dhe për pjesën tjetër të ekonomisë globale (Selmani, 2009). Vlerësimet nga përvojat e deritanishme thonë se do të duhej përafërsisht një vit për ringjalljen e tregut amerikan të kapitalit. Ky do të ishte fillimi i ringjalljes për ekonomitë e tjera nacionale në botë.

Kryetari i Rezervave Federale amerikane (Banka Qendrore Amerikane), vlerëson fundin e recesionit të thellë në këtë vit i cili do të imponojë një sërë masash antirecesive dhe programe nxitëse stabilizuese, nga të cilat priten që t'i japin rezultatet e duhura. Në të njëjtën kohë, tërhiqet vërejtja që deri te ringjallja e plotë ekonomike duhet të pritët më së paku dy deri në tre vitet e ardhshme. Nga kjo e dhënë, vlen të theksohet se ekonomia globale gjendet në kufirin e ngushtë mes RECESIONIT dhe DEPRESIONIT, e cila definohet si recesion i thellë (Civici, 2010:276).

Nga kush në të vërtetë do të varet dalja nga recesioni? Para se të gjithash, nga nxitja e politikave fiskale dhe e masave për stabilizimin e institucioneve financiare e të tregut financiar. Pra, shteti përsëri duhet të inkuadrohet që t'i përmirësojë “gabimet” e tregut, të cilat kryesisht lajmërohen gjatë periudhave të normave të larta të rritjes ekonomike (prosperitetit). Kryesisht kjo ndodh për shkak të dëshirës së paskrupullt për profite. Është e njohur tashmë që shteti nuk është treguar si pronar dhe menaxhues i suksesshëm në ekonomi. Për këtë do të duhet të bëhen mjaft përpjekje që masat antirecesive të cilat po ndodhin, të jenë efikase. Këtë e garanton vetëm suksesi. Në rastin e kundërt, po qe se suksesi është i pamjaftueshëm, është i mundshëm thellimi i krizës ekonomike dhe vazhdimi i recesionit me pasoja katastrofale për ekonominë globale (Selmani, 2009).

Gjithsesi duhet theksuar që lojtarët prej të cilëve varet dalja nga kriza dhe ringjallja e ekonomisë globale me masat shtetërore, do të varen nga ringjallja e partnerëve kryesorë tregtarë të SHBA-ve (UE, Japonia, Kina etj.). Në rast se përmirësimi i ekonomive të tyre do të jetë më i ngadalshëm, atëherë recesioni në ekonominë globale do të zgjasë. Mirëpo, në qoftë se e kemi parasysh thirrjen e Presidentit amerikan para disa ditësh për korporatat dhe për qytetarët amerikanë që ata të blejnë vetëm prodhimet “Made in USA”, nuk mund të llogaritet në një ringjallje të shpejtë të partnerëve të saj tregtar. Arsyeja është e thjeshtë, kur dihet se defikiti buxhetor i SHBA-ve varet nga shitja e obligacioneve shtetërore pikërisht këtyre partnerëve tregtarë. Pra, defikiti buxhetor i cili është 2 miliardë në ditë, mund të mbulohet vetëm nga sufikiti i Japonisë, Kinës, Gjermanisë, Holandës, Norvegjisë etj. Mirëpo, shtrohet pyetja se edhe për sa kohë do të mundën të financojnë, sepse masat antirecesive në SHBA po kërkojnë ende pará (WEF, 2009).

Unioni European këto ditë ka vendosur që nuk dëshiron të financojë fondin e posaçëm prej 180 miliardë eurosh, në ndihmë të ekonomive të vendeve të Evropës Lindore dhe të Mesme. Kur Kryeministri hungarez tentoi të sigurojë paratë për ndihmë ekonomisë hungareze e cila gjendet para kolapsit financiar, por edhe për shtetet e tjera fqinje, kësaj inisiative iu kundërvu njëra nga vendet e rralla anëtare të UE-së, që ka sufikit në bilancin e pagesave: Gjermania. Kancelarja Merkel mendon që ndihma për dhjetë vendet e reja anëtare të UE-së të cilat i janë bashkëngjitur para 5 vjetëve, në të vërtetë do të ishte e tepruar (Selmani, 2009).

Dhe krejt në fund, mund të thuhet që fillimi i prosperitetit në ekonominë globale do të varet nga suksesi dhe kohëzgjatja e masave antirecesive, të cilat po i ndërmarrin ekonomitë e vendeve më të fuqishme në botë. Njëkohësisht kjo është e vetmja mënyrë e daljes nga kriza ekonomike që ka përfshirë botën. Pra gjasat e daljes nga kriza për ekonominë globale janë reale. Por, në lidhje me atë se a do të zgjatë kjo 2, 3 apo më shumë vite, askush tani për tani nuk mund të jetë i sigurtë. Mirëpo, një gjë tashmë është e njohur. Që të gjitha ekonomitë shtetërore po ndërmarrin masa antirecesive përmes programeve të stabilizimit, me qëllim që të shpëtojnë atë çka është e mundur të mbrohet në këtë situatë të krizës ekonomike globale, të paparë në 80-të vitet e fundit në ekonominë botërore.

KAPITULLI I GJASHTË

ANALIZA, DISKUTIME, KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

6. Analiza statistikore e efekteve të krizës në Kosovë

Në këtë pjesë të veçantë të punimit, dëshirojmë të arrijmë në përfundime vërtetuese dhe konkluzione, që na bëjnë të mundur të shohim lidhjen mes faktorëve që kanë pasur ndikim në kohë krize në ekonominë e Kosovës.

Remitencat dhe Investimet e huaja direkte ishin prekur më së shumti nga kjo krizë. Por, duke dashur të hulumtojmë detajisht, në të njëjtën kohë do të arrijmë në argumentimin e lidhjes mes remitencave dhe krizës financiare, apo saktësisht se pse kriza financiare u reflektua në uljen e dërgesave të emigrantëve dhe Investimet e huaja direkte në Kosovë.

Duke u bazuar gjithmonë në hulumtime, dua të jap një përgjigje shkencore se a ka lidhje mes masës dhe sasisë së remitencave dhe krizës, a ka lidhje mes remitencave dhe bashkimit familjar apo kompletimit të familjeve që emigrantët tanë kanë bërë gjatë kohës së analizës sonë. A janë shkaqet e pasigurisë dhe pagat e ulëta faktorë të rënies së sasisë së parave që dërgojnë emigrantët tanë? Po ashtu, në këtë hulumtim kam përdorur pyetësorë që kanë edhe pyetje të tjera mbi sasinë, lartësinë, formën dhe kanalet e dërgimit të remitencave. Përgjigjet e marra na japin të kuptojmë se remitencat vijnë kryesisht në rrugë jozyrtare apo në dorë (mbi 75 %) e kjo është një bazë e fortë që këto para ndikojnë në informalitet dhe në një matje jo shumë të sigurtë të fuqisë reale të tyre.

Mirëpo, synim i këtij punimi është që të argumentohet hipoteza H1. Kriza financiare globale ka prekur Kosovën, ka ngadalësuar remitencat dhe ka ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në uljen e investimeve të huaja direkte në Kosovë. Duke u bazuar në të gjeturat faktike, në baza shkencore argumentojmë këtë hipotezë dhe konstatojmë lidhjen e krizës globale financiare me remitencat. Nga analiza e pyetësorëve rezultoi që faktorët kryesorë që ndikojnë në lartësinë e dërgesave të emigrantëve janë:

1. Kriza financiare apo gjendja e ekonomisë në vendin pritës
2. Bashkimi i familjes apo rritja e familjes
3. Pasiguria në punë dhe pagat
4. Rritja e kostos së jetesës, sidomos arsimimi i fëmijëve

5. Mungesa e lejeve për punë dhe kriminaliteti

Renditje të këtyre faktorëve që ndikojnë në të ardhurat nga remitencat sipas lidhjes së tyre, kam tentuar që me modele të thjeshta të mund të argumentoj fortësinë e tyre.

Për të bërë analizën e faktorëve kryesorë ka mjaft metoda por për arsye se të dhënat e marra nga pyetësorët janë të dhëna subjektive dhe jo të shumta në numër, jam detyruar që të përdor një nga metodat më të thjeshta. Kjo është Metoda e tabelave të paparashikueshmerisë (kontigjencës).

I. Tabela e paparashikueshmerisë (kontigjencës)³³

Tabelat e paparashikueshmerisë për të dhënat tona bazohen në një tabelë me 2 hyrje ose një tabelë dykahëshe e rastit që jep vlerat e vrojtura njëkohësisht të dy ndryshoreve statistikore e kategorike (cilësore, sasiore).

Le të jenë: $(x_1, y_1) \dots (x_n, y_n)$ të dhënat për përkatësisht dy ndryshore cilësore X dhe Y. Një përshkrim i thjeshtë i çiftit $(X; Y)$ është paraqitja e vlerave x_i dhe y_i në formën e një table me dy hyrje që quhet tabela e kontigjencës me 2-hyrje.

Nëse $p_1, p_2, \dots, p_k$ modalitetet e ndryshores X, ndërsa: $q_1, q_2, \dots, q_r$ modalitetet e ndryshores Y. Atëhere matrica me rendin $k \times r$, që ka si elemente numrat x_{ij} , ku x_{ij} është numri i individëve që kanë përkatësisht vlerat p_i dhe q_j , $i=1, \dots, k$, $j = 1, \dots, r$ është tabela e kontigjencës e ndryshoreve X dhe Y. Duke u bazuar në teorinë e paparashikueshmerisë, paraqesim zbatimin e saj në studimin tonë.

Në vijim po paraqesim të dhënat e mbledhura dhe të përpunuara me qëllim të argumentimit të variabëlve të varura dhe të pavarura nga pyetësi ynë. Pra, duam të shohim lidhjen se:

1. Sa është sasia e dërgesave gjatë viteve të analizuar?
2. Cilat janë arsyet e këtyre dërgesave?

³³ Tabela e paparashikueshmerisë-kontigjencës, aplikohet në analizat statistikore në një format të matricës që tregon shpërndarjen (multivariate) frekuencë të variablove . Ata janë përdorur kryesisht në kërkimin e studimit , të zbulimit të biznesit , inxhinieri dhe kërkimit shkencor . Ato japin një pasqyrë themelore të ndërlidhjes në mes të dy variablove dhe mund të ndihmojë për të gjetur ndërveprimet mes tyre . Tabela Termi paparashikuara është përdorur më parë nga Karl Pearson në "Për Teoria e paparashikuara dhe marrëdhëniet e saj me Shoqatën dhe Korrelacioni Normal ", në vitin 1904 .


Tabela në vijim paraqet bazën e të dhënave për dy hyrjet dhe ndryshoret e tyre.

Tabela 36. Të dhënat numerike mbi arsyet e rënies së remitencave

Sasia / Arsyja	Kriza	Bashkimi i familjes	Papunësia	Paga	Total
Pak	87	22	27	4	140
Aspak	35	46	11	5	97
Total	122	68	38	9	237

Burimi: Të dhëna nga pyetësi

Grafiku 35. Të dhënat numerike mbi arsyet e rënies së remitencave




Të dhënat sipas rreshtave të nxjerrë nga lart si dhe frekuencat e sasisë dhe shkakut të remitencave.

Tabela 37. Të dhënat në përqindje mbi arsyet e rënies së remitencave

Sasia / Arsyja	Kriza	Bashkimi i familjes	Papunësia	Paga	Total
Pak	62.14	15.71	19.29	2.86	100
Aspak	36.08	47.42	11.35	5.15	100
Total	49.11	31.56	15.32	4.01	100

Burimi: Të dhëna nga pyetësi

Grafiku 36. Të dhënat në përqindje mbi arsyet e rënies së remitancave




Frekuencat e lidhjes së sasisë së remitencave më të dhënat bazë nga pyetjet në lidhje me faktorët që ndikuan në uljen e remitencave

Tabela 38. Frekuencat e lidhjes së sasisë së remitencave me krizën

Sasia / SHKËU	Kriza	Bashkimi i familjes	Papunësia	Paga	Mbledhja	Totali
Pak	71.31	32.35	71.05	44.44	219.15	54.79
Aspak	28.69	67.65	28.95	55.56	180.85	45.21
Total	100	100	100	100	400	100.00

Burimi: Të dhëna nga pyetësori

Grafiku 37. Frekuencat e lidhjes së sasisë së remitencave me krizën



Për të argumentuar hipotezën se kriza globale ka ndikuar në remitenca dhe se ato kanë një sërë faktorësh që ndërlidhen mes veti, e vërtetojmë përmes tabelës së paparashikueshmerisë ku trajtojmë lidhjen e dy varianteve sipas frekuencave të tyre.

Duke u bazuar në modelet statistikore, tabela e paparashikueshmerisë me dy hyrje (shkaku dhe sasia) mund të zgjerohet në tabela me shumë hyrje për të matur variancën multinominale. Nëse arrijmë të kuptojmë se pavarësia statistikore në mes të X_1 dhe X_2 , është paraqitur teorikisht në tabelat tona të analizës dhe grafikut, atëherë zbatueshmërinë e saj do ta shohim konkretisht në tabelën 39.

Tabela 39. Pavarësia statistikore e pa parashikueshmerisë

	$X_1 = 0$ (Pak)	$X_1 = 1$ (Aspak)	TOTALI
$X_2 = 0$ (Kriza, papunësia, paga)	118	51	169
$X_2 = 1$ (Bashkimi familjare)	22	46	68
TOTALI	140	97	237 (=N)

Burimi: Të dhëna nga pyetësi

Nga analiza e rezultateve të këtushme, shohim konkretisht që variablat të janë të varura me krizën.

Tani le të tentojmë që bazuar po në këtë model, të ndajmë krizën nga faktorët e tjerë. Tashmë kjo tabelë merr një trajtë të re, siç e shohim në vijim (tabela 40).

Tabela 40. Tabela e paparashikueshmerisë që vërteton trajtën 2 x 3

	$X_1 = 0$ (Pak)	$X_1 = 1$ (Aspak)	TOTALI
$X_2 = 0$ (Kriza, papunësia, paga)	87	35	122
$X_2 = 1$ (Bashkimi familjare)	22	46	68
TOTALI	109	81	190 (= n)

Burimi: Të dhëna nga pyetësi

Siç vërehet, kjo na paraqet një vërtetësi të plotë. Mirëpo, këtë sërish tentojmë ta argumentojmë edhe më shumë në trajtën e paparashikueshmerisë në vijim 2/3.

Nëse e marrim për bazë Tabelën 39 dhe e njohim si tabelë bazë për këtë nivel, (kriza , papunsia dhe paga) atëherë pavarësia statistikore saktesohet nga teorema që: “Nëse dy ndryshoret e tabelës së paparashikueshmerisë 2x3 janë të pavarura statistikisht, atëhere vërtetohet barazimi:

$$X_{11}X_{22} - X_{12}X_{21} = X_{12}X_{23} - X_{22}X_{13} = X_{13}X_{21} - X_{11}X_{23} = 0$$

Pra, kjo që u tha më lart në tabelën e paparashikueshmerisë, mund të zgjerohet edhe në tabelat e tjera, posaçërisht në trajtën 2 n, me kusht që $n \geq 3$.

Tabela 41. Tabela e paparashikueshmerisë që vërteton trajtën 2 x 4

	$X_1 = 0$	$X_1 = 1$	$X_1 = 2$	$X_1 = 3$	TOTALI
$X_2 = 0$ (Pak)	87	22	27	4	140
$X_2 = 1$ (Aspak)	35	46	11	5	97
TOTALI	122	68	38	9	237 (=N)

Burimi: Të dhëna nga pyetësi

Pra, ketu mund të shohim se variablet janë të varura dhe ky ndryshim është i vërtetë edhe për rastet e përgjithshëm që argumentojnë ndikimin e krizës dhe faktorëve të saj.

Nëse tentojmë të vërtetojmë hipotezën mbi dy ndryshoret cilësore dhe nëse ato janë të pavarura, shohim se rezultatet përdoren edhe për ndryshoret sasiore.

Le të jenë X dhe Y dy ndryshore cilësore. Atëherë modalitetet e ndryshores X janë: $p_1, p_2, \dots, p_k$, ndërsa modalitetet e ndryshores Y janë: $q_1, q_2, \dots, q_r$. Përkufizimi është i pavarur dhe duket: $P(X=k, Y=r) = P(X=k) \cdot P(Y=r)$, ku për çdo çift vlerash k dhe r të X-it apo Y-it, paraqiten në katror për të vërtetuar hipotezën.

H_0 : X dhe Y janë të pavarura

H_1 : X dhe Y nuk janë të pavarura

Duke përdorur testin e Hi-katrore, do të marrim në konsideratë të gjitha shkaqet, dhe më pas do të ndalemi vetëm në dy nga to, si: bashkimi familjar dhe kriza. Fillimisht, të shohim se si duket lidhja në mes të krizës financiare, bashkimit familjar, papunësisë dhe pagës së ulët në sasinë e remitencave të dërguara gjatë kohës së analizës, dhe kjo kohë janë vitet 2008 - 2013.

Për të argumentuar këtë, po përdorim Tabelën 40, e cila do të na krijojë një tabelë të re të lidhjes së frekuencave.

Tabela 42. Frekuenca e lidhjes së sasisë së remitencave me shkaqet

	X ₁ =0	X ₁ =1	X ₁ =2	X ₁ =3	TOTALI
X ₂ =0	87	22	27	45.32	140
(Pak)	72.0	40.17	22.45		
X ₂ =1 (Aspak)	35	46	11	5	97
	49.93	27.83	15.55	3.68	
TOTALI	122	68	38	9	237 (=N)

Burimi: Të dhëna nga pyetësi

Duke e llogaritur vlerën statistikore përmes metodës Hi-katrorë, konstatoj se bie poshtë hipoteza se sasia e remitencave të dërguara viteve të fundit është e pavarur nga kriza financiare globale. Në përgjithësi pritet që sasia e remitencave të jetë e varur nga bashkimi familjar (ritja e numrit të banorëve brenda familjes në mërgim). Ajo që ne kërkojmë të vërtetojmë këtu është së rënie e sasisë së remitencave nuk vjen vetëm si pasojë e shkakut, por kryesisht e krizës financiare globale dhe variablëve të varur nga kriza. Për këtë arsye, verifikojmë edhe një herë kontrollin e hipotezave duke marrë si tip “shkaqet” me dy modalitetet: kriza dhe bashkimi familjar si dhe kriza e paga. Duke u nisur nga tabela e paparashikueshmerisë 2 x 2, do të kemi:

Tabela 43. Tabela e paparashikueshmerisë 2 x 2, “shkaqet” në dy modalitetet

	X ₁ =0	X ₁ =1	TOTALI
X ₂ =0 (Pak)	87	22	109
	(69.99)	(39.01)	
X ₂ =1 (Aspak)	35	46	81
	(52.01)	(28.99)	
TOTALI	122	68	190 (=N)

Burimi: Të dhëna nga pyetësi

Kjo argumenton atë se ka varësi në mes remitencave të dërguara në vend dhe krizës globale financiare.

Për të përforcuar edhe më shumë këtë konstatim përfundimtar, përsërisim edhe një herë kontrollin e hipotezës, duke shtuar në sasinë e përgjigjeve, opsionin: “PO” - kriza financiare globale është shkaku kryesor i uljes së sasisë së remitencave, si dhe ato përgjigje që nxjerrin si shkak edhe papunësinë e pagat e ulëta, si pasoja të krizës në vend.

Këto dy opsione nxjerrin në dritë tabelën e poshtëshënuar:

Tabela 44. Paparashikueshmeria dhe rezultatet e shkakut kyç.

	$X_1 = 0$	$X_1 = 1$	TOTALI
$X_2 = 0$ (Pak)	118 (99.83)	22 (40.17)	140
$X_2 = 1$ (Aspak)	51 (69.17)	46 (27.83)	97
TOTALI	169	68	237 (=N)

Burimi: Të dhëna nga pyetësi

Nga kjo që është analizuar më lart, përmes tabelave të tyre të rastësisë, vërtetohen hipotezat tona, por që kjo të jetë edhe më bindëse, ne po përdorim edhe metodën e mesatares rrëshqitëse, indekset stinore dhe metodën e trendit lineare.

II. Prognozomi përmes mesatares rrëshqitëse, Modeli MA (moving average)

Për zbutjen ose eliminimin në tërësi të shmangieve dhe variacioneve, në kuadër të studimit të tendencës dhe intensitetit të dukurive, përdoret mesatarja rrëshqitëse. Sipas kësaj, çdo numër i serisë së dhënë zëvendësohet me nivelin e mesatares së filluar. Numri konstant i madhësive, në bazë të të cilave llogariten mesataret rrëshqitëse, mund të jetë tre ose më shumë, por

zakonisht duhet të jetë në numra tek. Formula për llogaritjen e serive me tri të dhëna është:

$$m_1 = \frac{x_1 + x_2 + x_3}{3}; m_2 = \frac{x_2 + x_3 + x_4}{3}; m_3 = \frac{x_3 + x_4 + x_5}{3}; \text{ ndërsa me pesë:}$$

$$m_1 = \frac{m_1 + m_2 + m_3 + m_4 + m_5}{5}; m_2 = \frac{m_2 + m_3 + m_4 + m_5 + m_6}{5}; m_3 = \frac{m_3 + m_4 + m_5 + m_6 + m_7}{5}$$

Nëse analiza duhet të bëhet për disa vite (apo periudha) të ecursisë së një dukurie, atëherë metoda e mesatares rrëshqitëse duhet të përdoret për ato periudha që është analizuar. Në punim kemi analizuar vitet nga 2008 - 2013, që ishin fokusi i hulumtimit në kohë krize.

Për të qartësuar studimin tonë, së pari llogarisim me tre të dhëna, duke përdorur metodën e mesatares rrëshqitëse:

$$m_1 = \frac{x_1 + x_2 + x_3}{3} = \frac{608.72 + 585.70 + 584.33}{3} = \frac{1778.75}{3} = 592.92$$

$$m_2 = \frac{x_2 + x_3 + x_4}{3} = \frac{585.70 + 587.33 + 584.81}{3} = \frac{1754.83}{3} = 584.95$$

$$m_3 = \frac{x_3 + x_4 + x_5}{3} = \frac{584.83 + 584.81 + 605.63}{3} = \frac{1774.77}{3} = 591.59$$

$$m_4 = \frac{x_4 + x_5 + x_6}{3} = \frac{584.81 + 605.63 + 620.83}{3} = \frac{1811.27}{3} = 603.75$$

Po ashtu, llogaritet mesatarja rrëshqitëse me pesë të dhëna dhe rezultatet inkorporohen në tabelën në vijim:

$$m_1 = \frac{x_1 + x_2 + x_3 + x_4 + x_5}{5} = \frac{608.72 + 585.70 + 584.33 + 584.81 + 605.63}{5} = \frac{2969.19}{5} = 593.84$$

$$m_2 = \frac{x_2 + x_3 + x_4 + x_5 + x_6}{5} = \frac{585.70 + 584.33 + 584.81 + 605.63 + 620.83}{5} = \frac{2981.3}{5} = 596.26$$

Tabela 45. Tabela e llogaritjes përmes mesatares rrëshqitëse, të dhënat janë në mil. euro

Viti	Të dhënat	Niveli i mesatares rrëshqitëse	
	Remitencat në milionë €	Me 3 të dhëna	Me 5 të dhëna
2008	608.72	-	-
2009	585.7	592.92	-
2010	584.33	584.85	593.83
2011	584.81	591.95	569.26
2012	605.63	603.75	-
2013	620.83	-	-

Burimi: Të dhëna të përpunara nga autori

Nëse marrim për bazë vitin 2008 kur kemi edhe refleksionet e para të krizës financiare globale në Evropë, dhe rezultatet e dala nga Modeli MA, mund të konstatojmë se kemi rënie të mesatares së investimeve për 3 vitet (2008, 2009, 2010) nga 608.72 milionë euro në një mesatare prej 592.92 milionë euro.

Po ashtu, nëse marrim mesataren për 5 vitet nga viti bazë (2008 = 2008, 2009, 2010, 2011, 2012), atëherë mund të konstatojmë se kemi rënie prej 14.89 milionë euro në periudhën e krizës që kemi analizuar.

Kjo do të duket kështu:

1. Për nivelin e mesatares rrëshqitëse me 3 seri, duke filluar nga viti 2008 si bazë, do të kemi:
remitenca për vitin bazë 2008 = 608.72 milionë € – 592.92 mil € = 15.8 milionë €
2. Për nivelin e mesatares rrëshqitëse me 5 seri, duke filluar nga viti 2008 si bazë do të kemi:
remitenca për vitin bazë 2008 = 608.72 milionë € – 593.83 mil € = 14.89 milionë €

III. Llogaritja përmes Metodës së trendit linear, Modeli $Y_i = Y_c$

Analiza e serive kohore është kryer në tri dimensionet: a) studimi i trendit; b) studimi i luhatjeve nga trendi; c) çrregullimet seriale. Trendi tregon rritjet ose rëniet afatgjate në të dhënat, ku rritjet dhe rëniet sipas serive në disa raste janë lineare dhe në disa të tjera jolineare. Ciklet janë luhatjet afatgjate nga trendi i të dhënave të një serie të vërtetuar. Kurse çrregullimet janë funksion i faktorëve të rastit që ndikojnë sjelljet në të dhënat e serisë së vërtetuar.

Përmes metodës së trendit zbulohen tendencat e ecjes dhe të zhvillimit të dukurisë, në një periudhë të caktuar kohore. Kjo arrihet duke i përcjellë ndryshimet sasiore dhe cilësore gjatë periudhës zhvillimore të dukurisë. Përmes aplikimit të metodave dinamike, tentohet të eliminohen apo të zbuten ndryshimet a variacionet që luhaten në afate të gjata.

Prej të gjitha metodave të analizës dinamike, më e përshtatshme është trendi, që është dukuria në lëvizje. Në analizën dinamike trendi paraqet vijën e tendencës qendrore të zhvillimit kohor të dukurisë masive. Pra, ajo shpreh nivelin mesatar të ecjes së dukurisë në periudhë të gjatë kohore.

Tabela 46. Remitenca në Kosovë në vitet 2008 - 2013. Vlera në milionë euro

Viti	2008	2009	2010	2011	2012	2013
Kosovë	608.72	585.70	584.33	584.81	605.63	20.83

Tabela 47. Llogaritja e trendit linear. Remitenca në Kosovë në vitet 2008 -2013, në milionë euro

Viti	Të dhënat Remitencat y_i në milionë euro	Shenjat e periudhës x_i	x_i^2	$x \cdot y$	y_c
2008	608.72	-2.50	6.25	-1521.8	595.14
2009	585.7	-1.50	2.25	-878.55	596.42
2010	584.33	-0.50	0.25	-292.165	597.70
2011	584.81	0.50	0.25	292.405	598.98
2012	605.63	1.50	2.25	908.445	600.26
2013	620.83	2.50	6.25	1514.07	601.54
	3590.02		17.5	22.41	3590.02

Burimi: Autori

Përmes aplikimit të trendit, fitohen seri me të dhëna të reja të rregulluara nga seria faktike. Kjo bëhet e mundur duke aplikuar procesin e interpolimit dhe ekstrapolimit të trendit, duke aplikuar funksionin: $Y_i = Y_c$, ndërsa $Y_c = a + bx$, pra gjinden parametrat **a** dhe **b** si në vijim:

$$a = \frac{\sum y}{n} = \frac{3590.02}{6} = 598.34 \quad b = \frac{\sum x \cdot y}{\sum x^2} = \frac{22.41}{10} = 1.28$$

Pastaj e zëvendësojmë në funksion rezultatin e dy parametrave: $a = 598.34$ dhe $b = 1.28$

$$y_{c_{2008}} = a + bx = 598.34 + 1.28(-2.5) = 595.14$$

$$y_{c_{2009}} = a + bx = 598.34 + 1.28(-1.5) = 596.42$$

$$y_{c_{2010}} = a + bx = 598.34 + 1.28(-0.5) = 597.70$$


$$y_{c_{2011}} = a + bx = 598.34 + 1.28(0.5) = 598.98$$

$$y_{c_{2012}} = a + bx = 598.34 + 1.28(1.5) = 600.26$$

$$y_{c_{2013}} = a + bx = 598.34 + 1.28(2.5) = 601.54$$

Meqenëse të dhënat për të ardhurat nga remitencat janë të pakta dhe të pastabilizuara, pothuajse të gjitha parashikimet, me të gjitha metodat, japin rezultate të njëjta.

Grafiku 38 Diagrami i pranimi të remintancave 2008-2013



Përmes analizës dinamike, konkretisht metodës së trendit, marrim për bazë vitin 2008, kohë kjo kur kriza financiare ishte në kufijtë e vendeve të origjinës nga edhe vijnë remitencat. Duhet theksuar se viti 2008 ishte një vit shumë i suksesshëm për sa i përket remitencave, nëse e krahasojmë me vitin paraparak 2007 (që pati 18.1 % rritje krahasuar vitin 2007).

Në vitin 2009 kishim rënie prej 3.8 % të remitencave në krahasim me vitin 2008, që llogaritur në masë monetare i bie 23.2 milionë € më pak të hyra të evidentuara.

Në vitin 2010 ka pasur rënie prej rreth 0.24 % në krahasim me vitin 2009, që llogaritur në masë monetare i bie 370 mijë € më pak të hyra të evidentuara.

Kjo është periudha kur në vendet e zhvilluara vazhdonte kriza ekonomike, e cila pati dhe vazhdon të ketë ndikim edhe sot e kësaj dite në vlerën e remitencave që dërgohen për në Kosovë.

Në vitin 2011 pati rritje shumë të lehtë të remitencave të dërguara në krahasim me vitin 2010. Trendet rritëse janë edhe për vitin 2012, ku gjatë këtij viti shuma e remitencave të dërguara u rrit për 3.6 % krahasuar me një vit më parë.

Të gjithë këto të dhëna, më së miri mund të vërehen edhe nga grafiku i lartshënuar dhe në tabelën përkatëse, ku është paraqitur ecuria e remitencave që nga viti 2008 e deri në vitin 2013.

Duke u nisur nga analiza statistikore e përdorur në këtë pjesë të punimit, bazuar në tabelën e paparashikueshmerisë, llogaritjes bazë dhe përdorimit të testit Hi-katrorë, metodës së mesatares rrëshqitëse dhe metodën e trendit ($Y_i = Y_c$), do të dalim në përfundime statistikore të cilat argumentojnë hipotezat paraprake se:

1. Kriza globale financiare dhe bashkimi familjar janë faktorët kryesorë të uljes në sasi të remitencave në vend
2. Faktorët e tjerë si: pagat e ulëta, pasiguria në punë, gjendja socio -ekonomike dhe konsumi, kanë ndikim por janë kryesisht të lidhur me krizën dhe janë derivat i saj
3. Analiza që krahason se si pozicionohen remitencat kundrejt faktorëve të tjerë të krizës së IHD-ve, kursimeve, papasurisë etj., nxjerr në pah rolin e secilit indikator dhe të të gjithëve së bashku në ekonominë e brendshme
4. Remitencat, viteve të fundit të analizës sonë, kanë filluar të përmirësohen dukshëm dhe mund të konstatojmë se viti 2012 dhe viti 2013 kanë rritje të theksuar në sasinë e dërgesave dhe kanë përmirësuar trendin e tyre në përgjithësi
5. Mirëpo , kjo nuk do të vlejë për investimet e huaja sepse në këto gjashtë vitet e fundit, shqetësim më i madh është rënia shumë e theksuar e sasisë së IHD-ve në Kosovë, e që është reduktuar për 29 %. Kjo tregon një opsion jo fort interesant të tërheqjes së investimeve të huaja në vend dhe njëkohësisht shfaq shenja të një ekonomie ku niveli i jetesës dhe konsumi janë të lidhura ngushtë me kontributin e diasporës, si një kategori e rëndësishme në jetën ekonomike të vendit.

IV. Prognozimi i IHD-ve përmes mesatares rrëshqitëse, Modeli MA

Investimet e huaja direkt (IHD) në vitin 2007 kanë qenë më të larta (440.7 milionë €) dhe vitet e tjera menjëherë kemi rendje të mëdha, pra ka shënuar një rënie të konsiderueshme çdo vit që nga ai vit. Pra, orientim yni në këtë punim ishte që të matim këtë lëvizje dhe ndikimin e saj në ekonominë e Kosovës.

Për të qartësuar studimin tonë, së pari llogarisim me 3 të dhëna duke përdorur metodën e mesatares rrëshqitëse:

$$m_1 = \frac{x_1 + x_2 + x_3}{3} = \frac{366.45 + 287.41 + 365.8}{3} = \frac{1019.66}{3} = 339.89$$

$$m_2 = \frac{x_2 + x_3 + x_4}{3} = \frac{287.41 + 365.80 + 393.86}{3} = \frac{1047.07}{3} = 349.02$$

$$m_3 = \frac{x_3 + x_4 + x_5}{3} = \frac{365.80 + 393.86 + 228.64}{3} = \frac{988.30}{3} = 329.43$$

$$m_4 = \frac{x_4 + x_5 + x_6}{3} = \frac{393.86 + 228.64 + 259.02}{3} = \frac{881.52}{3} = 293.84$$

Po ashtu, llogaritet mesatarja rrëshqitëse me 5 të dhëna dhe rezultatet inkorporohen në tabelën në vijim:

$$m_1 = \frac{x_1 + x_2 + x_3 + x_4 + x_5}{5} = \frac{366.45 + 287.41 + 365.80 + 396.86 + 228.64}{5} = \frac{1642.16}{5} = 328.43$$


$$m_2 = \frac{x_2 + x_3 + x_4 + x_5 + x_6}{5} = \frac{287.41 + 365.80 + 396.86 + 228.64 + 259.02}{5} = \frac{1534.73}{5} = 306.95$$

Tabela 48. Tabela e llogaritjes përmes mesatares rrëshqitëse për IHD

Viti	Të dhënat	Niveli i mesatares rrëshqitëse	
	IHD në milionë €	Me 3 të dhëna	Me 5 të dhëna
2008	366.45	-	-
2009	287.41	339.89	-
2010	365.8	349.02	328.43
2011	393.86	329.43	306.95
2012	228.64	293.84	-
2013	259.02	-	-
Mesatarja	X= IHD/n	328.04	317.69

Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori

Grafiku 39. IHD në Kosovë gjatë kohës së krizës globale financiare



Burimi: Të dhëna nga BQK 2014

Nëse marrim për bazë vitin 2008 kur kemi edhe refleksionet e para të krizës financiare globale në Europë, dhe rezultate e dala nga Modeli MA, mund të konstatojmë se kemi rënie të mesatares së investimeve për 3 vitet (2008, 2009, 2010) nga 608.72 milionë euro në një mesatare prej 592.92 milionë euro.

Po ashtu, nëse marrim mesataren për 5 vitet nga viti bazë (2008 = 2008, 2009, 2010, 2011, 2012), atëherë mund të konstatojmë se kemi rënie prej 14.89 milionë euro në periudhën e krizës që kemi analizuar.

Kjo do të duket kështu:

1. Për nivelin e mesatares rrëshqitëse me 3 seri (2008 - MA3): IHD për vitin bazë 2008 = 366.45 milionë € - 328.04 mil € = 38.41 milionë €, pra mesatarisht 38.41 milionë € më pak investime
2. Për nivelin e mesatares rrëshqitëse me 5 seri (2008 - MA5): IHD për vitin bazë 2008 = 366.45 milionë € - 317.69 mil € = 48.76 milionë €, pra mesatarisht 48.64 milionë € më pak investime
3. Përmes metodës së Gjerësisë së variacionit, ku paraqitet maksimumi minus minimumin e të hyrave, IHD-të do të duken kështu: $Gjv = x_{\max} - x_{\min} = 366.45 - 228.46 = 137.99$ milionë €

V. Llogaritja e IHD-ve përmes treguesit absolut dhe relativ të variacionit

Nga të dhënat e IHD-ve do të llogarisim Treguesit absolutë të variacionit, për vitet e analizuar të periudhës 2008 - 2013, kohë kjo kur kriza financiare la gjurmët e saj.

Tabela 49. Treguesit absolutë të variacionit për IHD-të në Kosovë në miliona euro

Viti	Të dhënat IHD në milionë €	$(x_i - \bar{x})$	$(x_i - \bar{x})^2$
2008	366.45	49.59	2458.84
2009	287.41	-29.45	867.50
2010	365.80	48.94	2394.80
2011	393.86	77.00	5928.49
2012	228.64	-88.22	7783.36
2013	259.02	-57.84	3345.85
Total	1901.18	0.00	22778.83

Burimi: Të dhëna të përpunuara nga autori

Shmangia mesatare kuadratike apo varianca, paraqet madhësinë mesatare të shmangieve të të dhënave në katror nga mesatarja aritmetike. Varianca sillet prej 0 deri në $+\infty$ dhe shënohet përmes shkronjës së vogël sigma σ^2 .

Prej kësaj përfundojmë se vargu i numrave është homogjen (vlera mesatare $\bar{X}$ më mirë e përfaqëson atë varg) sepse vargu i parë ka devijim mesatar absolut më të vogël se sa vargu i dytë. Që të mund të llogarisim treguesit e variacionit, së pari duhet gjetur mesi aritmetik. Kështu kemi:

$$\bar{x} = \frac{\sum x_i}{n} = \frac{1901.18}{6} = 316.86 \text{ milEuro}$$

Që t'u shmangemi llogaritjeve me vlerë absolute është treguar më e leverdisshme që për masë të devijimit të vlerave të karakteristikës x nga mesi aritmetik $\bar{x}$, të merret katrori mesatar i devijimit të vlerave $x_1, x_2, \dots, x_n$ nga $\bar{x}$, dhe kjo do të japë këto rezultate:

$$\sigma^2 = \frac{\sum (x_i - \bar{x})^2}{n} = \frac{22778.83}{6} = 3796.47.$$

Ndërsa, që të shohim se sa është devijimi standard, atëhere përdorim formulën e tij, ku vlera e variancës futet në rrënjën katrore, pra devijimi standard për IHD-të gjatë periudhës 2008 - 2013 do të duket kështu:

$$\sigma = \sqrt{\frac{\sum (x_i - \bar{x})^2}{n}} = \sqrt{\frac{22778.83}{6}} = \sqrt{3796.47} = 61.61$$

Dispersioni është devijimi standard i shumëzuar me rezultatin e rrënjës katrore të dyshit ((2)^{0.5}). Përmes dispersionit krahasohen shmangiet mesatare lineare me ato të madhësive mesatare. Në të dhënat për IHD-të në Kosovë gjatë viteve 2008 - 2013 do të kemi:

$$\delta = \sigma \cdot \sqrt{2} = 61.61 \cdot 1.414 = 87.12 \text{ milionë euro}$$

Koefiçienti i variancës është tregues relativ i cili shpreh madhësinë relative të raportit në mes të devijimit standard dhe mesatares aritmetike të dukurisë masive. Varësisht nga karakteristikat e dukurisë dhe qëllimit të analizës statistikore, koefiçienti i variancës shprehet në formë të thjeshtë si koefiçient ose si madhësi numerike në përqindje. Nga analiza e IHD-ve në Kosovë do të kemi:

$$K_v = \frac{\delta}{\bar{x}} = \frac{61.61}{316.83} = 0.1944 \text{ si koefiçiente apo shprehur në përqindje}$$

$$K_v = \frac{\delta}{\bar{x}} = \frac{61.61}{316.83} = 0.1944 \cdot 100 = 19.44\%$$

Nga ky model i llogaritjes, vërehet se lartësia e koefiçientit të variancës kushtëzohet nga madhësia e variancës, përkatësisht e devijimit standard.

Koefiçienti i fituar si rezultat i raportit të mesit aritmetik, tregon shmangie mesatare të tiparit që është 19.44 % nga mesi aritmetik.

VI . Llogaritja e IHD-ve përmes indekseve bazë

Për studimin e dinamikës së dukurive të ndryshme dhe krahasimin mes tyre, përdoren më së shumti treguesit relativë që quhen indekse. Përmes indekseve bëhet krahasimi i të dhënave të periudhave të ndryshme kohore dhe i dukurive të ngjashme statistikore.

Indekset shprehin raportin e niveleve të caktuara të një dukurie në periudha të ndryshme kohore. Indekset pra, pasi shprehin raportin në mes të dy madhësive, atëhere ato janë madhësi relative që shprehen zakonisht në përqindje.

Në këtë punim, për të ardhur deri tek një rezultat më i qartë, kam përdorur metodën e **indeksit bazë**, që paraqet raportin e nivelit të serisë kohore ndaj nivelit të serisë kohore e zgjedhur si bazë krahasimi. Pra, të gjitha të dhënat vihen në raport me një nivel që e caktojmë paraprakisht si bazë dhe e shohim ndryshimin relativ që ekziston në mes të niveleve të ndryshme me atë nivel të marrë për bazë.

Shprehja e masës së variacionit në përqindje ia shton vlerën këtij treguesi, sepse është më i përdorshëm dhe më i kuptueshëm në studimin e variacionit të dukurisë masive.

Tabela 50. Indeksi i vlerës së investimeve (viti 2008 është vit bazë)

Viti	Të dhënat IHD në milionë €	Indeksi bazë 2008	Ndryshimi në vitin 2008
2008	366.45	100.00	100.00
2009	287.41	78.43	-21.57
2010	365.80	99.82	-0.18
2011	393.86	107.48	7.48
2012	228.64	62.39	-37.61
2013	259.02	70.68	-29.32
Total	1901.18	-	-

Burimi: Të dhëna nga punimi doktoral

Nga kjo llogaritje verifikohet qartë se kemi rënie permanente gjatë gjithë kohës së analizuar, duke marrë për bazë vitin 2008, kur edhe reflektohet kriza financiare globale në vendin tonë, me përjashtim të vitit 2011 ku kemi një rritje të lehtë prej 7.48 %.

Pra, nga kjo verifikohet hipoteza bazë se kriza financiare ka prekur IHD-të dhe ekziston një lidhje e fortë në mes të krizës dhe investimeve. Në kontekstin tonë, mund të konkludojmë se duhet ndërhyrë urgjent në përmirësimin e imazhit për të bindur investitorët potencialë që të investojnë në Kosovë.

Nga kjo mund të konstatojmë se:

1. Një nga arsyet për rënie të konsiderueshme gjatë periudhës 2008 - 2010 mund t'i atribuohet krizës financiare globale
2. Është gjithashtu e rëndësishme të theksohet se privatizimi i ndërmarrjeve publike zakonisht sjell sasi më të madhe të investimeve të huaja direkte, prandaj rënia mund t'i atribuohet edhe fundit të valëve më të mëdha të privatizimit në vend.
3. Arsyet kryesore për rënien e IHD-ve kryesisht mund t'i faturuhet imazhit të keq të Kosovës, të krijuar nga niveli i lartë i korrupsionit (Indeksi i Perceptimit të Korrupsionit rendit Kosovën në vendin e 111-të nga 177 pozicione me një rezultat 33/100), zhvatjes, krimit të organizuar, burokracisë dhe probleme të tjera të ngjashme
4. Duke marrë për bazë vitin 2008 kur edhe reflektohet kriza financiare globale në vendin tonë, kemi rënie të vazhdueshme ku mesatarja e rënieve të IHD-ve është 16.24 %, me përjashtim të vitit 2011 ku kemi një rritje të lehtë prej 7.48 %
5. Sa i përket origjinës së IHD-ve, vendet e Bashkimit European (BE) vazhdojnë të jenë investitorët kryesorë në Kosovë

6.1. Diskutim mbi gjetjet kryesore

Shkakut kryesor të krizës financiare është fakti se ka filluar në fluskën e tregut të kredive hipotekare nën standarde dhe dështimet e larta në këtë treg kredish. Një rol kyç kanë luajtur produktet financiare: letra me vlerë të kolateralizuara dhe borxhi obligacionar i kolateralizuar. Kriza e fundit financiare u shkaktua në një masë të madhe nga babëzia e institucioneve financiare: banka e kompani investimesh morën përsipër rreziqe të mëdha dhe nuk u treguan transparente në aktivitetin e tyre, si edhe nga huamarrës të etur të cilët nuk u treguan të përgjegjshëm në shlyerjen e kredive.

Derregullimi dhe institucionet rregullatorë jovigjilente kanë krijuar terrenin e duhur për zhvillimin e krizës. Kosova si shtet që është ende në tranzicion, vazhdon të përballlet me efektet e krizës globale financiare dhe do të përballlet me të edhe në vitet në vijim.

Elementi bazë i këtij punimi është vërtetimi i hipotezave të ndërtuara paraprakisht, ku argumentohen: **Hipoteza 1.** Kriza financiare globale ka prekur Kosovën, ka ngadalësuar remitencat dhe ka ndikuar direkt në uljen e investimeve të huaja direkte në Kosovë; ndërsa analiza vërteton **Hipotezën 2** se kriza globale financiare ka ndikuar drejtpërdrejtë në tranzicionin ekonomik dhe në procesin e privatizimit në Kosovë. Mund të konstatojmë se që të dyja hipotezat janë vërtetuar bindshëm dhe pyetjet kërkimore të parashtruara kanë dhënë efektin e tyre duke vërtetuar që kriza financiare globale ka ndikuar në ekonominë e Kosovës dhe në fazën e tranzicionit.

Zgjidhja e krizave, apo tejkalimi i pasojave të saj është më shumë një art sesa një shkencë. Zgjidhja e krizave (sidomos e krizave sistematike) kërkon që autoritetet të marrin parasysh jo vetëm kushtet ekonomike, por edhe mjedisin politik dhe shoqëror. Zgjidhja nuk duhet të mbështetet në dogma ideologjike të çfarëdo lloji, por duhet të mbështetet në politikë realiste. Kështu, për të përsëritur mësimin e mëparshëm, vendeve duhet t'u këshillohej që të mendonin për zgjidhjet e mundshme (brenda një kuadri të gjerë) shumë më përpara.

Si shkak për përhapjen e krizës financiare dhe ekonomike në Evropë, mund të jenë dobësitë e integritetit politik të Europës. Po ashtu duhet cekur se mungesa e rregullave të mbikëqyrjes, mungesa e unifikimit fiskal dhe bankar, kreditë hipotekare si dhe mungesa e politikave të

përbashkëta buxhetore janë ndër shkaqet që kanë ndikuar në përhapjen e krizës financiare dhe ekonomike në Europë.

Ndërsa ekonomia e Kosovës, sipas analizës që është bërë në këtë punim, del se nuk është në pozitë të mirë ekonomike. Ka probleme të shumta siç janë: papunësia e lartë, varfëria, korrupsioni dhe mungesë në zbatimin e ligjeve.

Kriza financiare dhe ekonomike e përhapur në Europë ka ndikuar edhe në ekonominë e Kosovës, por në një masë më të vogël, pra ka ndikuar në mënyrë indirekte. Kriza ka ndikuar më shumë në uljen e investimeve të huaja, në të ardhurat nga diaspora dhe në rënie të eksporteve. Sektori bankar në Kosovë, edhe pse nuk është ndikuar direkt nga kriza financiare, vazhdon të aplikojë normat më të larta në Evropë për të gjitha llojet e kredive, përfshirë edhe kreditë për zhvillimin e bizneseve dhe zhvillimin e bujqësisë. Gjithashtu, gjetje tjetër gjatë hartimit të këtij punimi janë problemet me politikat ekonomike që po përballen bizneset. Politika fiskale është në favor të bërjes biznes por jo në atë masë sa duhej të ishte, në mënyrë që të kemi një zhvillim më të suksesshëm të biznesit të vogël dhe të mesëm.

Kemi mungesë të politikave mbrojtëse, kemi mangësi në krijimin e kushteve të nevojshme për investitorët e jashtëm dhe vendorë të cilët dëshirojnë të investojnë kapitalin e tyre në Kosovë.

Ekonomia e Kosovës ka kaluar nëpër vështirësi të ndryshme financiare. Po ashtu ka pasur kufizime të shumta ekonomike që i ka sjellë për shumë vite me rradhë statusi i pazgjidhur i Kosovës, deri në vitin 2008 kur edhe bëhet shtet i pavarur.

Duhet të bëhet më shumë për krijimin e një ekonomie të qëndrueshme, ndërsa çelësi për zhvillimin ekonomik dhe për çarjen e vendit drejt BE-së, është arsimi cilësor, konkretisht investimi në përgatitjen e gjeneratave të reja. Gjithashtu në këtë drejtim, qeveritë dhe bankat qendrore të vendeve të zhvilluara, ishin aktive në ndërmarrjen e masave për të stimuluar aktivitetin ekonomik në vendet e tyre dhe kohët e fundit jemi dëshmitarë të shenjave të para të një rikuperimi ekonomik në disa ekonomi.

6.2. Konkluzione

Bazuar në analizën dhe rezultatet e këtij studimi do të përpiqemi të paraqesim disa kontribute teorike dhe konkluzione bazë mbi përshkrimin e krizës financiare globale dhe faktorëve kryesorë që kanë shkaktuar e thelluar krizën globale dhe ndikimet e saj në ekonominë në tranzicion të Kosovës. Mund të konkludohet se:

1. Krizës globale që stagnoi aktivitetin ekonomik në shume vende të zhvilluara, tashmë duket se i ka ardhur fundi, por pavarësisht shenjave bindëse për rimëkëmbjen ekonomike, situata ekonomike vazhdon të ketë ende pasiguri në shumë sektorë. Prandaj më tepër se kurrë, kërkohen lëvizje të menduara mirë dhe globalisht të bankave qendrore dhe të qeverive, e mbi të gjitha vënien në lëvizje të mekanizmave korrigjuese për të shmangur përsëritjen e një krize të tillë në të ardhmen.
2. Duke e krahasuar me krizat më të mëdha të ndodhura më parë, midis krizës aktuale dhe krizave të mëparshme ka shumë të përbashkëta, ashtu siç ka dhe ndryshime.
3. Vendet donatore kanë hezituat të rrisin ndihmën e tyre për Kosovën, për shkak të problemeve të tyre të brendshme si pasojë e krizës.
4. Kanalet kryesore përmes të cilave kriza u reflektua në ekonominë e Kosovës janë të hyrat nga jashtë, kryesisht dërgesat e emigrantëve dhe investimet e huaja direkte, të cilat u zvogëluan gjatë kësaj periudhe. Po ashtu, rënia e eksporteve të cilat edhe ashtu kishin nivel të ulët, si dhe shkalla e ulët e prodhimit e cila ndikoi negativisht në aktivitetin ekonomik në vend, duke bërë që Kosova të ketë defiçit të lartë të llogarisë rrjedhëse.
5. Rënia pasuese e dërgesave nga kosovarët të cilët punojnë jashtë vendit ka ndikim negativ në ekonominë e Kosovës në përgjithësi. Kriza e vitit 2008 ka reflektuar në uljen e dërgesave dhe ndërrimin e kanaleve të dërgimit. Këto pará që dërgohen nga diaspora në Kosovë, për shumë familje janë si burim i vetëm i të ardhurave, pasi papunësia është shumë e madhe në Kosovë.
6. Problematikë në vete paraqitet informaliteti (mbi 30 %). Në këto kohë krize, remitencat kanë ndikuar edhe më shumë në këtë drejtim, pasi mbi 75 % e të anketuarve thonë se paratë i pranojnë në dorë, që do të thotë se nuk evidentohen apo nuk tatohen as në Kosovë, e as në vendin e origjinës.
7. Sfidë e vazhdueshme për ekonominë e Kosovës në tranzicion, vazhdon të jetë norma e lartë papunësisë (rreth 40 %), e cila paraqet nevojën për normë më të lartë të rritjes

ekonomike, gjenerim më të madh të vendeve të punës dhe absorbimit të fuqisë punëtore e cila karakterizohet me një normë të lartë të rritjes.

8. Zhvillimeve financiare dhe ekonomike si pasojë e krizës, na obligojnë që të kemi politika monetare dhe fiskale të qarta dhe fleksibile në përgjigje të krizës financiare e ekonomike ku konstatuam se:
 - a) Politikat monetare të zbatuara në përgjigje të krizës globale patën efekte të vonuara dhe të pjesshme në tregjet financiare.
 - b) Edhe pse bankat qendrore ulën normat e interesit në nivele shumë të ulëta, përsëri nuk pati efekte në uljen e normave të interesit të kredidhënies.
 - c) Kjo erdhi si rezultat i faktit që nuk u diagnostikua problemi i vërtetë që shkaktoi krizën, risku i tregut, i cili më vonë shkaktoi edhe mungesën e likuiditetit.
 - d) Ndër efektet e pjesshme pozitive që pati ishin rritja e likuiditetit në treg dhe pengimii i rënies së mëtejshme të çmimeve.
9. Në kuadër të sektorit financiar, Trusti i Kursimeve Pensionale të Kosovës (TKPK) përfaqëson sektorin më së shumti të goditur, i cili shënoi një rënie të konsiderueshme në vlerën e investimeve në tregjet financiare ndërkombëtare gjatë kësaj periudhe. Trusti ka pësuar rënie në vlerën e aksioneve, por nuk ka pasur humbje.
10. Humbjet e rënda që pësuan shumë banka të mëdha ndërkombëtare do të ndikojnë në të gjitha vendet e botës, pasi këto institucione financiare kanë interesin e tyre investues në pothuajse të gjitha vendet.
11. Tregu është rregullatori kryesor i aktivitetit ekonomik, planifikimi është më tepër indikativ dhe platformë e masave të politikës makroekonomike, nëpërmjet të cilave stimulohet konkurrenca e tregut të brendshëm dhe të jashtëm, e mbështetur në tregun e hapur dhe në liberalizimin e tregtisë së jashtme, ku bëhen rregullimet e nevojshme të tregut, korrigjohen deformimet e tij dhe sendërtohen koncepti e strategjia e zhvillimit. Sistemi ekonomik siguron barazinë e subjekteve ekonomike në treg.

6.3. Rekomandime

Bazuar në analizën dhe konkluzionet e këtij studimi do të përpiqemi të japim disa rekomandime drejtuar institucioneve të Kosovës, bizneseve dhe hulumtuesve të këtyre problematikave, si një kontribut modest dhe bazë e mirë për të vazhduar më tutje:

1. Kosova me ekonomi relativisht të pazhvilluar është prekur nga kriza financiare globale dhe për të dalë nga ajo, duhet me çdo kusht të stimulohen investimet në sektorët e ekonomisë që garantojnë punësim, prodhojnë për konsumin vendas dhe përmirësojnë bilancin tregtar, pra të ndërtohet një strategji në nivel republike, e cila do të koordinojë IHD-të dhe remitencat drejt investimeve të qëndrueshëm zhvillimorë.
2. Agjencia për Promovimin e Investimeve duhet të krijojë një strategji kombëtare të veçantë për qytetaret në diasporë si dhe t'i informojë ata për mundësitë e investimeve në Kosovë. Kjo të arrihet përmes Ambasadave, zyrave konsullore, konferencave, panairove, buletineve dhe kontakteve direkte.
3. Të themelohen fonde për investime nga diaspora, si mundësi të koncentrimit të burimeve investive, të cilat janë të interesuar të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik të vendit. Të intensifikohet e koordinohet komunikimi më i mirë mes biznesmenëve që veprojnë në vende të ndryshme të botës, duke krijuar bazën e të dhënave të tyre, e cila mundëson ndërlidhjen me asociacionet e biznesit në Kosovë.
4. Institucionet e Kosovës duhet bërë përpjekje më të mëdha në përmirësimin e kushteve dhe të imazhit për rritjen e investimeve të huaja në vend, duke krijuar politika të qarta që sigurojnë një stabilitet politiko - ekonomik dhe ambient të favorshëm për të investuar.
5. Të iniciohet baza ligjore për mundësinë e shfrytëzimit të fondeve të grumbulluara, apo të mbajtura në mirëbesim nga procesi i privatizimit dhe kursimet pensionale në të mirë të zhvillimit ekonomik, apo dhënien e tyre në formë të kredive të buta për bizneset prodhuese, për agrobizneset dhe ato që eksportojnë.
6. Të aplikohen politika stimuluese dhe mbrojtëse për prodhuesit vendorë që dëshirojnë t'i zgjerojnë kapacitetet e tyre të prodhimit, duke plotësuar dhe përmirësuar kriteret për t'u bërë pjesë e tregut ndërkombëtar.
7. Luftimi i korrupsionit, evazioni fiskal dhe transparenca e korrektësia në procesin e privatizimit, duhet të jetë prioritet i institucioneve shtetërore për mundësinë e zhvillimit ekonomik më të shpejtë të Kosovës.

8. Rregullimi makroekonomik në fazën e tranzicionit në ekonominë e Kosovës duhet të bazohet në ekonominë e tregut të lirë, në një kalim gradual drejt taksimit direkt në një periudhë afatmesme, ndërsa opsionet afatshkurtëra përfshijnë forcimin e mëtejshëm të TVSh-së dhe taksës së akcizës.
9. Më qëllim të uljes së papunësisë, në këto kohë të vështira ekonomike, rekomandoj të ulët mosha e pensionit nga 65 në 60 vjeç për sektorin publik, për të krijuar mundësi e hapësirë punësimi për afërsisht 17,000 persona. Sipas Trustit Pensional të Kosovës, në vitin 2014 ishin 17,479 punëtorë në institucionet publike mbi moshën 60 - vjeçare.
10. Të ndalohej punësimi i shumëfishtë në sektorin publik. Ky vendim do të mundësojë të hapen përafërsisht 2,000 vende pune. Sipas Agjencisë Kundër Korrupsionit, në vitin 2014 ishin 1.900 të punësuar në më shumë se një vend pune (Saktësisht: 1,555 persona të angazhuar në dy vende pune, 312 në tre, 33 persona mbajnë katër e më tepër pozita pune në sektorin publik).
11. Të zhvillohet ideja për krijimin e kredive tatimore. Secili biznes që arrin të hapë tre vende të reja të punës brenda një viti fiskal, qofshin ato kompani kosovare apo të huaja, të ketë mundësi të zbrësë detyrimet tatimore vjetore deri në shumën e rrogave të paguara për punëtorët e angazhuar.
12. Të gjitha institucionet financiare që operojnë në Kosovë, rekomandohet të përdorin norma fikse të interesave dhe të jenë të kujdesshëm në kredidhënie, për të ruajtur likuiditetin. Bankat duhet të kenë gjithmonë parasysh perspektivën globale. Kjo do të rezultonte në strategji investimi më të mira, në teknika menaxhimi më të avancuara, në sigurim të cilësisë më të lartë dhe në shërbime më të shumta ndaj klientëve të tyre, posaçërisht ndaj mërgimtarëve dhe parave të tyre.
13. Bankat të krijojnë një produkt të ri për dërgesat e remitencave dhe të shtojnë numrin e degëve apo bankomateve në qendrat rurale, më qëllim të bindjes së emigrantëve që të shfrytëzojnë transferat bankare për dërgesa.
14. Të shqyrtohet mundësia që çdo qytetar që hyn në Kosovë në pikat doganore, të deklarojë shumën e parave mbi 500 € që ka me vete, më qëllim të matjes reale të fuqisë së remitencave dhe luftimit të informalitetit. Aktualisht, me ligj deklarohen vetëm shumat mbi 10.000 €.
15. Nuk duhet pritur që të integrohemi në Bashkimin Evropian për t'i zgjidhur problemet. Duhet e kundërta: të zgjidhim problemet si: varfëria, papunësia, korrupsioni dhe krimi i organizuar, e kjo do të mundësojë një përafrim me BE-në.

6.4. Fusha për kërkime të mëtejshme

Shikuar nga këndvështrimi shkencor, matja e efekteve në fushat e krizës është relativisht e vështirë pasi kemi të dhëna të diskutueshme, forma, lloje dhe indikatorë që merren në konsideratë për të dhënë një mendim të bazuar shkencor. Megjithatë, në këtë punim doktrate janë vendosur disa baza të shëndosha, nga ku mund të kemi një avancim të mëtejshëm kërkimor dhe shkencor. Përdorimi i metodave të avancuara për matjet përmes ekonometrisë dhe aplikimi i serverëve të avancuar, mund të sjellë edhe në rezultate më bindës dhe më të sigurtë. Studiuesit duhet të orientojnë studimet e tyre në të ardhmen që të argumentojnë edhe më shumë dërgesat në fusha të sigurta të investimeve të tyre, e të orientojnë në programe zhvillimore dhe investime të sigurta.

Në këtë punim është hulumtuar dhe analizuar nëse ka pasur efekte kriza financiare në ekonominë e Kosovës, dhe kemi matur se në cilët sektorë të saj ka pasur më shumë ndikim. Por, studiuesit e tjerë duhet të vazhdojnë dhe të arrijnë konkluzione edhe më të argumentuara, të shohin ndikimet e saj direkte dhe indirekte në fushat specifike dhe në ekonominë në përgjithësi.

Sigurimi i një platforme të unifikuar mbi remitencat dhe një kanal më të sigurtë, do të ishte interes i veçantë për hulumtim pasi nga konkluzionet e këtij punimi del se mbi 75 % e të hyrave nga emigrantët janë në rrugë jolegale apo në shërbim të informalitetit.

Investimet e huaja direkte është një fushë mjaft e gjerë dhe pak e hulumtuar në Kosovë, prandaj studiuesit e tjerë duhet të orientojnë në mundësinë e rritjes së këtyre Investimeve dhe sigurimin e kanaleve të reja, që këto investime të shkojnë në shërbim të një ekonomie më të avancuar, si dhe të ndërtojnë një strategji kombëtare për zhvillimin ekonomik.

Do të ishte tepër ideale sikur të krijohet një hulumtim i ri i bizneseve të emigrantëve në vendet e tyre. Të krijohet një bazë e të dhënave që të mund të dihen saktë numri, lloji, mënyra dhe fuqia e investorëve që potencialisht mund të jenë ata ndërmarrësit që e transformojnë ekonominë tonë drejt një ekonomie moderne dhe të konkurrencës së vlerave, pra të jenë bërësit potencialë në procesin e privatizimit në Kosovë.

Prandaj ky punim është një kontribut modest në këtë fushë. Inkurajoj të tjerët të vazhdojnë këtë rrugë dhe të kemi gjithmonë e më shumë studiues të këtyre potencialeve dhe studimeve, edhe pse është për të ardhur keq që tani për tani ata nuk respektohen aq sa duhet nga kompetentët.

BIBLIOGRAFIA

Literatura

- **Angjeli, A.** (2012): Kriza Globale, ajo e Eurozonës dhe Shqipëria, Tiranë
- **Autoriteti i Konkurrencës**, (2007), Politika kombëtare e Konkurrencës, Autoriteti i Konkurrencës
- **Allen, F., Gale, D.** (2000), “Corporate Governance and Competition”, in Xavier Vives (ed.), Corporate Governance, Cambridge: Cambridge University Press.
- **Barajas, A., T. Beck, E. Dabla-Norris, dhe R. Yousefi** (2013): Too Cold, Too Hot, Or Just Right? Assessing Financial Sector Development Across the Globe, IMF WP/13/81
- **Civici, A.** (2010): Kriza Financiare apo globale, UET, Tirane
- **Ebrill, L., M. Keen, J. Bodin, dhe V. Summers** (2001): The Modern VAT, IMF, 2001
- **Engle, R. F., dhe C. W. J. Granger** (1987): Co-integration and Error Correction: Representation, Estimation, and Testing, Econometrica.
- **Fisher, I.** (2011): The Debt - Deflation Theory of Great Depressions, Important Books, USA
- **Shaorshadze, I. & Sachiko M.** (2010), Foreign Remittances and Poverty Reduction in Kosovo, November, 2010
- **Harvey S. R.** (2010): Public Finance, UET Pres, Tirana
- **Heinberg, R.** (2011): The End of Growth: Adapting to Our New Economic Reality, New Society Publishers,
- **Kugler, M., dhe Rapoport H.** (2006): International Labor and Capital Flows
- **Keen, M. dhe Baunsgaard T.** (2010): Tax revenue and (or?) Trade Liberalization, Journal of Public Economics, 94, f. 563-77
- **Luboteni, G.** (2007): Financat e Korporatave, Prishtinë
- **Meka, E.** (2010): Kriza Financiare, përmbledhje analizash dhe ese, Tiranë
- **Merovci, S.** (2008): Tregjet financiare, Prishtinë, Botimi i dytë
- **Mishkin, F.** (1991): Anatomy of a Financial Crisis, Dhjetor 1991
- **Matthew, P.** (2011), Knightian Uncertainty and Interbank Lending, 2011
- **Selmanaj, S.** (2006): Globalizimi dhe Tranzicioni, Prishtinë, 2006.
- **Prasad, N. dhe Gerecke M.** (2010), “Social policy in times of crisis”, Global Social Policy, NY 2014
- **Stiglitz E. J.:** Uspjeh globalizacije. Novi koraci do pravednog svijeta, algoritam, Zagreb, Maj 2009.
- **Stiglitz, E. J.** (2009): Uspjeh globalizacije. Novi koraci do pravednog svijeta, Algoritam, Zagreb

- **Taylor, J. B.** (2008): The Financial Crisis and the Policy Responses: An Empirical Analysis of What Went Wrong, November 2008
- **The Economic Consequences of the Kosovo Crisis:** An Updated Assessment April 16, 1999 IMF/WB
- **The Italy - Albania Remittance Corridor,** Shifting from the Physical Transfer of Cash to a Formal Money Transfer System, March 2006, Bari, Italy
- **Xhepa, S. dhe Agolli, M.,** (2004), Small And Medium - Sized Enterprises Development, Tirana: ISB & ACIT Publications
-

Publikime shkencore dhe raporte

- **Angelini, P., Cetorelli, N.** (2000), "Bank Competition and Regulatory Reform: The Case of the Italian Banking Industry", Bank of Italy Temi di discussione, Nr. 380.
- **Angelini, P., Cetorelli, N.** (2003), "The Effect of Regulatory Reform on Competition in the Banking Industry ", Journal of Money, Credit and Banking, 35(5), 663-684.
- **Akhtar, M. H.** (2010), "X-Efficiency Analysis of Pakistani Commercial Banks" International Management Review, Vol. 6 Nr. 1.
- **De la Torre, A., E. Feyen dhe A. Ize** (2011): Financial Development: Structure and Dynamics, World Bank Policy Research Paper 5854, 2011
- **International Monetary Fund-IMF** (2013): Kosovo, Country Report No. 223, 2013
- **International Monetary Fund-IMF** (2011): Kosova: Reform Proposals Towards a More Balanced and Revenue - Productive Tax System," FAD Technical Assistance Report, 2011
- **IMF (2012): Republika e Kosovës:** Financial System Stability Assessment, IMF Country Report No. 13/99, April
- **IMF (2013): The Boom - Bust of Foreign Bank Flows into CESEE,** Central, Eastern and Southeastern Europe Regional Economic Issues, April 2013
- **Complements or Substitutes,** Economic Letters 94, 155-162
- **Javorcik, B., C. Ozden, M. Spatareanu, C. Neagu (2010):** Migrant Networks and Foreign Direct Investment, Journal of Development Economics 94, 231-241
- **Johansen, Soren** (1991): Estimation and Hypothesis Testing of Cointegration Vectors in Gaussian Vector Autoregressive Models a , Econometrica, 59, 1551–1580.
- **MDA (2014): VLERËSIM BAZË I RAJONIT EKONOMIK JUG,** UNDP dhe Ministria për Punë të Jashtme e Finlandës, Prishtinë
- **Miszlivetz, F.** (2012): Kriza shumëpjesëshe në Europë, International Relations Quarterly, Vol. 3. No. 1, 2012, perkthyer nga Elsa Kryeziu, per me shume shif: http://www.southeast-europe.org/pdf/09/DKE_09_AB_B_Miszlivetz-Ferenc_Elsa-Kryeziu.pdf
- **Mustafa, I.** (2010): Konferenca e nëntë ndërkombëtare “Biznesi dhe punësimi”, Prishtinë

- **Nimani, A** (2014): AFTER WORLD GLOBAL CRISIS, International Journal of Academic Research and Reflection, Vol. 3, No. 1, 2014, ISSN 2309-0405, per me shume shif: <http://www.idpublications.org/wp-content/uploads/2014/10/AFTER-WORLD-GLOBAL-CRISIS-Full-Paper.pdf>"
- **OBEZH, Zyra Statistikore e Komuniteteve Europiane** (Eurostat) (2005), Manuali Oslo: Udhëzime për mbledhjen dhe interpretimin e të dhënave të inovacionit, botimi i tretë, OBEZH, Paris.
- **OBEZH** (2009), Burimet specifike të sektorit për konkurrencën në Ballkanin Perëndimor: rekomandimet për një Strategji Rajonale të Investimeve, OBEZH, Paris.
- **OBEZH** (2010), Strategjia e INovacionit të OBEZH: Nisma e një Fillimi Udhëheqës për të Nesërmen, OBEZH, Paris.
- **OBEZH** (2010), Indeksi i Reformës së Investimit 2010: Politikat e monitorimit dhe Institucionet për Investime Direkte në Evropën Juglindore, OBEZH, Paris.
- **OBEZH** (2011), Rishikimet e Politikës së Inovacionit të OBEZH: Federata Ruse, OBEZH, Paris. OBEZH (2012a), Indeksi i Politikës së NVM-ve: Ballkani Perëndimor dhe Turqia 2012: Progresi në zbatimin e Aktit të Biznesit të Vogël për Europën, OBEZH, Paris.
- **OBEZH** (2012b), Rishikimet e Politikës së Inovacionit të OBEZH: Slloveni, OBEZH, Paris.
- **OBEZH** (2012c), Raporti i OBEZH për Sistemin e Inovacionit të Kroacisë, OBEZH, Paris.
- **OBEZH** (2012d) "Tendencat kryesore në politikën e shkencës, teknologjisë dhe Inovacionit (SHTI) ", Pasqyrë për Shkencën, Teknologjinë dhe Industrinë e OBEZH 2012, OBEZH, Paris
- **Ruli, G.** (2010): KUR PERFUNDON TRANZICIONI? TEORIA KUNDREJT REALITETIT NE RASTIN E SHQIPERISE, Banka e Shqipërisë, 2010, për më shumë shiko: https://www.bankofalbania.org/web/pub/ruli_275_1.pdf
- **Report on the Trade Policym**, Analysis Papers and Related Position Papers Prepared by MTI Officials: Andras Lakatos, Senior Expert, Pristina, 14 janar 2013. 82
- Report on the Trade Policy Analysis Papers and Related Position Papers Prepared by MTI Officials: Andras Lakatos , Senior Expert, Prishtinë, 14 janar 2013
- **Selmani, B.** (2009): Dimensionet e Krizës Financiare Globale, ISN Victory , Trendi Global, Prishtinë, për më shumë shiko: http://www.institutivictory.org/repository/docs /TRENDTI_ GLOBAL_2.pdf
- **The Economic Consequences of the Kosovo Crisis:** A Preliminary Assessment of External Financing Needs and the Role of the Fund and the World Bank in the International Response
- **TRUST** (2010): Raporti vjetor 2010, për më shumë shiko: http://trusti.org/wp-content/uploads/2015/09/2010_Raporti_Vjetor.pdf

- **TRUST** (2011): Raporti vjetor 2011, për më shumë shiko: http://trusti.org/wp-content/uploads/2015/09/2011_Raporti_Vjetor.pdf
- **TRUST** (2012): Raporti vjetor 2012, për më shumë shiko: http://trusti.org/wp-content/uploads/2015/09/2012_Raporti_Vjetor.pdf
- **TRUST** (2013): Raporti vjetor 2013, për më shumë shiko: http://trusti.org/wp-content/uploads/2015/09/2013_Raporti_Vjetor.pdf
- **TRUST** (2014): Raporti vjetor 2014, për më shumë shiko: http://trusti.org/wp-content/uploads/2015/09/2014_Raporti_Vjetor.pdf
- **Swis Cooperation Office in Kosovo** (SCOK 2014): Raporti i Zhvillimit Njerëzor në Kosovë 2014, për më shumë shiko: <http://www.ks.undp.org/content/dam/kosovo/docs/KHDR2014/KHDR2014Albanian.pdf>
- **United Nations Kosovo Team** (UNKT): Njerëzit pas shifrave, 2012, për më shumë shiko: <http://www.undp.org/content/dam/kosovo/docs/UNKT/Njerëz-prapa-shifrave-shqip.pdf>
- **Vrioni, S.:** KRIZA EKONOMIKE GLOBALE-Analizë dhe implikime, Universiteti Aleksandër Moisiu, Durrës, 2013, për më shumë shif: <http://www.uamd.edu.al/new/wp-content/uploads/2013/01/KRIZA-EKONOMIKE-GLOBALE-Analiza-dhe-Implikime-.pdf>
- **World Bank WB** (2010): Kosova-Rishikim i shpenzimeve publike, Raport Nr. 53709-XK
- **World Economic Forum** (2009): The Financial Development Report 2009, për më shumë shif: http://www.reforum.org/docs/WEF_FinancialDevelopmentReport_2009.pdf

Webfaqe dhe burime tjera

- **Angjeli, A.:** Kriza ekonomike e financiare, sfidat e viti 2013, Gazeta Panorama, 06.01.2013, për më shumë shiko: <http://www.panorama.com.al/kriza-ekonomike-e-financiare-sfida-e-vitit-2013/>
- **Autoriteti i Konkurrencës:** Politika Kombëtare e Konkurrencës, 28.12.2006, për më shumë shiko: http://www.caa.gov.al/uploads/publications/POLITIKA_aca.pdf
- **Agjencia e Statistikave të Kosovës** (2011), Seria 3: Statistikat Ekonomike, Tregtia e jashtme 2010, Qeveria e Kosovës, Prishtinë . http://esk.rks-gov.net/ENG/publikimet/cat_view/14-externaltrade
- **Agjencia e Statistikave të Kosovës** (2012), Seria 3: Statistikat Ekonomike, Statistika e tregtisë së jashtme, Dhjetor 2011, Qeveria e Kosovës, Prishtinë. http://esk.rksgov.net/ENG/publikimet/doc_download/1064-external-trade-statistics-december-2012
- **Banka Botërore** (2012): Shoqata ndërkombëtare për zhvillim korporatan ndërkombëtare financiare dhe agjencia shumëpalëshe për garantim të investimeve

strategji e partneritetit me shtetin për Republikën e Kosovës për periudhën vf12–vf15,01.05. 2012, pwr mw shumw shiko: http://siteresources.earthbank.org/KOSOVOEXTN/Resources/297769-1337270502513/Kosovo_CPS_SEC_PO_ALB.Pdf

- **Banka Botërore** (2014): Të bërit biznes, 2014, pwr mw shumw shiko: <http://www.doingbusiness.org/data/exploreeconomies/kosovo>
- **Banka Botërore** (2010), Indikatorët e Zhvillimit Botëror, website, <http://databank.worldbank.org>. Banka Botërore, SMBPN në vështrim 2008 Kosovë, Sondazhi i Mjedisit Biznesor dhe Performancës së Ndërmarrjeve (SMBPN IV), Banka Botërore, Uashington D.C.
- **Banka Botërore**, Korporata Financiare Ndërkombëtare (KFN) (2012), Profili Ekonomik Kosovë, Të Bërit Biznes 2012, Të Bërit Biznes në një Botë më Transparente, Krahësimi i Rregullores për Firmat Vendore në 183
- **Banka Botërore** (2012). Raporti i Të Bërit Biznes 2012, Banka Botërore. <http://www.doingbusiness.org/~media/fpdkm/doing%20business/documents/annualreports/english/db12-fullreport.pdf>
- **Banka Botërore** (2013). Raporti i Të Bërit Biznes 2013, Banka Botërore. <http://www.doingbusiness.org/~media/GIAWB/Doing%20Business/Documents/AnnualReports/English/DB13-full-report.pdf>
- **Banka Botërore** (2012). Raporti i Rregullt Ekonomik i Europës Juglindore Nr. 3, Nga recesioni Double Dip tek Reformat e Përsheptuara, Banka Botërore, http://www.worldbank.org/content/dam/Worldbank/document/SEERER_3_Report_FINAL_en.pdf<http://www.doingbusiness.org/~media/giawb/doing%20business/documents/profiles/country/KSV.pdf>
- **BQK** (2007): Raporti vjetor 2007, për më shumë shiko: <http://bqk-kos.org/repository/docs/2010/Raport%20Vjetor%202007.pdf>
- **BQK** (2008): Raporti vjetor 2008, për më shumë shiko: <http://bqk-kos.org/repository/docs/2010/BQK%20Raporti%20Vjetor%202008.pdf>
- **BQK** (2009): Raporti Vjetor 2009, për më shumë shiko: <http://bqk-kos.org/repository/docs/2010/Raporti%20Vjetor%202009.pdf>
- **BQK** (2010): Raporti vjetor 2010, për më shumë shiko: <http://bqk-kos.org/repository/docs/2011/Raporti%20Vjetor%202010.PDF>
- **BQK** (2011): Raporti vjetor 2011, për më shumë shiko: <http://bqk-kos.org/repository/docs/2013/BQK-RV%202011-shqip.pdf>
- **BQK** (2012): Raporti vjetor 2012, për më shumë shiko: <http://bqk-kos.org/repository/docs/2013/BQK-RV-2012.pdf>
- **BQK** (2012): Raporti i Bilancit të Pagesave, 2012, për më shumë shiko: http://bqk-kos.org/repository/docs/2012/RBP_nr%2011.pdf
- **BQK** (2013): Raporti vjetor 2013, <http://bqk-kos.org/repository/docs/2014/BQK-RV-Shqip-2013.pdf>

- **BQK** (2013): Raporti i Zhvillimeve Makroekonomike, për më shumë shiko: <http://bqk-kos.org/repository/docs/2013/BQK-Makro%202.pdf>
- **BQK** (2013): Raporti i Bilancit të Pagesave, Numër 12, për më shumë shiko: http://www.bqk-kos.org/repository/docs/2013/BQK_BOP_Nr12_2012.pdf
- **BQK** (2014): Raporti vjetor 2014, pwr mw shumë shiko: <http://bqk-kos.org/repository/docs/2015/Raporti%20Vjetor%202014.pdf>
- **BQK** (2014): RAPORTI I STABILITETIT FINANCIAR, Numër 5, pwr mw shumë shiko: http://bqk-kos.org/repository/docs/2014/BQK_2014_FSR%205.pdf
- **CPSS/World Bank** (2007), General principles for remittances, për më shumë shiko: http://siteresources.worldbank.org/INTPAYMENTREMITTANCE/Resources/New_Remittance_Report.pdf
- **Civici, A.:** Revista Bankieri , Nr 2 Janar 2012, pwr mw shumë shiko: http://www.aab.al/bankieri/2/BANKIERI_2_alb_low.pdf
- **Claessens S. & Kose A.** (2013), IMF Working Paper, Research Department Financial Crises: Explanations, Types, and Implications, për më shumë shiko: <https://www.imf.org/external/pubs/ft/ëp/2013/ëp1328.pdf>
- **Čihák M., A. Demirgüç-Kunt, E. Feyen, dhe R. Levine** (2012): Benchmarking Financial Systems around the World (Piketimi i sistemeve financiare në të gjithë botën) , World Bank Policy Research Working Paper 6175
- **Deutsche Welle:** Zhvillim i rrezikshëm - Shkaqet dhe pasojat e krizës ekonomike, pwr mw shumë shiko: <http://ëëë.arkivalajmeve.com/Zhvillim-i-rrezikshëm---Shkaqet-dhe-pasojat-e-krizës-ekonomike.372259/>
- **Erebara, Gj.** (2009): Kosovo has Highest GDP Growth in Balkans, për më shumë shiko: <http://www.balkaninsight.com/en/article/kosovo-has-highest-gdp-growth-in-balkans>
- **Feyen, E. dhe Kibuuka K.** (2013): FinStats 2013: A ready-to-use tool to benchmark financial sectors across countries—User Guide and Benchmarking Methodology (Një instrument i gatshëm për të matur sektorët financiarë në vende të ndryshme — Metodologjia e udhëzuesit dhe vendosjes së pikave referuese) , tetor 2012 (Version 3.0)
- **G-20** (2009), Communiqué, Meeting of Finance Ministers and Central Bank Governors, United Kingdom, 14 March 2009, për më shumë shiko: <http://www.g20.org/English/Documents/PastPresidency/201512/P020151225612935930282.pdf>
- **GAP** (2010-2011): Monitorimi i vendimeve të Qeverisë, dhjetor 2010 -Janar 2011, pwr mw shumë shiko: <http://www.gapmonitor.org/publikimet/20110504094502539.pdf>
- **Hasselbach, Ch.:** Në të ardhmen një rritje ekonomike tjetër" - Barroso rreth temave të takimit të G8, Deutsche Welle, 07.07.2009, për më shumë shif: <http://www.dw.com/sq/n%C3%AB-t%C3%AB-ardhmen-nj%C3%AB-rritje->


ekonomike-tjet%C3%ABr-barroso-rreth-temave-t%C3%AB-takimit-t%C3%AB-g8/a-4461579

- **Llojdia, G.:** Çfarë Është Kriza Financiare Sipas Vlerësimit Shkencor Të Prof. Dr. Adrian Civici, 23.05.2013, për më shumë shiko: <http://gazetadielli.com/cfare-eshte-kriza-financiare-sipas-vleresimit-shkencor-te-prof-dr-adrian-civici/#sthash.c8yOFRk4.dpuf>
- **Merkel, A.**(2012): Eurozona rikthen aleancat e vjetra, 2012, për më shumë shiko: <http://www.telegrafi.com/eurozona-rikthen-aleancat-e-vjetra/>
- **Ministria e Financave** (2011): Raporti i Fondit Monetar Ndërkombetar, 2011, për më shumë shiko: <https://mf.rks-gov.net/sq-al/Raporte/Raporte-dhe-Publikime/Raportet-e-fondit-monetar-nd%C3%ABrkomb%C3%ABtar>
- **Ministria e Tregtisë dhe Industrisë-MTI** (2009): POLITIKA TREGTARE E KOSOVËS, 2009, per me shume shif: http://www.mti-ks.org/repository/docs/PolitikaTregtare_Fin_270809.pdf
- **Moore, K.** (2008): Kriza financiare globale, Radio Evropa e Lirë, 23 dhjetor 2008, për më shumë shiko: <http://www.evropaelire.org/a/1362817.html>
- **Pula, B.** (2013): Opinione, per me shume shif: <https://besnikpula.ëordpress.com/2013/01/03/komponentet-e-rritjes-ekonomike-ne-kosove/>
- **Roubini, N.** (2008): The Rising Risk of a Systemic Financial Meltdown: The Twelve Steps to Financial Disaster, Për më shumë shiko: <http://www.economonitor.com/nouriel/2008/02/05/the-rising-risk-of-a-systemic-financial-metoden-the-tëelve-steps-to-financial-disaster/#sthash.sRVnySri.dpuf>
- **Selmani, B.** (2009): Sa do të zgjasë kriza ekonomike globale, 2009, për më shumë shiko: <http://albanur.eu/showthread.php?t=307>
- **Strauss-Kahn, Dominique** (2009): Shkaqet dhe pasojat e krizës financiare ndërkombëtare, për më shumë shiko: <http://www.arkivalajmeve.com/Shkaqet-dhe-pasojat-e-krizes-financiare-nderkombetare.22138/>
- **UNDP** (2011): Zhvillimi dhe Tranzicioni 5, 2011, për më shumë shiko: <http://www.slideshare.net/ValbonaKacmoli/development-and-transitions-shqip>
- **Vestervelle, G.:** Perspektiva e krizës financiare në Evropë, 2011, për më shumë shiko: <http://albanian.tribuna.com/lajme/item/97449-perspektiva-e-kriz%C3%ABs-financiare-n%C3%AB-evrop%C3%AB>
- **Young, J. T.** (2016), An economy mired in mediocrity, për më shumë shiko linkun: <http://www.washingtontimes.com/news/2016/feb/9/jt-young-obamas-economy-mired-in-mediocrity/?page=all>
- **Zogaj, A.** (2011): Kriza në Eurozonë zvogëlon remitencat në Kosovë, për më shumë shiko: <http://www.evropaelire.org/a/24397436.html>
- **Zyra e Kryeministrit (ZK):** PROGRAMI I QEVERISË SË REPUBLIKËS SË KOSOVËS 2011-2014, për më shumë shiko: http://www.kryeministri-ks.net/repository/docs/Programi_i_Qeverise_shqip_.pdf


ANEKSI 1

NDIKIMI I KRIZËS FINANCIARE GLOBALE, E PARAQITUR PËRMES GRAFEVE

A.1.1. Ndikimi i krizës financiare globale në vendet në zhvillim




A.1.2. Ndikimi i krizës financiare në Kosovë



A 1.3. Diagrami i funksionimit të remitancave

Diagrami i funksionimit të remitancave



ANEKSI 2

EFEKTI I KRIZAVE FINANCIARE GLOBALE NË BIZNESET EKONOMIKE NË KOSOVË

2.1.PYETËSORI

Data _____

Qëllimi i këtij pyetësori është të marrë informacion rreth “Efektit të krizave financiare globale në bizneset në ekonomike në Kosovë”.

Bashkëpunimi juaj është shumë i rëndësishëm dhe do të jetë bazë në punimin tim të doktorates pranë UET-së.

Faleminderit për pjesëmarrjen tuaj në këtë studim.

Pjesa A: Në këtë seksion synohet të merret informacion i përgjithshëm mbi kompaninë tuaj dhe aktivitetin e saj

A1. Rajoni/Komuna: _____

A2. Emri i Kompanisë_____

A3. Madhësia e saj: numri i punonjësve: _____

A4. Viti i krijimit: _____

A5. Cila veprimtari zhvillohet në ndërmarrjen tuaj?

- a) Tregtare b) Prodhuese c) Shërbyese

A6. Cila është pozita juaj në kompaninë ku ju punoni?

1. Menaxher financiar
2. Menaxher i përgjithshëm

A7. Niveli i kualifikimit tuaj (rretho)

- b) Shkolla e Mesme b) Bachelor c) Master d) Doktorate

A8. Qarkullimi vjetor

_____ €

Pjesa B: Mbikqyrja e menaxhmentit

B1: Faktorët formues të qeverisjes së kompanisë (shënoni me X në kuadratin përkatës)

Cilët janë faktorët që formojnë sistemet e qeverisjes së korporatës?	Pajtohem plotësisht(1)	Pajtohem (2)	Neutral(3)	Nuk pajtohem(4)	Nuk pajtohem plotësisht(5)
1. Personalitetet					
2. Pronësia					
3. Modeli themelor i biznesit					
4. Kuadri ligjor dhe kulturor					

B2: A i shton vlerë biznesit sistemi i qeverisjes së kompanisë?(shënoni me X në kuadratin përkatës)

A shton vlerë kompanis suaj top menaxhmenti?	Pajtohem plotësisht(1)	Pajtohem (2)	Neutral (3)	Nuk Pajtohem(4)	Nuk Pajtohem Plotësisht (5)
5. I shton të dhëna të reja zhvillimit dhe zbatimit të strategjisë					
6. Mundëson një bazë të gjerë informacioni, nëpërmjet diversitetit të drejtorëve të cilët testojnë dhe provojnë supozimet në zbatimin e strategjisë?					
7. Siguron zbulimin e hershem të zhvillimeve negative					

Pjesa C: Menaxhimi i riskut

C1: Parandalimi i krizave(shënoni me X në kuadratin përkatës)

Si mund të ndihmojë bordi i drejtorëve parandalimin apo pakësimin e krizës ?	Pajtohem plotësisht(1)	Pajtohem (2)	Neutral (3)	Nuk pajtohem(4)	Nuk Pajtohem plotësisht (5)
8. Përcakton strategjinë e duhur dhe masën e riskut të dëshiruar					
9. Mbikëqyr zbatimin dhe ekzekutimin e sistemeve të menaxhimit të riskut					
10. Shqyrton mjedisin dhe kupton faktorët shtytës të biznesit, në mënyrë që ta ndihmojë për të zbuluar më herët krizën					
11. Eliminon shkaqe të caktuara të krizës së brendshme					
12. Rrit besimin për të ardhmen e kompanisë tek palët e jashtme të interesuara, veçanërisht tek investitorët dhe punonjësit					

C2: Kriza të zakonshme të qeverisjes së kompanisë (shënoni me X në kuadratin përkatës)

Cilat janë llojet e konflikteve ne drejtimin e kompanisë që krijojnë krizat e lidhura me qeverisjen e korporatave?	Pajtohem plotësisht(1)	Pajtohem (2)	Neutral (3)	Nuk Pajtohem (4)	Nuk Pajtohem Plotësisht (5)
13.Aksionarët kundër aksionarëve					
14. Aksionarët kundër menaxhimit					
15. Bordi kundër menaxhimit					
16. Anëtarët e bordit kundër anëtareve te bordit					

C3: Pengesa e vendimmarrjes së shëndoshe(shënoni me X në kuadratin përkatës)

A mendoni se paragrafët e mëposhtëm flasin për tre pengesa tipike te vendimmarrjes se shëndoshe ?	Pajtohem plotësisht(1)	Pajtohem (2)	Neutral (3)	Nuk Pajtohem (4)	Nuk Pajtohe plotësisht (5)
17. Pengesat politike					
18. Pengesat e organizimit					
19. Pengesat psikologjike					

C4: Shenjat paralajmëruese të krizës(shënoni me X në kuadratin përkatës)

Cilat janë shenjat paralajmëruese të krizës?	Pajtohem plotësisht(1)	Pajtohem (2)	Neutral (3)	Nuk Pajtohem (4)	Nuk PajtohemPlotësisht (5)
20. Menaxhimi i lartë shfaq prirje psikologjike në marrjen e vendimeve					
21. Ndryshimet në rregullat e kontabilitetit apo raportime, duke paraqitur një situatë më të favorshme financiare					
22. Hyrjet e parave jo nga operacionet, por nga burimet e pazakonta					
23. Kostot, sidomos ato administrative, rriten me shpejt sesa të ardhurat					
24.Pakënaqësitë e dukshme nëpër klientë					

Pjesa D: Përgjithësia ndaj krizës**D1: Nëse perceptoni apo realisht jeni në krizë cilët hapa i ndërmerri?(shënoni me X në kuadratin përkatës)**

Nëse perceptoni apo realisht jeni në krizë cilët hapa i ndërmerri?	Pajtohem plotësisht(1)	Pajtohem (2)	Neutral (3)	Nuk pajtohem (4)	Nuk Pajtohem plotësisht(5)
25. Pranoni realitetin: jemi në krizë!					
26. Veproni shpejt për të frenuar krizën					

27. Ndryshoni bordin dhe proceset per t'iu përshtatur realitetit të ri					
28. Ndani qartë përgjegjësitë					

D2: Nga kush përbëhet skuadra përgjegjëse për krizën? (shënoni me X në kuadratin përkatës)

Nga kush përbëhet skuadra përgjegjëse për krizën?	Pajtohem plotësisht(1)	Pajtohem (2)	Neutral (3)	Nuk pajtohem (4)	Nuk pajtohem plotësisht (5)
29. Drejtori ekzekutiv/CEO-ja përfshire Drejtorin e financës CFO					
30. Kryetari i bordit					
31. Drejtorët e komitetit të bordit të ngarkuar me përgjigjen ndaj krizës					
32. Këshilltari i përgjithshëm i kompanisë					
33. Këshilltari i jashtëm					
34. Ekspert te industrisë					

Vini re: Nëse mund të jepni “Një mendim tuaj për krizën”

Pyetësori u realizuar me qëllime kërkimore shkencore për arsyetimin e hipotezave në këtë punim Doktorate, Ju, menaxhere dhe drejtuese e keni bartë mbi kurrizin tuaj krizën financiare globale dhe askush më mirë se ju nuk mund të jep një përgjigje të argumentuar.

Ju falënderoj paraprakisht të gjithave për kohën tuaj të çmuar që ndatë për ne!

FALIMINDERIT PËR BASHKËPUNIM !

Më respekt!

Artan Nimani

artannimani@gmail.com

Mobil +37744620720

Zyre +381 390325444

ANEKSI 3

A3.1 Baza e të dhenave mbi pyetsorin e Remitancave

Të dhënat bazë të anketimit mbi Remitancat			
Pyetja 1	A pranoni të ardhura nga bashkëatdhetarët tanë që gjenden në vendet e perëndimit?	Pergjigjet e të anketuarve	
Nr	A pranoni të ardhura nga bashkëatdhetarët tanë që gjenden në vendet e perëndimit?	Numëri	Përqindja
1	Po, gjithmonë	53	26.50
2	Po, ndonjëherë	133	66.50
3	Jo, asnjëherë	14	7.00
	Total	200	100.00
Pyetja 2		Pergjigjet e të anketuarve	
Nr	Nga kush pranoni më së shpeshti të ardhura?	Numëri	Përqindja
1	Familjarët e gjakut	46	23.00
2	Familjarët e fisit	123	61.50
3	Miqtë, shokët	21	10.50
4	Burime tjera	10	5.00
	Total	200	100.00
Pyetja 3		Pergjigjet e të anketuarve	
Nr	Mesatarisht sa të ardhura ju dërgojnë në muaj	Numëri	Përqindja
1	100 – 200 euro/muaj	56	28.00
2	200 – 400 euro/muaj	134	67.00
3	Më shumë se 400 euro/muaj.	10	5.00
	Total	200	100.00
Pyetja 4		Pergjigjet e të anketuarve	
Nr	Dërgesa e të hollave në çfarë menyre bëhet, cila është rruga e dergesave?	Numëri	Përqindja
1	Me para të gatshme, keshe ne dorë	150	75.00
2	Me anë të Western Union dhe agjensive si motra	44	22.00
3	Përmes transfertave bankare	6	3.00
	Total	200	100.00
Pyetja 5		Pergjigjet e të anketuarve	
Nr	Paratë që merrni për cka i përdorni më së shumti?	Numëri	Përqindja
1	Ushqim,veshëmbashtje e gjëra të tjera konsumuese	104	52.00
2	Pagesa të ndryshme	71	35.50
3	Investim në shkollimin tuaj apo të fëmijëve tuaj.	25	12.50
	Total	200	100.00
Pyetja 6		Pergjigjet e të anketuarve	
Nr	A Ka ndikuar Kriza financiare ne dergesa tuaja?	Numëri	Përqindja
1	Po	70	35.00
2	jo, nuk është vërtetë	56	28.00
3	pak	74	37.00
	Total	200	100.00
Pyetja 7		Përgjigja	
Nr	Cilët faktorë mendon që kane ndikuar në uljen e remitancave	Numër	Përqindja
1	Papunësia	20	10
2	Kriza financiare ne vend	89	44.5
3	Ulja e pagese si pasoji e krizës	10	5
4	Bashkimi i familjes, rritja e familjes	53	26.5
5	Shkollimi I fëmijëve	12	6
6	Mungesa e lejes se qëndrimit	9	4.5
7	Rritja e kustosë se jetese	7	3.5
	Total	200	100

[illegible]

A large, stylized blue house with a chimney and a door, positioned on the right side of the page. The house is a simple, cartoonish illustration with a triangular roof, a chimney on the right side, and a door with a handle. It is colored in a solid blue.

Artan Nimani
artannimani@gmail.com
 Mobil +37744620720
 Zyre +381390325444